

Senad Maku

# TRINITETI

Misteri shekullor i krishterimit

Boton: Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës  
Shtëpia Botuese: Dituria Islame - Prishtinë  
Biblioteka: Akaid  
Për botuesin: Mr. Naim Tërnavë

Recensent:  
Dr. Zija Abdullahu

Redaktor gjuhësor:  
Dr. Hysen Matoshi

Përgatitja kompjuterike:  
Bashkim Avdiu

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës



© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ndalohet ribotimi, përkthimi, apo shumëzimi i këtij libri me çfarëdo mënyre, pa lejen me shkrim nga autori, tërësisht apo pjesërisht, me përjashtim të citimeve të shkurtra në artikuj dhe në analiza kritike ose recensione.

Senad Maku

# TRINITETI MISTERI SHEKULLOR I KRISHTERIMIT



Prishtinë 2009



### BIBLA THOTË:

*“Ata e ndryshuan të vërtetën e Perëndisë në gënjeshtër dhe e adhuruan dhe i shërbyen krijesës në vend të Krijuesit, që është i bekuar përjetë”.* (Romakëve 1:25)

*“Do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do t’ju bëjë të lirë”.* (Gjoni 8:32)

### KUR’ANI THOTË:

قُلْ يٰٓأَهْلَ ٱلْكِتٰبِ تَعٰلَوْٓا۟ اِلَىٰ كَلِمَةٍ سَوَآءٍ بَيْنِنَا وَبَيْنَكُمْ اِلَّا نَعْبُدُ اِلَّا ٱللّٰهَ وَلَا نَشْرِكُ  
بِهٖ شَيْئًا وَلَا يَتَّخِذَ بَعْضُنَا بَعْضًا اَرْبَابًا مِّنْ دُوْنِ ٱللّٰهِ فَاِنْ تَوَلَّوْا۟ فَقُوْلُوْا اَشْهَدُوْا بِاَنَّا  
مُسْلِمُوْنَ ﴿١٥١﴾

*Thuaj: “O ihtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do ta adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t’i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!”* (Ali Imran 64)

لَا اِكْرَاهَ فِى ٱلْدِيْنِ قَدْ تَبَيَّنَ ٱلرُّشْدُ مِنَ ٱلْغَيِّ ﴿١٥١﴾

*“Nuk ka detyrim në fe, rruga e drejtë është dalluar shumë qartë nga ajo e padrejta”* (Bekare 256)



## Fjala e recensentit

Feja gjatë historisë ka luajtur një rol esencial në jetën e njeriut dhe ky rol vazhdon të jetë aktual edhe në kohën e sotme, sepse ajo ka qenë, është e do të mbetet pjesë e personalitetit esencial të njeriut në përgjithësi, qoftë si individ, qoftë si shoqëri, kuptohet me pak përjashtime. Këtë e shohim qartë në lidhjen e pashkëputshme të njeriut me fenë, ngase kur përmendet emri njeri, pjesë e pandashme e tij është feja, meqë asnjë gjallesë tjetër fizike nuk është fetare. Këtë nevojë më së miri e ilustrjnë fetë e shpikura, që tregojnë për nevojën e pashmangshme të njeriut për një çështje të tillë, pa hyrë në gjykime për vërtetësisë e saj.

Meqë pozita e fesë në jetën e njeriut është kaq e rëndësishme dhe njeriu, për ta mbushur këtë nevojë, me aftësitë e tij të kufizuara, e sidomos ndaj çështjeve metafizike, shpesh mund të çorientohet e të degradohet nga pozita njerëzore, e gjejmë në mënyrë të pandërprerë përkujdesjen Zotit me anë të shpalljeve, përmes pejgamberëve, që ta vetëdijesojë njeriun në këtë sferë, e të mos humbasë pas besimeve të kota.

Ndonëse shpalljet ishin të njëjta, me kalimin e kohës, u formuan sjellje të ndryshme fetare, si rrjedhojë u formuan kultura të ndryshme. Kështu, hasim edhe fetë e shpallura, si: judaizmi, krishterizmi dhe islami si fe kryesore monoteste në esencën e tyre, me përmasa globale, secila në vete përmban individualitetin e jashtëm dogmatik, që ndryshon nga njëra te tjetra. Për t'i njohur dogmat e njëra-tjetrës është e domosdoshme të formohen njohuritë elementare për secilën prej tyre, pasi çdo religjion ka nevojë për kuptim të drejtë nga të tjerët, ashtu siç e kundron ai veten.

Kjo njohje, pa dyshim, ndihmon në ngritjen e marrëdhënieve ndërkonfesionale, dhe shmangien e veprimeve konfliktuale, nëse jo çrrënjosjen e plotë të

tyre. Pse jo edhe ndihmën e njëri-tjetrit, përmes kësaj njohjeje, për të arritur tek e vërteta e që është synim i çdo njeriu në këtë botë.

Në këtë kah, islami, që nga ditët e para të paraqitjes së tij, është ndeshur me fetë e tjera, së pari me politeizmin që ishte i shtrirë në ato troje, pastaj edhe me fetë e shpallura, përkatësisht me judaizmin dhe krishterizmin. Në këtë kontekst, islamin e hasim si nxitës për njohjen e tjetrit dhe shtrirjen e urës së dialogut me të, por edhe pranimin e tij, ngase vetë dialogu nënkupton pranimin e bashkëjetesës me tjetrin. Madje, ithtarët e feve të shpallura i vlerëson me status të veçantë, duke i quajtur *“ehlel kitab”* “Ithtarë të Librit”<sup>1</sup>.

Mirëpo, luftërat e mëvonshme ndërmjet njerëzve të feve të ndryshme, posaçërisht ndërmjet muslimanëve dhe të krishterëve, do të ndikojnë në gjykimin dhe mënjanimin e islamit \krishterizmit nga ana e krishterëve\ muslimanëve, si nga aspekti doktrinar, ashtu edhe ai politik, e sidomos në Ballkan, ku përherë erzistonte një prapavijë urrejtjeje të ndërsjellë, të shkaktuar nga interesat politike, duke e bërë të afërmin shumë të largët në të gjitha aspektet e jetës, e posaçërisht në atë kulturoro-fetar. Një hov edhe më të madh të kësaj mosnjohje të ndërsjellë në trojet tona ia dha edhe sistemi politik dominues për një kohë të gjatë në Ballkan, gjë që la zbrazëti të thellë në këtë drejtim.

Me ndërrimin e këtyre sistemeve kohët e fundit dhe me ndryshimin e konceptit kulturoro-fetar ndaj tjetrit, pa dyshim se marrëdhëniet mund të përmirësohen duke e njohur tjetrin sa më mirë, e posaçërisht thelbin e besimit, njohjen e besimit të krishterë, e sidomos *trinitetin*, si shtyllë e besimit të krishterizmit, meqë besimi nuk është vetëm fenomen individual, por mbarëshoqëror, i tillë që reflekton në të gjitha aspektet e jetës.

Duke u nisur nga ky këndvështrim, Senad Maku, në veprën e tij *“Triniteti-Misteri shekullor i krishterimit”*, përpiqet që ta bëjë këtë njohje të ndërsjellë, duke u orvatur që ta nxjerrë realitetin ashtu si është, duke qenë i liruar nga paragjykimet. Këtë e pohon në shumë vende dhe duke bërë ballafaqimin e dy besimeve,

---

<sup>1</sup> Shih: Kur’ani: 3: 64, 71, 113, 199; 4: 123, 153, 171, 5: 15, 19, 47, 59, 68, 77; 29: 46]



krishterizmit\islamit për të njëjtën çështje dhe duke ofruar argumentet e të dyja palëve, me një gjykim logjik dhe të arsyeshëm aty ku ka qenë e mundur një qasje e tillë. Pra, punimi është serioz, ngase është bërë duke përfillur metodologjinë shkencore, e cila i ka bërë të mundur autorit që çështjet t'i shqyrtojë me sy kritik, duke i nxjerrë në pah të gjitha aspektet pozitive dhe negative të çështjes së studiuar, të cilat i trajton si të tilla bazuar në shtjellimin e duhur të argumenteve përkatëse.

Fokusimi i Senad Makut në doktrinën e trinisë së shenjtë - për të cilën na ofron njohuri të bollshme, duke e shtjelluar me përpikëri dhe me shumë argumente nga Bibla e Kur'ani - e cila shtrihet në një periudhë kohore shumë të gjatë, duke filluar nga zanafilla e kësaj doktrine, rreth 3000 vjet para e.s., pastaj gjatë kohës së Jezusit e deri në kohën tonë, gjë që e përbën bazën kryesore të besimit të krishterët. I gjithë ky dimension shterues trajtimi flet bindshëm për cilësinë unike të punimit në fjalë.

Në këtë punim autori të nxitë dhe të bën kureshtar që të futesh sa më thellë në analizimin e gjërave deri te zbulimi i së vërtetës, duke qenë sa më objektiv në zgjidhjen e një çështjeje. Kështu, punimi është tërheqës për entuziastët, por, njëkohësisht, edhe nxitës dhe shtytës për studime të mëtejshme që janë aq shumë të nevojshme. Me këtë punim autori i hap horizonte të reja të studimit serioz në aspektin religjioz ndërshqiptar.

Pa dyshim, çështjet e tilla religjioze, sikurse çështja e trinisë, në kontekstin brendashqiptar janë fare pak të analizuara e të studiuar si duhet, ndaj vepra e tillë do ta mbushë një zbrazëti të madhe në këtë lëmë në gjuhën shqipe. Gjithashtu, vepra do ta gjejë vendin e merituar në mesin e lexuesve të rëndomtë, meqë ajo nuk i dedikohet vetëm një niveli të caktuar, por shtresës së gjerë të opinionit, ndaj mund të thuhet lirisht se intenca e shtjellimit të autorit ka qenë që këtë punim ta bëjë të përshtatshëm për çdo lexues, studiues e hulumtues shkencor.

E lusim Allahun xh.sh. ta shpërblejë autorin për këtë vepër, ndërsa ne i urojmë suksese të mëtejshme në këtë drejtim.

*Prishtinë, 02.03.2009*

*Dr. Zija Abdullahu*





*“Me emrin e Allahut, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit të posaçëm”*

## **Parathënie**

Falënderimi i takon Allahut të Madhërishëm, Krijuesit të gjithësisë, ndërsa paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Pejgamberin, Muhamedin s.a.v.s, mbi familjen e tij, shokët e tij dhe mbi pasuesit e tij të ndershëm deri në përfundim të jetës së kësaj bote.

Kur një njeri hulumton dhe studion për një religjion, apo për religjionet në tërësi, puna e tij kërkimore dallon nga të studiuarit që do ta bënte një besimtar për fenë e vet, në këtë rast një i krishterë për fenë e tij. Një ithtar i fesë së vet është i edukuar në atë mënyrë që të besojë se feja e tij është e drejtë, se është një fe e vetme që duhet ta ndjekim, kurse për të të gjitha fetë e tjera janë të kota dhe të rrejshme.

Misionarët e krishterë përpiqen t'i shfrytëzojnë të gjitha mundësitë për t'i bindur të tjerët se si feja e krishterë, apo krishterizmi që ka arritur deri në ditët e sotme, është një fe të cilën duhet ta besojmë, të jemi mbështetës e pjesëtarë të saj, kurse në anën tjetër themeluesit e feve të tjera, sipas kësaj pikëpamjeje, janë njerëz të prishur dhe gënjeshtarë. Më tej, ata, gjatë hulumtimit të tyre, nëse te fetë e tjera hasin ndonjë gjë të përbashkët me fenë e tyre, pohojnë se kjo është një kopje që është marrë nga feja tyre dhe se kjo ngjashmëri është produkt i ndikimit të krishterë.

Ne, si muslimanë, jemi të obliguar që të besojmë në të dërguarit, të cilët kanë ardhur në mesin e popujve ithtarë të librit, e që janë hebrenjtë dhe të krishterët. Ne duhet t'i pranojmë dhe të shprehim respekt ndaj këtyre pejgamberëve, si p. sh.

për: Ibrahimin (Abrahamin), Musanë (Moisiun), Isanë (Jezusin), ashtu sikurse kemi respekt dhe dashuri ndaj peygamberit të fundit Muhamedit (Paqja e Zotit qoftë mbi ta), sepse jemi të urdhëruar nga i Madhi Zot nëpërmjet fjalës së Tij, Kur'anit Famëlartë, që t'i nderojmë të gjithë peygamberët dhe të dërguarit e Tij.<sup>2</sup>

Muslimani - duke u bazuar në mësimet autentike islame, të cilat shpjegojnë originalitetin e fesë hebraike dhe atë krishtere - dëshpërohet kur sheh se si hebrenjtë dhe të krishterët pjesërisht janë larguar dhe i kanë ndryshuar mësimet e vërteta, me të cilat kanë ardhur këta peygamberë, duke devijuar ndjeshëm si nga mësimet e Musait a.s./Moisiut dhe po ashtu edhe nga mësimet e Isait a.s./Jezusit.

Kështu, gjatë kontakteve me grupet joislame, e posaçërisht me ato të krishtere, ballafaqohesha me shumë mësimet të tyre, të cilat ishin në kontradiktë të plotë me ato mësimet të besimit që i paraqet Kur'ani Famëlartë, madje ishin në kundërshtim edhe me një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes biblike dhe veçmas binin ndesh me mendjen e shëndoshë. Sidomos, në këtë drejtim, e tillë është doktrina e trinitetit, e cila në krishterizëm përbën elementin më thelbësor të besimit.

Me qëllim që ta kuptoj sa më mirë këtë doktrinë, që ta njoh sa më gjithanshëm rëndësinë e saj në krishterizëm, ashtu që të mund t'ua sqaroj lexuesve, vendosa ta marrë për studim, në përpjekje për ta vënë në pah të vërtetën e gjithnjë duke u bazuar në Kur'an, në Bibël, në mendje të shëndoshë dhe në kritikën e logjikës.

Ky punim, përveç parathënies, ka tre kapituj.

Në *kapitullin e parë* fillimisht kam bërë fjalë për doktrinën e trinitetit te fetë e tjera, për historinë e saj si doktrinë dhe, në mënyrë të veçantë, për doktrinën e trinitetit siç e besojnë të krishterët.

Më pas, në *kapitullin e dytë*, kam paraqitur këndvështrimin biblik dhe kur'anor ndaj kësaj doktrine, duke i theksuar emrat e saj që e përbëjnë këtë doktrinë,

---

<sup>2</sup> Shih Kur'anin: Bekare 285.

siç janë: Ati, i biri dhe shpirti i shenjtë, duke i elaboruar secilën prej tyre në mënyrë të veçantë sipas citateve biblike dhe ajeteve kur'anore.

Kurse në *kapitullin e tretë* dhe të fundit të këtij punimi i kam shqyrtuar citatet që, sipas të krishterëve, e argumentojnë këtë doktrinë. Pastaj kam trajtuar mendimet e personaliteteve të njohura rreth trinitetit dhe në fund i kam shtjelluar pikëpamjet kur'anore të kësaj doktrine.

Ç'është e drejta, një version me titull "*Doktrina e trinitetit – në mes të vërtetës dhe të pavërtetës*", e kam mbrojtur si punim diplome në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, para komisionit shkencor të këtij fakulteti.

Jam i vetëdijshëm se përpjekjet për ta njohur një çështje nga të dyja anët (nga prizmi islam dhe ai i krishterë), është një punë mjaft e vështirë dhe komplekse. Mirëpo, jam i vetëdijshëm se interesimi për ta njohur këtë doktrinë nga dy pikëvështrime, përbën një obligim me peshë, ngase me këtë sqarohen shumë të pavërteta.

Jam munduar që doktrinën e trinitetit ta paraqes nga këndvështrimi biblik dhe ai kur'anor në mënyrë të mirëfilltë dhe të argumentuar. Duke shkuar nga ajo që së pari ta prezantoj aspektin e krishterizmit, e pastaj aspektin e islamit. Kjo metodë faktikisht edhe na jep pasqyrimin real përkatës, si nga aspekti historik i kronologjisë së paraqitjes të kësaj doktrine, ashtu edhe nga aspekti i ballafaqimit të tyre dhe, në fund, për t'i vënë në pah lajthitjet, të pavërtetat që i kanë ndodhur dhe ia kanë bërë krishterizmit gjatë historisë.

Unë nuk e kam as më të voglin qëllim, as që dëshiroj të lëndoj ndjenjat fetare të shokëve të mi të krishterë, sepse e dua Krishtin (Isanë a.s.), Moisiun (Musanë a.s.), Abrahamin (Ibrahimin a.s.), ashtu siç i dua Muhamedin (s.a.v.s.) dhe të gjithë Pejgamberët, të dërguarit e tjerë të Zotit xh.sh.. Me punimin tim dhe me shkrimet e mia nuk kam për qëllim të shkaktoj zemërim, as të nxis mosmarrëveshje me religjionet e tjera, më së paku me këto krishtere, as që dua të ndjell urrejtje ndaj asnjë besimi, por vetëm (dua) të ftoj për një hulumtim vullnetar dhe miqësor (lidhur me të Vërtetën) dhe që këtë ta bëjnë me ndjenjën e dashurisë e të paanësisë. Nëse të krishterët heqin dorë nga përpjekja e tyre e kotë

për ta përkufizuar esencën e Qenies Superiore (se Jezusi qenka i biri i Zotit, apo edhe Zot) dhe ta pranojnë Njësinë Absolute të Tij (Nuk ka zot tjetër pos Allahut), atëherë bashkimi ndërmjet të krishterëve dhe muslimanëve nuk është vetëm i mundshëm, por jashtëzakonisht i mundshëm. Pra, atëherë le të shikojmë dhe ta studiojmë mirë se ku qëndron e vërteta e të largohemi nga e pavërteta.

Kam bërë përpjekje që punimin ta ilustroj me citate biblike dhe kur'anore, por edhe me komente, sqarime dhe mendime të ndryshme, qofshin ato të autorëve muslimanë, qofshin të krishterë, me qëllim që teksti të dalë sa më i qartë dhe shkencor.

Ajetet e Kur'anit janë marrë nga "Kur'ani - Përkthim dhe komentim" të H. Sherif Ahmetit. Citatet biblike kryesisht janë marrë nga Bibla - Diodati i ri, përkthim 1991-1994, por gjithashtu janë përdorur edhe citate nga Bibla - përkthyer dhe shtjelluar Dom Simon Filipaj, Ferizaj 1994 dhe nga Bibla - Shkrimet e Shenjta, përkthim nga "Bota e Re", Itali, 2006. Kurse nga literatura kam shfrytëzuar burime islame dhe të krishtera.

Në këtë punim - qoftë lidhur me kërkimin e literaturës, qoftë lidhur me procesin e plotësimit të njohurive, duke pasur kontakte me sekte të ndryshme të krishtera - dominon metoda e vëzhgimit të drejtpërdrejtë, apo e dialogut. Kështu që, për brumosjen me njohuri të nevojshme, për objektin e përcaktuar studimor, janë shfrytëzuar libra, enciklopedi, fjalorë të ndryshëm, revista, publikime, por edhe kontakti dhe dialogu personal me grupe të ndryshme krishtere.

Nuk pretendoj se ky punim për tematikën e trajtuar përbën fjalën e fundit, pasi që ka mundësi të diskutohet edhe më shumë lidhur me të, por, gjithsesi, jam munduar t'i paraqes ato që më janë dukur më kryesoret.

E ndiej për borxh që t'i falënderoj të gjithë ata që më ndihmuan në mënyra të ndryshme gjatë këtij punimi, qoftë në gjetjen e literaturës, por edhe ata që më ndihmuan me përkthime nga gjuhë të ndryshme në shqipe. Gjithashtu, falënderim të veçantë u shpreh profesorëve e mi të nderuar që e lexuan punimin, më ndihmuan e më nxitën vazhdimisht me komentet dhe me sugjerimet e tyre të dobishme.

Po ashtu falënderim të veçantë i shpreh edhe Bashkësinë Islame të Republikës së Kosovës që e mundësoi botimin e punimit tim.

Në fund i lutem Allahut xh.sh. ta pranojë këtë punim, e nëse ka ndonjë të metë në të, atëherë kjo vjen nga dija ime e kufizuar e njerëzore. I drejtohem Allahut për falje dhe mëshirë, sepse vetëm mëshira e Tij mund t'i mbulojë të gjitha mangësitë njerëzore. Lus Allahun e Madhërishëm që mundi dhe kontributi ynë të peshojë krahun e djathtë të peshores së veprave tona, në jetën e pasur. Amin!

*Senad Maku*

*Ulqin 2008*





Kapitulli I



# Doktrina e trinitetit dhe historia e saj

## 1. Doktrina e trinitetit te fetë e tjera

Doktrina<sup>3</sup> e trinitetit në krishterizëm konsiderohet elementi kryesor, esencial i besimit. Kjo doktrinë nuk është paraqitur për herë të parë në këtë fe, ngase si e tillë ka ekzistuar që nga fetë e tjera të mëhershme, nga fetë e sajuara, nga fetë pagane<sup>4</sup> dhe ishte një fenomen teologjik dominues në shumë fe të vjetra primitive në Mesdhe. Për shembull, feja egjiptiane, konkretisht origjina, doktrina e saj daton rreth 1700 vjet para Krishtit (p.e.r. = para erës së re); doktrina babilonase rreth 1200 vjet p.e.r.; doktrina siriane daton prej vitit 1160 p.e.r.; doktrina greke prej v. 1100 p.e.r.; doktrina persiane prej v. 400 p. e. r., etj.<sup>5</sup> Kështu, mund të përmendim fenë e vjetër *egjiptiane*, ku ka dominuar triniteti i përbërë prej “*Izisit*”, “*Ozirisit*” dhe “*Horusit*”. Të njëjtën skemë e ndeshim edhe te feja e *sumerëve*<sup>6</sup>: “*An*”, “*Enki*” dhe “*Anlil*”; te feja e vjetër e *Arabisë Veriore*: “*El*”, “*Asirat*” dhe “*Baal*”; te feja

---

<sup>3</sup> Doktrin/ë-a f. sh.-a,-at. Teori shkencore ose filozofike; tërësia e parimeve teorike të një shkence a të një dege të saj. Doktrinë materialiste (revolucionare). Doktrinë idealiste (reaktionare). Doktrinën filozofike (politike). Doktrina e Marksit dhe e Engelsit. (Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980, fq. 356.) Këtu ka të bëjë për doktrinën fetare, teologjike.

<sup>4</sup> Pagan/izëm-mi. Besimi në shumë hyjni a perëndi, formë e lashtë e feve, (por edhe e tashme) para kalimit në monoteizëm. (“*Fj. i gj. së sotme shqipe*”, fq. 1324; shiko më gjerësisht Dr. Ekrem Murtezai, “*Fjalori i feve*”, Prishtinë, 2000, fq. 337; dhe po ashtu tek: Dr. Ivan Cvitković, “*Rječnik religijski pojmovna*”, Sarajevo, 2005, fq. 333)

<sup>5</sup> Dr. Adel Elsaie, “*Please revise the Bible, Again*”, (kapitulli 2: Ancient and Christian Trinities, (fq. 92)), pa vend dhe vit botimi, libër i shkarkuar nga web faqa <http://www.usislam.org/revise/toc.htm>

<sup>6</sup> Religjioni i *sumerëve* është religjion i banorëve parasemitë i periudhës ndërmjet viteve 3000 dhe 1950 para erës së re, që ka përfshirë Mesopotaminë Jugore, në rrjedhën e poshtme të lumit Eufrat dhe Tigër, të cilët atëherë janë derdhur të ndarë në gjirin Persik. Religjioni *sumer* i përket religjionit mesopotamik dhe paraaziatik. Prej 3000-2800 para erës së re *sumerët* u vendosën në jug të Mesopotamisë (toka midis lum-  
enjve). (Gerhard J. Belinger, “*Veliki leksikon religija*”, Beograd, 2004, fq. 380)

e vjetër greke: “Zeus”, “Apollon” dhe “Hera”; te feja e vjetër romake: “Jupiteri”, “Marsi” dhe “Quirinus”.<sup>7</sup>

Këtë e vërteton edhe historiani Will Durant<sup>8</sup>, i cili konstaton: “Idea për trinitetin hyjnor erdhi nga Egjipti”.<sup>9</sup>

Feja *hitite* që i përkiste popullit hitit, gjatë Mbretërisë Hetite (1640 – 1200 p.e.r.), e cila shtrihet në Azinë e Vogël (Turqia e sotme dhe Siria Veriore), besonte në tre zota, të cilët ishin të bashkuar në trini dhe përbëheshin nga i ati “*Teshuba*”, e ëma “*Hepat*” dhe i biri “*Saruma*”.<sup>10</sup>

Në Egjiptin e lashtë feja ishte e mbushur me besime trinitare, edhe pse, kohë pas kohe, paraqitej monoteizmi, por ai ishte vetëm për një kohë të shkurtër.

<sup>7</sup> Sarikçioğlu, “*Baslangıçkan Gunumuze Dinler Tarihi*”, Ipsarta 2000, fq. 32, 45, 60, 81, 85, sipas Qani Nesimi, “*Ortodoksizmi te shqiptarët*”, Tetovë, 2005, fq. 151; lidhur me këtë shih edhe te: Victor Paul Wierwille, “*Jesus Christ is not God*”, Ohio, 1985, fq. 11-12

Në Romën e lashtë e hasim besimin trinitar, siç ishte “*Marsi*”, i cili më pas u bë i njohur si *zot i luftës* dhe muaji mars njihet si muaj i fillimit të vitit dhe të pushtimeve luftarake. Ndërsa zoti i dytë ishte “*Quirinius*”, i cili kishte një fuqi shpirtërore mistere, e që më pas u bashkua me *Romulus*-in, themelues legjendar të Romës. Kurse zoti i tretë ishte “*Jupiteri*”, i cili u shndërrua në zot kryesor. (Shiko: Geoffrey Parrinder, *El-Ukubat ed-Dinije Ledej esh-Shuub* (Besimet fetare ndër popuj), përkth. në arab. Imam Abdulfettah Imam, Kuvajt, 1993, fq. 94-95) Pra, edhe në Romë ishte prezent triniteti, ku dominonte *mitraizmi* si fe pagane. Siç dihet, ngadhënjeu krishterizmi dhe më vonë u afirmua aq shumë sa erdhi edhe u bë fe shtetërore e Perandorisë Romake. “Megjithëkëtë, *mitraizmi* ka lënë gjurma të rëndësishme; kjo shihet veçanërisht nga ndikimi, të cilin *mitraizmi* e ushtroi në fenë krishtere. Shumë pikëpamje e ide e një pjesë e përvojës dhe e praktikës fetare të *mitraizmit* janë inkorporuar në doktrinën dhe praktikën fetare të krishterizmit: përdorimi liturgjik i bukës dhe i verës me rastin e kungimit, asketizmi, kryqi, besimi se *Maria* e ka lindur të birin e saj Jezusin duke qenë dhe duke mbetur e virgjër..., etj.” (Më gjerësisht shih: Dr. Ekrem Murtezai, “*Fjalori i feve*”, fq. 289) Sipas Dr. Zija Abdullahu, “*Hyrye në studimin e feve*”, (punim i pabotuar), fq. 32.

<sup>8</sup> Will Durant, lindi më 5 nëntor 1885, ndërsa vdiq më 7 nëntor 1981 në Los Anxhelos (SHBA). Emri i tij i plotë ishte William James Durant. Ndër veprat e tij veçojmë: *Story of Civilization*, 11 vol. (1935–75); *Philosophy and the Social Problem* (1917); *The Story of Philosophy* (1926) (ky libër është shitur mbi 2.000.000 kopje, brenda tri dekadave, dhe është përkthyer në shumë gjuhë të botës), etj. (Durant, Will, Encyclopædia Britannica 2007 Ultimate Reference Suite. DVD)

<sup>9</sup> “*The Story of Civilization*” Part III, “*Caesar and Christ*”, by Will Durant, 1944, (Simon and Schuster, NY) fq. 595, Sipas “*A duhet të besosh në trinitet*”, fq. 11; shih edhe, M.A.C. Cave, “*Is the Trinity doctrine divinely inspired*”, fq. 25

<sup>10</sup> Gerhard G. Belinger, “*Veliki leksikon religije*”, fq. 135-136.

Xhefri Parinder (*Geoffrey Parrinder*), lidhur me këtë, thotë:<sup>11</sup> “Perënditë më së shumti i tubonin nëpër qendra të adhurimit të ngjashme me Heliopolisin. Mirëpo, atje kishte edhe një radhitje tjetër, ku bëhej tubimi sipas mënyrës së radhitjes së dashurisë familjare, vetëm këtu në aspektin trinitar, vendosej zoti lokal si kryesor, pastaj gruaja e tij dhe në radhë vinte i biri. Kështu, i gjejmë zotat “*Ptah*” “*Sehmet*” dhe “*Nefertum*”<sup>12</sup>, të cilët ishin tubuar në *Menf* (qytet)<sup>13</sup>; po ashtu me këtë radhë ishin tubuar zotat “*Amon*”, “*Mut*” dhe “*Hons*” në një trinitet tjetër. Ishte i tubuar edhe një trinitet i tretë ndërmjet “*Ptah*”-ut, “*Sokaris*”-it dhe “*Osiris*”-it, e që ishin tri perënditë e të vdekurve nga gjinia mashkullore. Është një ngjashmëri mahnitëse ndërmjet teksteve trinitare të *Menfit* dhe trinive të tjera ekzistuese. Dua të them lidhur me shikimin në këtë trinitet si në një zot. Është më se e qartë se këtu e gjejmë një garë të besimit të krishterë në të njëjtën mënyrë. Madje, edhe nëse kemi nevojë për argument, i cili do të na e vërtetonte se kishte një ndikim të caktuar në mënyrën e shprehjes krishtere, ky do të mjaftonte.”<sup>14</sup> Gjithashtu, kemi edhe një trinitet të përbërë nga “*Vajrapani*”, “*Manjusri*”

<sup>11</sup> *Geoffrey Parrinder*; profesor i krahasimit të feve në Universitetin e Londrës. Punoi si prift në kishën protestante. Kaloi një kohë të gjatë në Afrikë, e po ashtu shëtit në shumë vende në Lindjen e Mesme. I studioi fetë e ndryshme dhe botoi rreth tyre më shumë se njëzet libra. Disa nga ata i janë përkthyer në shtatë gjuhë. Ndër veprat e tij më kryesore: “*Fetë tradicionale në Afrikë*”, “*Magia në Evropë dhe Afrikë*”, “*Mesihu në Kur’an*”, “*Fryma e cila nuk zhduket*” dhe “*Njeriu dhe zotat*”. [Të dhënat nga libri i këtij autori: *Besimet fetare ndër popuj*, fq. 429. Sipas Dr. Zija Abdullahu, “*Hyrje në studimin e feve*”, fq. 33.

<sup>12</sup> I pari ishte burri, e dyta gruaja dhe i treti i biri.

<sup>13</sup> *Menf-Memfis*: Qytet në Egjiptin e lashtë, rreth 25 km në jug të Kajros së sotme, afër piramidave të famshme egjiptiane. [Shih: *Enciklopedinë elektronike*: DVD, Enciclopedia Britanica Library 2007, “*Memp-his*”].

<sup>14</sup> *Geoffrey Parrinder*, *El-Ukubat ed-Diniye Ledej esh-Shuub* (Besimet fetare ndër popuj), Kuvajt, 1993, fq. 52; po ashtu shih: Gerhard G. Belinger, “*Veliki leksikon religije*”, fq. 89.

Në studimin e tij gjejmë ndikimin e besimit të *Memfisit* edhe në besimin e lashtë grek, e sidomos që ka të bëjë me “fjalën” “*Logos*”, e cila më pas pati ndikim direkt edhe në krishterizëm, bile në vetë ungjijtë: *Ptah* po ashtu ishte perëndia e krijimit të qytetit *Menf*; i cili ndërkohë quhej *Atë* dhe *Ëmë* në “teologjinë menfisiane”, e që është një dokument i shkëlqyer dhe e tëra është nga shteti i lashtë. Dokumenti thotë se krijimin e botës e ka planifikuar mendja e perëndisë, ndërkaq mjeti i zbatimit ishte “*fjala*”, të cilën e shqiptoi, -kjo ishte një garë çuditëse e besimit grek që u shfaq pas një periudhe të gjatë rreth “*logos-it*” ose “*fjalës së shenjtë*”. (*Geoffrey Parrinder*, *po aty*, fq.47.) Këtu vlen të bëhet një krahasim me Ungjillin e Gjonit, ku

dhe “*Avalokitesvara*”, që e ka formën e trinitetit, tre në një dhe që është një zot i quajtur “*Buda*”. Kështu, kinezët dhe japonezët e adhurojnë *Buden*, por ata e dallojnë duke e quajtur atë “*Fo (Fu)*”. Kur ata e adhurojnë atë, thonë: “*Fo, është një zot, por i paraqitur në tri forma*”.<sup>15</sup>

Doktrinën e trinitetit e kemi edhe në Hinduizëm, fe e sajuar e cila daton që nga shekulli XV para erës sonë. Edhe sot e kësaj dite është një fe e shumicës në Indi. Duke filluar nga shekulli VII p. e. r. kjo fe quhet fe *brahmane-brahmanizëm*, sipas zotit të tyre Brahman.<sup>16</sup> Ky zot, sipas tyre, edhe pse është një, në raport me punën dhe angazhimin konsiderohen tre:

- *Brahma* - zoti që krijon,
- *Vishna* - zoti që mbikëqyr ekzistencën,
- *Shiva* - zoti që shkatërron.

Me këtë qëndrim të indianëve mbi besimin në shumë zota u përhap edhe bindja e trinitetit. Kjo bindje u përhap në shekullin VII para Krishtit (p. e. r.).<sup>17</sup>

Në *Encyclopedia of Religion and Ethics* (Enciklopedia e fesë dhe e moralit), James Hasting shkruan: “Në besimin indian p. sh. ndeshim grupin trinitar të përbërë nga Brahma, Shiva e Vishna; në besimin egjiptian gjejmë grupin trinitar të

---

shihet një përputhshmëri mahnitëse ndërmjet “*fjalës*” në të dy tekstet: “*Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi. Ajo (fjala) ishte në fillim me Perëndinë. Të gjitha gjërat u bënë me anë të saj (fjalës), dhe pa atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë.*” (Gjoni 1:1-3) Sipas, Dr. Zija Abdullahu, “*Hyrje në studimin e feve*”, fq. 33. (Lidhur me këtë citat biblik më gjerësisht shih analizën në kapitullin e tretë të librit tonë.)

<sup>15</sup> Misha'al Ibn Abdullah, “*What did Jesus really say?*”, USA, 2001, fq. 303.

<sup>16</sup> Naim Tërnav, “*Islami, besim i vërtetë dhe fetë e tjera – Akaid 2*”, Prishtinë, 1998, fq. 112.

<sup>17</sup> Po aty, fq. 112-113; Ekziston një legjendë në besimin e hinduizmit lidhur me njëshmërinë dhe trinitinë në të njëjtën kohë. Ajo thotë: Njëherë njëri nga klerikët u drejtua në një faltore ku ndodheshin të tre idhujt: Brahma, Vishna dhe Siva, duke iu drejtuar atyre me këtë pyetje: Cili nga ju është Perëndia e vërtetë? U përgjigjen që të tre; të gjithë ne jemi perëndia e vërtetë; perëndia është një, mirëpo ai shfaqet sipas veprave që i kryen, kush e adhuron njërin nga ne, i ka adhuruar që të tre! Dr. Safvet Hamid Mubarek, “*Hulumtimi mbi fetë*”, fq. 25,- Sipas: Dr. Zija Abdullahu, “*Hyrje në studimin e feve*”, fq. 33.

formuar nga Osirida, Isida dhe Horusi”.<sup>18</sup> Ndërkaq, Sigfrid Morenz, në librin e tij *“Religjioni egjiptian”* konstaton: “Triniteti ishte preokupimi kryesor i teologëve egjiptianë... Tri perëndi janë kombinuar dhe trajtuar si një qenie e vetme, e konsideruar në njëjës. Në këtë mënyrë, fuqia frymore e fesë egjiptiane tregon një lidhje të drejtpërdrejtë me teologjinë e krishterë”.<sup>19</sup>

Në fjalorin frëng gjejmë këtë koment: “Triniteti platonik, që në vetvete është thjesht një rikonstruktim i triniteteve të vjetra, që rrjedhin nga popuj më të lashtë, duket se është triniteti filozofik racional i attributeve, që u dha jetë tri hipostazave, apo personave hyjnorë të mësuar nga kishat e krishtere... Ky koncept filozofik grek mbi trinitetin hyjnor... mund të gjendet në të gjitha besimet e lashta pagane”.<sup>20</sup>

Doktrina të tjera të trinitetit gjejmë edhe te fe të tjera pagane, siç është p.sh.:

*Triniteti babilonas:*

- Ana
- Enli<sup>21</sup>
- Ea

*Triniteti egjiptian:*

- Oziris
- Izis
- Horus



Kamboxhia: hyjni treshe budiste rreth shek. XII të erës së re. (Muzeu Nacional, Francë)



Egjipt: triada e Horusit, Osiridës dhe Isidës, mijëvjeçari II p.e.r. (foto: Muzeu i Luwrit, Paris)

<sup>18</sup> *“Kush është i vetmi Perëndi i vërtetë”*, Zgjuhuni, Revistë mujore, botuar nga Watchtower Bible and Tract Society of New York, shtypur në Itali, nga Dëshmitarët e Jehovait në gjuhën shqipe, Roma, 22 prill 2005, fq. 7; shiko edhe, M.A.C. Cave, *“Is the Trinity doctrine divinely inspired”*, fq. 26

<sup>19</sup> Siegfried Morenz, *“Egyptian Religion”*, 1973, (Cornell University Press, Ithaca, NY) fq. 255; sipas: *“A dubet të besosh në trinitet”*, fq. 11; po ashtu shih edhe, M.A.C. Cave, *“Is the Trinity doctrine divinely inspired”*, fq. 25-26

<sup>20</sup> Maurice Lachatre, *“Nouveau Dictionnaire Universel”*, Paris 1467, Vëll. 1, fq. 1467.

<sup>21</sup> Përveçse Encarta 2009 i vërteton këto doktrina të trinitetit te besimet e tjera që i kam cekur në punim, desha një sqarim lidhur me trinitetin babilonas, që Encarta e përshkruan në këtë mënyrë trinitetin babilonas që e përbëjnë: Ana, Bel dhe Ea. Për më tepër, lidhur me këto shih: Microsoft Encarta Premium 2009 (DVD), me nëntituj: “Trinity” ose “Triad”.

*Triniteti greko-romak:*

- Jupiteri
- Juno
- Menerva

*Triada egiptiane e Ramsesit II:*

- Amon
- Ra
- Nut



Indi: perëndia treshe hinduse rreth shek. VII të erës së re.



Palmira: triada e perëndisë-hënë, zotit të qiejve dhe perëndisë-diell, Rreth shek. I të erës së re.

(foto: Muzeu i Luvrit, Paris)

*Triada palmires:*

- Zoti i hënës
- Zoti i parajsës
- Zoti i diellit<sup>22</sup>

Po ashtu te feja budiste po të studiohet, do të vërejmë se pasuesit e saj arritën në konkludim duke konstatuar se, ai (Buda) nuk ishte njeri i thjeshtë, por njeri në të cilin ishte personifikuar dhe mishëruar shpirti i Zotit. Ky ishte besimi i mishërimit apo personifikimit të cilin më vonë e huazuan edhe të krishterët, kur thanë se Mesihu-Jezusi / Isai a.s. kishte dy personalitete: hyjnore dhe njerëzore. Hyjnorja është mishëruar te njerëzorja, d. m. th. te Jezusi (sipas tyre).<sup>23</sup>

<sup>22</sup> Të gjitha këto doktrina mund t'i gjeni në këto burime: Abuhuraira Abdurrahman, "The bible or the Quran wich one is the word of God?", Malaysia, 2001, fq. 48; M.A.C. Cave, "Is the Trinity doctrine divinely inspired", (pa vend botimi) 1996, fq. 26; dhe Misha'al Ibn Abdullah, "What did Jesus really say?", USA, 2001, fq. 152; Ndërsa fotografitë e paraqitura, janë marrë nga libri "A dubet të besosh në trinitet", grup autorësh, shtypur në Itali, nga Dëshmitarët e Jehovait, botues Watchtower Bible and Track Society of New York, Roma, 1996, fq. 10

<sup>23</sup> Rreth Budës shfleto: "Čovječanstvo u potrazi za Bogom", (Njerëzimi në kërkim të Zotit), grup autorësh, Brooklyn, New York 1995, fq. 159, 160; dhe Dr. Ahmed Shelebi, "Fetë në Indinë e madhe", fq. 170-173. Sipas: Dr. Zija Abdullahu, "Hyrye në studimin e feve", fq. 37.

Ihtarët e Budës e konsiderojnë atë: si djalë të Zotit, shpëtimtarin e njerëzisë nga vuajtjet dhe dhimbjet. Besojnë se Zoti është mëshiruar te virgjëresha nëna e tij Maha-Maja. Ata supozojnë se, kur lindi Buda, në qiell u paraqit një yll si shenjë për lindjen e tij. Me lindjen e tij janë gëzuar ushtritë e qiellit, ndërsa engjëjt kanë kënduar himne për hir të porsalindurit. Buda i tha të ëmës se ai është njeriu më i madh i tërë



Të gjitha këto trinitete na e rikujtojnë çështjen e Jezusit/ Isait a. s. dhe të trinitetë së shenjtë në krishterizmin e sotëm. Kjo na vjen nga fakti se të gjitha këto fe pagane e kanë historinë më të lashtë se krishterizmi, andaj ndikimi i krishterizmit nga ato religjione është i qartë në këtë aspekt. Kjo u vërejt sidomos pasi që Pali e pranoi krishterizmin dhe përfshiu e i shkriu në të disa nga mësimet pagane.

Krishterizmi në formën e vet origjinale ka qenë i njëjti besim në një Zot me të cilin Zoti i ka porositur të gjithë peygamberët e Vet që t'ia komunikojnë njerëzimit. Ishin romakët ata që, kur pranuan krishterizmin, e kishin të vështirë të hiqnin dorë nga zotat e tyre mitologjike dhe të bëheshin monoteistë. Gradualisht këto mite u shkrinë brenda krishterizmit “zyrtar”, si p. sh., paganizmi u pranua nga kisha dhe nga ajo çdo disident shkishërohej.<sup>24</sup>

Këtë madje e pranon edhe vetë pastori i protestantizmit, dr. Fehmi Cakolli: “Si në Judaizëm ashtu edhe në Krishterizëm, mund të gjenden elemente pagane. Nuk mund të pandeh se nuk përmban ndonjë element pagan, përkatësisht pa pasur elemente të religjioneve të tjera”.<sup>25</sup> “Origjina [e trinitetit] është krejtësisht

---

njerëzisë. Thanë gjithashtu që Buda, kur kishte hyrë në tempull, të gjithë idhujt iu përkulën. Ndërsa djalli u orvat që ta mashtronte, atë por nuk mundi. Budës i zbriti një dritë, e cila ia rrethoi kokën dhe nga trupi lëshoi një dritë të madhe, prandaj ata që e shikuan thanë: “Ky nuk është njeri, por një zot i madhëruar”. Kur vdiq Buda thanë se është ngritur në qiell me trupin e tij, pasi që e kreu misionin e tij në tokë dhe përsëri do të kthehet për ta kthyer mbi të paqen dhe bekimin e tij. (Sipas *Enciklopedia e shkurtër për fetë, doktrinat dhe partitë bashkëkohore*, vëll. 2, fq. 769, - Sipas: Dr. Zija Abdullahu, “*Hyrje në studimin e feve*”, fq. 45 ). Ne theksuam disa gjëra me rëndësi lidhur me Budën, ashtu që nëse krahasojmë me Jezusin biblik do të vërejmë një ngjashmëri të plotë mes tyre. Ai që ka pak njohuri se si përshkruhet Jezusi në Bibël, lirisht mund ta bëjë identifikimin e ngjashmërisë ndërmjet tyre dhe ndikimin që e pësoi krishterizmi edhe nga kjo fe pagane-budiste.

<sup>24</sup> Sejjid Kutub, “*Islami dhe paqa universale*”, Tetovë, 2005, fq. 49.

<sup>25</sup> Dr. Georges Houssney, “*Perënditë paraislame të arabëve*”, Prishtinë, 2004, fq. 1 (Parathënia e pastorit Dr. Fehmi Cakolli), po ashtu shih edhe tek: Dan Brown, “*Kodi Da Vinçi*”, Tiranë, 2004, fq. 195-196 (Edhe pse romani i Dan Brownit nuk është vepër shkencore që t'i referohemi, e përmenda në mënyrë që lexuesi ta shohë se si autori e tregon realitetin e kësaj feje të krishterë, shtrembërimin dhe ndikimin pagan në te.)

pagane.”<sup>26</sup> Triniteti i krishterë është një rit pagan, as vetë të krishterët nuk mund ta kuptojnë këtë doktrinë.

Në librin *“Ti afrohemi Jehovahit”* theksohet: “Në shekullin e parë të krishterët patën shumë bekime frymore. Por Jezusi dhe apostujt<sup>27</sup> parathanë se adhurimi i vërtetë do të korruptohej e do të humbiste. (Mateu 13:24-30; Veprat 20:29-30) Pas periudhës apostolike në skenë doli i ashtuquajtur i krishterim. Klerikët e saj përvetësuan mësimet dhe praktikat pagane. Gjithashtu, e bënë gati të pamundur afrimin me Perëndinë, duke përshkruar atë si një trinitet të pakuftueshëm...”<sup>28</sup> Kisha i dha Zotit formë të njeriut dhe njerëzve ua prezantonte Zotin në fizionomi të njeriut. Nën ndikimin e religjionit të krishterë njerëzit, që nga fëmijëria, e paramendonin Zotin në trajtë njerëzore dhe materiale.<sup>29</sup> Kështu, Krishti zot ndodh bashkërisht me njeriun historik të Jezusit nga Nazareti. Pra, vetë Zoti ka qenë i mishëruar në njeriun përgjatë historisë. Fanatizmi është zell i shërbyesve të kishës për t’ua imponuar njerëzve një hyjni me pamje njeriu.<sup>30</sup>

Kryeprifti Scevola nuk donte që popujt të mësonin të vërtetën përse i përket zotave, që besimi i tyre të mos pakësohej, dhe për këtë arsye e gjykonte të drejtë se në çështjet e fesë ishte e domosdoshme t’i mashtrojë.<sup>31</sup>

<sup>26</sup> Arthur Weigall, *“The Paganism in Our Christianity”*, 1928, (G. P. Putnam’s Sons, NY, London) fq. 197; *“A Dictionary of Religious Knowledge”*, edited by Lyman Abbott, 1875, (Harper & Brothers, Publishers, NY) fq. 944.

<sup>27</sup> Apostull-i (gr. Apostolos- i dërguar) - në përgjithësi: lajmëtari, i dërguari, ndërmjetësuesi; ai që është dhënë në mënyrë të sinqertë dhe të zjarrtë pas ndonjë teorie, doktrine, pikëpamjeje, dogme, ideje, etj. dhe që në mënyrë vetëmohuese përpiket për mbrojtjen dhe veçanërisht përhapjen e këtyre ideve apo pikëpamjeve, për të cilat është bindur se janë të drejta, të mira, të arsyeshme dhe të dobishme. (Ekrem Murtezai, *“Fjalori i feve”*, fq. 37.)

<sup>28</sup> Grup Autorësh, *“Ti afrohemi Jehovahit”*, botuar nga Watchtower Bible and Tract Society of New York, shtypur në Romë, 2003, nga Dëshmitarët e Jehovahit, në gjuhën shqipe, fq. 80

<sup>29</sup> Dr. Murteda Mutahhari, *“Shkaqet e animet ndaj materializmit”*, Gjilan, 1997, fq. 27.

<sup>30</sup> Prof. Dr. Bekir Topaloglu, *“Ekzistenca e Zotit”*, Prishtinë, 2002, fq. 189.

<sup>31</sup> De Civitate Dei, IV, 27, sipas Fatmir Cupi, *“Autoriteti dhe saktësia e Shkrimit të Shenjtë”*, Tiranë, 2003, fq. 41-42.

Adhurimi i Perëndive pagane që përbëheshin nga grupe prej tri hyjnish, ose triadat, ishte i përhapur siç përmendëm më lart edhe para se të lindte Jezusi/ Isai a.s.

Historiani Will Durant thotë: “Krishterimi nuk e shkatërroi paganizmin; e adoptoi atë...”<sup>32</sup> Shumë dogma pagane, të trilluara nga egjiptianët e të idealizuara nga Platoni, u mbajtën si të denja për t’u besuar (sipas: *History of christianity*).... ajo u zhvillua dhe iu shartua krishterizmit nga dora e Etërve Platonistë (*The Church of the First Three Centuries*).<sup>33</sup> Influenca e filozofive dhe e religjioneve pagane në Izrael ka qenë po aq e fortë edhe në kohën kur ka jetuar Jezusi/ Isai a.s.. Të gjithë studiuesit e historisë së Izraelit e dinë shumë mirë këtë gjë.<sup>34</sup> Mirëpo, sidoqoftë, triniteti është një doktrinë e korruptuar, e huazuar nga besimet pagane dhe e shartuar në besimin e krishterë.<sup>35</sup>

Kështu, kur e kemi parasysh se kjo hapësirë (Mesdheu) është edhe vendi ku ka jetuar dhe vepruar Shën Pali, i cili edhe ka qenë njohës i mirë i paganizmit, lirisht mund të konkludojmë se triniteti në teologjinë krishtere nuk është diç e re, por, ndoshta, me një formë pak më të ndryshme, ai është bartur nga këto koncepte të feve të vjetra të këtyre vendeve.<sup>36</sup>

Si përfundim mund të themi se teologjia e trinitetit në krishterizëm është një sinkretizëm i koncepteve të feve të vjetra dominuese në rajon, i gnosticizmit dhe i

<sup>32</sup> Will Durant, “*The Story of Civilization*” Part III, “Caesar and Christ”, 1944, (Simon and Schuster, NY) fq. 595, sipas “*A duhet të besosh në trinitet*”, fq. 11; shiko edhe, M.A.C. Cave, “*Is the Trinity doctrine divinely inspired*”, fq. 25

<sup>33</sup> “*A duhet të besosh në trinitet*”, fq. 11; shiko edhe, M.A.C. Cave, “*Is the Trinity doctrine divinely inspired*”, fq. 27.

<sup>34</sup> Shih temën *Pagan sources in the New Testament*, në “*Dictionary of New Testament Background*”, InterVarsity Press, Illinois, 2000, fq. 756-763. Ndërsa Ekrem Murtezai, te: “*Fjalori i feve*”, fq. 567, tregon: “Përfaqësuesi i shkollës së Tybingenit, David Shtraus (1808-1874) është i mendimit se ungjijtë mbështeten në mite e gojëdhëna që qarkullonin nëpër bashkësitë e para krishtere; i këtij mendimi është edhe Artur Shopenhaueri (1788-1860)”.

<sup>35</sup> “*A Dictionary of Religions Knowledge*”, sipas: “*A duhet të besosh në trinitet*”, fq. 11.

<sup>36</sup> Qani Nesimi, “*Ortodoksizmi te shqiptarët*”, fq. 151.

transmetimeve lidhur me Isanë/Jezusin.<sup>37</sup> Në parathënien e Eduard Gibonit, në *History of Christianity*, lexojmë: “Nëse paganizmi u pushtua nga krishterizmi, është po kaq e vërtetë se krishterizmi u korruptua nga paganizmi.<sup>38</sup> Shumë dogma pagane, të trilluara nga egjiptianët dhe të idealizuara nga Platoni, u mbajtën si të denja për t’u besuar”<sup>39</sup>

“Është më se e qartë se triniteti nuk ka një origjinë biblike. Ky kult mund të gjurmohet në Babiloninë e lashtë, te grekët dhe romakët paganë. Ai iu imponua kishës së krishterë nga perandori Kostandin, bindjet e të cilit i mbështetën peshkopët që kishin frikë të flisnin kundër tij. Më pas, kur protestantët u ndanë nga kisha romake, pjesa më e madhe e tyre vazhduan të besonin në doktrinën pagane të trinitetit, sepse ata e kishin pasur atë si pjesë të fesë së tyre për një kohë kaq të gjatë dhe tashmë nuk mund ta hidhnin më poshtë”<sup>40</sup>

Mund të përmendim studiuesin P. Hadot, i cili thotë: “Më shumë se për fundin e paganizmit, duhet të flasim për një shkrimje ndërmjet këtij të fundit dhe krishterizmit. Në fakt, ndonëse pas një lufte të dhunshme politiko-shpirtërore, krishterizmi fitoi mbi paganizmin, e vërteta është edhe se, falë një procesi historik që konfirmon veten e tij në çdo epokë, dy antagonistët, në mes të vlimit të konfliktit, kishin ndotur në mënyrë të ndërsjellë njëri-tjetrin”<sup>41</sup>

Kështu, i shtyrë nga kjo situatë, autori Johannes Lehmann në librin e tij *“The Jesus Report”*, fq. 127, shkruan: “... diskontinuiteti ndërmjet Jezusit historik dhe Krishtit të kishës është bërë aq i madh, sa kurrfarë përbashkësie në mes tyre mund të njihet”<sup>42</sup>

<sup>37</sup> Shinazi Gyndyz, *“Pavlus Hiristijanligin Mimari”*, Ankara, 2001, fq. 102-108, sipas Qani Nesimi, *“Ortodoksizmi te shqiptarët”*, fq. 152.

<sup>38</sup> *“A duhet të besosh në trinitet”*, fq. 11.

<sup>39</sup> Edward Gibbon, *“History of Christianity”*, 1891, (Peter Eckler, No. 35, NY) fq. 14.

<sup>40</sup> Rev. Alexander Hislop, *“The Two Babylons”* 1916. Sipas “Christianity.” *Encyclopædia Britannica 2007 Ultimate Reference Suite*. dhe tek, “biblical literature. (Judaism)” *Encyclopædia Britannica 2007 Ultimate Reference Suite*. DVD.

<sup>41</sup> P. Hadot, *“La fine del paganesimo”*, në, *“Le Religioni del mondo classico”*, (nën kujdesin e H.-C. Puech), Roma-Bari 1987, fq. 295.

<sup>42</sup> Ungjilli sipas Barnabes, përktheu Avdi Berisha, fq. 190.

*Vështro dhe krahaso trinitetin nëpërmjet fotove<sup>43</sup>.*


Triniteti indian



Triniteti i krishterë



Triniteti egiptian



Triniteti brahman



<sup>43</sup> Fotografitë janë të marra nga: *Zgjuhuni*, 22 prill 2005; *A duhet të besojmë në trinitet, Cili është qëllimi i jetës*; dhe nga [www.google.com](http://www.google.com) “Trinity”



Në të majtë: Skulpturë egjiptiane, mijëvjeçari II p.e.s., ku duket triada e Amon-Ra, Ramses II dhe Mut. Në të djathtë: Skulptura trinitare e Jezu Krishtit, Atit dhe frymës së shenjtë (shek. XIV e.s.). Vëre, tre persona, por vetëm katër këmbë.

(Foto: Muzeu i Beaux-Arts de Troyes)



(Foto nga: Muzeu Britanik, dhe Muzeu egjiptian, Torino)



Francë: Triniteti, Indi: Perëndi treshe Itali: Triniteti rreth Triada brahmane Gjermani: Triniteti rreth shek. XIV e.s. indiane rreth shek. VII shek. XV të e.s. rreth shek. XIX e.s.



Babiloni: Triada e Ishtarit, Sinit dhe Shamashit, Mijëvjeçari II p.e.s. (Muzeu Nacional, Francë) Triada budiste Triniteti egjiptian Triniteti i krishterë

## 2. Doktrina e trinitetit të krishterët

“Në emër të Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë”, është kredoja të cilën krishterizmi ia ofron njerëzimit. Kjo është esenca, baza e krishterizmit dhe, po nuk besove e nuk u pagëzove me këtë formulë, nuk je i krishterë. Kjo doktrinë është ndër mësimet më të rëndësishme të kishës. Ajo konsiderohet si shtyllë e teologjisë krishtere.

Trinitet do të thotë: Një Zot që na e ka shfaqur veten me tre persona: me Atin, të birin dhe frymën e shenjtë (shpirti i shenjtë) dhe këta tre persona janë zot i vetëm.<sup>44</sup>

<sup>44</sup> Josh McDowell dhe Don Stewart, “Përgjigje & Argumente”, Albania, 2002, fq. 39; shiko edhe: Dr. Ivan Cvitković, “Rječnik religijski pojmova”, Sarajevo, 2005, fq. 455.

Sipas të krishterëve, mbështetur në citimet biblike që ata i ofrojnë, Zoti ndahet në tre persona: Është një person, të cilin Bibla e quan Atë, pra Zoti Atë: *“Paçi hirë e paqe nga Perëndia Ati...”* (Galatasve 1:3). Personi tjetër është Jezusi, apo i biri, ose “Fjala” e quajtur gjithashtu Zot, duke u argumentuar me citatin biblik te Gjoni 1:1, ku thuhet: *“Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi”*; dhe po ashtu duke e cekur dhe argumentin tjetër që Jezusi ishte i barazuar me Perëndinë: *“...por edhe se thoshte se Perëndia ishte ati i vet, duke e barazuar veten me Perëndinë”*. (Gjoni 5:18) Ndërkaq, personi i tretë i kësaj doktrine është edhe shpirti i shenjtë. ose siç quhet ndryshe fryma e shenjtë, të cilën gjithashtu, në të njëjtën kohë, e konsiderojnë zot: *“Sepse tre janë ata që dëshmojnë në qiell: Ati, Fjala dhe Fryma e Shenjtë; dhe këta të tre janë një”*. (1 Gjoni 5:7)

Pra, mbështetur në tërë këtë, sipas të krishterëve, Zoti i ka tri personalitete dhe, në të njëjtën kohë, është Një Zot. Kurse sa i përket nënës së Jezusit, Maria e Virgjër të cilën e ka lindur Jezusin, konsiderohet Nëna e zotit.<sup>45</sup>

Kisha ortodokse autoqefale shqiptare, sikurse edhe kishat e tjera ortodokse, Marinë e njeh si lindëse e zotit (theotocos). Në historinë e krishterizmit, që prej shek. V diskutohet çështja nëse Maria e ka lindur Jezu Krishtin zot, apo Jezu Krishtin njeri. Shën Cyrilli<sup>46</sup> nga Aleksandria thotë: “Nëse Jezu Krishti është zot, atëherë edhe virgjëresha e shenjtë (Maria), e cila e ka lindur atë është theotocos – nëna e Zotit. Prandaj, mendimi i pranuar nga ortodoksët është se Maria ka lindur zot dhe kështu është nëna e zotit”<sup>47</sup>.

Kisha katolike e Romës pohon: “Triniteti është termi i përdorur për të përcaktuar doktrinën qendrore të fesë së krishterë... Pra, me fjalët e Kredos Atanasiane: Ati është perëndi, Biri është perëndi dhe Fryma e Shenjtë është perëndi, e

<sup>45</sup> Don Nosh Gjolaj, *“Meditime për Trininë e Shenjtë”*, Prishtinë, 1999-2000, fq. 17.

<sup>46</sup> Shën Cyrilli, ka lindur në vitin 375, ndërsa ka vdekur më 27 qershor 444. Ka qenë teolog i krishterë dhe peshkop. (“Cyril of Alexandria, Saint.” *Encyclopedia Britannica. Encyclopedia Britannica 2007 Ultimate Reference Suite*. DVD).

<sup>47</sup> Popović, *„Dogmatika Pravoslavne Crkve”*, v. II, fq. 233; sipas Qani Nesimi, *„Ortoksizmi te shqiptarët”*, fq. 165-166.



megjithatë nuk janë tri perëndi, por një perëndi. Në këtë Trinitet... personat janë njësoj të përhershëm e të barabartë: në mënyrë të njëjtë të gjithë janë të pakrijuar e të plotfuqishëm”.<sup>48</sup>

Me këtë përcaktim janë të pajtimit pothuajse të gjitha kishat e tjera të të ashtuquajturit krishterim, p.sh. kisha ortodokse greke e quan trinitetin “Doktrinë themelore të krishterizmit”, madje thotë: “Të krishterët janë ata që e pranojnë Krishtin si perëndi”. Në një libër mbi ortodoksinë, po kjo kishë thekson: “Perëndia është Trini... Ati është tërësisht perëndi. Biri është tërësisht perëndi. Fryma e Shenjtë është tërësisht perëndi”.<sup>49</sup>

Pra, doktrina e trinitetit tregon se ekziston një Zot në tre persona, secili prej të cilëve është hyjni, pa fillim, i plotfuqishëm, as më i madh e as më i vogël se të tjerët. Ky formulim gjithnjë e ka hutuar lexuesin, qoftë ai i krishterë ose jo, dhe e ka nxitur të pyes i habitur: Si është e mundur që Ati të jetë zot, i biri të jetë zot, shpirti i shenjtë të jetë zot, e, ndërkaq, të mos i kemi tre zota, por një?!

Dijetarët e teologjisë biblike ndër shekuj janë munduar t’i japin një përgjigje të kënaqshme kësaj pyetjeje dhe shumë të tjerave të ngjashme me këtë, të cilat vinin në pah pamundësinë logjike të një doktrine të tillë. Mirëpo, çdo tentativë ka përfunduar duke krijuar gjithnjë e më shumë habi e pëshëjellim.

### 3. Historia e doktrinës së trinitetit në krishterizëm

Isai a.s./ Jezusi ishte njëri ndër peygamberët e zgjedhur të Allahut xh.sh., ishte një nyjë në zinxhirin e gjatë të peygamberëve prej Ademit a.s./Adamit e deri tek i dërguari i fundit Muhamedi s.a.v.s., të cilët Zoti i dërgoi që t’ua përcjellin mesazhin e Tij, njerëzve, kombeve të ndryshme sa herë që ata kishin nevojë për një udhëheqje, apo sa herë që devijonin nga mësimet e Zotit xh.sh.

<sup>48</sup> The Catholic Encyclopedia; sipas grup autorësh, “*A dubet të besosh në trinitet*”, shtypur në Itali, nga Dëshmitarët e Jehovahit, botues Watchtower Bible and Track Society of New York, Roma, 1996, fq. 3.

<sup>49</sup> Our Orthodox Christian Faith; sipas “*A dubet të besosh në trinitet*”, fq. 3.

Izraelitët, të cilët kishin devijuar nga mësimet e Musait a.s./ Moisiut dhe të dërguarve të tjerë që u kishin ardhur atyre dhe të cilët e braktisën rrugën e drejtë e besimin e pastër që ua kishin treguar pejgamberët e Zotit.

Allahu xh.sh. përgatiti në mënyrë të veçantë Isanë a.s./ Jezusin për ta vazhduar misionin e pejgamberëve të tjerë para tij, duke i thirrur njerëzit në rrugën e drejtë dhe besimin në një Zot e duke i larguar nga rruga e shtrembër, idhujtaria.

Dyzet vjet pas Isait a.s./ Jezusit, romakët e pushtojnë Jerusalemin. Një pjesë të hebrenjve i vranë, kurse një pjesë tjetër i zunë robër. Torën dhe librat e tjerë, pothuajse që të gjithë, i dogjën. Jerusalemin e kthyen në gërmadhë, ndërsa pasuesit e Isait a.s./ Jezusit u shpërndanë gjithandej dhe nisën ta përhapnin fenë e Jezusit, fenë e pastër dhe besimin në një Zot.<sup>50</sup>

Pas kësaj, hebrenjtë u bashkuan me romakët, grekët dhe idhujtarët për ta luftuar fenë e Jezusit/ Isait a.s. Madje, në rastet kur i kapnin pasuesit e Isait a.s./ Jezusit i nxirrnin në arena për t'i shqyer luanët. Çifuti (hebreu) Dhunuvas dhe njerëzit e tij i hidhnin të krishterët e Nexhranit, të cilët s'e pranonin hebraizmin, në hendeqe me zjarr dhe i sodisnin teksa digjeshin. Megjithatë, besimtarët që i qëndruan besnikë të Isait a.s. nuk hiqnin dorë prej besimit dhe, për çështjet e tyre, shkonin pa frikë drejt e në zjarr.<sup>51</sup> Në Kur'anin e Madhëruar këta quhen "Shokët e Hendekut", për të cilët Allahu xh.sh. thotë:

وَالسَّمَاءِ ذَاتِ الْبُرُوجِ ﴿١﴾ وَالْيَوْمِ الْمَوْعُودِ ﴿٢﴾ وَشَاهِدٍ وَمَشْهُودٍ ﴿٣﴾ قَتَلَ أَصْحَابُ  
 الْأَحْدُودِ ﴿٤﴾ النَّارِ ذَاتِ الْوَقُودِ ﴿٥﴾ إِذْ هُمْ عَلَيْهَا قُعُودٌ ﴿٦﴾ وَهُمْ عَلَىٰ مَا يَفْعَلُونَ  
 بِالْمُؤْمِنِينَ شُهُودٌ ﴿٧﴾

"Pasha qiellin me plot yje, Pasha ditën e premtuar, Pasha atë që dëshmon dhe atë që dëshmohet! Mallkuar qofshin ata, të zotët e hendeqeve, të zjarrit me plot lëndë djegëse, kur ata rrinin ulur rreth tij dhe dëshmonin atë që bënin me besimtarët". (Burruxh 1-7)<sup>52</sup>

<sup>50</sup> Osman Nuri Topbash, "Vargu i profetëve 3", Stamboll, 2004, fq. 210-211.

<sup>51</sup> Ismail ibën Kethiri, "Tefsirul Kur'anil Adhim", Vol. 4, Bejrut, 1969, fq. 494.

<sup>52</sup> Citimet e Kur'anit në gjuhën shqipe janë marrë nga Kur'ani-Përkthim me komentim i H. Sherif Ahmetit dhe nga Kurani i madhërisëm, përkthyer nga Hasan I. Nahi.

Nxënësit dhe ndjekësit e fesë së Jezusit/ Isait a.s. u keqtrajtuan në mënyra të ndryshme e më barbare nga ana e hebrenjve. Kështu, në mesin e hebrenjve ishte edhe hebreu me emrin Pali (që në hebraishte quhej Saulo<sup>53</sup>). Pali ishte fanatik çifut, madje shumë aktiv, i cili, si pjesëtar i “racës së zgjedhur”, nuk dëshironte të dëgjonte se në Palestinë ishte paraqitur një profet, që pretendonte të ishte Mesia. Shkurt, u bë kundërshtar i reptë i Jezusit dhe fanatik i madh kundër pasuesve të tij, i palodhur në dëmtimin dhe mizorinë e tyre. Në fund, protagonisti kryesor i transformimit të sektit hebraik në religjion botëror.<sup>54</sup>

Keqtrajtimin që e kanë bërë Pali dhe të tjerët e tregojnë Veprat e apostujve 26:9-11, ndërsa për këtë dëshmojnë vetë fjalët e Palit, i cili tha:

*“Unë vetë mendova se ishte detyra ime të bëj shumë gjëra kundër emrit të Jezusit Nazarenas. Dhe këtë kam bërë në Jerusalem; mbasi kam marrë pushtet nga krerët e priftërinjve, futa në burg shumë shenjtorë dhe, kur i vrisnin, jepja miratimin tim. Dhe shpesh, duke shkuar nga një sinagogë te tjetra, i kam detyruar të blasfemojnë dhe, me zemërim të madh kundër tyre, i kam përndjekur deri në qytetet e huaja”.*

Në një vend tjetër tregohet edhe mënyra e vrasjes së Stefanit në prani të Palit dhe miratimi i tij për vrasje të tilla:

<sup>53</sup> Claude Tresmontant, “Shën Pali”, Prizren 1999, fq. 3.

<sup>54</sup> “The Jesus report”, Johanes Lehman, fq. 128, sipas Hajrudin Muja, “Krishterimi Paulian”, shih tek webfaqet: [www.zeriislam.com](http://www.zeriislam.com) dhe [www.bibladhekurani.com](http://www.bibladhekurani.com).

Më vonë Pali do të fillonte të shkruante letra të shumta nëpër qytet, duke i ftuar njerëzit në fenë e re, fenë e Palit që hyjnizon Jezusin, lejon të ndaluarën dhe anëtarësohet në grupin fanatik, që më vonë do ta marrë emrin kristian. Se çfarë bëri ai, afërsisht një dekadë pas konvertimit, mbetet mister, sepse as letrat e tij, as Veprat e apostujve nuk thonë gjë të qartë.

Në letrat e tij, ai ngatërronte idhujtarinë romake dhe filozofinë greke me doktrinat e fesë së re, ashtu që t'i përshatet idhujtarisë së Perandorisë Romake, që ishte bërë traditë e tyre. Kështu, kur ai vërejti se romakët nuk bëhen synet, edhe vetë e ndaloi synetinë; kur pa se ata vetë e hanë mishin e derrit dhe ndalimet tjera, ai ua lejoji ato; kur pa se ata besojnë në shumë zota dhe në bijtë e tyre, shpalli hyjninë e Jezusit dhe tha se ai është i biri i Zotit, por edhe zot. Me këtë ai punoi për afrimin e krishterizmit me idhujtarinë pagane të Romës dhe me filozofinë greke, prandaj romakët nuk u kristianizuan, por të krishterët u romanizuan. Një numër i madh i dijetarëve dhe i historianëve të krishterë besojnë se Pali e pranoi kristianizmin që ta devijojë me dinakërinë e tij. Në Romë ai qëndroi dy vjet. U arrestua dhe u burgos në burgun romak, u gjykua me vdekje në gjyqin e Neros dhe u ekzekutua me shpatë, tre mile larg Romës, në vitin 67 apo 68. (Hajrudin Muja, “Krishterimi paulian”)

*“Dhe, si e nxorën jashtë qytetit, e vranë me gurë. Dëshmitarët i vunë rrobat e tyre te këmbët e një djaloshi, të quajtur Saul (Pal). Kështu e vranë me gurë Stefanin”.* (Veprat e apostujve 7:58-59)

*“Por Sauli e kishte miratuar vrasjen e tij. Në atë kohë u bë një përndjekje e madhe kundër kishës që ishte në Jerusalem; dhe të gjithë u shpërndanë nëpër krabinat e Judesë dhe të Samarisë, me përjashtim të apostujve... Por Sauli po shkatërronte kishën: hynte shtëpi më shtëpi, merrte me vete burra dhe gra dhe i fuste në burg”.* (Veprat e apostujve 8:1,3)

*“Atëherë unë thashë: “O Zot, ata e dinë vetë se unë burgosja dhe rrihja nga një sinagogë te tjetra ata që besonin në ty; kur u derdh gjaku i Stefanit, dëshmorit tënd, edhe unë isha i pranishëm, e miratoja vdekjen e tij dhe ruaja rrobat e atyre që e vrisnin”.* (Veprat e apostujve 22:19-20)

Ndërkohë, ai përndiqte edhe dishepujt e tjerë. *“Ndërkaq Sauli, duke shfryrë akoma kërcënime dhe kërdi kundër dishepujve të Zotit”.* (Veprat e apostujve 9:1)

Hebrenjtë nuk u kënaqën me keqtrajtimin e të krishterëve, ata bënë plane për ta zhdukur fenë e Jezusit/ Isait a. s. me rrënjë. Pali pasi që ishte edhe njëri që i sulmonte dhe bënte çmos për ta asgjësuar fenë e Jezusit, hynte nëpër shtëpi, merrte burra e gra dhe i dorëzonte në burgje, i keqtrajtonte në të gjitha mënyrat.

Sipas studiuesit Ibn Hazmi<sup>55</sup>, lidhur me persekutimet dhe ndodhitë që janë zhvilluar, thekson se të krishterët kanë humbur një pjesë të rëndësishme të teksteve origjinale biblike për disa arsye. Për shembull, numri i besimtarëve kur Jezusi/ Isai a.s. përhapte porosinë e tij, ishte i paktë; fshehtësia e besimtarëve rreth besimit dhe fesë së tyre; presioni që bëhej kundër të krishterëve rreth besimit dhe fesë së tyre nën shtypjen pas Jezusit/ Isait a. s. Këto ishin disa nga arsyet që e shkakton

<sup>55</sup> Ibn Hazmi, i lindur më 7 nëntor 994, në Kordovë (Kalifati i Kordovës), ndërsa vdiq më 15 gusht 1064. Me profesion ishte historian, jurist dhe teolog, studiues i feve, i shkollave të mendimit, i cili, duke i shfrytëzuar librat e dijetarëve të krishterë dhe hebrenj, i ka kritikuar mësimet e tyre. Emri i tij i plotë ishte, Abu Muhammad Ali ibn Ahmad ibn Said Ibn Hazm; sipas, “Ibn Hazm” Encyclopedia Britannica. Encyclopedia Britannica 2007 Ultimate Reference Suite. DVD.

humbjen e teksteve origjinale (të shpallura). Besëlidhja e Re e tashme nuk është ajo që i është zbuluar Jezusit.<sup>56</sup>

#### 4. Pali - arkitekti i krishterizmit

Një ditë Palit, duke udhëtuar për në Damask, në rrugë i shndriti një dritë prej qiellit, ndërsa ai u rrëzua për tokë dhe dëgjoi një zë që i tha: “Saul, Saul, pse po më salvon?” Ai e pyeti: “Kush je ti, zotëri?” E ai i tha: “Unë jam Jezusi që ti e salvon...! Pastaj Pauli u mbush me shpirtin e shenjtë dhe filloi prej atij momenti që ta predikonte fenë e Jezusit dhe kështu nuk i keqtrajtoi më ndjekësit e Jezusit.

Kjo ishte mënyra e vetme, sipas së cilës, kinse, Palit iu dëftua Jezusi dhe filloi ta pasonte atë; përkatësisht ishte mënyra e vetme që ta shtrembërojë fenë e Jezusit/ Isait a.s. dhe ta fitonte besimin e atyre që e ndjekin atë.

Historinë e Palit dhe paraqitjen e Jezusit para tij në formë drite e përshkruajnë edhe Veprat e apostujve. Këtu vërejmë një kontradiktë të madhe që na mbjell dyshim nëse kjo ngjarje është e vërtetë apo jo, sipas Biblës, ku thohet në Veprat e apostujve 9:3-4,7:

*“Por ndodhi që, ndërsa po udhëtonte dhe po i afrohej Damaskut, befaz rreth tij vetëtiu një dritë nga qielli. Dhe, si u rrëzua përtokë, dëgjoi një zë që i thoshte: “Saul, Saul, përse më përndjek?”... Dhe njerëzit që udhëtonin me të ndaluan të habitur, sepse dëgjonin tingullin e zërit, por nuk shikonin njeri”.*

Shih po ashtu në të njëjtin libër, Veprat e apostujve 22:6-9:

*“Dhe më ndodhi që kur isha duke udhëtuar dhe po i afrohesha Damaskut, aty nga mesi i ditës, papritmas një dritë e madhe nga qielli vetëtiu rreth meje. Dhe unë rashë përdhe dhe dëgjova një zë që po më thoshte: “Saul, Saul, përse më përndjek?” Dhe unë u përgjigja: “Kush je ti, o Zot?” Edhe ai më tha: “Unë jam Jezus Nazareasi,*

<sup>56</sup> “*Ibën Hazm Al-Andalusi dhe vështrimet e tij mbi doktrinën e trinitisë*”, Muhamed Uruçi, Takvim, 2003, Prishtinë, 2003, fq. 92-93.

*të cilin ti e përndjek”. Edhe ata që ishin me mua e panë dritën dhe u trembën, por nuk dëgjuan zërin e atij që më fliste”.*

Këtu shihet qartë mospërputhja ndërmjet fjalëve të të njëjtit libër. A mund të jemi të sigurt se burimi i këtyre rrëfimeve kontradiktore është Zoti? Natyrisht, se jo. Në kapitullin e 9, vargu 7, thuhet se njerëzit që udhëtuan me Palin e dëgjuan zërin, por nuk panë asnjë njeri, kurse në kapitullin e 22-të, vargu 9, tregohet e kundërta e kësaj, ata e panë dritën e personit me të cilin fliste Pali, por nuk dëgjuan asnjë zë. Kjo histori na lë në dyshim nëse ishte apo nuk ishte e vërtetë. Përkitazi me këtë ngjarje ish-prifti Anselm Tormedi<sup>57</sup> i shek. XIV, thotë se ky tregim lidhur me Palin është një gënjeshtër, një trillim.<sup>58</sup>

<sup>57</sup> Anselm Tormedi ka lindur në një familje të krishterë në Spanjë, në qytetin Palma de Majorka, nga fundi i shekullit XIV. Pas shkollimit shumëvjeçar dhe veprimtarisë së tij si klerik, në vitin 1420 e përqafoi islam. Pasi e pranoi fenë islame, e ndërroi emrin dhe u quajt Abdullah et-Terxhumani. Ai shkroi veprën e tij të njohur *“Tuhfetul-erib fir-reddi ala ehli-salib”*, ku flet, për jetën dhe rrugën e vet në islam, kurse më tutje, në mënyrë kritike, e shqyrton konceptin mbi krishterizmin. Para gjashtë shekujsh kjo ngjarje bëri bujë të madhe, sepse Kisha atëkohë ishte në kulmin e fuqisë dhe të inkuizionit të saj. Për fat të mirë këtë veper të këtij ish-klkeriku, e kemi të përkthyer edhe në gjuhën shqipe, të titulluar si *“Rruga e Prifit në Islam”*, të cilën nga gjuha boshnjake e përktheu Shaqir Ismaili, botuar nga shtëpia botuese El-Kelimeh, Novi Pazar, 2006. (biografi e marrë nga libri i tij *“Rruga e Prifit në Islam”*, fq. 5).

<sup>58</sup> Për më tepër lidhur me këtë ngjarje shih: Abdullah et-Terxhuman, *“Rruga e Prifit në Islam”*, Novi Pazar, 2006, fq. 57-58.

Mirëpo çfarë ishte në realitet kjo dritë që e pa Pali. A ishte ajo një vegim i tremë i Jezusit? A mund të ishte ajo një dritë prej ndonjë demoni ose fryme të Satanait. Meqë Jezusi profetizoi se kush thotë se më ka parë në shkretëtirë mos u besoni (*Pra, në qoftë se ju thonë: “Ja, (Jezusi) është në shkretëtirë”, mos shkoni atje: “Ja, (Jezusi) është në dhomat e fshehta”, mos u besoni”. (Mateu 24:26)*), atëherë kush ishte ai që e mashtrou Palin. Sipas Palit, Satanai shndërrohet dhe në engjell drite:

*“Të tillë apostuj të rremë, janë punëtorë hileqarë, që shndërrohen në apostuj të Krishtit. Dhe nuk është për t’u çuditur, sepse Satanai vetë shndërrohet në engjell drite”. (2 Korintasve 11:13-14)*

Nga e dinte Pali se engjëlli i satanait shndërrohej në engjell drite? Pali deklarou se ai dinte edhe se Jezusi ishte ngritur në të tretin qiell, por një engjell i Satanait i binte me grushte për të mos e treguar të vërtetën.

*“Unë njoh një njeri në Krishtin, i cili, para katërmëdhjetë vjetësh (a ishte në trup, a ishte jashtë trupit, nuk e di; Perëndia e di), u rrëmbye gjer në të tretin qiell. Dhe e di se ai njeri (a me trupin ose pa trupin, nuk e di, Perëndia e di), u rrëmbye në parajsë dhe dëgjoi fjalë të patregueshme, që nuk është e lejuar të thuhet nga njeri. Për atë njeri unë do të krenohem, por nuk do të krenohem për veten time, veç se për dobësitë e mia. Edhe sikur të doja të krenohesha, nuk do të isha i marrë, sepse do të flisja të vërtetën; por nuk e bëj këtë, se mos ndonjë më çmon më tepër nga ajo që më sheh, a më tepër nga ajo që dëgjon nga unë. Dhe, që të mos më rritet mendja për*

Kjo histori përmban edhe kundërthënien të tjera. Përderisa tek kapitulli i 29 i Veprave të apostujve është thënë se Pali i mori udhëzimet për misionin e tij te johebrenjtë nga Jezusi gjatë vizionit, kurse te kapitulli i 22-të i Veprave të apostujve thuhet se pas vizionit Pali shkoi në Damask, u kthye në Jerusalem dhe vetëm atëherë i pranoi instruksionet për misionin e tij. Gjithashtu, një kundërthënie tjetër gjendet se te Letrat e galatasve, ku Pali pohon se ai nuk u kthye direkt në Jerusalem nga Damasku (siç është pohuar te Veprat, 22) por priti për tre vjet të plotë para se ta bënte këtë.<sup>59</sup> Pra, Pali pohon se, pas konvertimit të tij rrugës për në Damask, nuk ka shkuar në Jerusalem për të parë ata që ishin apostuj para tij (Galatasve 1:16-17), ndërkohë që në librin e Veprave thuhet se ikja në Jerusalem ishte gjëja e parë që ai bëri pasi e la Damaskun (Veprat 9:26).<sup>60</sup>

Në Veprat e apostujve (23:6), Pali thotë se ishte farise bir fariseu. A thua, Jezusi zgjodhi një farise për t'ia dhënë vizionin e tij, kurse në Ungjillin e Mateut (23:15) për Jezusin farisenjtë ishin hipokritë, fëmijët e ferrit!!

Kështu, Pali filloi t'i shtonte gënjeshtat e veta dhe filloi që të shkruante ungjij të ndryshëm dhe, me gënjeshtat e tij, filloi ta ndryshonte ligjin e Jezusit/ Isait

*shkak të jashtëzakonshmërisë së zbulesave, m'u dha një gjemb në mish, një engjëll i Satanit, për të më rënë me grushte, që të mos mbahem me të madh..". (2 Korintasve 12:2-7)*

Për kë thoshte Pali "Për atë njeri unë do të krenohem"..!? "Krenohemi në Krishtin Jezus pa besuar në mish". (Filipianëve 3:2-3) Pse thoshte Pali "m'u dha një gjemb në mish, një engjëll i Satanit, për të më rënë me grushte"

Sepse në vegimin e tij, që e pa në shkretëtirë, iu tha nga drita "është e rëndë për ty të godasësh me shqelm kundër gjembave". (Veprat e apostujve 9:6)

"Por ndodhi që, ndërsa po udhëtonte dhe po i afrohej Damaskut, befasisht rreth tij vetëtiu një dritë nga qielli. Dhe, si u rrezua për tokë, dëgjoi një zë që i thoshte: "Saul, Saul, përse më përndjek?". Dhe ai tha: "Kush je, Zot?". Dhe Zoti tha: "Unë jam Jezusi, që ti e përndjek; është e rëndë për ty të godasësh me shqelm kundër gjembave"... Dhe njerëzit që udhëtonin me të ndaluan të habitur, sepse dëgjonin tingullin e zërit, por nuk shikonin njeri". (Veprat e apostujve 9:3-7) Për më tepër, lidhur me këtë ngjarje, shih artikullin "A u kryqëzua Jezusi", të autorit Xhemis Stafa, i cili gjendet tek webfaqja [www.bibladhekurani.com](http://www.bibladhekurani.com). Artikulli është pjesë e librit të tij të pabotuar me titull "Islami, krishterimi dhe thirrja sataniste".

<sup>59</sup> Halil Ibrahim, "Islami dhe krishterimi", Prishtinë, 2005, fq. 94-95.

<sup>60</sup> Bart D. Ehrman, "Të keqçitosh Jezusin-Si dhe përse u ndryshua Bibla", "Erasmus", Tiranë, 2007, fq. 32.

a.s. Shtrohet pyetja: Cili është themeluesi i fesë së re të cilën sot e njohim si krishterizëm?

Historiani i madh H. J. Wells<sup>61</sup> jep përgjigje në këtë pyetje dhe thotë:

“Shën Pali, personit të cilit i takojnë meritat më të mëdha për përhapjen e krishterizmit të ri, nuk e ka parë kurrë Jezusin/Isanë a.s., as e ka dëgjuar atë që ai ua ka thënë njerëzve. Emri i tij i vërtetë është Saul i cili në fillim ishte njëri ndër kundërshtarët dhe dëbuesi i një numri të nxënësve të Jezusit/Isait a.s. Në mënyrë të papritur e ka pranuar krishterizmin dhe ka ndërruar emrin e tij prej Sauli në Paul... Pali e ka njohur mirë filozofinë e grekëve të vjetër, të cilën e ka paraqitur shkolla aleksandrike, ka arritur që frytet e saja t'i përfshijë në krishterizëm me ndihmën e të cilit ajo ka kaluar prej formës njëboshitore në trinitet. Me të është përputhur një numër i madh i atyre që kanë besuar në shumë zota. Disa nga ithtarët e Palit kanë pasur sukses që të futen në kishë dhe ashtu të kenë ndikim në formimin e vetëdijes krishtere. Në atë mënyrë ka pasuar bashkimi i qëndrimeve filozofike të vjetra dhe të krishterimit të ri”.<sup>62</sup>

Shën Pali, i cili ishte me gjenezë nga Tarsusi, ishte i edukuar në lëvizjen fari-site dhe, po ashtu, ishte një hebre i rritur në një mes, ku ndikim të madh kishin helenizmi dhe fetë mistere, si feja mistere në Tarsus me kultet *Sandan*, *Mithra* dhe bashkëshorti i hyjneshës *Cybele*, *Attis*. Ky i fundit në Egjipt dhe në Azinë e Mesme adhurohet si *Osiris*, *Tammuz*, *Dumuz* ose *Adonis*. Prej doktrinave të tjera edhe kulti *Kyrios* zë vend të rëndësishëm në doktrinën e Shën Palit.<sup>63</sup> Pali ishte

<sup>61</sup> Herbert George Wells, ka lindur në Bromley, në Kent të Anglisë, ndërsa vdiq më 13 gusht 1946 në Londër. Me profesion ishte historian, sociolog, novelist. Ndër veprat e tij veçojmë: *The War of the Worlds* (1898); *The Food of the Gods* (1904); *The Stolen Bacillus* (1895); *The Plattner Story* (1897); *Tales of Space and Time* (1899), etj. - Sipas: “Wells, H(erbert) G(eorge).” Encyclopædia Britannica. Encyclopædia Britannica 2007 Ultimate Reference Suite. DVD.

<sup>62</sup> Muhamed Gazali, *Islam ili Kršćanstvo izazov vremena*, Sarajevo, 2005, fq. 11-12, shih edhe: Muhamed Kutub, *“Bota në fokusin Islam”*, Tiranë, 2006, fq. 15.

<sup>63</sup> Më gjerësisht, lidhur me konceptin teologjik të Palit, shih Sinasi Gyndyz, *“Paulus Hiristiyanligin Mimari”*, Ankara Okulu, Ankara, 2001, fq. 95-97; *“Rastežot na Ideite”*, grup autorësh, Kultura, Shkup, 1995, fq. 69-71; Butmann, R., *“Theology of the New Testament”*, Londër, 1952, fq. 133; Machen, J. G., *“The Ori-*



njohës i mirë i kulturës pagane. Ai duke e komentuar mesazhin e Jezusit në bazë të kulturës helene, feve mistere, feve gnostike dhe fesë hebraike, ka vënë themelet e krishterizmit të sotëm.<sup>64</sup>

Pali thoshte se Zoti është një, por se i ka tri attribute. Fenë e shkruante me anë të filozofisë së Platonit. Thelbi i filozofisë së Platonit ishte:

- Zoti - Krijuesi i padukshëm,
- Logosi (logjika), ndihmësi dhe zëvendësi i dukshëm i Zotit,
- Gjithësia që shihet dhe njihet.

Edhe Pali e organizoi fenë kështu:

- Zoti
- I biri, Jezusi
- Shpirti i shenjtë

Kështu u fut në krishterizëm besimi trinitar, apo doktrina e trinitetit.<sup>65</sup>

Filozofia platonike është mbështetur në këtë abstraksion metafizik, ashtu që tri principet origjinale janë prezantuar në sistemin platonik në tre zota të unifikuar mes vetes prej një gjenerate misterioze dhe veçanërisht *Logosi* është konsideruar në karakterin e të birit, Atit dhe Krijuesit e Sunduesit të botës. Me kalimin e kohës, identifikimi arbitrar i “Krishtit” me “Logosin” e Platonit u shkrinë në një dhe kështu lindi “doktrina trinitare”, e cila, më në fund, u kurorëzua me ortodoksizmin kishter.<sup>66</sup>

Studiuesi T.W. Doane, në veprën e tij: *“Bible Myths and Their Parallels in Other Religions”*, shprehet: “Vepra e Platonit u studiuua gjerë e gjatë nga etërit e

*gin of Paul's Religion*”, The Macmillan Company, New York, 1923, fq. 56, sipas Qani Nesimi, “*Ortoksizmi te shqiptarët*”, fq. 27-28.

<sup>64</sup> Qani Nesimi, “*Ortoksizmi te shqiptarët*”, fq. 29.

<sup>65</sup> Osman Nuri Topbash, “*Vargu i profetëve -3*”, fq. 211-212, po ashtu shih “*Feja e krishterë dhe qytetërimi perëndimor*”, Dr. Qazim Qazimi, “*Dituria Islame*”, nr. 178, Maj 2005, Revistë mujore që e boton Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, fq. 25.

<sup>66</sup> Hajrudin Muja, “*Krishterimi Paulian*”, shiko në: [www.zeriislam.com](http://www.zeriislam.com) dhe [www.bibladhekurani.com](http://www.bibladhekurani.com).

kishës<sup>67</sup>, një prej të cilëve, me një entuziazëm të papërshkrueshëm, njohu te mësuesi i madh edukatorin, i cili, me kalimin e kohës, ishte i destinuar për t'i drejtuar të pafetë te Krishti, ashtu siç bëri Moisiu me hebrenjtë<sup>68</sup>.

Pali filloi ta çrënjoste pak nga pak fenë e pastër të Isait a.s. / Jezusit, duke u bërë ky një nga themeluesit e krishterizmit. Madje, Majkëll Hartit në veprën *"100 njerëzit më me ndikim në histori"*, e radhit atë në vendin e gjashtë, duke thënë: "Nuk ekziston individ tjetër që ka luajtur rol aq të madh në përhapjen e krishterizmit... Në të vërtetë, ndikimi i ideve të tij është aq i fortë, sa disa gjurmues thonë se Pali, e jo Krishti, duhet të konsiderohet si themelues i religjionit të krishterë"<sup>69</sup>.

Për ata që i mbeten besnikë fesë së Jezusit/ Isait a.s. (hebraiko-krishterët), Pali ishte tradhtar; dokumentet hebraiko-krishtere e konsiderojnë si "armik", duke e paditur për shkak të "dyfytërsisë taktike"<sup>70</sup>. Pali ishte ai që e vuri themelin e fesë krishtere, filloi ta predikonte një ungjill të ri, të shkruar nga dora e tij, dhe duke u larguar nga mësimet e Jezusit/ Isait a.s. Kjo paraqitet në letrat e tij, siç janë: letra e parë e Palit dërguar korintasve dhe letra e dytë e Palit dërguar romakëve, ku thotë:

*"Sipas hirit të Perëndisë që më është dhënë, si arkitekt i ditur, unë kam hedhur themelin dhe një tjetër ndërton mbi të; por secili të ketë kujdes se si ndërton mbi të"* (1 Korintasve 3:10)

<sup>67</sup> Etërit e kishës- personalitete të shquara të krishterizmit të hershëm, autorë shkrimesh të shumta apologjistikë (shekulli II- fillimi i shek. III), antiheretikë, komentues, historianë etj. të së ashtuquajturës literaturë e të shenjtëve (shekujt II-VIII), të emërtuar patristikë. Ortodoksia njih si *"etër të kishës"* vetëm Athanasin e Aleksandrisë, Vasilin e Madh, Grigori Niskon, Grigori Nazianskun, Joan Zllatoustin e të tjerë, ndërsa kisha katolike njih edhe të kanonizuarit - Klimentin e Aleksandrisë, Origenin, Jeronimin, Stridonskun, Amvrosi Mediolanskun, Augustinin, Martin Turskin dhe Gregorin e Madh. Dogma e *"etërve të kishës"* është formuar, nga njëra anë, në luftë me paganizmin dhe judaizmin, kurse, nga ana tjetër - me herezitë e krishtera: agnosticizmin, arianizmin, etj. (Halit Muharremi, *"Fjalori i teologjisë"*, Tiranë, 2006, fq. 84.)

<sup>68</sup> T.W.Doane, *"Bible Myths and Their Parallels in Other Religions"*, (pa vit dhe vend botimi), fq. 375-376.

<sup>69</sup> Majkëll Hart, *"100 njerëz më me ndikim në histori"*, Shkup, 2000, fq. 34-35.

<sup>70</sup> Dr. Maurice Bucaille, *"Bibla, Kur'ani dhe shkencat"*, Gjakovë (pa vit botimi), fq. 71.

*“Ditën në të cilën Perëndia do të gjykojë të fshehtat e njerëzve me anë të Jezu Krishtit, sipas ungjillit tim”.* (Romakëve 2:16)<sup>71</sup> Gjithashtu, në letrat e Palit, të shkruara dhe të përmbledhura në Dhiatën e Re, tregohet se si Pali u bë dinak, si përdori dredhi. Bie fjala, tek 2 korintasve 12:16 tregohen fjalët e Palit: *“Ashtu qoftë! Unë nuk u bëra barrë për ju; megjithatë duke qenë dinak ju zura me dredhi”.* Atëherë, mund të pyesim se çfarë njeriu dinak dhe përtac e paska frymëzuar Perëndia për ta shkruar Librin Shenjtë!?

Duke e pasur parasysh faktin se Pali, apo ungjilli i tij, binte ndesh me ungjijtë e tjerë, sepse ai dëshironte që ungjilli i tij të mbretëronte mbi ta ndaj, për t’i plotësuar qëllimet e tij, ai t’i mallkonte të gjithë ata që e kundërshtonin, bile do të dilte edhe kundër engjëllit. Ai do ta konsideronte të mallkuar këdo që nuk i përmbahej ungjillit të tij.

Këtë e vërtetojnë letrat e Palit dërguar galatasve, ku thoshte:

*“Por, edhe sikur ne ose një engjëll i qiellit t’ju predikonte një ungjill të ndryshëm nga ai që ju kemi predikuar, qoftë i mallkuar. Ashtu si e thamë më përpara, po e them përsëri: Në qoftë se dikush ju predikon një ungjill tjetër nga ai që keni marrë, qoftë i mallkuar”.* (Galatasve 1:8-9)

Kjo vinte nga fakti se Pali ishte xheloz dhe se në atë kohë, përveç ungjillit të tij, kishte dhe ungjij nga apostujt e vërtetë të Jezusit, të cilët Pali i konsideronte si të pasaktë.

*“Çuditërisht që kaluat kaq shpejt nga ai që ju thirri ju me anë të hirit të Krishtit, në një ungjill tjetër, i cili nuk është tjetër; por ka disa njerëz që ju turbullojnë dhe që duan ta shtrembërojnë ungjillin e Krishtit.”* (Galatasve 1:6-7)

Kështu, Pali i këshilloi pasuesit e tij që të mos i ndjekin mësimet e të tjerëve, por vetëm të tijin, duke u thënë:

<sup>71</sup> Kështu Heinz Zahrnt thotë se “Pali ishte korruptuesi i Ungjillit të Jezusit”; Johanes Lehman, *“The Jesus Report”*, fq. 126, sipas Misha’al Ibn Abdullah, *“What did Jesus really say?”*, USA, 2001, fq. 188.

*“Pali, apostulli i Jezu Krishtit ... Ashtu si të nxita kur u nisa për në Maqedoni, qëndro në Efes për t’u urdhëruar disave të mos mësojnë doktrina të tjera”. (1 Timoteut 1:1,3)*

Ndërkaq, kundër Palit flet edhe Pjetri, në mënyrë indirekte, duke thënë:

*“Por ka pasur edhe profetë të rremë midis popullit, ashtu si do të ketë midis jush mësues të rremë, të cilët do të fusin fshëburazi herezi shkatërruese dhe, duke mohuar Zotërinë që i bleu ata, do të tërheqin mbi vete një shkatërrim të shpejtë. Dhe shumë vetë do të ndjekin doktrina shkatërruese të tyre dhe për shkak të tyre udha e së vërtetës do të shahet”. (Letra e dytë, Pjetër 1:20-21)*

Ndërkohë Pali me Pjetrin nuk e kishin ungjillin unik për të gjithë njerëzit, sepse vetë Pali tha: *“Madje, duke parë se mua m’u besua ungjilli për të parrethprerët, sikurse Pjetrit ai për të rrethprerët”. (Galatasve 2:7)<sup>72</sup>*

<sup>72</sup> Nëse e analizojmë te Mateu 24:1-22 do të vërejmë një profeci të Jezusit për Palin. Në citatet e këtij ungjilli, në këtë pjesë të profecisë, Jezusi flet për shkatërrimin e tempullit në Jerusalem: *“Në të vërtetë po ju them se këtu nuk do të mbetet asnjë gur mbi gur që nuk do të rrënohet”. (Mateu 24:2)*

*“Ndërsa, kur dishpëjti e tij e pyetën se ku do të ndodhte kjo, ai u tregoi si shenjë paraprirëse të saj. “Ruhuni se mos ju mashtron ndokush! Sepse shumë do të vijnë në emrin tim, duke thënë: “Unë jam Krishti” dhe do të mashtrojnë shumë njerëz”. (Mateu 24:4-5)*

Sipas Jezusit, këto do të ishin shenjat e para të prishjes së Tempullit. Kush erdhi me emrin e Jezusit dhe pretendoi se e pa Jezusin para prishjes së tempullit nga romakët në vitin 73. Askush tjetër përveç Palit. Ai pretendoi se ungjillin e tij e kishte marrë nga Jezusi ndërkohë që ai vetëm e kishte parë një dritë që i foli për përndjekjen dhe jo për ungjillin. Ndërsa Pali tha: *“Tani, o vëllezër, po ju vë në dijeni se ungjilli që është shpallur nga unë, nuk është sipas njeriut, sepse unë nuk e kam marrë as e kam mësuar nga ndonjë njeri, por e kam marrë nëpërmjet një zbulose nga Jezu Krishti”. (Galatasve 1:11-12)*

Jezusi u ndal prapë te këta mashtrues të cilët do të ishin rreziku kredencial i mësimeve të tij. Ai profetizoi se si do të quhen dhe çfarë do të bëjnë këta profetë dhe krishterë të rremë: *“...në qoftë se dikush do t’ju thotë: “Ja, Krishti është këtu”, ose “është atje”, mos i besoni. Sepse do të dalin krishterë të rremë dhe profetë të rremë, dhe do të bëjnë shenja të mëdha dhe mrekulli të tilla aq sa t’i mashtrojnë, po të ishte e mundur, edhe të zgjedhurit. Ja, unë ju paralajmërova. Pra, në qoftë se ju thonë: “Ja, është në shkretëtirë”, mos shkoni atje: “Ja, është në dhomat e fshëhta”, mos u besoni”. (Mateu 24:23-26)*

Sipas verseteve biblike Jezusi i paralajmëroi njerëzit që të kenë kujdes dhe mos u besojnë njerëzve që do të thonë se e kanë parë atë në shkretëtirë. *“Atëherë në qoftë se dikush do t’ju thotë: “Ja, Krishti është këtu”, ose “është atje”, mos i besoni...”. (Mateu 24:23)*

Kush ishin profetët e rremë dhe mësuesit e rremë të dalë mbas Jezusit dhe para shkatërrimit të tempullit në vitin 73? Në Bibël përmenden disa profetë, të cilët nuk kishin shpallje hyjnore për t’u quajtur profetë.

Duke e parë se Pali pretendonte se ishte i zgjedhur nga ana e Jezusit dhe se e pranonte shpallje, ai filloj të dërgonte letra nëpër vende të ndryshme me të cilat edhe e formonte doktrinën e fesë së ardhshme, gjegjësisht krishterizmit. Nga ai lindi ideja se Jezusi është kryqëzuar, është varrosur dhe është ngritur në qiell (1 Korintasve 15:3-4). Koncepti i mëvonshëm teologjik i trinitetit krishterë tërësisht do të bazohet në mendimet dhe në fjalët e Palit.<sup>73</sup>

Dr. Annold Meyer, profesor i teologjisë në Universitetin e Cyrihut, thotë: “Nëse me krishterim nënkuptojmë besimin në Krishtin, si bir qiellor i Zotit, i cili nuk i ka takuar njerëzimit të kësaj bote, por i cili ka jetuar i barabartë dhe në

*“Por në kishën e Antiokisë ishin profetë dhe mësues: Barnaba, Simeoni, i quajtur Niger, Luci nga Kireneas, Manaeni, që ishte rritur bashkë me Herodin tetrark, dhe Sauli (Pali)”.* (Veprat 13:1)

Fjalët e Jezusit “do të dalin krishtër dhe profetë të rremë” mund të interpretohet dhe si një paralajmërim për ardhjen e antikrishtëve të vegjël. Kushdo që quhet krisht i rremë mund të emërtohet dhe si antikrisht i vogël, pasi antikrishti i madh do të paraqitet në kohën e ardhjes së dytë të Jezusit. Pikërisht një nga këto krishtër të rremë ishte dhe Pali sipas Gjonit. “Sepse në botë kanë dalë shumë mashtrues, të cilët nuk rrefejné se Jezu Krishti ka ardhur në mish (si njeri); ky është mashtruesi dhe antikrishti”. (1 Gjonit 1:7)

Pra, sipas Gjonit, ai që nuk thotë se Jezusi ka ardhur në mish (si njeri) është antikrishti. Këtë e përforcon dhe verseti tjetër.

*“Shumë të dashur, mos i besoni çdo frymë, por i vini në provë frymërat për të ditur nëse janë nga Perëndia, sepse shumë profetë të rremë kanë dalë në botë. Nga kjo mund të njihni Frymën e Perëndisë: çdo frymë që rrëfen se Jezu Krishti ka ardhur në mish, është nga Perëndia. Dhe çdo frymë që nuk rrëfen se Jezu Krishti ka ardhur në mish, nuk është nga Perëndia; dhe kjo është fryma e antikrishtit që, siç e keni dëgjuar se vjen; dhe tashmë është në botë”.* (1 Gjonit 4:1-3)

Pra, Gjoni në letrën e tij flet për ardhjen e profetëve të rremë dhe antikrishtëve, ndër të cilët ishte Pali “tashmë është në botë” (Shiko dhe Veprat 13:1) dhe se këtë e përforcon dhe verseti se “çdo frymë që nuk rrëfen se Jezu Krishti ka ardhur në mish, nuk është nga Perëndia; dhe kjo është fryma e antikrishtit” ose “kanë dalë shumë mashtrues, të cilët nuk rrefejné se Jezu Krishti ka ardhur në mish (si njeri); ky është mashtruesi dhe antikrishti”.

Kush ishte ai që deklaroi se Jezusi nuk ka ardhur në mish (si njeri)? Sigurisht ishte Pali në letrat e tij. “Ruhuni nga qentë, ruhuni nga punëtorët e këqij, ruhuni nga të prerët. Sepse rrethprerja e vërtetë jemi ne, që i shërbejmë Perëndisë në Frymë dhe që mburremi në Krishtin Jezus pa besuar në mish”. (Filipianëve 3:2-3) “Prandaj tash e tutje ne nuk njohim më askënd sipas mishit; po, edhe sikur ta kemi njohur Krishtin sipas mishit, nuk e njohim më ashtu”. (2 Korintasve 5:16) (Për më tepër në lidhje me këtë analizë shiko artikullin “A u kryqëzua Jezusi”, të autorit Xhemi Stafa, i cili gjendet tek webfaqja [www.bibladhekurani.com](http://www.bibladhekurani.com))

<sup>73</sup> “Rastezhot na Ideite”, Grup autorësh, Kultura, Shkup, 1995, fq. 69-71; Sinasi Gunduz, “Dim ve Inanç Sozlugu”, Vadi, Ankara, 1998, fq. 302-303, sipas Qani Nesimi, „Ortoksizmi te shqiptarët”, fq. 27.

lavdi me Zotin, i cili ka zbritur nga qielli në tokë, i cili ka hyrë në njerëzoren dhe e ka marrë formën e njeriut, përmes virgjëreshës Mari, që të mund të heqë (t'i shpaguajë) mëkatet njerëzore përmes gjakut të tij në kryq, i cili pastaj është zgjuar nga vdekja dhe është ngritur në të djathtë të Zotit, si zotërues i popullit të vet, i cili në të ka besuar, i cili i dëgjon lutjet e tyre, i mbron dhe i udhëheq; i cili, megjithatë, banon dhe vepron personalisht në secilin prej tyre; i cili do të vijë përsëri me retë e qiellit që t'i gjykojë botës; i cili do t'i rrëzojë të gjithë armiqtë e Zotit dhe i cili popullin e tij do ta marrë me vete në shtëpinë e dritës qiellore, ashtu që ata të mund të bëhen si trupi i tij i popullarizuar - nëse ky është krishterimi, atëherë krishterimin e tillë e ka themeluar Pali i shenjtë, e jo Zoti ynë".<sup>74</sup>

## 5. Historia e trinitetit në Konkilin<sup>75</sup> e Nikesë

Çështja e doktrinës së trinitetit është vendosur shumë vjet më vonë pas Isait a.s./ Jezusit. Triniteti, besimi në Zotin e shpërndarë në tre persona, nuk është praktikuar nga ana e Jezusit, e as nga ndonjëri profet para tij. Më vonë fillojnë të mbahen koncilë, mbledhje dhe shumë gjëra filluan të caktohen, të shtohen në fenë e Jezusit. Filluan të dalin ungjij të tjerë të shkruar nga autorë të ndryshëm. Kështu, Inxhili/ Ungjilli humbi origjinalitetin e zbritjes.

Këtë e vërteton studiuesi dhe eksperti i krishterizmit të hershëm, Bart D. Ehrman<sup>76</sup>, i cili thotë: "Skribët profesionistë janë shfaqur në krishterim në një

<sup>74</sup> "Jesus or Paul", fq. 122, sipas "Ungjilli sipas Barnabes", përktheu Avdi Berisha, (shih shtojcën e librit), fq. 179.

<sup>75</sup> *Koncil-i* (lat. *concilium*-konvokoj së bashku me të tjerët, greqisht: *Sinod-i*)-tubimi, këshillimi; kuvendi i përgjithshëm i ipeshkvinjëve dhe i personaliteteve të tjera kishtarë, i konvokuar me qëllim të shqyrtimit apo të marrjes së ndonjë vendimi lidhur me çështje të rëndësishme nga fusha e teologjisë, liturgjisë, apo nga ndonjë fushë tjetër që ka të bëjë me jetën shpirtërore të të krishterëve. Gjatë mijëvjeçarit të parë të erës sonë koncilët e konvokonin kryesisht perandorët apo mbretërit, kurse gjatë mijëvjeçarit të dytë këtë e bënin papët. (Ekrem Murtezai, "Fjalori i feve", fq. 194.)

<sup>76</sup> Bart Ehrman është një studiues i njohur i Dhiatës së Re si dhe një ekspert i krishterizmit të hershëm. Masterin dhe doktoraturën e ka kryer në Seminarin Teologjik të Princentonit. Aktualisht ai është shef i dep-

periudhë shumë të vonshme, aty nga shekulli i katërt. Për këtë arsye, është e natyrishtme që në kopjet e hershme të jenë bërë gabime të shumta gjatë kopjimit. Mirëpo, më me rëndësi është fakti se këta skribë kanë qenë të përfshirë personalisht në debatet teologjike që kanë marrë plot jetë njerëzore në krishterimin e hershëm... Duke pasur parasysh polemikat, konfliktet e ndryshme, mosmarrëveshjet teologjike, e veçanërisht debatet mbi kriptologjinë<sup>77</sup>, skribët e krishterë u nxitën t'i ndryshonin fjalët e shkrimit të shenjtë, në mënyrë që t'i bënin ato më të dobishme për debatin. Skribët e ndryshuan tekstin në dorëshkrimet e tyre për t'i bërë tekstet më qartësisht “ortodokse” dhe më pak të “keqpërdorshme” nga kundërshtarët e tyre.<sup>78</sup> Kjo ka ndodhur sa herë që skribët përgjegjës për kopjimin e tekstit kanë dashur të sigurohen që teksti të thoshte pikërisht atë që ata dëshironin që ai të thoshte.<sup>79</sup>

Në tubimin që thirri mbreti Konstantin, në vitin 325 të erës sonë, u paraqitën shumë ungjij, nga të cilët vetëm katër u pranuan si më të saktit: Ungjilli i Mateut, Markut, Llukës dhe i Gjonit, të cilët po ashtu kanë mospajtime të shumta ideologjike, në mes tyre.<sup>80</sup>

Sipas fesë islame, Zoti i dërgon libër vetëm profetit dhe jo pasuesve të tij, kurse në krishterizëm kjo gjë pranohet edhe për pasuesit, ndaj kemi ungjillin e Mateut, Markut, Llukës, Gjonit, Palit etj. A duhet të ketë nevojë për katër libra të

artamentit të studimeve fetare në Universitetin “Chaper Hill” të Karolinës së Veriut. (Biografi nga libri i tij: *“Të keqçitosh Jezusin....”*, në fund të librit.)

<sup>77</sup> Kriptologji-a: shkenca që merret me shifrimin dhe me deshifrimin e shkrimeve të fshehta. (Mikel Ndreca, *“Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja”*, Prishtinë, 2000, fq. 415.)

<sup>78</sup> Bart D. Ehrman, *“Të keqçitosh Jezusin-Si dhe përse u ndryshua Bibla”*, fq. 10.


<sup>79</sup> Po aty, fq. 78. Gjatë shekujve II dhe III, po ashtu gjatë kohës së Konstantinit, Bart Ehrman tregon se “këta dy shekuj kanë qenë veçanërisht të pasur në ndryshime teologjike ndërmjet të krishterëve të hershëm. Në të vërtetë, dallimet teologjike ishin kaq shumë të shtrira, saqë grupe që e quanin veten e tyre të krishtera ndiqnin besime dhe praktika që shumë të krishterë sot do të këmbëngulnin se nuk kanë të bëjnë aspak me krishterizmin”. (Po aty, fq. 78)

<sup>80</sup> Më gjerësisht lidhur me Ungjijtë shiko tek: Halit Muharremi, *“Fjalori i teologjisë”*, Tiranë, 2006, fq. 333-334.

njëkohshëm (siç janë katër ungjijtë)? Jo, sepse dihet që Zoti ia dërgon një profeti vetëm një libër.<sup>81</sup>

“Dolën shumë shkrime të shkruara, të publikuara mbi Jezusin. Kur krishterizmi i modelit palian ngadhënjeu përfundimisht dhe e përpiloi përmbledhjen e vet në tekste zyrtare, “Kanonin”, i cili i përjashtoi dhe i gjykoj si të kundërta me besimin e vërtetë të gjitha dokumentet e tjera që nuk ishin në përputhje me linjën që e kishte zgjedhur kisha”.<sup>82</sup>

Po ashtu në koncilin e Nikesë (Iznikut) të vitit 325 u vendos për karakterin hyjnor të Jezusit, sipas të cilit Jezusi ishte perëndi.<sup>83</sup> Po në këtë koncil është paraqitur dogma e krishterë rreth trinitës së shenjtë.<sup>84</sup>



Pikturë nga Këshilli i Konstantinit-Nikesë<sup>85</sup>

<sup>81</sup> Abdurrahman Ajgyn, “Profeti Islam në Ungjillin e Barnabës”, Konja 1989, fq. 25.

<sup>82</sup> Këtë e thekson R.P. Kannengiesser, sipas, Dr. Maurice Bucaille, *vep. e cit.* fq. 73.

<sup>83</sup> “A duhet të besosh në trinitet”, fq. 8; po ashtu shih edhe te: Hassan Hathout, “Leximi i mendjes së Muslimanit”, Tiranë, 2006, fq. 28.

<sup>84</sup> Dr. Ivan Cvitković, “Rječnik religijski pojmovna”, fq. 455; po ashtu edhe tek: Ekrem Murtezai, “Fjalori i feve”, fq. 561; Gjithashtu edhe një libër i krishterë e mohon doktrinën e trinitetit, duke deklaruar që kjo u shpall në këshillin e Nikesë në vitin 325, dhe kjo doktrinë ishte e panjohur për të krishterët e hershëm, shih: “Bazat e Biblës - Udhëzime Kapitujsh” (Shpalosja e gëzimit dhe paqes së krishterimit të vërtetë), botuar nga Christadelphian Bible Mission (CBM), England (pa vit botimi), fq. 154.



Për shumë vite ka pasur mjaft kundërshtime në fushën biblike lidhur me përhapjen e idesë se Jezusi ishte perëndia. Në përpjekje për ta zgjidhur konfliktin, perandori Romak Konstantini<sup>86</sup>, mbloodhi në këshillin e Nikes peshkopët. Mirëpo, vetëm disa prej tyre, rreth 300 veta, morën pjesë. Konstantini nuk ishte i krishterë. “Ai, ashtu si i ati i tij, e adhuronte diellin e pamposhtur”.<sup>87</sup>

Çfarë roli luajti ky perandor në këshillin e Nikesë? Një Enciklopedi tregon: “Vetë Konstantini rrinte në krye, duke drejtuar me zjarr diskutimet dhe propozoi personalisht ... formulën vendimtare që shprehte lidhjen e Krishtit me Perëndinë në kredon e nxjerrë nga këshilli, se ai ‘është prej një substance me të Atin’... Për shkak të nënshtrimit dhe frikës ndaj perandorit, peshkopët, me përjashtim të dyve prej tyre, e firmosën kredon, megjithëse shumica e bënë këtë krejtësisht kundër vullnetit të tyre”.<sup>88</sup>

Stannus Hugh, në veprën e tij *“Historia e doktrinë së trinitetit në kishën e hershme”* thotë: “Përpara se ta mbyll këtë kapitull, është e domosdoshme që t’ju njoftoj juve, lexues të dashur, përkitazi me origjinën e doktrinë së trinitetit: Ju mund të jeni të sigurt se ajo nuk vjen nga shkrimet e shenjta dhe as nga arsyeja, duke qenë kaq e kundërt me këtë të fundit ... Dije, pra, miku im, se kjo doktrinë lindi 300 vjet pasi u deklarua ungjilli i lashtë; u formulua nga padituria, u ruajt dhe u përhap nga dhuna e mizoria”.<sup>89</sup>

<sup>85</sup> Foto: Skala New York/Firence, sipas *“A dubet të besojmë në trinitet”*, fq. 8

<sup>86</sup> Ndryshe quhet edhe Konstantini i Madh, emri i tij në latinisht ka qenë Flavius Valerius Constantinus, ka qenë i pari perandor Romak i pranuar nga të krishterët. Ai lindi përfaqësisht në vitin 280 të erës sonë në Naissus (në Nishin e sotshëm, në Serbi) dhe vdiq më 337 në Ancyrona, pranë Nicomedia (në Izmir, Turqi). (“Constantine I.” Encyclopædia Britannica 2007 Ultimate Reference Suite. DVD).

<sup>87</sup> *“A dubet të besojmë në trinitet”*, fq. 8.

<sup>88</sup> Po aty, fq. 8.

<sup>89</sup> Stannus Hugh, H., *“A History of the Doctrine of the Trinity in the Early Church”*, London 1882, (Christian Life Publishing Co. 281 Strand London), fq. 7.

Gjithashtu, edhe Viktor Paul Wierwille<sup>90</sup> deklaroi: “Doktrina sipas së cilës Jezus Krishti, i biri i Zotit, është zot u dekretua nga pushteti klerikal dhe perandorak. Njerëzit u detyruan ta pranonin me forcë, deri edhe në kanosjen me vdekje nëse vepronin të kundërtën. Kësisoj, gabimi i trinitetit u përhap aq shumë, sa që për pasojë njerëzit filluan të besonin se ishte e vërtetë. Krishterizmi në thelb u bë i njëjtë me paganizmin babilonas, vetëm se me një lustër emrash të krishterë”.<sup>91</sup>

Sipas burimeve të një libri të historisë së krishterë (*A short History of Christian Doctrine*) thuhet: Konstantini nuk e kishte as idenë më të vogël për çështjet që ngriheshin në teologjinë greke. Ajo që kishte kuptuar ishte ndasitë fetare përbënin një kërcënim për perandorinë e tij, kurse ai donte ta forconte atë.<sup>92</sup> Konstantini bëri një përzjerje politike të religjionit të kishës zyrtare me religjionin e vjetër të shtetit romak. Ai publikisht nuk pranoi, nuk refuzoi as që i dha rëndësi njëres mbi tjetrën. Ai i mbrojti të dyja. Veprimet e tij japin të kuptosh se toleranca e kishës zyrtare ka qenë bazuar në arsye politike për të mbajtur pozitën e perandorit dhe jo për ta pranuar fenë krishtere.<sup>93</sup>

---

<sup>90</sup> Ndër veprat e tjera të këtij autori veçojmë: *Jesus Christ is not God* (1981); *The Bible tell me so*; *The new dynamic church*; *Jesus Christ our passover*; *Forgers of the Word*; *Receiving the Holy Spirit today*; etj.

<sup>91</sup> Victor Paul Wierwille, “*Forgers of the Word*”. 1983, sipas [www.erasmusi.org](http://www.erasmusi.org), “Disa thënie në lidhje me trinitetin”, Përmbledhi Rrezart Beka.

<sup>92</sup> “*A duhet të besosh në trinitet*”, fq. 8.

<sup>93</sup> Ahmad Thomson & Muhammad. Ata’ur-Rahim, “*For Christ’s Sake*”, London 1996, fq. 17.

Konstantini unifiko i Sabathin (të shtunën - që e kishte celebruar Jezusi) e kishës zyrtare me të dielën – ditën e adhurimit të zotit të diellit *Dies Solis*. Ai mori masa për futjen e simboleve pagane në fenë e re të krishterizmit, gjegjësisht në kishën zyrtare. Edhe kryqi, që kishte qenë simbol i zotit të diellit *Dies Solis* romak, u bë simbol i krishterizmit dhe tashmë në sistemin perandorak nuk kishte ndonjë ndryshim nga të qenët i krishterë ose pagan. Gibboni thotë se ushtarët e Perandorisë Romake, shumë kohë më parë, në kraharorin e tyre mbanin kryqin për simbol. Për më tepër shih: E. Gibbon, “*Decline and fall of the Roman empire*”, vol. II, 1823, 1909-1914, fq.454, 458, sipas Hajrudin Muja, “*Krishterimi Paulian*”, shih tek webfaqet: [www.zeriislam.com](http://www.zeriislam.com) dhe [www.bibladhekurani.com](http://www.bibladhekurani.com)

## 6. Zhvillimi i trinitetit në koncilë të tjerë, sidomos ai i Kostandinopojës<sup>94</sup> (v. 381)

Mbas Koncilin të Nikes, debatet vazhduan me dekada lidhur me çështjen e Jezusit/ Isait a.s. Madje, edhe ata që nuk besonin në pohimin se Jezusi ishte i barabartë me Zotin, për njëfarë kohe e favorizuan atë. Megjithatë, në Nike ata vendosën vetëm natyrën e Jezusit, por jo rolin e frymës së shenjtë<sup>95</sup>. Nëse Triniteti do të kishte qenë një mësim i qartë biblik, pse nuk e zgjodhën edhe shpirtin e shenjtë si pjesë të trinitetit? Mirëpo, kjo ndodhi më vonë.

Më vonë në koncilin e Kostandinopojës, që u mbajt në vitin 381, e pranoi besimin, që tash quhet besimi katolik, sipas të cilit “shpirti i shenjtë” rrjedh prej zotit bir. Ky këshill pranoi ta vinte frymën e shenjtë në të njëjtin nivel me perëndinë dhe Krishtin. Për herë të parë triniteti i të ashtuquajturit krishterim filloi të vihej në qendër të vëmendjes.<sup>96</sup>

Ne habitemi kur shohim sesi për një doktrinë, çështje besimi, vendosin njerëzit, me gjithë faktin se të gjitha doktrinën zbresin, janë të përcaktuara nga Zoti i Plotfuqishëm, kjo na vërteton se hyjnizimi i Jezusit nuk ishte shfaqur në mënyrë zyrtare në kohën e tij, por pas vdekjes së Jezusit, përkatësisht pas tre shekujve, gjë që dëshmon në mënyrën më domethënëse se Jezusi, i biri i Marisë, nuk ishte autor i kësaj thënieje të shëmtuar, por atë e kishin sajuar “pasuesit” e tij, në krye të të cilëve, siç kemi thënë, qëndronte Pali, duke e devijuar mesazhin e Jezusit.

<sup>94</sup> Kostandinopoja (Stambolli i sotshëm)

<sup>95</sup> Fryma e shenjtë, apo shpirti i shenjtë.

<sup>96</sup> Shiko: “*A duhet të besoh në trinitet*”, fq. 8; Hajrudin Pekarić- Dino, “*Sljedbenici Knjige*”, Tuzla, 2003, fq. 133; Dr. Muhamed Ali El-Havli, “*Komperacioni mes katër ungjijve*”, Shkup, 2002, fq. 70; Victor Paul Wierwille, “*Jesus Christ is not God*”, Ohio 1985, fq. 25; Marmarinta- Omar P. Mabaya, “*Božija Jednoća: Konačno rješenje proturiječnosti trojstva*”, Sarajevo, 2003, fq. 8; dhe tek: “Constantinople, Council of.” Encyclopædia Britannica 2007 Ultimate Reference Suite. DVD; ndërsa sipas Ivan Cvitković në librin e tij “*Religije suvremenoga svijeta*”, Sarajevo, 2005, fq. 169, thotë: “*Në dy këshilla, mbledhje në Nike 325 dhe në Carigrad (Kostandinopojë) 381, është vërtetuar mësimi themelor i besimit të krishterë*”.

Nga kjo vërejmë se hyjnizimi i Jezusit ishte një fabrikim i kulluar, i rrejtshëm nga “pasuesit” e tij për faktin se në besimet e sakta hyjnore nuk kanë qasje njerëzit, apo në përcaktimin e tyre, ngaqë besimet nuk duhet të jenë rezultat i ndonjë koncili prej koncilëve, veprim i ndonjë organizate apo shpikje të ndonjë grupi të caktuar e as të jenë si rezultat i diktimit të papëve (priftërinjve), por ato janë çështje të sakta, të vërteta të konfirmuara me shpallje nga Zoti i Plotfuqishëm nëpërmjet gjuhës së të dërguarve të Tij. Ndërkohë, lajmëtarët e predikojnë te njerëzit ashtu siç e kishin dëgjuar dhe siç u ishte shpallur atyre, pa ndryshuar, zëvendësuar, apo shtrembëruar, ndonjë gjë.

Në Enciklopedinë amerikane thuhet: “Triniteti i shekullit IV ishte një devijim nga mësimet fillestare të krishterizmit”.<sup>97</sup> Po ashtu edhe Enciklopedia e re katolike lë të kuptohet se doktrina e trinitetit nuk ka qenë e njohur për të krishterët e hershëm dhe se është vendosur në çerekun e fundit të shekullit IV.<sup>98</sup>

Duhet ta kemi parasysh faktin se Pali ishte ai që e barazoi hyjninë e Zotit me Jezusin dhe urdhëroi që Jezusi të quhet zot, duke i çmuar si të njëjtë, duke e hapur derën e koncepcionit të gabuar dhe duke përgatitur terrenin për formimin e doktrinës katolike. Atë që Pali ua bëri mësimëve të Jezusit, të tjerët ua bëri mësimëve të Palit! Ky proces arriti kulmin në rastin kur doktrina si doktrinë e trinitetit filloi të zyrtarizohet prej koncilit të Nikesë, më 325, e në vijim në koncilët e tjerë, sidomos kjo mori përmasa në koncilin e Kostandinopojës, me ç’rast bashkëngjitet edhe shpirti i shenjtë si pjesë e tretë e trinisë.

Triniteti u përcaktua më plotësisht në Kredon Atanasiane. Atanasi ishte një klerik që mbështeti Konstantinin në Nike. Kredoja, që mban emrin e tij, përmban: “Ne adhurojmë një Perëndi të vetme në trinitet... Ati është Perëndi, Biri është Perëndi dhe Fryma e Shenjtë është Perëndi; e megjithatë nuk janë tre, por një Perëndi e vetme”.<sup>99</sup>

---

<sup>97</sup> “The Encyclopedia America”, sipas “A duhet të besosh në trinitet”, fq. 8.

<sup>98</sup> Ulfe Azizus Samed, “Islami dhe Krishterimi”, Prizren, 1992, fq. 35.

<sup>99</sup> “A duhet të besosh në trinitet”, fq. 9.

Përplasjet më të theksuara në këtë pikëpamje ishin shënuar ndërmjet dy palëve. *Arianistët* “ndjekësit e Ariusit<sup>100</sup>”, njërit nga përfaqësuesit e shkollës së Antakisë, të cilët ishin të mendimit se Zoti është një dhe i pandashëm, se Jezusi është krijesë e Zotit dhe prandaj, nuk ka natyrë hyjnore. Jezusi ka mundësi që të pranohet si birësim i Zotit, kurse bir nuk mund të bëhet. Pala tjetër ishin *atanasianët*, të cilët, përkundrazi, ishin të mendimit se Zoti vërtet është Një, por shfaqet në tri trajta, apo në tri fytyra, duke e konsideruar Jezusin, si hyjni apo zot, të tillë e trajtonin edhe shpirtin e shenjtë. Për këtë çështje u mbajt një koncil në Aleksandri, në vitin 319, nën udhëheqjen e patrikut<sup>101</sup> Aleksandër, me ç’rast mendimet e Ariusit u refuzuan, duke e shpallur heretik dhe të ekskomunikuar nga kisha. Ky vendim edhe më shumë i hapi dyert e acarimit ndërmjet dy grupeve. Perandori Konstantin, nga frika e përçarjes dhe për ta ruajtur sigurinë e perandorisë, edhe vetë u angazhua për zgjidhjen e kësaj çështjeje dhe i thirri të dyja palët në një koncil, që u mbajt në Nike në vitin 325, për t’i bashkuar mendimet në një besim për tërë perandorinë. Në këtë koncil, siç përmendëm edhe më lart, u pranua hyjnia e Jezusit dhe në fund u pranua teoria e *atanasianëve*, meqë kjo teori më shumë i përgjigjej vetë perandorit, i cili ende ishte pagan, dhe i cili, madje,

<sup>100</sup> Ariusi u lind më 250 në Libi, ndërsa vdiq më 336 në Kostandinopojë (Stamboll i sotëm). Ishte prift i krishterë i Aleksandrisë, Egjipt, mësimet e të cilit i dhanë hov rritjes së një doktrine të njohur si arianizëm, e cila këmbëngulte në afirmimin e natyrës krijuese dhe të fundme të Krishtit, ishte i denoncuar nga kisha e asaj kohe si drejtimi kryesor heretik. Këshilli i Nikesë, në maj të vitit 325, e deklaroi Ariusin si heretik pasi që ai refuzoi ta nënshkruante formulën e besimit, të mbështetur në atë se Krishti ishte i natyrës së njëjtë hyjnore me Zotin. Për më tepër shih: “Arius.” *Encyclopædia Britannica* 2007 Ultimate Reference Suite. DVD.

<sup>101</sup> Patrik rrjedh prej fjalës *patriarches* dhe ka kuptimin i ati i parë, i pari, i pari i fisit. Sipas Dhiatës së Vjetër patrikë janë quajtur profetët: Abrahami, Ishaku, Jakobi. Ndërkaq më vonë me këtë emër janë quajtur udhëheqësi i kishës së Jerusalemit, Antakisë, Aleksandrisë, Romës, Kostandinopojës/ Stambollit. Sot me këtë emër quhen edhe kryetarët e kishave ortodokse që janë patrikana, si ajo serbe, greke. Patriku i Fanarit në Stamboll quhet *patriku ekumenik*, kurse ai i kishës ermene quhet *katolikes*. Prandaj, nëse në disa raste lexuesi e has titullin patrik e në disa raste e has për të njëjtin person titullin peshkop/kryepeshkop do të thotë se ai një herë është e herën tjetër nuk është më patrik. Po ashtu, duhet patur parasysh se çdo patrik është edhe peshkop, kurse çdo peshkop nuk është edhe patrik. (K. Watkins, Patrijarh, *Enciklopedija Zivih Religjia*, Nolit, Beograd, 1981, fq. 539; Ekrem Murtezai, *Fjalori i feve*, fq. 358).

dëshironte që ta gjente një kompromis ndërmjet fesë që ishte në rritje e sipër dhe qytetarëve të tjerë të perandorisë të cilët ende ishin paganë. Prandaj, ai këtu nxori një sërë rregullash kundër atyre që kanë qëndrim dhe besim të kundërt me atë të kishës zyrtare, duke vendosur mes tjerash:

- E mallkoi Ariusin dhe pasuesit e tij, i dogji librat e tij dhe e vendosi besimin anatasian, i cili e konsideronte Jezusin për zot.
- Vendosi njëzet ligje për organizimin e kishës.
- Pranoi vetëm katër ungjijtë (Ungjilin e Mateut, Llukës, Markut dhe të Gjonit), dhe disa nga letrat e Besëlidhjes së Re, ndërkaq të gjithë ungjijtë e tjerë i dogji dhe, pas këtij koncili, filloi lufta e ashpër kundër ungjijve të paautorizuar.
- Unifikoi Sabathin (të shtunën - që e kishte celebruar Jezusi) e kishës zyrtare me të dielën – ditën e adhurimit të zotit të diellit, *Dies Solis*.
- Mori masa për futjen e simboleve pagane në fenë e re të krishterizmit, gjegjësisht në kishën zyrtare. Edhe kryqi, që kishte qenë simbol i zotit të diellit, *Dies Solis* romak, u bë simbol i krishterimit dhe tashmë në sistemin perandorak nuk kishte ndonjë ndryshim nga të qenët i krishterë ose pagan.
- Konstantini bëri një përzierje politike të religjionit të kishës zyrtare me religjionin e vjetër të shtetit romak. Ai publikisht nuk pranoi, nuk refuzoi as që i dha rëndësi njëres mbi tjetrën. Ai i mbrojti të dyja. Veprimet e tij japin të kuptosh se tolerimi i kishës zyrtare ka qenë bazuar në arsye politike për të mbajtur pozitën e perandorit dhe jo për ta pranuar fenë e krishterë.<sup>102</sup>

Profesor Abdul Ahad Dawud<sup>103</sup>, më parë i njohur si David Benjamin Keldani, ishte kryepeshkop Kaldeas në Urmiah (Iran), kur flet për trinitetin, thekson:

<sup>102</sup> Për më tepër në lidhje me këto, shfletu: Ekrem Murtezai, “*Fjalor i feve*”, fq. 561; Ekrem Sarikçioglu “*Historia e feve, prej fillimit deri sot*”, Shkup 2007, fq. 498-500; Qani Nesimi, “*Ortodoksizmi te shqiptarët*”, fq. 30-33; Ahmad Thomson & Muhammad. Ata’ur-Rahim, “*For Christ’s Sake*”, fq.17, dhe Dr. Zija Abdullahu, “*Hyrje në studimin e feve*”, fq. 38.

<sup>103</sup> Abdulahad Davud, i njohur fillimisht si Atë David Benjamin Keldani, lindi në vitin 1867 në Urmia të Iranit. Pas studimeve filozofike e teologjike në kolegjin “Propaganda Fide” në Romë, u emërua prift në vit-

“Dega e trinisë së kishës së krishtere ka gati XVII shekuj që i ka shterur të gjitha mendjet e shenjtorëve të saj dhe të filozofëve që janë përpjekur ta definojnë Esencën dhe Personalitetin e Perëndisë. A thua çka kanë zbuluar? Ato zbuluan gjithë ata që ua kanë imponuar të krishterëve atanasianët, augustinasi dhe akuinasit që “nën dhembjen e mallkimit të përhershëm” të besojnë në njëfarë zoti, i cili është “i treti nga të tretë?”.<sup>104</sup>

Një nga presidentët më të shquar të Amerikës, Thomas Jefferson (1743-1826), në një letër drejtuar James Smithit thotë: “Asnjë fakt historik nuk është i rrënjësor më thellë sesa doktrina e një Zoti, Një dhe të Vetëm, e cila mbizotëronte në periudhën e hershme të krishterizmit... Njëshmëria e Qenies Supreme nuk u përjashtua nga besimi i krishterë përmes përdorimit të arsyes, por përmes dhunës së sundimtarëve, vënë nën urdhrin e Athanasit. Fantazma e një zoti të ngjashëm me Cereberusin, me një trup dhe tre kokë, lindi dhe u rrit mbi gjakun e mijëra martirëve... Paradoksi i Athanasit që një është tre dhe tre është një, është kaq i pakuptimtë për mendjen njerëzore, saqë asnjë njeri i kthjellët nuk mund të sqarojë se ç’kupton me të; e si mundet, pra, që ai të besojë atë që nuk paraqet asnjë ide? Ai që mendon ndryshe, vetëm sa e mashtron veten. Kjo provon gjithashtu se njeriu, kur dorëzon arsyen e tij, nuk i mbetet më asnjë mbrojtje nga absurditetet më të çuditshme dhe ashtu, si një anije pa timon, mbetet në mëshirë të

---

in 1895. Më pas, ai u anëtarësua në Misionin Francez Lazarist të Urmias, ndërsa më 1897 u dërgua për të përfaqësuar katolikët lindorë në Kongresin Eukaristik të mbajtur në Parai-lë-Monial, në Francë, nën kryesimin e kardinal Perrodit.

Në vitin 1898, Atë Benjamini u dërgua nga autoritetet kishtare për të marrë përsipër dioqezën e qytetit të Salmasit në Iran. Në verën e vitit 1900, ai u tërhoq në vilën e tij në Digala, ku kaloi një muaj në lutje, meditim e studim. Pas kësaj, ai i kërkoi dorëheqjen kryeipeshkvit të Urmias. Në vitin 1904, pas një vizite në Stamboll dhe bisedave me muslimanë të ditur atje, përqafoi islamin. Prof. Davidi zotëronte disa gjuhë të huaja: latinisht, greqisht, hebraisht, siriakisht, arabisht, turqisht, anglisht dhe frëngjisht. Ai është i njohur me artikujt e tij të shumtë në gazetat “*The Tablet*”, “*Irish Record*”, “*The Levant Herald*”, “*Kala-La-Shara*”, dhe një numër përthimesh të “*Ave Maria*” në gjuhë të ndryshme, të botuara në revistën “*Illustrated Catholic Missions*”, etj. Prof. Abdulahad Davud vdiq në SHBA, në vitin 1940. (biografia e tij është e marrë nga vepra e tij “*Muhamedi në Bibël*”, Tiranë, 2004 [botimi më i ri nga ai i 1995]).

<sup>104</sup> Prof. Abdul Ahad Dawud, “*Muhamedi në Bibël*”, Prishtinë, 1995, fq. 18.

çdo lloj ere. Me një njeri të tillë, mashtrimi, që ata e quajnë besim, e merr timonin nga duart e arsyes, dhe mendja, për pasojë, shkatërrohet”.<sup>105</sup>

Migel Servetosi<sup>106</sup>, studiues i shkrimeve të shenjta, në librin e tij “*Gabimet e trinitetit*” (latinisht), thotë: “Krishterizmi ishte korrumpuar gjatë tre shekujve të parë të erës sonë. Mësoi se Konstandini dhe pasuesit e tij kishin nxitur mësim të rreme, që, si përfundim, çuan në adoptimin e trinitetit si doktrinë zyrtare”.<sup>107</sup>

Autorët (teologë, historianë, komentues, peshkopë<sup>108</sup>) Hyppolytos, Tertullion, Eusebius, Epiphanius dhe Theodorët, në krye me atin e kishës Irenaeus<sup>109</sup>, i cili ka jetuar në shek. II pas erës sonë, flasin për një grup, i cili për shkak se ka dalë jashtë doktrinës së Palit, ka qenë i fajësuar për herezi nga kisha zyrtare. Këta nga autorët e lartpërmendur janë quajné me emrin Ebionitë. Ky emër është përdorur për shoqërinë e parë të Isait a.s./ Jezusit, që ka ekzistuar para periudhës së Palit. Ebionitët janë quajtur edhe Nasurajtë. Ebionitët besonin se Isai a.s./Jezusi

<sup>105</sup> Thomas Jefferson: Letër dërguar James Smithit, 8 dhjetor 1822, sipas [www.bibladhekurani.com](http://www.bibladhekurani.com), “*Triniteti i pakuptueshëm*”, nga Rrezart Beka.

<sup>106</sup> Migel Servetosi lindi përafërsisht më 1511 në Vilanueva, ose Tudela të Spanjës. Me profesion ishte psikolog, teolog, studiues i shkrimeve të shenjta. Ai u mor me studimin e doktrinës së trinitetit dhe përfundoi se kjo doktrinë nuk është prej mësimve të Jezusit. Ishte ndër kundërshtarët e kësaj doktrine (siç e kemi edhe më lartë mendimin e tij lidhur me këtë doktrinë, të marrë nga libri i tij me titull “*Gabimet e trinitetit*”), ndër veprat e tij kryesore lidhur me trinitetin janë: *De Trinitatis erroribus libri vii* (1531); *Dialogorum de Trinitate libri ii* (1532), etj. Vdiq më 27 tetor 1553. Sipas: “Servetus, Michael.” Encyclopædia Britannica 2007 Ultimate Reference Suite. DVD.

<sup>107</sup> “*Migel Servetosi i vetëm në kërkim të së vërtetës*”, “Zgjohuni”, revistë mujore, botuar nga Watchtower Bible and Tract Society of New York, shtypur në Itali, nga Dëshmitarët e Jehovait në gjuhën shqipe, Romë, maj 2006, fq. 19; rreth Servetosit shih edhe te: Marmarinta- Omar P. Mabaya, “*Božija Jednoća: Konačno rješenje proturiječnosti trojstva*”, fq. 9.

<sup>108</sup> Peshkop-i, m. (gr. mbikëqyrës), kryetar i një dioqeze ortodokse. (Mikel Ndreca, “*Fjalor fjalësh...*”, fq. 545.)

<sup>109</sup> Irenausi u lind më 120/ 140 në Azi të Vogël, ndërsa vdiq në vitin 200/ 203, me gjasë në Lion. Irenausi ka qenë peshkop i Lugdunumit (Lionit) dhe udhëheqës fetar i krishterë, teolog gjatë shekullit të dytë. Puna e tij ka qenë kundër herezive (Adversus haereses) e shkruar gjatë vitit 180, ishte një përgënjeshtrim i gnosticismit. Në rrjedhën e shkrimeve të tij, Irenausi avancoi zhvillimin e një ligji kishtar autoritar të shkrimeve të shenjta (citeve biblike), besimin dhe autoritetin e zyrës peshkopale (zyrës së peshkopit), etj. Për më tepër shiko: “*Irenaeus, Saint.*” Encyclopædia Britannica 2007 Ultimate Reference Suite. DVD



është një pejgamber dhe kundërshtonin mendimin për hyznizimin (shenjtërimin) e Isait a.s., gjë që është sajuar më vonë nga ana e Palit.<sup>110</sup>

Për t'i vërtetuar torturat dhe masakrimet që u bëheshin të krishterëve mund të na shërbejë edhe letra që Irenausi ia shkruan Papës Viktori që t'i ndalë masakrimet që u bëhen të krishterëve, të cilët nuk e pranonin këtë doktrinë të sjellë nga kisha pauliane, e përkrahur nga ana e romakëve.<sup>111</sup>

Koncili i parë i përgjithshëm për persekutimin e ka gjykuar ashpër Ariusin, i cili ka pohuar se Jezusi nuk është zot, por genie e rëndomtë, e krijuar”.<sup>112</sup>

Mund të themi se gjatë tërë shekujve janë mbajtur koncilë të ndryshëm, duke ndryshuar, apo shtuar diçka të re në krishterizëm. Madje, kjo vazhdon edhe në kohën e sotme, ku Papa me seli në Romë, sipas besimit të tyre, është në shkallën e apostullit të Jezusit, apo konsiderohet si zëvendës i Krishtit në Tokë<sup>113</sup> dhe kinse mund të ndryshojë ndonjë gjë në besimin e krishterë, sepse ai njëherësh është edhe i frymëzuar nga shpirti i shenjtë. Deri tani janë mbajtur shumë koncilë, duke ia filluar me Koncilin e Nikesë (viti 325), kurse i fundit me Koncilin e dytë të Vatikanit (1962-1965) i cili është mbajtur në Vatikan<sup>114</sup>.

<sup>110</sup> Qani Nesimi, “*Dialogu obligim hyjnor*”, fq. 151-152; shih më gjerësisht: “*Ebionite.*” Encyclopædia Britannica 2007 Ultimate Reference Suite. DVD

<sup>111</sup> E.J. Goodspeed, *The Apostolic Fathers*, 1950; Muhamed Ata Ur-Rahman, “*Jesus: Prophet of Islam*”, Rijad 1984, fq. 74-75, sipas Marmarinta- Omar P. Mabaya, “*Božija Jednoća: Konačno rješjenje proturiječnosti trojstva*”, fq. 6.

<sup>112</sup> J.F. De Groot “*Mësimi katolik*”, fq. 149, sipas: Ulfe Azizus Samed, “*Islami dhe krishterimi*”, fq. 37

<sup>113</sup> Abdullah et-Terxhuman, “*Rruga e Priftit në Islam*”, fq. 83. Shih edhe te: Halit Muharremi, “*Fjalori i teologjisë*”, fq. 254-255.

<sup>114</sup> Koncilët e mbajtur janë: Koncili i Nikesë (325); K. i Kostandinopojës (381); K. i Efesit (431); K. i Halkedonit (451); K.i dytë i Kostandinopojës (553); K.i tretë i Kostandinopojës (680); K. i dytë i Nikesë (787); K. i Kostandinopojës (869); K. i Lateranit (1123); K. i dytë i Lateranit (1139); K. i tretë i Lateranit (1179); K. i katërt i Lateranit (1215); K. i parë i Lionit (1245); K. i dytë i Lionit (1274); K. i Vjenës (1311); K. i Konstancës (1414-1418); K. i Bazelit (1431-1437) {*Në Enciklopedinë Britanika 2007 (DVD), nuk figuron koncili i Bazelit (1431-1437), ndërsa të tjerat të gjitha*}; K. që u mbajt në Ferrari dhe Firence (1438-1439); K. i pestë Lateranit (1512-1517); K. i Trientes (1445-1463); K. i parë i Vatikanit (1869-1870) dhe Koncili i dytë i Vatikanit (1962-1965). - Ekrem Murtezait, “*Fjalori i feve*”, fq.194; po ashtu shiko: “*council.*” Encyclopædia Britannica 2007 Ultimate Reference Suite. DVD.

Gjatë koncilëve të mbajtur, që u zhvilluan rreth besimit në doktrinën e trinitetit, si ajo e mbajtur në vitin 325 në Koncilin e Nikesë, pastaj në vitin 381 në Kostandinopojë, filluan të paraqiteshin mosmarrëveshje<sup>115</sup> dhe më vonë krishterizmi ndahet në sekte të ndryshme, e grupime.

## 7. Konsiderimi i Marisë si “Nëna e Zotit”

Duke pasur parasysh adhurimet e devijuara që bëhen në krishterizëm, duke adhuruar krijesat e Zotit të Madhëruar, duke i hyjnizuar ato, duhet përmendur çështjen e Nënës së Jezusit, Marisë (Merjemes), ngase siç e cekëm më lart, të krishterët e quajnë si Nëna e Zotit (Teodokos)<sup>116</sup>, apo lindësja e zotit, të cilën disa sekte të krishtera, si ai ortodoks, e adhurojnë dhe bëhet pjesë e trinisë së shenjtë dhe e cila zë një vend të veçantë.

Kjo është njëra ndër çështjet më kontradiktore dhe të theksuara në historinë çështja e Marisë / Merjemes dhe birit të saj. A ishte ajo nënë e njeriut, apo e zotit?! Ajo, a e lindi zotin, apo njeriun? Nëse e ka lindur zotin, qenia e saj çfarë duhet të jetë?

Nëna e Jezusit e ka një pozitë të lartë në krishterizëm, sepse si rrjedhojë logjike vjen se nëse Jezusi është me të vërtetë Zot, atëherë nëna e tij duhet të titullohet “Nëna e Zotit”.<sup>117</sup> Mirëpo, asnjë i krishterë nuk pretendon se Maria është gruaja e Zotit. Në vitet në vazhdim janë kultivuar një sërë mënyrash të respektimit deri në adhurim dhe lutje drejtuar saj, edhe pse në realitet ajo nuk ishte përpos nënë biologjike e Jezusit. Ajo konsiderohet “si *‘arka e Besëlidhjes’* ku hyji banon në

---

<sup>115</sup> Mosmarrëveshje kishte edhe para këtyre koncilëve, por konfliktet, mosmarrëveshjet, kundërshtimet të shumta filluan mbas këtyre koncilëve, ato ishin të ndryshme qofshin në besim, doktrina, rreth librit të shenjtë të tyre - Biblës, në ritet fetare, etj. gjë që çuan deri në ndarje të grupeve të ndryshme.

<sup>116</sup> Don Nosh Gjolaj, *“Meditime për Trininë e Shenjtë”*, fq. 19.

<sup>117</sup> Grup autorësh, *“Čovječanstvo u potrazi za Bogom”*, fq. 277.

mesin e popullit (...) është Tempulli i Zotit, (...) vendi i pranisë së Zotit, shenjtoria e gjallë i të shenjtueshmit.”<sup>118</sup>

Për shembull, në kishën ortodokse të lindjes, ikonat e Jezusit, Marisë (nënës së Jezusit), trinitetin etj. i paraqesin si simbole adhurimi dhe luten me përkushtim dhe besim të veçantë. Një vepër referimi për ortodoksinë greke shpjegon: “Me besim dhe përkushtim të veçantë, ne nderojmë më të shenjtën nënën e perëndisë, nënën e zotërisë sonë dhe kërkojmë mbrojtjen dhe ndihmën e saj”.<sup>119</sup>



Kjo skulpturë e vjetër (fotoja në të djathtë) prej shekujsh në Francë (Kolegjia e Montrealit, Yonne Francë), paraqet kurorëzimin e “virgjëreshës” Mari nga triniteti. Besimi në trinitet çoi në nderimin e Marisë si “Nënë e Perëndisë”

<sup>118</sup> Don Nosh Gjolaj, “*Meditime për Trininë e Shenjtë*”, f. 23-25.

Ajo po ashtu titullohet edhe “*Virgjëreshë*” dhe që ka mbetur shtatzënë nga “Fryma e Shenjtë” e jo me anë të shtatzënisë me palën tjetër, përkatësisht me anë të ndonjë burri. Mohimi i një besimi të tillë e nxjerr besimtarin e krishterë nga feja e tij. Ajo ishte virgjëreshë jo vetëm para lindjes, por edhe pas lindjes. Besohet se ajo me një dhunti të veçantë nga Zoti nuk ka bërë asnjë mëkat dhe ka qenë e pastër, si para lindjes së Jezusit, ashtu edhe pas lindjes së tij. Këtë mendim e mbrojnë katolikët. Kurse ortodoksët e konsiderojnë se edhe ajo e ka trashëguar mëkatën e parë nga Adami dhe Eva si të gjithë njerëzit e tjerë, por pas lindjes së Zotit ajo u pastrua, nga këtu edhe u bë e pamëkatshme. Ndërkaq, te protestantët edhe pas lindjes së Zotit nuk është pastruar për arsye se nuk është përmend asgjë në Dhiatën e Re për këtë çështje. (Shih: Qani Nesimi, “*Ortodoksizmi te shqiptarët*”, fq. 165-168; dhe Dr. Zija Abdullahu, “*Hyrje në studimin e feve*”, fq. 52)

<sup>119</sup> “*A duhen përdorur ikonat në adhurim?*”, (pa autor), Zgjohuni, 8 maj 2005, fq. 20.

Në vitin 431 të erës sonë, në Efes<sup>120</sup> u mbledh këshilli i tretë ekumenik<sup>121</sup>, ku u diskutua se prej çfarë natyre ishte Krishti... Po ashtu vendimi që u mor në Efes, me anë të të cilit roli i Marisë u lartësua nga bartëse e Krishtit në bartëse të perëndisë, jo vetëm që hodhi bazën për shndërrimin e Marisë në një kult, por shkaktoi edhe përçarjen e parë të madhe brenda kishës... Ky debat vazhdon deri në ditët e sotme.<sup>122</sup>

Nëse studiohen hollësisht besimet dhe kulturat e lashta na del se çështja e Marisë si nënë e zotit është ndikuar më tepër nga fetë pagane. Gjatë shekullit XI para erës sonë (para Krishtit) pasi e pushtuan Efesin (bregu perëndimor i Turqisë së sotme), perandori të ndryshme. Pushtuesit hasen njerëz që njiheshin për adhurimin e perëndeshës së nënave, një hyjneshë që më vonë do të njihet si Artemisa efesiane. Kulti i Artemisë kishte lëshuar rrënjë të thella në Efes. Para kohës së mbretit Kres, Cibela, Nëna e perëndive, ishte hyjnesha kryesore që adhurohej në vend. Duke krijuar një lidhje gjenealogjike midis mitit të Cibelës dhe mitit të perëndive greke... nga mesi i shekullit të gjashtë para erës sonë, filloi puna për ngritjen e tempullit të Artemisë, pasueses së Cibelës.<sup>123</sup> Kështu, adhurimi i Cibelës dhe i Artemisë u zëvendësua me adhurimin e Marisë, nënës së perëndisë. Ashtu siç pohohet: “Kulti i Marisë në Efes.... është një traditë që vazhdon të praktikohet

<sup>120</sup> Bregu perëndimor i Turqisë së sotme.

<sup>121</sup> Ekumenizëm-i: lëvizja fetare e shoqërore krishtere, e cila synon t'i bashkojë të gjitha kishat krishtere anembanë botës; pikëpamja, sipas të cilës të gjitha kishat krishtere kudo në botë duhet të bashkëpunojnë ndërmjet tyre dhe të bashkohen me qëllim të këndelljes së vetëdijes fetare krishtere, të kapërcimit të ndasive ndërmjet kishave dhe me qëllim të sigurimit të një ndikimi më të madh në organet e pushtetit dhe në rrjedhat shoqërore në përgjithësi. (Ekrem Murtezai, *“Fjalori i feve”*, fq. 96)

<sup>122</sup> *“Aty ku u përplasën adhurimi i vërtet me paganizmin”*, “Kulla e rojës”, revistë dyjavore, botuar nga Watchtower Bible and Tract Society of New York, shtypur në Itali, nga Dëshmitarët e Jehovait në gjuhën shqipe, Romë, 15 dhjetor 2004, fq. 28; dhe *“A duhet t'i luteni virgjëreshës Mari?”*, Zgjohuni, 8 shtator 2005, fq. 26

<sup>123</sup> Për më tepër shiko: *“Aty ku u përplasën adhurimi i vërtet me paganizmin”*, “Kulla e rojës”, 15 dhjetor 2004, fq. 26-27.

deri në ditët e sotme, traditë që nuk mund të shpjegohet pa bërë lidhjen me kultin e Artemisë”.<sup>124</sup>

Për më tepër disa nga sektet e krishtera<sup>125</sup>, jo që nuk e praktikojnë adhurimin e Marisë, por e konsiderojnë si akt kundërbiblik. Prandaj, shprehen me një lloj revolte ndaj këtij akti duke thënë: “Këtë adhurim të Marisë as Bibla vetë nuk na autorizon t’i lutemi asaj. Shumë vetave që i luten Marisë, u është mësuar se mund të bekohen duke përsëritur një sërë lutjesh specifike, si p.sh. lutjen: Ave Maria, Ati ynë, etj. Libri “*Simbolet e katolicizmit*” (anglisht) thotë se “për katolikët forma më e përhapur e adhurimit të Marisë është pa dyshim ajo me anë të rruazave”.<sup>126</sup>

Po të bëhet më tutje një studim lidhur me fetë pagane dhe krishterizmin do të vërejmë shumë ngjashmëri, gjë që tregon se krishterizmi ka qenë shumë i ndikuar nga besimet dhe ritet pagane të cilat vetë krishterizmi i huazoi dhe ua përshatati besimeve të tyre. Konkretisht mund t’i cekim ikonat, të cilat shfaqen nëpër kisha dhe manastire, ku është e pikturuar Maria duke e mbajtur fëmijën e saj, Jezusin, në krah, apo diçka të ngjashme, është një huazim i marrë nga kultet e lashta të perëndive pagane.

Kështu perëndesha egjiptiane “*Hator*” shpesh është shfaqur duke e mbajtur fëmijën e saj “*Horusin*” në krah dhe duke i dhënë gjë. Ajo është paraqitur në mënyrë ikonografike në formën e “*Marisë*” së krishterë, me fëmijën e saj “*Jezusin*”. Gati në të gjitha provincat e perandorisë romake gjendeshin kultet e perëndeshës së “*Izisit*”. Kulti i fundit që mbeti ishte vendi më i shenjtë në ishullin *Filë*, u mbyll në vitin 560 të e. s. nën urdhrin e perandorit *Justinijan* (527-565).<sup>127</sup> Ngjashmëri mund të gjendet edhe te perëndesha babilonase “*Semirami*” dhe Zoti i personifikuar në bir; gjithashtu te perëndesha indiane “*Devka*” dhe foshnja e saj

<sup>124</sup> Po aty, fq. 28.

<sup>125</sup> Protestantët, Dëshmitarët e Jehovahit etj.

<sup>126</sup> “A duhet t’i luteni virgjreshës Mari?”, *Zgjuhuni*, 8 shtator 2005, fq. 27.

<sup>127</sup> Gerhard G. Belinger, “*Veliki leksikon religije*”, fq. 88.

“*Krishna*”; perëndesha indiane “*Isi*” si dhe foshnja e saj “*Isvara*” etj.<sup>128</sup> Të gjitha këto janë kulte dhe rituale pagane, të cilat më vonë i huazoi krishterizmi.

Këto mund t’i elaborojmë edhe me fotografi të ngjashme që tregojnë ritualet pagane të Maria dhe Jezusi<sup>129</sup>:



**Perëndesha Babilonase Semiramis dhe Zoti - i personifikuar në Bir**



**Perëndesha Indiane Devka dhe foshnja e saj Krishna**



**Perëndesha Indiane Isi dhe foshnja e saj Isvara**



**Perëndesha Egjiptiane Isis dhe djali i saj Horus**




**Romano Katolikë - Maria dhe Zoti i personifikuar në Jezusin**

<sup>128</sup> “*Babylon Mystery Religion*”, fq. 13-15, marrë nga artikulli “*Worship of Semiramis*”, te web faqja [www.montana.com](http://www.montana.com).

<sup>129</sup> “*Babylon Mystery Religion*”, fq. 13-15, fotografi e marrë nga artikulli “*Worship of Semiramis*”, te web faqja [www.montana.com](http://www.montana.com)

Fotografia e mëposhtme përbëhet nga tri skulptura që tregojnë ngjashmëri të madhe ndërmjet Marisë me Jezusin dhe skulpturave të tjera të besimeve tjera pagane. Në të majtë të fotografisë është perëndesha e Egjiptit Izisi me djalin e saj Horusin, në mes është Maria me djalin e saj Jezusin, ndërsa në të djathtë perëndesha romake Mater Matuta.<sup>130</sup>



Gjithashtu ngjashmërinë ndërmjet Marisë me fëmijën e saj Jezusin, mund ta gjejmë edhe te budizmi, ku vërejmë nënën e zotit me fëmijën e saj dhe krahasimin e Marisë me Jezusin:<sup>131</sup>



Shumë të krishterë, sidomos katolikët dhe ortodoksët, i vizitojnë vendet e shenjta që i përshkruhen Marisë (si Efesi në Anadoll dhe Nasira në Palestinë). Në

<sup>130</sup> Rreth këtyre të dhënave dhe fotografive të tjera shfletu: Grup autorësh, “Čovječanstvo u potrazi za Bogom”, (Njerëzimi në kërkim të Zotit), fq. 277.

<sup>131</sup> Po aty, fq. 33.

kishë vend të posaçëm kanë portretet e Marisë, respektivisht skulpturat e saj. Besimtarët për shpëtimin e tyre i kërkojnë që të ndërmjetësojë.<sup>132</sup> Besohet se Maria, me përfundimin e jetës në këtë botë, është ngritur në qiell dhe se atje jeton bashkë me të birin. Vetë ajo, me shpirt dhe me trup, është ngritur në qiell. Në Dhiatën e Re nuk ka të dhëna definitive për ngritjen e Marisë në qiell. Ky besim bazohet në doktrinën e kishës katolike për shenjtërimin dhe nderimin e Marisë.<sup>133</sup>

Tek disa nga të krishterët ka mendime se atë duhet ta adhurojmë për faktin se ka qenë grua e bekuar dhe se Bibla e cek këtë. Mund t’iu themi se nuk është Maria e vetmja grua e bekuar në Bibël, por ka edhe gra të tjera, si p. sh. tek Gjyqtarët 5:24, tregon se edhe Jaela quhet grua e bekuar. Megjithëkëtë, Bibla nuk tregon se duhet të adhurohet Maria.

Po ashtu Zoti i Madhëruar në Kur’anin librin e Tij të fundit të shpallur Muhamedit s.a.v.s., ua tërheq vërejtjen njerëzve, sidomos të krishterëve, lidhur me Jezusin dhe Nënëen e tij, me ç’rast thotë:

مَا الْمَسِيحُ ابْنُ مَرْيَمَ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِ الرُّسُلُ وَأُمُّهُ صِدِّيقَةٌ كَانَا يَأْكُلَانِ الطَّعَامَ أَنْظُرْ كَيْفَ نَبِّئُ لَهُمُ الْآيَاتِ ثُمَّ أَنْظِرْ أَنِّي يُؤْفَكُونَ ﴿١٥٦﴾  
 قُلْ أَتَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَمْلِكُ لَكُمْ ضَرًّا وَلَا نَفْعًا وَاللَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ

<sup>132</sup> Ekrem Sarikçioglu, “Historia e feve - Prej fillimit deri sot”, Shkup, 2007, fq. 511.

<sup>133</sup> Po aty, fq. 511-512.

Një katekizëm i të krishterëve, botuar në Irlandë, tekstualisht e përshkruan trinitetin si të përbërë nga Jozefi (ati i Jezusit), Maria (e ëma e tij) dhe vetë Jezusi. Aty thuhet: “Zemër e Jezuit të adhuroj, Zemër e Marisë të përgjërohem, Zemër e Jozefit e pastër dhe e drejtë; në këto tri zemra e vendos besën time” (“What Every Christian Must Know and Do”, Rev. J. Furniss, botuar nga James Duffy, Dublin.) Një trini e njëjtë është gjetur edhe në një vend tjetër në Irlandë. Një pamflet i quajtur “Paschal Duty, St. Mary’s Church, Bishopwearmouth 1859” thoshte si më poshtë nën titullin “Të dashur të krishterë”: “Të bekuar qofshin Jezui, Maria dhe Jozefi. Jezus, Mari dhe Jozef ta jap zemrën time, jetën time dhe shpirtin tim. Jezus Mari dhe Jozef pranoje frymën time të fundit. Amen.” Sipas: “A është Kur’ani (5:19) gabim kur thotë se të krishterët e konsideronin Marinë si hyjni?”, shkruar nga MENJ, pasuroi me komente H. Ibrahim, nga [www.islamidhekrishterimi.com](http://www.islamidhekrishterimi.com)



“Mesihu, i biri i Merjemes, është vetëm një i dërguar. Edhe para tij kanë kaluar të dërguar. Nëna e tij përherë ka qenë e drejtë. Që të dy hanin ushqim. Shiko si ua shpjegojmë atyre shpalljet tona dhe shih si largohen nga e Vërteta! Thua ju (o Muhamed): “Si mundet vallë, që ju adhuroni në vend të Allahut, atë që nuk është në gjendje t’ju sjellë as dëm e as dobi, ndërkohë Allahu dëgjon dhe di çdo gjë?!”. (El Maide 75-76)

وَإِذْ قَالَ اللَّهُ يٰعِيسَىٰ ابْنَ مَرْيَمَ ۗ أَنْتَ قُلْتَ لِلنَّاسِ اتَّخِذُونِي وَأُمِّيَ إِلَهَيْنِ مِن دُونِ اللَّهِ ۗ قَالَ سُبْحٰنَكَ مَا يَكُونُ لِيٰٓ أَن أَقُولَ مَا لَيْسَ لِيٰ بِحَقِّ ۖ إِن كُنتُ قُلْتُهُ فَقَدْ عَلِمْتَهُ ۗ تَعَلَّمْ مَا فِي نَفْسِي وَلَا أَعْلَمُ مَا فِي نَفْسِكَ ۗ إِنَّكَ أَنْتَ عَلَّمُ الْغُيُوبِ ﴿١٠١﴾ مَا قُلْتُ لَهُمْ إِلَّا مَا أَمَرْتَنِي بِمَعَ ۗ إِنِ اعْبُدُوا اللَّهَ رَبِّي وَرَبَّكُمْ ۗ وَكُنْتُمْ عَلَيْهِمْ شَهِدًا مَّا دُمْتُمْ فِيهِمْ ۗ فَلَمَّا تَوَفَّيْتَنِي كُنْتَ أَنتَ الرَّقِيبَ عَلَيْهِمْ ۗ وَأَنْتَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ﴿١٠٢﴾

“Pastaj Allahu do të thotë (në Ditën e Gjykimit): “O Isa, i biri i Merjemes! Ti ishe ai që u the njerëzve: “Adhuromeni mua dhe nënën time si zota krahas Allahut?!” Isai do të thotë: “Qofsh i lartësuar dhe i laudëruar! Mua nuk më takon të them diçka, për të cilën nuk kam aspak të drejtë! Po ta kisha thënë ndonjëherë, Ti me siguri do ta dije. Ti e di çfarë ka në shpirtin tim, po unë nuk e di çfarë ka në Vetën Tënde. Vetëm Ti i di të gjitha të fshehtat. Unë nuk u kam thënë asgjë tjetër, përveç asaj që më ke urdhëruar Ti: “Adhurojeni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj!” Kam qenë dëshmitar, për sa kohë që kam jetuar midis tyre dhe, qëkurse më more mua, vetëm Ti ishe mbikëqyrës i tyre. Ti je Dëshmitar për çdo gjë”. (El Maide 116-117)

Komentuesi shqiptar i Kur’anit (Tefsirologu) Hafiz Ibrahim Dalliu, kur i komenton këto ajete të sures El-Maide 75 dhe ajetin 116-117 thotë: “Zoti e ka bërë të pavlerë besimin e të krishterë me tri mënyra:

- Isai ka nënë. Atëherë, ai njeri që ka nënë, është i krijuar dhe ai që është krijuar, kurrë nuk bëhet Zot.
- Isai dhe e ëma e tij hanë ushqim, dhe ai që ka të tilla nevoja nuk është Zot.
- Isai është i dërguar nga ana e Zotit. Atëherë, Ai njeri që është i dërguar profet nga ana e Zotit, nuk bëhet vetë Zot.

Pra, Zoti u thotë të krishterëve se hazreti Isai a.s./ Jezusi, është një pejgamber si të gjithë pejgamberët e ardhur para tij; Zoti, ashtu siç u ka dhënë pejgamberëve të tjerë mrekullira, për ta vërtetuar profetësinë e tyre, po ashtu i ka dhënë edhe Isait a.s.; prandaj, ashtu siç nuk u thuhet zot pejgamberëve të tjerë, nuk duhet t'i thuhet zot as Isait a.s. Nëse ata thonë se Isai ka lindur pa baba..., atëherë thuaju atyre: Po, Ademit, që është krijuar pa baba edhe pa nënë, përse nuk i thoni zot?<sup>134</sup>

Po ashtu Allahu xh.sh. iu drejtohet njerëzve duke ua sqaruar se ata (Isai a.s. dhe nëna e tij) "*që të dy ushqeheshin*", pra pas ushqimit vjen jashtëqitja e atij ushqimi, ndërsa qitja e ushqimit merr formën e fëlliqësisë. Lind pyetja: si mund që ata të jenë zota kur prej tyre del fëlliqësirë?! Sa të mjerë janë ata që e kanë konceptin e tyre ndaj Zotit!

Ndërsa për ajetet 116-117, thotë: "*Pyetja që i madhi Zot do t'ia bëjë Isait a.s./ Jezusit, "A ti u ke thënë njerëzve..."*" është për t'ua mbyllur gojën të krishterëve dhe për t'ua nxjerrë në shesh se besimi i tyre është i kotë; ndryshe përse duhej të pyeste Zoti, kur e dinte që Isai nuk e kishte thënë atë fjalë? Kjo pyetje nuk do të bëhet për të sqaruar ndonjë gjë që nuk di Zoti, por do të bëhet për t'u treguar të krishterëve me gojën e Isait se ata, kanë një besim të kotë".<sup>135</sup>

Doktrinat themelore të krishterizmit nuk bazohen në Bibël, por në mite të lashta-greke, egjiptiane, babilonase dhe të vendeve të tjera. Triniteti është "një mësim i kishës dhe jo një mësim që erdhi nga Jezusi".<sup>136</sup> Në fund të fundit, dogma e trinitetit është një koncept që doli në shekullin e katërt.<sup>137</sup>

<sup>134</sup> H. Hafiz Ibrahim Dalliu, "*Ajka e kuptimeve të Kur'anit Kerijmit*", Tiranë, 2005, fq. 620.

<sup>135</sup> Po aty, fq. 651.

<sup>136</sup> Revista "Christian Century" në numrin e 20-27 majit 1998, sipas "*Krishterimi ka tradhtuar Perëndinë dhe Biblën*", "Cili është qëllimi i jetës", broshurë e botuar nga Watchtower Bible and Tract Society of New York, shtypur në Itali, nga Dëshmitarët e Jehovahit në gjuhën shqipe, Romë, 2000, fq. 17; dhe "*Kush është i vetmi Perëndi i vërtetë*", Zgjhoni, 22 prill 2005, fq. 6.

<sup>137</sup> "New Catholic Encyclopedia" (1967), sipas "*Kush është i vetmi Perëndi i vërtetë*", Zgjhoni, 22 prill 2005, fq. 7; dhe M.A.C. Cave, "Is the Trinity doctrine divinely inspired", (pa vend botimi) 1996, fq. 31.

Tek Ungjilli i Barnabes<sup>138</sup> theksohen fjalët e Jezusit, ku tha:

*“Kur Zoti të më marrë nga bota, Satanai përsëri do ta ngre këtë alarm të mallkuar, ashtu që do të të bëjë që mosbesimtarët të besojnë se unë jam Zot dhe bir i Zotit, për ç’shkak, fjalët e mia dhe mësimet e mia do të njollosen, ashtu që do të mbesin mezi tridhjetë besimtarë”.*<sup>139</sup>

Po ashtu Jezusi tha: *“Unë nuk ju kam krijuar, por Zoti, Krijuesi ynë, i cili ju ka krijuar, do t’ju mbrojë. Sa më përket mua unë kam ardhur në botë që të përgatis rruqën për të dërguarin e Zotit, i cili do t’ia sjellë botës shpëtimin. Por, ruajuni e të mos mashtroheni, ngase do të vijnë shumë profet të rrejshëm, të cilët do t’i marrin fjalët e mia edhe do ta helmojnë Ungjillin tim”.*<sup>140</sup>

<sup>138</sup> Ungjilli i Barnabes është një ungjill të cilin kisha nuk e pranon për shkak se, sipas tyre, “përbajtja e tij është e dyshimtë”. Është shumë interesante se të krishterët kanë treguar zell shumë të madh për ta fshehur këtë libër. Shekuj me radhë ai është mbajtur larg. Në shekullin XVI, në bibliotekën e Papa Sixtus-it gjendej një kopje e një përkthimi jo të rëndomtë latin dhe askujt nuk i lejohej që ta prekte. Vetëm në fillim të shekullit XVIII, kjo kopje ra në dorën e të quajturit John Toland. Më pastaj, duke kaluar nëpër duar të ndryshme, në vitin 1738 arriti në Bibliotekën e Perandorisë së Vjenës. Përkthimi anglisht i këtij Ungjilli u botua më 1907 nga shtëpia botuese Oxford-Clanderen. Por, me të dalë në shitje, vepra shkaktoi një shqetësim në botën e krishterë, ndërsa shumë prijës fetarë e përfaqësues të kishës i kaploi skepticizmi se përhapja e tepërt e librit në fjalë mund të bëhej shkak që feja e krishterë të humbej.

Kudo që në literaturën e krishterë përmendej emri i tij, aty shënohej një kundërkomentim se fjala ishte për një Ungjill fals, prandaj është rekomanduar që të refuzohet. Disa prijës fetarë të krishterë të mangët nga shkenca kanë shkruar aq larg saqë kanë menduar se kjo është vepër e sajuar nga muslimanët. Kështu mundohen të hedhin dyshimin se Ungjilli i Barnabes është vepër e muslimanëve. Çdo njeri që e lexon, bindet në mënyrë të prerë se ai nuk është shkruar nga dora e muslimanit. Argumenti më i fortë për t’i shpallur të pabaza pretendimet e të krishterëve, madje që 75 vjet para ardhjes së Muhamedit a.s. në këtë botë, është përmendja e Ungjillit të Barnabes (*Evangelium Bernabe*) në listë e përgatitur “*Librat e gabuar dhe të kundërt me mendimin fetar*” në kohën e Papa Gelasiusit I. A mund ta kishte shkruar në atë kohë ndonjë musliman këtë Ungjill fals? Arsyeja që e refuzojnë të krishterët këtë ungjill është se në te tregohet qartazi për ardhjen e Muhamedit a.s., për refuzimin e Jezusit si bir të Zotit, apo zot, tregon se Jezusi nuk u kryqëzua por dikush tjetër u kryqëzua në vend të tij, tregon disa parime ashtu siç na urdhëron Kur’ani Famëllartë etj. Për më tepër shiko, Qani Nesimi, “*Dialogu obligim hyjnor*”, fq. 158-160; ndërsa për ta kuptuar më mirë se çfarë përmban ky ungjill lexojeni në gjuhën shqipe, *Ungjilli sipas Barnabes*, përkthyer nga Avdi Berisha, Prishtinë, 1998.

<sup>139</sup> “*Ungjilli sipas Barnabes*”, kapitulli 96, përktheu Avdi Berisha, Prishtinë, 1998, fq. 82.

<sup>140</sup> Po aty, kapitulli 72, fq. 64.

Në Biblën e “Dëshmitarëve të Jehovait<sup>141</sup>”, në faqen 5 të hyrjes, më herët ata rrëfeshin në këtë mënyrë: “Duke i kopjuar origjinalet e inspiruara ka depërtuar, pa mëdyshje, edhe dobësia e njeriut, dhe asnjë kopje prej mija kopjeve, nuk erziston në gjuhën origjinale; ato paraqesin kopje të përsosura. Si rezultat i kësaj gjendjeje është fakti se nuk gjenden as dy kopje të njëjta”. Tani mund të shihet se e gjithë “hyrja” që i ka 27 faqe, është eliminuar nga Bibla e tyre.<sup>142</sup>

Profesor Abdul Ahad Davud, më parë i njohur si David Benjamin Keldani, ish-priift katolik, kur flet për nënën e Jezusit, Marinë dhe për Perëndinë e vërtetë, thekson: “Të proklamosh tri qenie njerëzore në kreun e Perëndisë dhe të rrëfesh se i Gjithëfuqishmi, i Përjetshmi ishte përfytyruar dhe lindur nga Maria virgjërre-shë është një fyerje e rëndë e ligjit të Zotit dhe idhujtaria më e madhe”.<sup>143</sup> “Formula e përkujdesjes së krishterë (dëshmia e të krishterit): “*Në emër të Atit, Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë*”, as që e përmend emrin e Zotit! Ky, pra, është Zoti i të krishterëve! Ndërsa “*Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim*” (në fenë islame) që do të thotë: Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit dhe Mëshirëplotit, është në kundërtënie të madhe me formulën e trinisë”.<sup>144</sup>

<sup>141</sup> Jehovistë, Dëshmitarët e Jehovait - një nga rrymat fetare, e lindur në gjysmën e dytë të shekullit XIX në SHBA. Themelues i “Dëshmitarëve të Jehovait” ishte Çarls Resel (1852-1916), ndërsa në vitin 1931 u krijua “Shoqata e Dëshmitarëve të Jehovait”. Në aspektin doktrinar jehovistët cilësohen me faktin se nuk e pranojnë kishën zyrtare krishtere, ngase, sipas mendimit të tyre, në të tani dominon Satanai. Dëshmitarët e Jehovait nuk e pranojnë se Jezusi është qenie hyjnore... ndërsa trinia nuk ka mbështetje në krishterizmin burimor. (Ekrem Murtezai, “*Fjalori i feve*”, fq. 83; dhe shih: Halit Muharremi, “*Fjalori i teologjisë*”, fq. 140-141.)

<sup>142</sup> Ahmed Didat, “*A është Bibla fjalë e Zotit*”, Mitrovicë (pa vit botimi), fq. 33; po te ky autor shih: “*The Choice*”, vol. II, New Delhi 2001, fq. 100.

<sup>143</sup> Nazim Juniku, “*Porositë hyjnore*”, Gjakovë, 1996, fq. 126.

<sup>144</sup> Po aty, fq. 127.

## Kapitulli II



# Këndvështrimi biblik dhe kur'anor ndaj doktrinës së trinitetit

## 1. Koncepti i Zotit në Bibël dhe në Kur'an

Librat e shenjtë të hebraizmit janë të përmbledhur bashkë me librat e shenjtë të krishterizmit dhe së bashku e përbëjnë një përmbledhje të quajtur Bibël. Ky emër vjen nga greqishtja “He biblos” (apo biblion) që do të thotë “Libri”, kurse në trajtën diminutive “ta biblia” (apo bibla) d.m.th. libërthat, përmbledhje të librave.<sup>145</sup> Përbëhet nga dy pjesë kryesore: Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re. Dhiata e Vjetër, libri i shenjtë i hebrenjve dhe nga Dhiata e Re, libri i shenjtë i të krishterëve.

Ndërsa libri i shenjtë i fundit, i zbritur prej Zotit të Madhëruar, është Kur'ani, i shpallur për tërë njerëzimin. Kur'an do të thotë “i lexueshëm”, që në kuptimin etimologjik rrjedh nga fjala *Kare'e* që do të thotë lexim.

Kur'ani është fjalë e pakonkurrencë e Allahut xh.sh. Ai, nëpërmjet të besueshmit Xhibril, i është shpallur vulës së pejgamberëve (Muhamedit s.a.v.s.), është shkruar në Mus-hafë, i transmetuar në mënyrë më të besueshme (tevaturin) deri te ne; leximi i tij është ibadet, fillon me suren “El-Fatiha” dhe përfundon me suren “En-Nas”.<sup>146</sup>

---

<sup>145</sup> *Bibla*, përktheu dhe shtjelloi Dom Simon Filipaj, Ferizaj, 1994, fq. 11; dhe Ekrem Murtezai, “*Fjalori i feve*”, fq. 62.

<sup>146</sup> “*Kur'ani- Përkthim dhe komentim*” i H. Sherif Ahmetit, fq. 10.

### 1.1 Njëshmëria dhe cilësitë e Zotit në Bibël dhe në Kur'an

Zoti në Bibël<sup>147</sup> është i përmendur me disa prej këtyre emrave, si: Ati, Hyji, Perëndia, Zoti, Jehovahi, Adonai, Elohim etj.

Në vazhdim do t'i cek disa citate biblike që tregojnë Njësinë dhe cilësitë e Zotit xh.sh., nëpërmjet të cilave shihet qartë se burimi i tyre është nga Zoti i Lartmadhëruar, ashtu siç ka zbritur në origjinalitetin e tyre. Sipas besimit islam, çdo citat biblik, i cili përputhet me parimet kur'anore, është i vërtetë dhe duhet besuar si i tillë. Pra, ky duhet të jetë qëndrimi, kur kemi të bëjmë me Biblën, sepse dihet historikisht se është ndryshuar me kalimin e kohës dhe se dora e njeriut ka prekur në të.<sup>148</sup>

Citatet që flasin për Njëshmërinë e Zotit (monoteizmin) dhe për cilësitë e Tij, të cilat janë shumë, por ja disa prej tyre:

- *“Dëgjo, Izrael, Zoti, Perëndia ynë, është një i vetëm”*. (Ligji i Përtërirë 6:4)
- *“Të tëra këto të janë treguar, në mënyrë që të pranosh se Zoti është Perëndi dhe se nuk ka asnjë tjetër veç tij... Mëso, pra, sonte dhe mbaje në zemrën tënde se Zoti është Perëndi atje lart në qiejt dhe këtu poshtë në tokë, dhe se nuk ka asnjë tjetër”*. (Ligji i Përtërirë 4:35, 39)

<sup>147</sup> Në Bibël në shumicën e tekstit “Zoti-Perëndia” shënohet, shkruhet me “z” apo “p” të vogël. Në arabisht, hebraisht dhe greqisht nuk ka ndryshim ndërmjet shkronjës së madhe “Z” për Zotin dhe shkronjës së vogël “z” për Zotin, për dallim nga gjuhët e shteteve të sotme perëndimore, në të cilat të krishterët gjatë përkthimit të Biblës nuk e kanë përfillur një dallim të tillë. A nuk është ky një mosrespektim dhe një lënie anash e emrit të Zotit të Plotfuqishëm duke e shkruar me shkronjë të vogël. Ndërsa, sa u përket citateve në Dhiatën e Re, të krishterët kanë përdorur shkronjat e mëdha “P” dhe “F” apo “Z”, kur i referohen Jezusit. (Për më tepër lidhur me këtë shih: Ahmed Deedat, *“Combat Kit”*, Durban, 1992, fq. 8-9).

<sup>148</sup> Duhet theksuar se dallimi kryesor në mes Biblës katolike dhe Biblës protestante ka të bëjë me çështjen e librave që gjenden në të. Në Biblën katolike (*Bibla - Përktheu dhe shtjelloi Dom Simon Filipaj, Ferizaj, 1994*) dhe atë protestante (*Bibla- Diodati i ri, përkthim 1991-94*) dallimi përmblidhet në faktin se Bibla katolike i ka 7 libra më tepër se Bibla protestante. Ndërsa të dyja sektet librin e tyre e quajnë të shenjtë. Atëherë, shtrohet pyetja pse ky dallim ndërmjet biblave? Cila në të vërtetë është Fjalë e Perëndisë?



- *“Nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje. Nuk do të bësh skulpturë ose shëmbëllyrë të asnjë gjëje që ndodhet aty në qiejt ose këtu poshtë në tokë ose në ujërat nën tokë”. (Dalja 20:3,4)*
- *“O Zot, o Perëndi i Izraelit, nuk ka asnjë Perëndi të ngjashëm me ty, as në qiell, as në tokë”. (2 Kronikave 6:14 dhe 1 Mbretërve 8:23)*
- *“Unë, unë jam Zoti dhe përveç meje nuk ka Shpëtimtar tjetër”. (Isaia 43:11)*
- *“Nuk ka asnjë të barabartë me ty midis perëndive, o Zot, as ka vepra të njëjtoja me të tuat... Sepse ti je i madh dhe kryen mrekulli; vetëm ti je Perëndia”. (Psalmet 86:8,10)*
- *“Kështu thotë Zoti, mbreti i Izraelit dhe Çliruesi i tij, Zoti i ushtrive: “Unë jam i pari dhe jam i fundit, dhe përveç meje nuk ka Perëndi”. (Isaia 44:6)*
- *“Unë jam Zoti dhe nuk ka asnjë tjetër; jashtë meje nuk ka Perëndi. Të kam rrethuar, ndonëse ti nuk më njihje, me qëllim që nga lindja në perëndim të pranohet që nuk ka asnjë Perëndi përveç meje. Unë jam Zoti dhe nuk ka asnjë tjetër”. (Isaia 45:5-6)*
- *“Mos shkoni mbas perëndive të tjera për t’u shërbyer dhe për të rënë përmbys para tyre, mos provokoni zemërimin tim me veprën e duarve tuaja, dhe unë nuk do t’ju bëj asnjë të keqe”. (Jeremia 25:6)*

Citatet e lartpërmendura ishin nga Dhiata e Vjetër. Tani do t’i përmendim edhe disa nga Dhiata e Re, ku Jezusi urdhëroi që të adhurohet, të besohet dhe t’i shërbejmë vetëm një Zoti të vërtetë dhe se nuk ka asnjë Perëndi tjetër përveç Tij. Më poshtë tregohet dialogu ndërmjet Jezusit e satanait (djallit) dhe pastaj ndërmjet Jezusit dhe dishepujve të tij lidhur me Perëndinë.

- *“Atëherë Jezusi i tha: “Shporru, Satan, sepse është shkruar: “Adhuro Zotin, Perëndinë tënde, dhe shërbeji vetëm atij”. (Mateu 4:10)*
- *“Dhe Jezusi u përgjigj: “Urdhri i parë i të gjithëve është: “Dëgjo, o Izrael: Zoti, Perëndia ynë, është i vetmi Zot”, dhe: “Dua je Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë mendjen tënde e me gjithë forcën tënde!”. Ky është i pari urdhër. Atëherë skribi i tha: “Mirë, Mësues. The,*

*sipas së vërtetës, se ka vetëm një Perëndi dhe s'ka asnjë tjetër përveç tij...*"  
(Marku 12:29-30, 32)

- *"Dhe Jezusi i tha: "Përse më quan të mirë? Askush nuk është i mirë, përveç një të vetmi, domethënë Perëndisë".* (Lluka 18: 19)
- *"...nuk ka Perëndi tjetër, veç një".* (1 Korintasve 8: 4)
- *"një Perëndi i vetëm dhe Atë i të gjithëve, që është përmbi të gjithë, në mes të të gjithëve dhe në ju të gjithë".* (Efesianëve 4: 6)
- *"Në fakt një është Perëndia, dhe një i vetëm është ndërmjetësi midis Perëndisë dhe njerëzve: Krishti Jezus njeri...".* (1 Timoteut 2: 5)
- *"Dhe kjo është jeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar".* (Gjoni 17: 3)
- *"O Zot, ti je Perëndia që ke bërë qiellin, tokën, detin dhe gjithçka që është në ta...".* (Veprat 4: 24)

Këto ishin disa nga citatat që treguan qartazi se Zoti është Një dhe nuk ka të adhuruar tjetër pos Tij, të cilat thërrasin për largimin nga idhujtaria dhe për adhurimin e një Zoti të vetëm dhe të vërtetë.

Në vijim do t'i cekim edhe disa cilësi të Zotit që tregohen në Bibël, si p.sh.:

- *"Zoti është i ngadaltë në zemërim dhe i madh në mëshirë; ai fal padrejtësinë dhe mëkatin...".* (Numrat 14:18)
- *"Ai është Shkëmbi, vepra e tij është e përsosur, sepse në të gjitha rrugët e tij ka drejtësi. Është një Perëndi që nuk e njeh padrejtësinë; ai është i drejtë dhe i mirë".* (Ligji i Përtërirë 32:4)
- *"Sigurisht Perëndia nuk kryen të keqen dhe i Plotfuqishmi nuk shtrembëron drejtësinë".* (Jobi 34:12)
- *"Unë jam Perëndia i plotfuqishëm...".* (Zanafillja 17:1)
- *"Mos u bëni, pra, si ata, sepse Ati juaj i di gjërat për të cilat keni nevojë, para se ju t'i kërkoni".* (Mateu 6:8)
- *"Ja, ai që mbron Izraelin nuk dremet dhe nuk fle".* (Psalmi 121:4)

- “Sepse Zoti është i drejtë; ai e do drejtësinë...”. (Psalmi 11:7)
- “Zoti do të mbretërojë gjithnjë, përjetë”. (Dalja 15:18)
- “Jotja, o Zot, është madhështia, fuqia, lavdia, shkëlqimi, madhëria, sepse gjithçka që është në qiell dhe mbi tokë është jotja. E jotja o Zot është mbretëria, dhe ti ngrihesh sovran mbi gjithçka”. (1 Kronikave 29:11)

Nga citatet që lexuam vërejtëm qartazi cilësitë e vërteta të Zotit si: mëshirën, bujarinë, drejtësinë, pushtetin dhe madhërinë e Zotit. Këto janë fakte që tregojnë dhe vërtetojnë se një pjesë e Biblës ka mbetur nga origjinaliteti i ruajtur ashtu siç u është shpallur nga Zoti i Madhëruar pejgamberëve të Tij.

I Madhi Zot xh.sh. kërkoi nga njeriu që të besojë në Zotin Një, kërkoi nga ai që të mos i shoqërojnë Atij asgjë. Kjo thirrje për besim në Zotin Një i është bërë edhe njeriut të parë dhe pejgamberit të parë Ademit a.s./ Adamit, pejgamberëve të tjerë dhe njerëzve në përgjithësi. Libri i fundit, Kur’ani, na porositi që të besohet Zoti Një, Krijues i kësaj gjithësie, Zotit të cilit i nënshtrohet çdo gjë në gjithësi, deshëm, apo s’deshëm. Cilësitë e Tij janë të përhershme, pa fillim, janë të patretshme dhe nuk dobësohen kurrë në të ardhmen, kurse cilësitë e njerëzve janë të krijuara si edhe vetë ata. Zoti nuk i përngjet askujt dhe askush nuk i përngjet Atij.

Imam Ahmet ibn Hambeli thotë: “Allahu nuk përshkruhet përveç me çfarë e ka përshkruar Vetveten në Kur’an”.<sup>149</sup> Gabimi qëndron kur njeriu i ngatërron atributet e Allahut me ato të krijesave, ai e përfundon veprimin e vet duke i hyznizuar krijesat. Ky lloj hyznizimi i krijesave është esenca dhe baza e idhujtarisë në të gjitha format e saj. Njeriut u ka dhënë attribute hyjnore të rreme të gjitha kulleve, kështu që ato bëhen objekt adhurimi në vend të Allahut, apo së bashku me Allahun xh.sh.<sup>150</sup>

<sup>149</sup> *Er-Revdaturu nedijje*, fq. 22; *Sherhul Akidetil vasitijje li Muhamed Halil Herras*, fq. 21, sipas: Naim Jasin, “*Besimi-Baza, esenca dhe negacioni*”, Prishtinë, 2000, fq. 25.

<sup>150</sup> Abu Ameenah Bilal Philips, “*Bazat e teuhidit*”, Prishtinë (pa vit botimi), fq. 145.

Cilësi më e rëndësishme e Allahut xh.sh. është vuxhudi-ekzistenca. Kur’ani e verifikon ekzistencën e Zotit xh.sh., duke e parashtruar në mënyra të ndryshme; herë duke e paraqitur gjithësinë si krijesë të Tij, herën si Kujdestar i pashoq, herë si i Pafillim e i Pambarim, ku të gjitha krijesat e tjera kanë fillimin dhe mbarimin, etj., si p.sh.:

ذَٰلِكُمْ اللَّهُ رَبُّكُمْ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ خَلَقَ كُلَّ شَيْءٍ فَأَعْبُدُوهُ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ  
وَكَيلٌ ﴿١٠١﴾

“Ky është Allahu, Zoti juaj, nuk ka të adhuruar përveç Tij, Krijues i çdo sendi, pra adhurojeni Atë; Ai është mbikëqyrës ndaj çdo sendi”. (En’am 102)

الَّذِي لَهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَلَمْ يَتَّخِذْ وَلَدًا وَلَمْ يَكُن لَّهُ شَرِيكٌ فِي الْمُلْكِ  
وَخَلَقَ كُلَّ شَيْءٍ فَقَدَرَهُ تَقْدِيرًا ﴿١٠٢﴾

“Vetëm Atij i takon sundimi i qiejve dhe i tokës, Ai nuk ka as fëmijë e as nuk ka shok në sundimin e Tij. Ai krijoi çdo gjë, duke e përsosur në mënyrë të qartë e të matur”. (Furkan 2)

Gjithashtu:

اللَّهُ الَّذِي رَفَعَ السَّمَوَاتِ بِغَيْرِ عَمَدٍ تَرَوْنَهَا ﴿١٠٣﴾

“Allahu është Ai që i ngriti qiejt pa ndonjë shtyllë. Ju i shihni ata”. (Err-Rrad 2)

وَهُوَ الَّذِي تُحْيِي وَيُمِيتُ وَلَهُ اخْتِلَافُ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴿١٠٤﴾

“Dhe Ai është që jep jetë dhe vdekje dhe vetëm Ai bën ndryshimin e natës e të ditës; si nuk e kuptoni?” (El-Muminun 80)

Nga Kur’ani Famëlartë dimë se dituria e Allahut ngërthen të gjitha gjërat dhe i përthekon të gjitha, me ç’rast thotë:

يَعْلَمُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَيَعْلَمُ مَا تُسْرُونَ وَمَا تُعْلِنُونَ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ ﴿١٠٥﴾

“Ai di gjithçka që përmbajnë qiejt dhe Toka. Ai i di të fshehtat tuaja dhe ato që i bëni haptazi. Allahu i di të gjitha ç’keni në zemrat tuaja”. (Tegabun 4)

Numri i ajeteve që flasin për njëshmërinë e Allahut xh.sh. dhe për cilësitë e Tij është shumë i madh. Por ne do t'i paraqesim disa prej tyre:

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ ﴿٢٠٠﴾

“Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje”. (Ali Imran 2)

وَاللَّهُمَّ إِلَهٌ وَاحِدٌ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ ﴿٢٠١﴾

“Zoti juaj është një Zot i vetëm! S’ka zot tjetër (të denjë për adhurim), përveç Atij, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!”. (Bekare163)

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ﴿٢٠٢﴾ اللَّهُ الصَّمَدُ ﴿٢٠٣﴾ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ ﴿٢٠٤﴾ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ ﴿٢٠٥﴾

“Thuaj: Ai, Allahu është Një! Allahu është Ai të cilit çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s’ka lindur kë, as është i lindur. Dhe askush me Të nuk i është i barabartë”. (El-Ihlas 1-4)

Po ashtu Kur’ani flet se Pafillmësia dhe Përhershmeria janë dy veti të Allahut xh.sh.:

هُوَ الْأَوَّلُ وَالْآخِرُ ﴿٢٠٦﴾

“Ai është i pari dhe i fundit”. (Hadid 3)

كُلُّ مَنْ عَلَيْهَا فَانٍ ﴿٢٠٧﴾ وَيَبْقَىٰ وَجْهَ رَبِّكَ ذُو الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ ﴿٢٠٨﴾

“...çdo gjë që është në të (në tokë) do të zhduket. E do të mbetet vetëm Zoti yt që është i madhëruar e i nderuar!”. (Err-Rrahman 26-27)

Kur’ani tregon se Zoti i Madhëruar është (Ekzistues) që nuk i ngjan askujt, ku thotë:

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ ﴿٢٠٩﴾ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿٢١٠﴾

“...*Askush nuk është si Ai, Ai dëgjon dhe i sheh të gjitha*”. (Esh-Shura 11)<sup>151</sup>

## 1.2. Dallimet ndërmjet Biblës dhe Kur'anit lidhur me cilësitë e Zotit

Më lart kemi ofruar citatet biblike lidhur me Njëshmërinë dhe cilësitë e Zotit. Po ashtu i kemi ofruar edhe citatet kur'anore lidhur me to.

Ndërsa tani do t'ua paraqesim anën tjetër të medaljes të civateve nga Bibla, posaçërisht ato lidhur me Njëshmërinë dhe atributet e Zotit do të vërejmë: blasfemi, shpifje, të pavërteta në lidhje me Zotin, ku shihet dhe vërehet qartazi ndërhyrja e dorës njerëzore dhe falsifikimi i disa pjesëve të Biblës.

Popujt e ndryshëm gjatë historisë, u përpoqën ta besojnë Zotin, duke e personifikuar Atë, duke e identifikuar me shumë gjëra në këtë gjithësi, si p.sh., me gurë, drunj, duke e përshkruar Zotin me veti të njeriut, po ashtu, duke e përshkruar edhe si një gjallesë të jashtëzakonshme etj.

Një përshkrim i tillë është bërë edhe në Bibël në të cilën gjenden aspekte kontradiktore, ku, siç pamë, në disa vende kërkohet Njëshmëria, mosgjasimi i Zotit me krijesat e Tij, adhurimi i vetëm i Tij, e në vazhdim do të vërejmë të kundërtën e këtyre kërkesave, ku do të bëjmë dallimin në mes ajeteve kur'anore në lidhje me cilësitë dhe atributet absolute që i posedon Zotit i Madhëruar, duke i krahasuar me cilësitë që ia përshkruan Bibla Zotit e që janë të mangëta, dhe nuk i përkasin Zotit, por zotave të imagjinuar sipas mendjes së njeriut.

- Sipas Biblës, Zoti lodhet, prandaj ndien nevojën për pushim, pikërisht si krijesat e tjera e jo krijues:

“... *sepse në gjashtë ditë Zoti bëri qiellin dhe tokën, dhe ditën e shtatë pushoi dhe u çlodh*”. (Exodi 31:17)

“*sepse në gjashtë ditë Zoti krijoi qiejt dhe tokën, detin dhe gjithçka që është në to, dhe ditën e shtunë ai pushoi*” (Exodi 20:11 shih edhe te Zanafilla 2:2)

<sup>151</sup> Allahu i Lartëmadhëruar nuk varet nga krijesat e Veta, e as që i janë ato të nevojshme, Ai ekziston nga vetvetja (shih: El-Fatir 15-17; Nahl 51); flet për gjithmundësinë e Allahut dhe tregon se gjithçka e sheh në gjithësi është veprimtari e gjithmundshme krijuese (shih: Nur 45; Fatir 3) etj.

Ndërsa Kur'ani Famëlartë, tregon qartazi se Zoti nuk e posedon këtë cilësi të lodhjes-çlodhja:

وَلَقَدْ خَلَقْنَا السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ وَمَا مَسَّنَا مِنْ لُغُوبٍ ﴿٣٨﴾

*“Ne i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çdo gjë që gjendet ndërmjet tyre për gjashtë ditë, pa ndier lodhje aspak.”* (Kaf 38)

- Në Bibël thuhet se Jakobi luftoi me Zotin, madje Zoti pësoi disfatë nga ai:

*“Emri yt nuk do të jetë më Jakob, por Israel, sepse ti ke luftuar bashkë me Perëndinë dhe me njerëzit, dhe ke fituar”.* (Zanafilla 32:28)

A mund të ketë logjikë kjo që Zoti të luftojë me krijesën e Tij, siç ceket në citatin e lartpërmendur!? Në Kur'an thuhet:

مَا قَدَرُوا اللَّهَ حَقَّ قَدْرِهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَقَوِيٌّ عَزِيزٌ ﴿٧٤﴾

*“Ata nuk e çmojnë Allahun me vlerën e Tij të vërtetë. Vërtet, Allahu është i Fortë dhe i Plotfuqishëm”.* (El-Haxh 74)

- Bibla thotë se Zoti fle, bile edhe e përshkruan në një mënyrë të çuditshme:

*“Zgjohu! Pse fle, o Zot?”* (Psalmi 44:23)

*“Pastaj Zoti u zgjua si nga gjumi, ashtu si një trim që bërtet nën ndikimin e verës”.* (Psalmi 78:65)

*“Zgjohu dhe çobu, për të më siguruar drejtësi dhe për të mbrojtur çështjen time, o Perëndi dhe Zoti im”.* (Psalmi 35:23)

Kur'ani na tregon:

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ ۚ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ ﴿٢٥٥﴾

*“Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përgjeshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi!”.* (Bekare 255)

- Po ashtu Bibla e quan Zotin të Pamëshirshëm:

*“A do të më hedhë poshtë përgjithnjë Zoti? E nuk do të më pëlqejë më kurrë? Dhe mirësia e tij ka marrë fund për gjithnjë dhe falja e tij ka munguar për brezat e ardhshëm?”*

Vallë, Perëndia e ka harruar mëshirën dhe në zemërimin e tij u ka dhënë fund dhembshurive të tij?” (Psalm 77:7-9)

Zoti thotë në Kur’an:

قُلْ يٰۤاَعْبَادِيَ الَّذِيْنَ اَسْرَفُوْا عَلٰۤى اَنْفُسِهِمْ لَا تَقْنَطُوْا مِنْ رَّحْمَةِ اللّٰهِ ۚ اِنَّ اللّٰهَ يَغْفِرُ الذُّنُوْبَ  
 جَمِيْعًا ۗ اِنَّهٗ هُوَ الْغَفُوْرُ الرَّحِيْمُ ﴿٥٣﴾

“Thuaj: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti”. (Zumer 53)

- Te Zanafilla 3:8, tregohet se si Zoti ecën në kopsht dhe për ta gjetur njeriun që fshihet prej Tij, Zotit i duhet ta kërkojë. Po ashtu tregon edhe një pjesë të paditurisë së Zotit, siç tregohet në Bibël:

“Pastaj dëgjuan zërin e Zotit Perëndi që shëtiste në kopsht në flladin e ditës; dhe burri e gruaja e tij u fshehën nga prania e Zotit Perëndi midis pemëve të kopshtit. Atëherë Zoti Perëndi thirri njeriun dhe i tha: “Ku je?” Ai u përgjigj: “Dëgjova zërin tënd në kopsht, dhe pata frikë, sepse isha lakuriq dhe u fsheha”. Dhe Perëndia i tha: “Kush të tregoi se ishe lakuriq? Mos vallë ke ngrënë nga pema që unë të kisha urdhëruar të mos haje?”.

Ndërsa ajetet kur’anore tregojnë:

وَلِلّٰهِ الْمَشْرِقُ وَالْمَغْرِبُ ۚ فَاَيْنَمَا تُوَلُّوْا فَوَجْهُ اللّٰهِ ۚ اِنَّ اللّٰهَ وَّاسِعٌ عَلِيْمٌ ﴿١١٥﴾

“Të Allahut janë edhe (anët nga) lindja edhe perëndimi dhe ngado që të ktheheni, aty është anë e Allahut. Vërtet, Allahu është Gjithpërfshirës dhe i Gjithëdijsëm”. (Bekare 115)

وَهُوَ اللّٰهُ فِي السَّمٰوٰتِ وَفِي الْاَرْضِ ۗ يٰۤاَعْلَمُ سِرِّيْكُمْ وَجَهْرِكُمْ وَيَعْلَمُ مَا تَكْسِبُوْنَ ﴿٣٠﴾

“Ai është Allahu (që adhurohet e madhërohet prej çka ka në qiej dhe në tokë); Ai i di fshehtësitë dhe publikimet tuaja dhe Ai e di atë që bëni”. (Enam 3)



- Këtu Bibla e përshkruan Zotin si një gjallesë të jashtëzakonshme dhe si një Zot që kalëron mbi një Kerubin<sup>152</sup>:

*“Atëherë toka u trondit dhe u drodh, themelet e qiejve u lëkundën dhe u shkundën, sepse ai ishte tërë zemërim. Një tym ngjitej nga fejszat e hundës së tij dhe një zjarr përvëlues i dilte nga goja; prej tij dilnin thëngjij. . . Ai rrinte kaluar mbi një kerubin, fluturonte dhe dukej mbi flatrat e erës”. (2 Samueli 22:8-11)*

Kur’ani thotë të mos i përshkruani Allahut asnjë send si Ai, të mos i përshkruani shembuj, ku thotë:

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ ۖ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿١١﴾

*“Asnjë send nuk është si Ai; Ai është dëgjuesi, shikuesi”. (Esh-Shura 11)*

فَلَا تَصْرَفُوا لِلَّهِ الْأَمْثَالَ ۚ إِنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ ﴿٧٤﴾

*“Andaj, mos e krahasoni asnjë me Allahun! Në të vërtetë, Allahu di, ndërsa ju nuk dini”. (En-Nahl 74)*

- A mund të shihet Zoti? Bibla thotë:

*“Atëherë Jakobi e quajti këtë vend Peniel, sepse tha: “E pashë Perëndinë ballë për ballë dhe jeta ime u fal”. (Zanafilla 32:30)*

*“Pastaj Moisiu dhe Aaroni, Nadabi dhe Abihu dhe shtatëdhjetë nga pleqtë e Izraelit u ngjitën, dhe panë Perëndinë e Izraelit”. (Exodi 24:9-10)<sup>153</sup>*

Ndërsa Kur’ani Famëlartë thotë:

لَا تَدْرِكُهُ الْأَبْصَارُ وَهُوَ يُدْرِكُ الْأَبْصَارَ ۖ وَهُوَ اللَّطِيفُ الْخَبِيرُ ﴿٢٥٥﴾

<sup>152</sup> Kerubinë sipas botëkuptimit biblik (në hebraisht *kerub*, shumë *kerubim*). Kerubinët, edhe pse krijesa qiellore dhe frymore si engjëjt, dallohen nga ata, sepse engjëjt janë përdorur nga Perëndia sidomos si lajmëtarë, ndërsa kerubinët, përveçse e shoqërojnë lavdinë dhe shenjtërinë e Perëndisë, kanë detyrë ta pengojnë njeriun mëkatar t’i afrohet Perëndisë, sepse është i shenjtë dhe burim i jetës. (*Bibla - Diodati i ri*, përkthim në gjuhën shqipe 1991-94, (Pjesa II), fq. 323-324.)

<sup>153</sup> Shih edhe këto citate biblike ku tregohet se e kanë parë edhe të tjerët Zotin, si Amosi (Amosi 7:7), Isaia (Isaia 6:1), Abrahami (Zanafilla 18:1), etj. Ndërsa, në anën tjetër, Bibla bie në kontradiktë në mes citateve të saj, ku tregohet se “askush s’e ka parë Perëndinë kurrë dhe s’mund ta shohë askush”, shiko: Gjoni 1:18; 1 Gjoni 4:12; 1 Timoteu 6:16, etj.

*“Shikimet njerëzore nuk mund ta arrijnë Atë, ndërkohë që Ai i arrin shikimet e të gjithëve. Ai është Bamirës i pakufi dhe di çdo gjë”.* (El-Enam 103)

- Zoti dhe fëmijët e Tij! Bibla thotë:

*“Kështu thotë Zoti: Izraeli është biri im, i parëlinduri im”.* (Exodi 4:22)

*“Por Zoti e pa këtë dhe i hodhi poshtë, për shkak të provokimit të bijve të tij dhe të bijave të tij”.* (Ligji i Perterire 32:19)

*“Ti je im Bir, sot ti më linde”.* (Hebrenjve 5:5)

*“Do të shpallë dekretin e Zotit. Ai më ka thënë: “Ti je biri im, sot më linde”.* (Psalm 2:7)

- A mund të ketë Zoti fëmijë? (I Pastër qoftë Zoti nga ata që ia përshkruajnë). Kur’ani thotë:

وَيُنذِرَ الَّذِينَ قَالُوا اتَّخَذَ اللَّهُ وَلَدًا ۗ مَا لَهُمْ بِهِ مِنْ عِلْمٍ وَلَا لِابَائِهِمْ كَبُرَتْ  
كَلِمَةً خَازِجًا مِنْ أَفْوَاهِهِمْ ۚ إِنَّ يَقُولُونَ إِلَّا كَذِبًا ۗ

*“Për t’ua tërhequr vërejtjen atyre që thanë se Allahu ka fëmijë. Ata nuk kanë kurrfarë dijenie për këtë, as etërit e tyre. Sa fjalë e rëndë është ajo që del nga goja e tyre! Ata flasin vetëm gënjeshtër”.* (El-Kehf 4-5)

وَقَالَتِ الْيَهُودُ وَالنَّصَارَىٰ حَسُنَ آتَيْنَا اللَّهَ وَالْحَيُّوهُ ۗ قُلْ فَلِمَ يُعَذِّبُكُمْ بِذُنُوبِكُمْ بَلْ أَنْتُمْ  
بَشَرٌ مِمَّنْ خَلَقَ يَغْفِرُ لِمَن يَشَاءُ وَيُعَذِّبُ مَن يَشَاءُ ۗ وَلِلَّهِ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا  
بَيْنَهُمَا وَإِلَيْهِ الْمَصِيرُ ۗ

*“Hebrenjtë dhe të krishterët thanë: “Ne jemi bijtë e Allahut dhe të dashurit e Tij”. Thuaju: “Atëherë, përse Ai ju dënon për shkak të gjynaheve tuaja?” Jo, ju jeni njerëz që Ai ju krijoi. Ai fal kë të dojë dhe dënon kë të dojë. Sundimi i qiejve, i tokës dhe i gjithë asaj që ndodhet në mes tyre është vetëm i Allahut dhe vetëm tek Ai është e ardhmja”.* (El-Maide 18)

وَقَالُوا اتَّخَذَ اللَّهُ وَلَدًا ۗ سُبْحٰنَهُ ۗ بَلْ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ كُلُّ لَّهُ قَدْتُونَ ۗ  
بَدِيعَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَإِذَا قَضَىٰ أَمْرًا فَإِنَّمَا يَقُولُ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ ۗ

“Ata thonë: “Allahu ka fëmijë”. I Lavdishëm dhe i Lartësuar qoftë Ai! Përkundr-  
azi, Atij i përket çdo gjë që gjendet në qiej e në Tokë dhe Atij i nënshtrohet gjithçka.  
Ai është Krijuesi i qiejve dhe i Tokës, pa shembull të mëparshëm dhe, kur vendos për  
diçka, vetëm thotë për të: “Bëhu!” - dhe ajo bëhet”. (Bekare 116-117)

Pos ajeteve të lartpërmendura, gjithashtu Allahu i Plotfuqishëm tërheq vërej-  
tjen duke ua bërë me dije atyre që pretendojnë se Zoti ka fëmijë, duke iu thënë si  
do të ketë Zoti fëmijë kur Ai nuk pati bashkëshorte, por Zotit Fuqiptotë nuk i ta-  
kon të ketë as bashkëshorte e as fëmijë. (I lartësuar është Ai nga shpifjet që i bë-  
hen)

بَدِيعَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ أَنِّي يَكُونُ لَهُ وُلْدٌ وَلَمْ تَكُنْ لَهُ صَاحِبَةٌ وَخَلَقَ كُلَّ شَيْءٍ  
وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿١٠١﴾

“Ai është Krijuesi i qiejve dhe i Tokës! E si mund të ketë Ai fëmijë, ndërkohë që  
nuk ka bashkëshorte?! Ai ka krijuar çdo gjë dhe është i Dijshtëm për çdo gjë”. (El-  
Enam 101)

وَأَنَّهُ تَعَلَّى جَدُّ رَبِّنَا مَا اتَّخَذَ صَاحِبَةً وَلَا وَلَدًا ﴿٣٠﴾

“Qoftë lartësuar Madhëria e Zotit tonë! Ai nuk ka zgjedhur as bashkëshorte, as  
bir”. (El-Xhin 3)

Gjithashtu Kur’ani Famëlartë tregon:

وَقَالُوا اتَّخَذَ الرَّحْمَنُ وَلَدًا ﴿١٨﴾ لَقَدْ جِئْتُمْ شَيْئًا إِدًّا ﴿١٩﴾ تَكَادُ السَّمَوَاتُ يَتَفَطَّرْنَ مِنْهُ  
وَتَنْشَقُّ الْأَرْضُ وَخُرُّ الْجِبَالُ هَدًّا ﴿٢٠﴾ أَنْ دَعَوْا لِلرَّحْمَنِ وَلَدًا ﴿٢١﴾ وَمَا يَنْبَغِي لِلرَّحْمَنِ أَنْ  
يَتَّخِذَ وَلَدًا ﴿٢٢﴾

“Ata thanë: “I Gjithëfuqishmi ka fëmijë”. Ju (jobesimtarë) vërtet sollët një fjalë  
shumë të shëmtuar. Aq të shëmtuar sa gati u copëtuan qiejt, gati pëlciti toka dhe gati  
u shembën kodra nga ajo (fjalë). Për atë se të Gjithëmëshirshmit i përshkruan fëmijë.  
E të Gjithëmëshirshmit nuk i takon të ketë fëmijë”. (Merjem 88-92)

- Relativiteti i diturisë së Zotit dhe nga mosdija e Tij urdhëron njeriun që në disa shtëpi të vendosë nga një shenjë, që, kur të kalojë Zoti pranë dhe ta shohë shenjën në atë shtëpi, Ai nuk do ta zhdukë, siç tregohet:

*“Dhe gjaku do të jetë për ju një shenjë mbi shtëpitë ku ndodheni; kur unë të shoh gjakun do të kaloj tutje dhe nuk do të ketë plagë mbi ju për t’ju zhdukur, kur të godas vendin e Egjiptit”.* (Exodi 12:13)

Ndërsa Kur’ani thotë:

وَعِنْدَهُ مَفَاتِحُ الْغَيْبِ لَا يَعْلَمُهَا إِلَّا هُوَ وَيَعْلَمُ مَا فِي الْبُرِّ وَالْبَحْرِ وَمَا تَسْقُطُ مِنْ وَرَقَةٍ إِلَّا يَعْلَمُهَا وَلَا حَبَّةٍ فِي ظُلْمَتِ الْأَرْضِ وَلَا رَطْبٍ وَلَا يَابِسٍ إِلَّا فِي كِتَابٍ مُبِينٍ ﴿١٠٨﴾

*“Ai i ka çelësat e së padukshmes dhe vetëm Ai i njeh ata. Ai e di çfarë ka në tokë dhe në det; asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Leuhi Ma-hfudh)”.* (En’am 59)

قُلْ أَنْزَلَهُ الَّذِي يَعْلَمُ السِّرِّ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ إِنَّهُ كَانَ غَفُورًا رَحِيمًا ﴿١٠٩﴾

*“Thuaj: Atë e ka shpallur Ai që di fshehtësitë e qiejve dhe të Tokës. Ai fal shumë dhe është Mëshirues”.* (Furkan 6)

- Zoti e dënon njeriun për shkak të fajit të etërve të tyre! Bibla thotë:

*“Përgatitni masakrën e bijve të tij për shkak të paudhësisë së etërve të tyre”.* (Isaia 14:21)

Allahu xh.sh. në Kur’an na tregon se askush nuk e bartë barrën dhe paudhësinë e tjetrit, por gjithsecili është përgjegjës për punën e vet:

قُلْ أَغَيْرَ اللَّهِ أَبْغَىٰ رَبًّا وَهُوَ رَبُّ كُلِّ شَيْءٍ وَلَا تَكْسِبُ كُلُّ نَفْسٍ إِلَّا عَلَيْهَا وَلَا تَزِرُ وَازِرَةٌ وِزْرَ أُخْرَىٰ ۗ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّكُمْ مَرْجِعُكُمْ فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنتُمْ فِيهِ تُخْتَلِفُونَ ﴿١٠٩﴾

*“Thuaj: “A mos vallë do të kërkoj unë tjetër zot, përveç Allahut, kur Ai është Zoti i gjithçkaje? Kushdo që bën diçka, punon për vete dhe askush nuk ngarkohet me barrën e tjetrit. Pastaj të gjithë do të ktheheni te Zoti juaj dhe Ai do t’ju tregojë për kundërshtitë që kishit mes jush”.* (En’am 164)

- Po ashtu Bibla tregon se Zoti pendohet që ka krijuar njeriun në sipërfaqen e tokës:

*“Dhe Zoti u pendua që kishte krijuar njeriun mbi tokë dhe u brengos për këtë në zemër të vet. Kështu Zoti tha: “Unë do të shfaros nga faqja e dheut njeriun që kam krijuar, duke filluar nga njeriu deri te kafshët, te rrëshqanorët, te zogjtë e qiellit, sepse pendohem që i kam krijuar”. (Zanafilla 6:6-7)*

- Një tjetër cilësi të Zotit, që e tregon Bibla dhe që bie ndesh mes citateve të saja, është çështja e gënjeshtërisë dhe mospremtimit të Zotit!

Në Bibël thuhet se Zoti e gënjen Adamin se do vdesë ditën që do hajë frutën, por Adami jeton edhe pas asaj, largohet nga Edeni dhe jeton 930 vjet (Zanafilla 2:17 dhe 5:3-5).

*“por mos ha nga pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes, sepse ditën që do të hash prej saj ke për të vdekur me siguri”. (Zanafilla 2:17)*

*“Adami jetoi njëqind e tridhjetë vjet dhe i lindi një djalë që i përngjiste, një lloj në shëmbëlltysë të tij dhe e quajti Seth. Mbas lindjes së Sethit, Adami jetoi tetëqind vjet dhe pati bij dhe bija. Kështu Adami jetoi gjithsej nëntëqind e tridhjetë vjet; pastaj vdiq”. (Zanafilla 5:3-5)*

Gjithashtu thuhet: *“Zoti nuk gënjen, nuk e ndryshon mendjen, nuk do të pendohet”* (1 Samuelit 15:29), ndërsa te 2 Selanikasve 2:11 thuhet se *“Zoti gënjen”*.<sup>154</sup>

Zoti profetizon se qyteti i Tirot do shkatërrohet, banorët e tij do të vriten, mallrat e tyre do të plaçkiten dhe në gërmadhat e qytetit nuk do të ringrihet më qytet. (Ezekieli 26:7-14<sup>155</sup>) Pak më poshtë (Ezekieli 29:18-20<sup>156</sup>), Tiro jo vetëm

<sup>154</sup> Po ashtu Bibla thotë: *“Për zotin është e pamundur të gënjejë”* (Hebrenjve 6:18 - gjë që tregon se nuk është as “i gjithëfuqishëm”), ndërsa (te Jona 3:10, 1 Samueli 2:30) *Ndryshon mendje dhe nuk bën atë që thotë.*

<sup>155</sup> *“Sepse kështu thotë Zoti, Zoti: “Ja, unë sjell nga veriu kundër Tiros Nebukadnetsarin, mbretin e Babilonisë, mbretin e mbretërve, me kuaj, me qerre, me kalorës dhe një shumicë të madhe njerëzish. Ai do të vrasë me shpatë bijat e tua që janë në fshat, do të ngrrejë kundër teje kulla, do të ndërtojë kundër teje një ledh dhe do të ngrrejë kundër teje një çati mburojash. Do të drejtojë kundër mureve të tua deshtë e tij dhe do të rrezojë kullat e tua me kazmat e tij. Për shkak të morisë së kuajve të tij do të mbulohesh nga pluhuri i tyre; muret e tua do të dridhen nga zhurma e kalorësve, të rrotave dhe të qerreve, kur të hyjë nëpër portat e tua, ashtu siç hyhet në një qytet nëpër të cilin është hapur një e çarë. Me këmbët e kuajve të tij do të shkelë tërë rrugët e tua, do të vrasë*

që nuk shkatërrohet (dhe ekziston akoma dhe sot), por qëndresa e tij qe aq e fortë saqë ushtria babilonase iku me bisht në shalë, e as vrau, preu, plaçkiti e shkatërr-oi! Kështu që “zoti” e mendon dhe një herë dhe, që të mos e lërë duarthatë, ia premtoi kësaj radhe Egjiptin...

Pra, me këto citate biblike që i cekëm, doemos na imponohet pyetja: Vallë, a mund të jetë Zoti i tillë, me këto cilësi siç e përshkruan Bibla? Përshkrimet e tilla jo vetëm që nuk gjenden në Kur’an, por konsiderohen si kufër (mosbesim) ndaj Madhërisë së Allahut xh.sh. Allahu i Madhëruar në Kur’anin Famëlartë thotë:

سُبْحٰنَ رَبِّكَ رَبِّ الْعِزَّةِ عَمَّا يَصِفُوْنَ ﴿١٨٠﴾

*“I Lartësuar është Zoti yt, Zot i fuqisë nga ajo që ia përshkruajnë”.* (Saffat 180)

Pra, si është e mundur që të jenë kontradiktore kërkesat e Zotit? Dhe si Zoti e kthen Njeshmërinë e Tij në idhujtari?! Këtu shihet qartë ndërhyrja e dorës së njeriut në librin e shenjtë, kurse Kur’ani Fisnik pandërprerë i kërkon njeriut të mos i shoqërojë Atij asgjë, si në ekzistencë, Njeshmëri, e në të gjitha cilësitë e tjera. Përputhja mes disa citateve biblike, dhe ajeteve kur’anore tregon se disa citate kanë arritur t’i shpëtojnë dorës së njeriut; përndryshe do të mbetej kërkesa unike për ekzistencën e Allahut, Njeshmërinë e Tij, adhurimin dhe cilësitë e tjera, pikërisht siç është në Kur’anin Famëlartë.

---

*popullin tënd me shpatë dhe shtyllat e tua të fuqishme do të rrezohen. Do të grabitin pasuritë e tua, do të plaçkitin mallrat e tua, do të rrezojnë muret e tua, do të shkatërrojnë shtëpitë e tua të bukura, do të hedhin në mes të ujit gurët e tua, drurin tënd dhe tokën tënde. Do të bëj të pushojë zhurma e këngëve të tua dhe zëri i harpave të tua nuk do të dëgjohet më. Do të të bëj si një shkëmb të zhveshur; do të jesh një vend për të nderur rrjetat; nuk do të rindërtohesh më, sepse unë, Zoti, fola, thotë Zoti, Zoti”.* (Ezekieli 26:7-14)

<sup>156</sup> *“Bir njeriu, Nebukadnetsari, mbreti i Babilonisë, e vuri ushtrinë e tij në një shërbim të rëndë kundër Tiros; çdo kokë është bërë e shogët dhe çdo shpatull e rrjepur; por as ai, as ushtria e tij nuk kanë nxjerrë nga Tiro ndonjë shpërblim për mundin që kanë bërë kundër tij”. Prandaj kështu thotë Zoti, Zoti: “Ja, unë i jap Nebukadnetsarit, mbretit të Babilonisë, vendin e Egjiptit; ai do të marrë pasuritë e tij; ai do të marrë me vete robër dhe do ta plaçkitë; dhe ky do të jetë shpërblimi për ushtrinë e tij. Për mundin që ke bërë kundër tij unë i jap vendin e Egjiptit, sepse kanë punuar për mua”, thotë Zoti, Zoti”.* (Ezekieli 29:18-20)

Nga kjo që u tha më lart dhe që do të cekim në vijim, del se çdo vepër që ngërthen në vete çështje kontradiktore nuk mund të jetë nga Absoluti, por nga krijesat relative, që kanë të meta, prandaj edhe veprat e tyre janë me të meta.

Në këtë vërejtje dhe mësim Allahu xh.sh. na udhëzon, kur thotë:

أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْفُرْعَانَ ۚ وَلَوْ كَانَتْ مِنْ عِنْدِ غَيْرِ اللَّهِ لَوَجَدُوا فِيهِ أَحْتِلَافًا كَثِيرًا ﴿٨٢﴾

*“A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kur’anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie”.* (Nisa 82)

## 2. Trajtimi biblik dhe kur’anor ndaj Jezusit/ Isait a.s.

Muslimanët shtangën nga habia kur lexojnë shkollarë të dëgjuar, specialistë dhe, çka është më e keqja, klerikë, që i përshkruajnë islamit dhe muslimanët si armiq të Jezu Krishtit/ Isait a.s. Po ashtu, shumë krishterë të painformuar dhe të keqinformuar, çuditen kur u tregojmë për respektin dhe dashurinë që kemi për Jezusin/ Isanë a. s. dhe Marinë/ Merjemen, ndonëse kemi ndryshime doktrimore.<sup>157</sup>

Kur’ani është burimi për njohjen e Isait a. s. /Jezusit, që është i panjohur edhe për shumë studiues të krishterizmit. Kur’ani na udhëzon ta njohim mirë Isanë a.s., por, në të njëjtën kohë, na shton respektin dhe dashurinë ndaj tij e ndaj nënës së tij.

Kur’ani nuk na tregon jetën e Isait në hollësi, por na tregon dhe na informon gjërat më kryesore, të cilat duhet t’i dimë, ngase kemi dobi e duhet pasuar në jetën tonë të përditshme dhe që të largohemi nga gënjeshttrat e sajura nga të krishterët ndaj Isait a.s. Kur’ani na shtjellon historinë e Isait a.s. /Jezusit në ato pika më kryesoret si: lindja e tij, mrekullitë, misioni i tij dhe shumë gjëra të tjera.

<sup>157</sup> Hassan Hathout, *“Leximi i mendjes së muslimanit”*, fq. 23.

Emri i Isait a. s. përmendet në Kur'an 25 herë në 11 sure, kurse si Mesih<sup>158</sup> përmendet 11 herë në 4 sure, e gjithsej bëhen 36 herë në 12 sure.<sup>159</sup> Në shumicën e rasteve emri i tij vjen i ngjitur me emrin e nënës, Isai, i biri i Merjemes, duke hedhur poshtë aludimin që Isai a. s./ Jezusi është i biri i Zotit.

Muslimanët janë të obliguar të respektojnë e ta besojnë Isanë a.s./Jezusin si pejgamber/profet dhe se duhet ta nderojnë nënën e tij, Merjemen.

### 2.1. Nderimi i Merjemes / Marisë

Në Kur'an, edhe nëse e kërkojmë, nuk mund ta gjejmë emrin e babait ose nënës së Muhamedit s.a.v.s. Nuk do t'i gjejmë as emrat e grave, ose vajzave të tij, e as emrat e shokëve të dashur të tij<sup>160</sup>. Është për t'u habitur! Megjithatë, në

<sup>158</sup> Fjala apo emri "Mesiu" gjendet edhe në Bibël. Të krishterët krenohen duke menduar se ky emër iu dha vetëm Jezusit si "Mesiu" dhe ka një vlerë të lartë deri në atë shkallë sa ta quajmë të shenjtë, apo ta hyjnzojnë në rastin konkret si Zot, apo si i biri i Tij. Mirëpo, nëse e lexojmë Biblën do të vërejmë shumë persona të tjerë me këtë emër. Fjala Mesih-MESIU: U përkthye në "Krishti" (Gjoni1:41/ 4:25)- Mesiu është një emër shumë i zakonshëm në hebraisht. I përkthyer në greqisht ai bëhet "Cristos", i cili e ka kuptimin *i Vajosur!* Në çdo vend që paraqitet fjala "I vajosur" në përkthimin anglisht të Biblës (cilido version), ajo fjalë në hebraishten origjinale, në mënyrë të pandryshshme është fjala "Mesiu". Le të shohim disa shembuj në lidhje me këtë emër në Bibël: (a) "Unë jam Perëndia i Bethelit, ku ti ke Vajosur (Mesiu) një Përmendore... (Përmendorja e Krishtit?). Zanafilla 31:13; (b) 'Pastaj Moisiu mori vajin e Vajosjes (Mesiu) Vajosi (Mesiu) Tabernakullin... (Vaji i Krishtit! dhe vajosja e Krishtit ?). Levetiku 8:10; (c)...(Zoti) do t'i japë forcë mbretit të tij dhe do ta lartojë forcën e të vajosurit të tij (Mesiu). 1 Samuelit 2:10; (d) "Ti ishe një kerubin i vajosur (Mesiu)... (Krishti Kerubin?) Ezekiel 28:14; (e) "Kështu i thotë Zoti të vajosurit të tij (Mesiu) Kirit... (Krishti Kiri?) Isai 45:1; etj. Zoti i drejtohet madje edhe një mbreti pagan si Mesiut të tij, pra këtë emër, epitet e kanë poseduar edhe të tjerët dhe nuk është vetëm për Jezusin. (Më tepër lidhur me këtë shih: Ahmed Deedat, "Combat Kit", fq. 24-25).

<sup>159</sup> "Isai Biri i Merjemes a.s.", Omer Myrta, *Argumenti*, revistë mujore e botuar nga shtëpia botuese "Mirësia", Prishtinë, Shkurt, 2006, fq. 16; shiko edhe tek Hassan Hathout, "Leximi i mendjes së muslimanit", fq. 23.

<sup>160</sup> Në anën tjetër, ky është edhe një argument se Kur'anit nuk është vepër e Muhamedit a.s. Në qoftë se Muhamedi a.s. do të ishte autori i Kur'anit Famëlartë, po ashtu ai nuk do ta humbiste rastin për ta përfshirë në të me Merjemen, nënën e Isait a.s., edhe nënën e vet - Eminen, gruan e tij të dashur - Hatixhen ose vajzën e vet - Fatimen. Por jo! Kjo s'mund të ndodhte asnjëherë. Kur'anit nuk është krijim i mendjes së tij! Ai nuk mund të zgjidhte - ai nuk kishte të drejtë të fliste sipas ëndjes dhe mendimeve të tij personale. Por Zoti i Plotfuqishëm tha: "Sikur të trillonte ai (Muhamedi) për Ne ndonjë fjalë! Ne do ta kapnim atë me fuqinë Tonë. E pastaj do t'ia këputnim atij arterien e zemrës. Askush prej jush nuk do të mund të ndërhynte për



Kur'an do të gjeni një kaptinë të tërë që i kushtohet Merjemes, nënës së Isait a.s. /Jezusit, surja Merjem, kaptina e 19 e Kur'anit Fisnik. E emërtuar për nder të Merjemes, nënës së Isait a.s., nderim të cilin nuk e gjejmë t'i bëhet Merjemes në Biblën e krishterë, qoftë nga 66 librat protestantë (Bibla protestante) dhe 73 librat katolikë romanë (Bibla katolike), asnjëri prej tyre nuk është emëruar Maria, ose me emrin e djalit të saj Jezus.

Siç theksuam edhe më lart emri i Jezusit/ Isait a.s. është përmendur njëzetepesë herë, ndërsa emri i peygamberit, Muhamedit s.a.v.s. vetëm pesë herë. Arsyeja? A janë Isai a. s. dhe nëna e tij më të rëndësishëm se Muhamedi s.a.v.s. dhe nëna e tij? Jo! Aspak. Atëherë, pse ky ndryshim sa i përket paraqitjes në Kur'an? Thjesht për shkak se integriteti i Isait a.s. dhe nënës së tij ishte në rrezik. Kishte akuza të ndryshme të pasakta, insinuata dhe iluzione ndaj nënës dhe birit të saj që duheshin qartësuar. Prandaj, tregimi i lajmërimit, kuptimit të pastër dhe lindja e Isait a.s. duhej të shënoheshin. Kurrë askush nuk ka dyshuar në prejardhjen e peygamberit Muhamed s.a.v.s. në cilëndo kohë, prandaj asnjë fjalë nuk është harxhuar në tërë librin për lindjen e peygamberit, ose për prejardhjen e tij. Kur'ani nuk është jetëshkrim i Muhamedit s.a.v.s. Kjo gjë është e vështirë të kuptohet nga jobsimtari.<sup>161</sup>

Si Kur'ani ashtu edhe Bibla kur lexojmë për historinë e Merjemes/ Marisë, nënës së Isait a.s./Jezusit, na tregojnë se ajo ishte e bekuar dhe se Zoti e dalloi me besim dhe karakter, e gjithashtu e lartësoi mbi të gjitha gratë e botës.

Këtë e vërtetojnë si Bibla ashtu, edhe Kur'ani Famëlartë. Bibla fillimisht tregon kontaktin dhe dialogun ndërmjet Engjëllit dhe Marisë ku thotë se: *“Engjëlli hyri tek ajo dhe tha: “Tungjatjeta, o hirplote, Zoti është me ty; ti je e bekuar ndër gratë”*. (Luka 1:28)

Gjithashtu edhe Kur'ani Famëlartë bën fjalë për këtë dialog:

---

*mbrojtjen e tij*”. (Kur'an: Hakka 44-47) *“Ai (Muhamedi) nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kur'ani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet”* (Nexhm 3-4)

<sup>161</sup> Ahmed Deedat, *“Kur'ani-Mrekullia e mrekullive”*, Podujevë (pa vit botimi), fq. 52.

وَإِذْ قَالَتِ الْمَلَأِكَةُ يَمْرَمُ إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَاكِ وَطَهَّرَكِ وَأَصْطَفَاكِ عَلَى نِسَاءِ  
الْعَالَمِينَ

*“Rikujtoje kur engjëjt i thanë: “Oj Mejreme, Allahu të dalloj ty (me besim e karakter) dhe të lartësoi mbi gratë e botës”. (Ali Imran 42)*

Ajetet e Kur’anit na shtjellojnë dhe na tregojnë se Merjemja/ Maria ishte dhe do të jetë një grua e dalluar dhe e lartësuar mbi gratë e botës. Ajo ishte e drejtë dhe e ndershme, duke hedhur poshtë shpifjet që i bëhen nga hebrenjtë, të cilët e konsiderojnë atë të pamoralshme edhe sot e kësaj dite. Ndërkaq, të krishterëve u tregon se mos e ngrini në shkallën e hyjnisë, sepse si ajo po ashtu dhe Isai, fëmija i saj, ushqeheshin si njerëzit e tjerë. Allahu xh.sh. ua sqaron argumentet e tyre, por ata pastaj ia kthejnë shpinën të vërtetës.

مَا الْمَسِيحُ ابْنُ مَرْيَمَ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِ الرُّسُلُ وَأُمُّهُ صِدِّيقَةٌ كَانَا  
بِأَكْلَانِ الطَّعَامِ أَنْظِرْ كَيْفَ نَبِيِّنَّ لَهُمُ الْآيَاتِ ثُمَّ أَنْظِرْ أَنِّي يُؤْفَكُونَ

*“Mesihu, bir i Merjemes, nuk është tjetër, vetëm se i dërguar; para tij pati shumë të dërguar. Nëna e tij ishte e drejtë (e ndershme). Që të dy ata ishin që ushqeheshin (si njerëzit tjerë). Ja, si u sqarohen atyre argumentet dhe shih pastaj sesi ia kthejnë shpinën të vërtetës!” (Maide 75)*

Një ndër çështjet më kontradiktore në historinë te të krishterët, ashtu siç përmendëm më herët, është çështja e Marisë /Merjemes dhe e birit të saj. A është ajo nënë e njeriut, apo e zotit?! A e lindi ajo zotin, apo njeriun? Nëse ajo e ka lindur zotin, qenia e saj çfarë duhet të jetë? Me këtë këndvështrim ajo duhet të jetë hyjneshë? Dhe sërish kemi kthimin në paganizmin e lashtë grek, në hyjni dhe hyjneshë të shpikura nga imagjinata njerëzore, e jo në të kundërtën për të cilën kishte ardhur h. Isau a.s./ Jezusi, që vetëm një Zot të vërtetë ta adhuronin njerëzit, siç bënin nëna e tij Merjemja/ Maria dhe ai a.s.

## 2.2. Njerëzorja e Jezusit / Isait a. s.

Po ashtu ndër çështjet më kontradiktore është edhe çështja e Isait a.s. (Jezus-it). A ishte ai krejtësisht hyjnor apo krejtësisht njeri? A ishte Pejgamber, çfarë ishte misioni i tij, si e përshkruan Bibla këtë person? Në Bibël, përkatësisht në Dhia-tën e Re, ende gjenden tekste të shëndosha që përputhen me logjikën e shëndoshe, gjegjësisht me Kur'anin Famëlartë, edhe pse Bibla ka pësuar ndryshime të shumta. Bibla e tregon qartë se Jezusi ishte njeri i aprovuar nga Perëndia për një mision të caktuar te populli i tij, te kopeja e humbur e Izraelit<sup>162</sup>.

Citatet biblike vërtetojnë se Jezusi nuk mund të jetë Zot, sepse këto cilësi apo veti që do t'i cekim janë të njeriut dhe jo të vetë Zotit (I pastër qoftë nga ato që ia përshkruajnë).

### - Prejardhja e Jezusit:

*"Pasardhës i mbretit David"* (Romakëve 1:3), *"Pasardhës i Davidit dhe Abrahamit"* (Mateu 11:19).

### - Jezusi, bir i njeriut:

*"Erdhi Biri i njeriut, që ha dhe pi..."* (Mateu 11:19), *"Biri i njeriut do t'u dorëzohet në duart e njerëzve"* (Mateu 17:22), *"Me të vërtetë ky njeri ishte i drejtë!"* (Lluka 23:47).

### - Lindja e Jezusit:

*"Dhe ajo lindi djalin e saj të parëlindur, e mbështolli me pelena dhe e vendosi në një grazhd"* (Lluka 2:7), *"ju do të gjeni një fëmijë të mbështjellë me pelena, të shtrirë në një grazhd"* (Lluka 2:12)

### - Synetimi i Jezusit:

*"Dhe kur kaluan të tetë ditët, pas të cilave ai duhej rrethprerë, ia vunë emrin Jezus"* (Lluka 2:21)

### - Gjinia e Jezusit:

*"Dhe ajo do të lindë një djalë..."* (Mateu 1:21)

<sup>162</sup> Kështu e quan Bibla Jezusin, sepse ai erdhi veç te populli i Izraelit, siç thuhet te Mateu 15:24: *"Unë nuk jam dërguar gjetiu, përveç te delet e humbura të shtëpisë së Izraelit"*.

- Familja e Jezusit:

*“A nuk është ky i biri i marangozit?”<sup>163</sup> Nuk quhet nëna e tij Mari dhe vëllezërit e tij Jakob, Iose, Simon dhe Juda?” (Mateu 13:55)*

- Babai i Jezusit:

*“Jezusin nga Nazareti, të birin e Jozefit!” (Gjoni 1:45), “Bir, pse na e bërë këtë? Ja, yt atë dhe unë, në ankth, po të kërkonim!”<sup>164</sup> (Lluka 2:48)*

- Zhvillimi i Jezusit:

*“Ndërkaq fëmija rritej dhe forcohej”... “kur ai i mbushi dymbëdhjetë vjeç”... “Dhe Jezusi rritej në dituri, në shtat” (Lluka 2:40/42/52)*

- Profesioni i Jezusit:

*“A nuk është ky i biri i marangozit” (Mateu 13:55); “A s’është ky zdrukthëtar, i biri Marisë” (Marku 6:3)*

Nga citatat kuptojmë se Jezusi/Isai a.s. ishte i lindur, kishte prejardhje, ishte bir i njeriut, kishte gjini, kishte familje, ishte bërë synet, zhvillohej, ishte zdrukthëtar etj. etj. Vallë a mund t’i ketë Zoti këto cilësi apo veti, siç pretendojnë se Jezusi është zot. Si mund të jetë Jezusi zot kur ishte i lindur. Vallë, a lind Zoti?! A ka logjikë kjo?! A mund të lindë Zoti? Çdo njeri që lind edhe vdes. A vdes Zoti? Nëqoftëse lind dhe vdes, atëherë nuk meriton të llogaritet për Zot. A meriton Zoti të jetë foshnjë e mbështjellë me pelena dhe e vendosur në grazhd?! Jezusi mësonte, zhvillohej trupërisht, siç zhvillohen fëmijët e tjerë, të gjitha këto janë veti njerëzore e jo të Zotit, sepse Zoti nuk rritet, nuk u nënshtrohet rregullave biologjike dhe fizike siç u nënshtrohet njeriu.

---

<sup>163</sup> Bibla, Jezusin e quan si i biri i marangozit (zdrukthëtarit), biri i Jozefit. Është një argument në të cilin hedh poshtë pretendimin e Jezusit si bir i Perëndisë. Këtu vërejmë një kontradiktë: i biri i Jozefit, apo i biri i Zotit?! Mirëpo, në të njëjtën kohë, Bibla tregon se Jezusi paska pasur një familje shumanëtarëshe, a mund të ketë Zoti familje, nënë, baba, vëllezër?

<sup>164</sup> Madje, Bibla shkon aq larg sa ia zhvesh atij edhe mrekullinë e lindjes që ia pohon Kur’ani Famëllartë, sa që i emërton atij baba nga i cili ka lindur. Sipas Kur’anit, Jezusi s’ka pasur baba, por ishte një mrekulli e Zotit që ta krijonte ashtu. Mirëpo, ne po i referohemi Biblës në mënyrë që t’ua sqarojmë të krishterëve se si ka mundësi që, në të njëjtën kohë, Jezusi të ketë baba Jozefin, të ketë baba Zotin, e gjithashtu, në të njëjtën kohë, të jetë edhe Zoti!?

- Jezusi i pamësuar:

*“Jezusi u ngjit në tempull dhe mësonte”* (Gjoni 7:14)

- Jezusi qanë:

*“Jezusi qau”* (Gjoni 11:35)

- Jezusi i pafuqishëm:

*“Unë s’mund të bëj asgjë nga vetja ime”* (Gjoni 5:30)

- Jezusi i uritur:

*“Dhe, mbasi agjëroi dyzet ditë e dyzet net, në fund e mori uria”* (Mateu 4:2),  
*“Në mëngjes, kur po kthehej në qytet e mori uria”* (Mateu 21:18), *“A keni këtu diçka për të ngrënë?”* (24:41)

- Jezusi i etshëm:

*“Kam etje!”* (Gjoni 19:28)

- Jezusi i lodhur:

*“Dhe Jezusi, i lodhur nga udhëtimi”* (Gjoni 4:6)

- Jezusi flinte:

*“por ai flinte”* (Mateu 8:24)

- Jezusi i dobët:

*“Atëherë iu shfaq një engjell nga qielli për t’i dhënë forcë”* (Lluka 22:43)

- Jezusi trishitohej:

*“dhe filloi të ndjeje trishtim dhe ankth të madh... Shpirti im është thellësisht i trishtuar”* (Mateu 26:37-38)

- Jezusi frikësohej:

*“filloi ta zëre frika dhe ankthi”* (Marku 14:33), *“Që nga ajo ditë, pra, ata vendosën ta vrasin. Për këtë arsye Jezusi nuk ecte më haptazi midis Judenjve, por u tërhoq në një krabinë afër shkretëtirës...”* (Gjoni 11:53-54)

- Jezusi i tronditur:

*“Jezusi, përsëri i tronditur”* (Gjoni 11:38)

- Jezusi tundohej:

*“Atëherë Fryma e çoi Jezusin në shkretëtirë, që djalli ta tundonte”* (Mateu 4:1),  
*“qëndroi në shkretëtirë dyzet ditë, i tunduar nga Satanai”* (Marku 1:13)

- Jezusin e poshtërojnë:

*“Atëherë e pështynë në fytyrë, e goditën me shuplaka; dhe disa të tjerë i ranë me grushte”* (Mateu 26:67)

- Jezusi lutej:

*“ndërsa po lutej, qielli u hap” ... “Por ai tërhiqej në vende të vetmuara dhe lutej” ... “Jezusi po lutej në vetmi” ... “dhe ra në gjunjë dhe lutej” ... “shkoi në mal për t’u lutur, dhe e kaloi natën duke iu lutur Perëndisë”* (Lluka 3:21/ 5:16/ 9:18/ 22:41/ 6:12), *“Dhe, si shkoi pak përpara, ra me fytyrë për tokë dhe lutej”* (Mateu 26:39)

- Jezusi nuk i dinte stinët:

*“Dhe, duke parë nga larg një fik që kishte gjethe, shkoi për të parë në se mund të gjente diçka atje; por, kur iu afrua, s’gjeti asgjë përveç gjetheve, sepse nuk ishte koha e fijeve”* (Marku 11:13)

- Jezusi pa dijeni për të ardhmen:

*“Sa për atë ditë dhe atë orë, askush nuk e di, as engjëjt në qiell, as Biri, por vetëm Ati”* (Marku 13:32)-(Mateu 24:36)

- Jezusi kërkonte gomar:

*“Shkoni në fshatin që ndodhet përballë jush; aty do të gjeni menjëherë një gomar të lidhur dhe një pulishtë me të; zgjidhini dhe m’i sillni!”* (Mateu 21:2), *“Dhe Jezusi gjeti një kërric dhe hipi në të”* (Gjoni 12:14)

- Varfëria e Jezusit:

*“Dhe Jezusi i tha: “Dhelprat i kanë strofkat, dhe zogjtë e qiellit i kanë çerdhet, por Biri i njeriut nuk ka as ku të mbështetë kokën”* (Mateu 8:20)

- Jezusi pagëzohej<sup>165</sup>:

---

<sup>165</sup> Pagëzim – mister i krishterë që shpreh pranimin e njeriut në gjirin e kishës; kryhet me anën e futjes në ujë, spërkatjes me ujë etj. Shfrytëzimi i ujit si mjet pastrues i ka rrënjët në kohë të lashta. Ritet e pastrimit me ujë kryheshin në fetë e Egjiptit, Asirisë, Babilonisë dhe Palestinës. Foshnja gjatë pagëzimit çirohet nga mëkati i parë, kurse, kur kryhet pagëzimi i një të rrituri, falen edhe të gjitha mëkakat e tjera që i ka kryer para pagëzimit. Në këtë mënyrë, kuptimi pastrues i ritit, sikundër edhe në kultet para krishterizmit, ruhet, ndonëse përmbajtja e tij modifikohet. (Halit Muharremi, *“Fjalori i teologjisë”*, fq. 251-252)

“Atëherë erdhi Jezusi nga Galileja në Jordan te Gjoni për t’u pagëzuar prej tij”  
(Mateu 3:13)

- Jezusi vdiq<sup>166</sup>:

“Por Jezusi, si lëshoi një britmë të madhe, dha frymën (vdiq)” (Marku 15:37),  
“kur erdhën te Jezusi, dhe si panë se ai tashmë kishte vdekur” (Gjoni 19:33)

Këto citate tregojnë qartazi se Jezusi/ Isai a. s. është rob i Allahut xh.sh. dhe i dërguar i Tij. Po të merren këto cilësi si të Zotit, a thua Zoti vihet në sprovë, frikësohet, lodhet, i pafuqishëm, i padijshëm për të ardhmen, për stinët etj., të gjitha këto janë veti të njeriut. Zoti kalëron mbi gomar, çfarë absurd! Nevoja e Jezusit për gomar hedh poshtë karakterin e tij hyjnor. Jezusi lutej. Kujt i lutej? Zotit. Lutja e tij është argument për natyrën e tij njerëzore. A i lutet zoti Zotit? D.m.th. Jezusi nuk është zot, por është njeri dhe rob i cili i nënshtrohet Zotit.

Pagëzimi i Jezusit, si mund të jetë misioni i tij “shpëtimtar i mëkateve” apo si mund të quhet ai “i pamëkate” kur edhe vetë u pastrua nga mëkatet në lumin Jordan?

Nëse besohet se Zoti erdhi në tokë, në formë të Jezusit, atëherë i kujt ishte zëri që u dëgjua nga qielli<sup>167</sup>? I Zotit? Po zoti kishte zbritur në tokë në formën njerëzore. Ai ishte në barkun e nënës për nëntë muaj, siç thotë Bibla. Cili ka qenë

<sup>166</sup> Këtu po e përmendim në aspektin se si e përshkruan Bibla vdekjen e Jezusit. Ndërsa sipas Kur’anit as e kanë mbytur, as e kanë kryqëzuar, shih suren Nisa, ajeti 157-158. Por nëse studiohen dhe analizohet mirë, disa nga citatat biblike tregojnë qartazi se Jezusin as e kanë mbytur por as e kanë kryqëzuar, ngase dikush tjetër është kryqëzuar në vend të tij (në rast se do ta shtjellonim këtë temë do të na merrte shumë vend për ta përfshirë në këtë punim). Lidhur me këtë referoju këtyre librave: Ungjilli sipas Barnabes, përktheu Avdi Berisha, Prishtinë, 1998, Baxhil, Hasan, “Dialog ndërmjet të krishterit dhe myslimanit”, Prishtinë, 2001, Ibrahim, Halil, “Islami dhe Krishterimi”, Prishtinë, 2005, Abdullah, Misha’al Ibn, “What did Jesus really say?” USA, 2001, Deedat, Ahmed, “The Choice”, vol. II, New Delhi, 2001 etj.

<sup>167</sup> Shih tek Mateu 3:16-17; Lluqa 3:21-22. Nëse i lexojmë këto citate, vërejmë se Zoti foli prej qielli, duke thënë: “Ky është Biri im...” Shtrohet pyetja si ka mundësi që Jezusi në të njëjtën kohë të jetë Zot, por edhe i biri i Zotit? Gjithashtu në citat vërejmë edhe një dobësi tjetër të Perëndisë, sipas Biblës, duke pasur parasysh se edhe fryma e shenjtë është perëndi (sipas doktrinës së krishterë), në rastin e pagëzimit të Jezusit tregohet se “Fryma e Perëndisë zbriti si një pëllumb” mbi Jezusin. Përsëri shtrohet pyetja, a i përket cilësisë së Zotit, që Zoti të shndërrohet në shpend, apo në ndonjë krijesë tjetër?!

në barkun e nënës, Zoti i inkarnuar? Pra, Zoti ka zbritur në tokë dhe ka jetuar në barkun e nënës për nëntë muaj, atëherë si i përdorte ai fuqitë e tij që ta drejtonte gjithësinë prej barkut të nënës, i shndërruar në krijesë të vogël e të pafuqishme?, etj. etj.

Nëse logjikojmë me arsye të shëndoshë, a i ka hije Zotit të jetë me këto cilësi të mangëta, kur dihet se krijesat e Tij kanë veti më të mira se këto. Kurrsesi, por kjo dëshmon se Jezusi ishte vetëm njeri i thjeshtë dhe i dërguar nga Zoti.

Siç përmendëm më lart, Kur’ani nuk na tregon jetën e Isait në hollësi, por na tregon dhe na informon gjërat më kryesore, të cilat duhet t’i dimë, na tregon të vërtetën dhe që të largohemi nga gënjeshttrat e sajura nga të krishterët ndaj Isait a.s./ Jezusit.

Allahu xh.sh. na shpjegon në Kur’anin Famëllartë lindjen e Isait a.s., mënyrën se si Zoti dërgoi te Merjemja/ Maria melekun Xhebrail / Gabriell, për ta përgëzuar me lajmin, për lindjen e një fëmije si mrekulli nga ana e Zotit Fuqplotë.

Le të mbesim për pak çaste nën hijet e ajeteve kur’anore, ku Allahu xh.sh. thotë:

فَأَخَذَتْ مِنْ دُونِهِمْ حِجَابًا فَأَرْسَلْنَا إِلَيْهَا رُوحَنَا فَتَمَثَّلَ لَهَا بَشَرًا سَوِيًّا ﴿١٧﴾ قَالَتْ إِنِّي  
 أَعُوذُ بِالرَّحْمَنِ مِنْكَ إِنْ كُنْتَ تَقِيًّا ﴿١٨﴾ قَالَ إِنَّمَا أَنَا رَسُولُ رَبِّكِ لِأَهَبَ لَكِ غُلَامًا  
 زَكِيًّا ﴿١٩﴾

*“Ajo, vuri një perde ndaj tyre, e Ne ia dërguam asaj Xhebrilin, e ai iu paraqit asaj njeri në tërësi. Ajo tha: “Unë i mbështetem të Gjithëmëshirshmit prej teje, nëse je që i frikësohesh Atij (pra më lër të lirë)!” Ai (Xhebraili) tha: “Unë jam vetëm i dërguar (melek) i Zotit tënd për të dhuruar ty një djalë të pastër (pejgamber)”. (Merjem 17-19)*

Po ashtu thotë:



إِذْ قَالَتِ الْمَلَكَةُ يَمْرُؤِمُ إِنَّ اللَّهَ يَبْشُرُكَ بِكَلِمَةٍ مِّنْهُ اسْمُهُ الْمَسِيحُ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ  
وَجِيهًا فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَمِنَ الْمُقَرَّبِينَ ﴿١٥﴾

*“Rikujtoje kur engjëjt i thanë: “Oj Mejreme, Allahu të përgëzon me fjalën e vet (me lindjen e një fëmije si rezultat i fjalës së Zotit) emri i të cilit është Mesih, Isa, bir i Merjemes, do të jetë i nderuar në këtë botë dhe në tjetrën dhe nga të afërmit (e Zotit)”. (Ali Imran 45)*

Në këtë ajet përmendet, *“Fjalën e vet”, “Fjalë e Zotit”*. Fjala nuk është *“Logos”*, ose ndonjë person tjetër në mendjen e Zotit, siç bëjnë të krishterët (që Logosi është Jezusi, zot), por është urdhër ose komandë e Allahut xh.sh.: *“Kun”*, që d.m.th. *“Bëhu”*.

Allahu xh.sh. thotë:

بَدِيعُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَإِذَا قَضَىٰ أَمْرًا فَإِنَّمَا يَقُولُ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ ﴿١٦﴾

*“Ai është shpikës i qiejve e i tokës (pa kurrfarë modeli të mëparshëm) e kur dëshiron diçka, ai vetëm i thotë: “Bëhu!” në atë moment bëhet”*. (Bekare 117)

Dhe thotë:

قَالَتْ أَنَّىٰ يَكُونُ لِي غُلَامٌ وَلَمْ يَمَسِّنِي بَشَرٌ وَلَمْ أَكُ بَغِيًّا ﴿١٧﴾

*“Ajo tha: “Si do të kem unë djalë, kur mua nuk më është afruar njeri (nuk jam e martuar), e as nuk kam qenë e pamoralshme”*. (Merjem 20)

Po ashtu Allahu xh.sh. thotë:

قَالَتْ رَبِّ أَنَّىٰ يَكُونُ لِي وَالدُّ وَلَمْ يَمَسِّنِي بَشَرٌ قَالَ كَذَلِكَ اللَّهُ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ ۚ إِذَا  
قَضَىٰ أَمْرًا فَإِنَّمَا يَقُولُ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ ﴿١٨﴾

*“Ajo tha: “Zoti im! Qysh do të kem unë fëmijë, kur nuk më ka prekur askush?!” - “Kështu - tha (engjëlli) - Allahu krijon ç’të dojë Vetë. Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të: “Bëhu!” - dhe ajo bëhet”*. (Ali Imran 47)

Në suren Ali Imran ajeti 59, Zoti na sqaron lidhur me Ademin a.s. dhe Isanë a.s., duke ua larguar dyshimet e atyre që mendojnë se Jezusi është zot, sepse nuk

ka pasur baba. Por çështja e Isait tek Allahu është sikurse çështja e Ademit, ku thotë:

إِنَّ مَثَلَ عِيسَىٰ عِنْدَ اللَّهِ كَمَثَلِ آدَمَ ۖ خَلَقَهُ مِنْ تُرَابٍ ثُمَّ قَالَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ ﴿١٩٠﴾

“Vërtet, çështja e Isait (të lindur pa baba) tek Allahu është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj atij i tha “Bëhu!” dhe ai u bë”.

Ajetet e tjera që flasin për lindjen e Isait a. s. janë:

قَالَ كَذَٰلِكَ قَالَ رَبُّكَ هُوَ عَلَيَّ هَيِّنٌ ۖ وَلِنَجْعَلَهُ آيَةً لِلنَّاسِ وَرَحْمَةً مِنَّا ۚ وَكَانَ أَمْرًا مَّقْضِيًّا ﴿١٩١﴾

“(Xhibrili) Iu përgjigj: “Kështu është! Zoti yt ka thënë: ‘Kjo për Mua është e lehtë. Ne do ta bëjmë atë shenjë për njerëzit dhe mëshirë nga ana Jonë’. Dhe kjo është punë e kryer”. (Merjem 21)

Gjithashtu thotë:

فَحَمَلَتْهُ فَانْتَبَدَّتْ بِهِ مَكَانًا قَصِيًّا ﴿١٩٢﴾ فَأَجَاءَهَا الْمَخَاضُ إِلَىٰ جِذْعِ النَّخْلَةِ قَالَتْ يَلِيَّتَنِي مَثُ قَبَلٍ هَذَا وَكُنْتُ نَسِيًّا مَنَسِيًّا ﴿١٩٣﴾

“Ajo mbeti me barrë e u tërhoq me të në një vend të largët. Dhembjet e lindjes e detyruan atë që të shkonte te trangu i një hurme. Ajo tha: “Ah, sikur të kisha vdekur para kësaj (ngjarjeje) dhe të isha harruar krejt!” (Merjem 22-23)

### 2.3. A është Jezusi/ Isai a. s. bir i Zotit?

Gjithashtu, duke e lexuar dhe duke e shfletuar literaturën e krishterë, do të vërejmë se në shkrimet e tyre e cilësojnë Jezusin si djalë të Zotit, duke i atribuar Zotit një bir. Konstatimi se Jezusi është “Bir” i Zotit, paraqet edhe një shtrebbërim të mësimëve të Jezusit dhe me logjikë të thjeshtë kontradikton urdhrat biblikë. Po ta marrim burimin e tyre Biblën do të vërejmë se Bibla i atribuon shumë bij Zotit, p.sh.:

- “djemtë e Perëndisë panë që vajzat e njerëzve ishin të bukura, dhe morën për gra të gjitha ato që i zgjodhën vetë”. (Zanafilla 6:2)

- *“Kështu thotë Zoti: Izraeli është biri im, i parëlinduri im”*. (Exodi 4:22)
- *“...Efraimi është i parëlinduri im”*. (Jeremia 31:9)
- *“Do të shpallë dekretin e Zotit. Ai më ka thënë: “Ti je biri im, sot më linde”*. (Psalmi 2:7)
- *“Unë kam thënë: “Ju jeni perëndi, jeni të gjithë bijtë e Shumë të Lartit”*. (Psalmi 82:6)
- *“Sepse të gjithë ata që udhëhiqen nga Fryma e Perëndisë janë bij të Perëndisë”*. (Romakëve 8:14)
- *“Ju jeni bijtë e Zotit, Perëndisë tuaj...”* (Ligji i përtërirë 14:1)
- *“Lum ata që përpiqen për paqen, sepse ata do të quhen bij të Perëndisë”*. (Mateu 5:9)
- *“Ai do të kërkojë ndihmën time, duke thënë: “Ti je Ati im, Perëndia im dhe Këshijella ime e shpëtimit”. Do ta bëj gjithashtu të parëlindurin tim, më të shkëlqyerin ndër mbretërit e dheut”*. (Psalmi 89:26-27)
- *“Unë do të jem për të një baba dhe ai një djalë për mua...”* (2 Samueli 7:14)
- *“Dëgjoni; o qiej; dhe dëgjo, o tokë, sepse Zoti ka folur: “Kam edukuar fëmijë dhe i rrita, ata u rebeluan kundër meje”*. (Isaia 1:2)
- *“Ju nuk jeni populli im”, do t’u thuhet atyre: “Jeni bijtë e Perëndisë së gjallë”*. (Hosea 1:10)
- *“...dhe do të jem si një Atë për ju, dhe ju do të jeni për mua si bijtë e bijat, thotë Zoti i Plotfuqishëm”*. (2 Korintasve 6:18)
- *“por të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e tij”*. (Gjoni 1:12)
- *“Një ditë ndodhi që bijtë e Perëndisë shkuan të paraqiten përpara Zotit”*. (Jobi 2:1/1:6)

Pra, siç pamë për hebrejntë fjala “Bir i Zotit” është përdorur për t’i emëruar besimtarët e sinqertë të Zotit, shërbyesit e Tij, robërit e Zotit. Në Bibël vetëm në dy vende ekziston ku Jezusi i referohet vetes si “bir i Zotit”, në kaptinat 5 dhe 11

të Ungjillit të Gjonit<sup>168</sup>. Jezusi shumë herë e ka quajtur vetveten “bir i njeriut”, madje mbi 80 herë, në mbi 80 vende në Bibël.

Nëse ne e marrim shprehjen “Bir i Zotit” si Zot, atëherë, pra, të gjithë jemi zota. Mirëpo, fjala në Bibël “bir i zotit” kuptohet si rob i Zotit. Siç pamë më lart nga citatet biblike, me fjalët “bij” dhe fëmijë të perëndisë janë quajtur mjaft profetë, njerëz të thjeshtë etj. Kuptimi i fjalës “Bir i Perëndisë” nuk është i drejtpërdrejtë, por metaforik. Ato fjalë mund të përdoren për të gjithë ato që i do Perëndia. Jezusi u tha se Perëndia nuk është vetëm Ati i tij, por, gjithashtu, edhe Ati juaj. Ja disa citate që ta vërtetojmë këtë pohim:

*“për të qenë bij të Atit tuaj, që është në qiej, sepse ai bën të lindë diellin e tij mbi të mirët dhe mbi të këqijtë, dhe bën të bjerë shi mbi të drejtët dhe të padrejtët.... Jini, pra, të përkryer, ashtu siç është i përsosur Ati juaj, që është në qiej”.*(Mateu 5: 45, 48)<sup>169</sup>

*“Mos më prek, sepse ende nuk u ngjita te Ati im; por shko te vëllezërit e mi dhe u thuaj atyre se unë po ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te Perëndia im dhe Perëndia juaj”.* (Gjoni 20:17)

Riccardo Di Segni, prift nga Roma, kur ia parashtruan pyetjen “A ishte Krishti bir i Perëndisë”, u përgjigj natyrshëm: “Të gjithë jemi bij të Perëndisë, e në këtë aspekt Jezusi është si të gjithë. Nëse në atë kohë në aramaisht kalon fjala bir i Perëndisë, kjo kurrë nuk i ka pasur nuancat që më vonë iu dhanë kongreset ikumenike, pasi në aramaisht “bir” e “rob”, ka të njëjtin kontekst”.<sup>170</sup>

Fjalët greke të Testamentit të Ri të përdorura për “bir” janë “*pias*” dhe “*pa-ida*”, të cilat kanë kuptimet “shërbëtor” apo “*bir në kuptimin e shërbëtorit*”. Shprehja “*bir i Zotit*” nuk mund të thuhet se ka ardhur nga vetë Jezusi<sup>171</sup>, por është një shtrembërim që i është bërë Dhiatës së Re.

<sup>168</sup> Dr. Maneh Hammad Al Johani, “E vërteta rreth Jezusit”, Tiranë, 1993, fq. 14.

<sup>169</sup> Hasan Baxhil, “Dialog ndërmjet të krishterit dhe myslimanit”, Prishtinë, 2001, fq. 42.

<sup>170</sup> “Isai a.s. (Jezu Krishti)- hyjnor apo njerëzor?”, Senad Maku, Takvimi, 2008, Botuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, 2008, fq. 187.

<sup>171</sup> Dr. Maneh Hammad Al Johani, *vep. e cit.*, fq. 14.

Hulumtuesja e njohur, Ulf Azizus Samed, për citatet që përmendin Jezusin si “bir” të Zotit, thotë: “Këto fraza nuk do të thonë tjetër, përveç “afërsi me Zotin në dashuri”. Themeluesi i krishterizmit vetë ka thënë se çdo njeri, i cili punon sipas vullnetit të Atit në qiej është bir i Hyjit (Zotit). Këta janë ata, të cilët bëjnë jetë të devotshme, kanë fisnikëri, mirënjohje që e bën njeriun qenie të nënsh-truar, të tillët quhen Bij të Zotit”.<sup>172</sup> Këtë e vërtetojnë shumë thënie të Jezusit si:

*“E unë po ju them: Doni armiq të tuaj, lutuni për ata që ju shpëtojnë, për t’u bërë bijtë e Atit tuaj që është në qiell”.* (Mateu 5:44-45)

Po ashtu ai tha: *“Lum pajtuesit, sepse do të quhen bijtë e Hyjit”* (Mateu 5:9)

Ndërsa dijetari islam Ibn Tejmije, i cili ka radhitur disa pika konkluduese që e aludojnë përdorimin e termit “Bir” me konotacion metaforik. Ai thotë: “Fakti që Davudi a.s. është quajtur “Bir i Tij”, bëhet e qartë se termi “Biri” nuk është specifik vetëm për Mesihun a.s./ Jezusin, sepse janë emëruar edhe robërit tjerë të Tij me këtë. Prandaj, dihet se “Biri” nuk është prej cilësive të Zotit të Plotfuqish-ëm, por është emër për të gjithë ata robër që i përkushtohen Atij në adhurim”.<sup>173</sup>

Pas kërkimeve të shumta nëpër dokumentet e vjetra, dr. Robert Alley nxori këtë përfundim: “Paragrafët e Biblës ku Jezusi flet për të birin e Zotit janë shtesa të bëra më vonë... ato që kisha thotë për të”.<sup>174</sup>

Nëse i shikojmë dhe i analizojmë me vëmendje citatet e lartpërmendura, do të gjejmë edhe kontradikta ndërmjet tyre. Ne po paraqesim vetëm një, tek Jeremia 31:9 thotë: *“Efraimi është i parëlinduri im”*, kurse tek Exodi 4:22 biri i parë u quajt Izraeli: *“Kështu thotë Zoti: Izraeli është biri im, i parëlinduri im”*. Cili pra në të vërtetë është biri i parë i Perëndisë? Ndërsa te Mateu 1:1 tregon që Jezusi është biri i Davidit, birit të Abrahamit:

*“Libri i gjenealogjisë së Jezu Krishtit, birit të Davidit, birit të Abrahamit”.*

<sup>172</sup> Ulf Azizus Samed, “Islami dhe krishterimi”, fq. 40.

<sup>173</sup> Ibn Tejmije, “El-xhevabus-sabihu limen bed-dele dinel mesih”, pjesa e parë (pa vend dhe vit botimi), fq. 2/238.

<sup>174</sup> Gazeta “The Washington Post”, 5 Janar 1978, sipas Dr. Maneh Hammad Al Johani, *vep. e cit.*, fq. 17.

Ndërsa Allahu xh.sh. në Kur'anin e Madhëruar dëshiron të na tregojë dhe t'i demantojë shpifjet që i bëhen Atij, duke i përshkruar fëmijë, me ç'rast thotë:

لَقَدْ جِئْتُمْ شَيْئًا إِذَا ۝ تَكَادَ السَّمَوَاتُ يَتَفَطَّرْنَ مِنْهُ وَتَنْشَقُّ الْأَرْضُ وَخُرُّ الْجِبَالُ هَدًّا ۝ أَنْ دَعَوْا لِلرَّحْمَنِ وَلَدًا ۝ وَمَا يُبْغِي لِلرَّحْمَنِ أَنْ يَتَّخِذَ وَلَدًا ۝ إِنَّ كُلُّ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ إِلَّا آتَى الرَّحْمَنِ عَبْدًا ۝

*“Ju (jobesimtarë) vërtet sollët një fjalë shumë të shëmtuar. Aq të shëmtuar sa gati u copëtuan qiejt, gati pëlciti toka dhe gati u shembën kodra nga ajo (fjalë). Për atë se të Gjithëmëshirshmit i përshkruan fëmijë. E të Gjithëmëshirshmit nuk i takon të ketë fëmijë. Nuk ka tjetër, vetëm se gjithë çka është në qiej e në tokë ka për t’iu paraqitur Zotit si rob”.* (Merjem 89-93)

Dhe thotë:

وَقَالُوا اتَّخَذَ اللَّهُ وَلَدًا ۗ سُبْحٰنَهُ ۗ بَل لَّهُ مَا فِي السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضِ ۗ كُلُّ لَّهُ قٰنِطُوْنَ ۗ

*“Ata (ithtarët e librit) thanë: “Allahu ka fëmijë”? I pastër është Ai nga kjo e metë! E Tij është gjithçka në qiej e në tokë, gjithçka i është nënshtruar Atij”.* (Bekare 116)

Aspekti islam ndaj birësisë hyjnore në përgjithësi dhe në këtë rast ndaj Isait a.s./ Jezusit është qartë prerazi: Nuk mund të quhet Zot, ai që lind fëmijë, apo që lindet, dhe ai që ha dhe pi, sepse patjetër duhet të ndiejë edhe nevojë për jashtëqitje, e si është e mundur të jetë zot, ai që ndien nevojë dhe të dalin prej tij fëlliqësi- ra!? Kjo është e qartë dhe absurde, sepse të lindurit fëmijë, do të thotë atribuim i dobësive njerëzore dhe antropofizëm i Krijuesit. Dhe kjo nuk i përket të Lartmadhërishtit. Prandaj, Allahu xh.sh. na lajmëron se nga atributet e Tij janë: as nuk është i lindur nga dikush, e as nuk e ka lindur dikë dhe ai është që ushqen e që nuk ka nevojë të ushqehet.<sup>175</sup>

Kontekstualisht është shumë interesante, sikurse i potencuam ajetet e Kur’anit Famëlartë, se si Allahu e shoqëron fjalën Mesih me fjalën Ibnu Merjem

<sup>175</sup> Shiko këto ajete: El-Ihlas 2; El-En’am 14.

(Mesihu ibnu Merjem- Mesihu/Isau djalë i Merjemes), në mënyrë që të shuhet çdo përgënjeshttrim, ngase ai është djalë i Merjemes (Ibnu Merjem), e jo djalë i Zotit (Ibnullah).

#### 2.4. A është Jezusi/ Isai a.s. Zot?

Gjatë elaborimit të këtij kapitulli rreth Jezusit kemi zënë ngoje më lart citate dhe argumente për njerëzoren e Jezusit, ku vetvetiu nënkupton se ai nuk mund të quhet Zot, por do të vazhdojmë edhe me të tjera argumente, të cilat e demantojnë këtë trillim të krishterëve lidhur me Jezusin të dërguarin e Zotit xh.sh.

Ne do t'i parashtrojmë dhe do t'i elaborojmë vetëm disa citate biblike prej qindrave që ekzistojnë lidhur me Jezusin dhe me mohimin e tij si Zot. Si p.sh.:

- **Bibla thotë:**

*“Sepse duhet që ai të mbretërojë, derisa t'i vërë të gjithë armiqtë e tij nën këmbët e veta. Armiku i fundit që do të shkatërrohet është vdekja. Sepse Perëndia i vuri të gjitha nën këmbët e tij. Por, kur thotë se çdo gjë i është nënshtruar, është e qartë se përjashtohet ai që ia ka nënshtruar çdo gjë. Dhe kur t'i ketë nënshtruar të gjitha, atëherë Biri vetë do t'i nënshtrohet Atij që i nënshtroi të gjitha, që Perëndia të jetë gjithçka në të gjithë”. (1 Korintasve 15: 25-28)*

Sikur edhe mos të mos ekzistonte asnjë argument tjetër në Bibël që do të kundërshtonte karakterin hyjnor të Jezusit, kjo do të mjaftonte. Nga rreshta e cituar mund të nxirren disa përfundime:

- Jezusi nuk kishte kurrfarë fuqie apo pushteti, por Ati ia kishte dhënë këtë në një kohë të caktuar.
- Misioni i tij ishte i përkohshëm, sepse do të vinte koha e përmbushjes së misionit të tij dhe atëherë edhe vetë Jezusi *do t'i nënshtrohej Atij që e emëroi Zot (sundimtar) të të gjithëve.*

- Pas kësaj, Jezusi do të kthehej në gjendjen e mëparshme kur nuk kishte kurrfarë fuqie dhe Perëndia - Ati do të jetë i vetmi Zot; *do të sundojë drejtpërdrejt mbi të gjitha*.<sup>176</sup>

- Citati tjetër biblik tregon për agoninë e tij në kryq, ku Jezusi vajtoi:

*“Eloi, Eloi; lama sabaktani?”*, që e përkthyer do të thotë: *“Perëndia im, Perëndia im, përse më ke braktisur?”*. (Marku 15:34)

A mund të mendojë dikush se fjalët e këtilla dalin nga goja e Zotit (nëse Jezusi është zot). Këtu e kemi vajtimin e njeriut të paaftë në agoni, të drejtuar Krijuesit dhe Zotërisë së tij.<sup>177</sup> Kjo është një fatkeqësi e madhe që Jezusi i tha ato fjalë në kryq (sipas supozimit të tyre). Kjo është një shpallje e zhurmshe mosbesimi sipas gjithë autoriteteve teologjike. Kushdo që ia atribuon atë një profeti, është jobesimtar sipas feve të shpallura.<sup>178</sup>

Nëse Jezusi bërtiti, apo thirri ashtu: *“Perëndia im, Perëndia im, përse më ke braktisur”*, shtrohet pyetja se kë po e thërriste Jezusi, kujt po i drejtohej? Vetes apo Zotit? Sigurisht ajo thirrje nuk mund të bëhej nga dikush që e konsideron veten Perëndi. Nëse Jezusi ishte perëndi nga kush që braktisur? Nga vetja? Kjo nuk do të kishte kuptim. Nga citati kuptojmë edhe, se Jezusi u kryqëzua pa dëshirën e tij (jo siç thonë me vetëdëshirë). Kjo argumenton se i kryqëzuar në vetën e tij ndjente se i është bërë e padrejtë dhe se ai nuk flijoi veten në kryq që t’i shlyejë mëkatet, siç pretendojnë. Sikur të ishte kryqëzimi sipas vullnetit të tij për hir të flijimit, ai nuk do të ankohej se si Zoti hoqi dorë prej tij.

Po ashtu Jezusi tha:

*“O Atë, në duart e tua po e dorëzohj frymën time!”*. Dhe, si tha këto, dha frymë. (Luka 23:46)

Nëse Jezusi ishte zot, pse duhej t’ia dorëzonte frymën Atit (Perëndisë)?

<sup>176</sup> Halil Ibrahim, *“Islami dhe krishterimi”*, fq. 12.

<sup>177</sup> Ulfe Azizus Samed, *“Islami dhe krishterimi”*, fq. 38.

<sup>178</sup> Grup përkthyesish, *“Shpjegimi i kuptimeve të Kur’anit të lartë në gjuhën shqipe”*, Riad, 2000, fq. 921 (shtojca I, në fund të Kur’anit).



Shtrohet pyetja tjetër rreth Jezusit në kryq: A kryqëzohet Zoti? Nëse Jezusi është zot, a vdes Zoti? Apo nëse Jezusi është i biri i Zotit, a kishte mundësi Ati t'i falte njerëzit pa flijuar birin e Tij apo jo? Përgjigjja besoj se është Po, ngase në të kundërtën Ati atëherë nuk qenka i Gjithëfuqishëm, e nëse nuk është i Gjithëfuqishëm, atëherë nuk mund të jetë Zot. Nëse Zoti mund t'i falte njerëzit pa e sakrifikuar të birin e tij, atëherë pse të bëhet një sakrificë aq e madhe?<sup>179</sup>

Jezusi, vdiq! Mirëpo, kush e ringjalli Jezusin nga vdekja? Nëse ishte vdekur ai nuk mund ta ringjallte vetveten. Bibla tregon se Jezusin e ringjalli Perëndia nga të vdekurit, ku thotë: *“Këtë Jezus, Perëndia e ka ringjallur; dhe për këtë të gjithë ne jemi dëshmitarë!”*. (Veprat 2:32) *“Por Perëndia e ka ringjallur, pasi e zgjidhi nga ankthet e vdekjes”*. (Veprat 2:24)

Sepse Perëndia nuk vdes, është i pavdekshëm. Për këtë Bibla thotë: *“Para se të kishin lindur malet dhe para se ti të kishë formuar tokën dhe botën, madje nga mot dhe përjetë ti je Perëndia”*. (Psalmi 90:2) *“Por ti je gjithnjë po ai dhe vitet e tua nuk do të kenë kurrë fund”*. (Psalmi 102:27)

- Pas ringjalljes së supozuar, Jezusi i kishte thënë Maria Magdalenës:

*“Mos më prek, sepse ende nuk u ngjita tek Ati im; por shko te vëllezërit e mi dhe u thuaj atyre se unë po ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te Perëndia im dhe Perëndia juaj”*. (Gjoni 20:17)

Edhe ky është një nga argumentet që tregojnë qartazi se Jezusi nuk është zot. Po të ishte zot, pse tha që *“Unë po ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te Perëndia im dhe Perëndia juaj”*. Këtu tregohet se Perëndia i tij dhe i të tjerëve është vetëm Zoti i Plotfuqishëm dhe askush tjetër. Pra siç shihet Zoti nuk ishte vetëm Atë i Jezusit, por edhe Zot i tij. Nëse Jezusi besohet të jetë Zot, apo personalitetit trinitar i Zotit, a mund të besojmë se “zoti ka Zot”. Besoj se nuk do koment për më gjerë.

- Fragmenti tjetër që e mohon Jezusin si zot, është se, kur skribët e pyetën Jezusin, cili është i pari i urdhërimeve. Jezusi iu përgjigj: Urdhërimi i parë i të gjithëve është:

<sup>179</sup> Për më tepër shih: Tahir Kukaj, *“Besueshmëria e citateve kur'anore dhe atyre biblike”*, Prishtinë, 2005, fq. 253, dhe, Mohamed Ghounem, *“200+ ways the Quran corrects the Bible”*, Brooklyn NY 2003, fq. 173.

*“Dëgjo, o Izrael: Zoti, Perëndia ynë, është i vetmi Zot”, dhe: “Dua je Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë mendjen tënde e me gjithë forcën tënde!” Ky është i pari urdhër”. (Marku 12:29-30)*

Citati tregon dhe kuptojmë se Jezusi iu përgjigj se ka vetëm një Zot të vetëm, Një Perëndi si për të ashtu edhe për të gjithë të tjerët. Këtu shihet se Jezusi nuk është zot, sepse tha *Zoti ynë*. Këtu tregohet njëshmëria e Zotit, tregohet se Jezusi nuk tha Zoti juaj në trinitet (Ati, biri dhe shpirti i shenjtë), por tha, Zoti ynë, i imi, por edhe juaji.

Të njëjtat fjalë gjinden edhe te Ligji i përtërirë 6:4 në Dhiatën e Vjetër ku thotë: *“Dëgjo, Izrael, Zoti, Perëndia ynë është një i vetëm”*. Një përkthim katolik i Biblës (*New Jerusalem Bible*) është kështu: *“Dëgjo o Izrael: Jahve është Perëndia ynë, Jahve është një i vetëm”*.<sup>180</sup> Sipas gramatikës së këtij vargu, fjala *“Një”* nuk ka modifikime në shumës që të sugjerojmë se ajo nënkupton diçka më shumë se një individ.<sup>181</sup>

- Argumenti tjetër që hedh poshtë hyjninë e Jezusit/ Isait a.s. është lindja e tij dhe zhvillimi i tij (për këtë shih te nëntitulli *Njerëzorja e Jezusit*). Të krishterët mundohen ta mbrojnë tezën e tyre se Jezusi është zot, duke treguar se ai lindi pa baba dhe kjo, sipas tyre, është një argument bindës.

Këta së pari e harrojnë krijimin e Ademit a.s./ Adamit që Zoti e krijoi pa prindër. Po të shikojmë nga aspekti prindëror, Adami do duhej të konsiderohej për zot më tepër se Jezusi, sepse Adami s’kishte prindër, kurse Jezusi, Po, nënën Marinë/Merjemen.

Hafiz Ibrahim Dalliu thotë lidhur me këtë: Në krijim, Isai a.s. i përngjan Ademit a.s., Ademi është krijuar edhe pa nënë edhe pa baba, por askush nuk thotë për Ademin a.s. se ai është zot, ose bir i Zotit. Prandaj, ju o të krishterë! Me çfarë arsytimi thoni për Isain a.s., se ai është bir i Zotit? Nëse duhej thënë kështu

<sup>180</sup> Ky citat gjendet edhe te *“Shkrimet e shenjta”*, përkthim “Bota e re”, Romë, 2006.

<sup>181</sup> *“A duhet të besosh në trinitet”*, fq. 13.

kjo më shumë duhej të thuhej për Ademin a.s. që është krijuar pa nënë dhe pa baba.<sup>182</sup>

Te revista “Zgjohuni” e Dëshmitarëve të Jehovait shkruan: “Jezusi ngjante në shumë gjëra me njeriun e parë, Adamin. Për shembull, që të dy ishin njerëz të përsosur që nuk kishin baba njerëzor” (Zanafilla 2:7,15). Prandaj, Bibla e quan Jezusin “Adami i fundit”... Jeta e Jezusit ishte e barabartë me jetën e njeriut të Parë, Adamit... (1 Korintasve 15:45)<sup>183</sup>

Çështjen e krijimit të Ademit a.s. dhe të Isait a.s. e tregon më së miri, qartazi dhe prerazi Kur’ani Famëlartë te surja Ali Imran, ajeti 59, ku Allahu xh.sh. thotë:

إِنَّ مَثَلَ عِيسَىٰ عِنْدَ اللَّهِ كَمَثَلِ آدَمَ ۖ خَلَقَهُ مِن تَرَابٍ ثُمَّ قَالَ لَهُ كُن فَيَكُونُ ﴿٥٩﴾

“Vërtet, çështja e Isait (të lindur pa baba) tek Allahu është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj atij i tha “Bëhu!” dhe ai u bë”.

Sipas Biblës, ngjashëm me Jezusin kemi edhe të ashtuquajturin Melkisedeku, ku tregohet tek Letra e hebrenjve 7:1, 3:

“Sepse ky Melkisedeku, mbret i Salemit dhe prift i Shumë të Lartit Perëndi, i doli përpara Abrahamit, kur po kthehej nga disfata e mbretërve dhe e bekoj,... (Melkisedeku) Pa atë, pa nënë, pa gjenealogji, pa pasur as fillim ditësh as fund jete, por i përngjashëm me Birin e Perëndisë, ai mbetet prift në amshim”.

Këtu del “një kandidat” tjetër për ta bërë zot, sepse vetëm Zoti i Plotfuqishëm i ka këto cilësi. Adami / Ademi kishte një fillim, edhe Jezusi/ Isai a.s. kishte një fillim; Ademi ka pasur një fund gjithashtu edhe për Isanë të krishterët tregojnë se ka pasur një të tillë. Po mbreti i Salemit ku është?

Nga citati vërejmë se Melkisedeku, duhet të ketë më tepër meritë të quhet zot sipas Biblës, se sa Adami dhe Jezusi. Melkisedeku, sipas Biblës, s’ka atë, s’ka

<sup>182</sup> H. Hafiz Ibrahim Dalliu, “Ajka e kuptimeve të Kur’anit Kerijmit”, fq. 332.

<sup>183</sup> “Kush është Jezu Krishti?”, Zgjohuni, 22 prill 2005, fq. 4.

nënë, s'ka gjenealogji, s'ka fillim ditësh e as fund jete.<sup>184</sup> Shtrohet pyetja si ta konsiderojmë këtë njeri? A mund ta quajmë këtë zot?

Shihet qartazi se Bibla ka pësuar ndryshime gjatë kohës dhe nuk janë ata libra që u janë shpallur pejgamberëve nga Zoti xh.sh., por me kalimin e kohës janë shtrembëruar. Është e vërtetë se çështja e trinitetit është krejtësisht e pabazë.

- Jezusi nuk pohoi kurrë se ishte Perëndi. Çdo gjë që tha rreth vetes së tij, tregon se në asnjë mënyrë nuk e konsideronte veten të barabartë me Perëndinë. Në Bibël thuhet:

*“Atëherë Jezusi u përgjigj dhe u tha atyre: “Në të vërtetë, në të vërtetë, po ju them se Biri nuk mund të bëjë asgjë prej vetvetes, përveç asaj që sheh se bën Ati...”.* (Gjoni 5: 19)

*“...sepse unë kam zbritur nga qielli jo për të bërë vullnetin tim, por vullnetin e atij që më ka dërguar”.* (Gjoni 6:38)

*“Jezusi atëherë iu përgjigj atyre dhe tha: Doktrina ime nuk është imja, por e atij që më ka dërguar”.* (Gjoni 7:16)

- Para se ta arrestonin Jezusin, ai bëri një lutje, ku tregoi një dallim ndërmjet Jezusit dhe Perëndisë, me ç'rast tha:

*“O Atë, po të duash, largoje këtë kupë nga unë! Megjithatë mos u bëftë vullneti im, por yti”.* (Lluka 22:42) Kuj po i lutej? Vetvetes së tij, ndonjë pjese të vetes së tij? Jo, por ai iu lut Perëndisë që është i ndarë nga ai. Iu lut Perëndisë, sepse ishte i vetmi që mund t'ia largonte “atë kupë” dhe ta ndihmonte.

Po ashtu te Mateu 23:9-10, Jezusi tha:

*“Dhe përmbi tokë mos thirrni askënd atë tuaj, sepse vetëm një është Ati juaj, ai që është në qiej. As mos lejoni që t'ju quajnë udhëheqës, sepse vetëm një është udhëheqësi juaj: Krishti”.*

Nga ky citat kuptojmë:

---

<sup>184</sup> “New World Translation of The Holy Scriptures”; American Standard version, sipas “Pyetje nga lexuesit”, “Kulla e rojës”, 15 mars 1994, fq. 31.

- Nuk ekziston Atë mbi faqen e dheut, ose nuk ekziston zot mbi tokë (përpos të vërtetit). D.m.th. Krishti/ Isai a.s. ia tërhoqi vërejtjen popullit të vet për të mos e trajtuar atë si Zot.
- Zoti është Një në qiell, e jo tre siç pretendon kisha.
- Krishti/ Isai a. s. është udhëheqës (mësues, i dërguar) e nuk është zot, e as bir i Zotit. Mesihu shumë bukur i qartësoi punët, Allahu është Një, ndërsa Mesihu është udhëheqësi, por kisha nuk e dëshiron atë që thotë Mesihu.<sup>185</sup>

Në Bibël, në 66 librat në versionin protestant, apo në 73 librat e versionit roman-katolik, nuk mund të gjendet asnjë pohim që Jezusi të ketë thënë: “Mua të më adhuroni”.<sup>186</sup>

Pothuajse ngjashëm është edhe një citat tjetër që e mohon Jezusin të jetë zot, i cili gjendet te 1 Timoteu 2:5, ku shkruan: *“Një është Perëndia, dhe një i vetëm është ndërmjetësi midis Perëndisë dhe njerëzve, Krishti Jezus njeri”*.

Në një nga librat e krishterë, siç është libri “Bazat e Biblës”, në komentin e këtij citati thuhet se:

- Duke qenë vetëm *një* Perëndi, është e pamundur që Jezusi mund të jetë Perëndia; në qoftë se Ati është Perëndia dhe gjithashtu Jezusi është Perëndia, atëherë ka dy Perëndi. *“për ne s’ka veçse një Perëndi, Ati”* (1 Korintasve 8: 6). *“Perëndia Atë”* është pra i vetmi Perëndi. Prandaj, është e pamundur që të ketë një qenie të veçantë të quajtur *“Perëndia Bir”*, siç thotë doktrina e rreme e trinitetit. Edhe Dhiata e Vjetër spikat Yahweh, të vetmin Perëndi, si Atin (Isaia 63: 16 / 64: 8).
- Përveç këtij një Perëndie, është ndërmjetësi, njeriu Krishti Jezus - *“...dhe një ndërmjetës...”*. Ajo fjala *“dhe”* tregon një dallim ndërmjet Krishtit dhe Perëndisë.

<sup>185</sup> Dr. Muhamed Ali El-Havli, *“Komperacioni mes katër ungjijve”*, fq. 69-70.

<sup>186</sup> Ahmed Deedat, *“Krishti në islam”*, Mitrovicë, 1995, fq. 45.

- Disa herë na është kujtuar që *“Perëndia nuk është njeri”* (Numrat 23: 19; Hosea 11: 9); megjithatë Krishti ishte qartësisht *“biri i njeriut”*, siç quhet shpesh në Dhiatën e Re, *“njeriu Krishti Jezus”*.<sup>187</sup>
- Një djalosh i ri e pyeti Jezusin dhe, mes tjerash, i tha: *“Mësues i mirë”*, ndërsa Jezusi i tha: *“Përse më quan i mirë? Askush nuk është i mirë, përveç një të vetmi, domethënë Perëndisë”*. (Marku 10:18)

Nga citati kuptojmë se Jezusi refuzoi të quhej i mirë dhe tha se vetëm Një i vetëm, Perëndia, është i mirë, as unë vetë nuk jam i mirë. Po ta analizojmë këtë citat në përkthime të ndryshme do të vërejmë se mund të ndryshohet fjala, vetëm me një shkronjë. P.sh. te Bibla në gjuhën angleze të versionit të mbretit Xhejms, apo në përgjithësi në Biblat në gjuhën angleze, fjala *“Zot”* quhet GOD, ndryshon nga fjala *“I mirë”* GOOD, vetëm me një *“O”*. Vetëm një *“O”* e shtuar bën që ne të marrim një përkthim apo kuptim tjetër të citatit biblik. *“Pse më quan të mirë (GOOD), mos ndoshta Jezusi ka thënë “Pse më quan Zot (GOD)”*. Këtë shembull e mora duke pasur parasysh manipulimin me tekstet biblike, të cilat janë ndryshuar me kalimin e kohës.

- Një ndryshim ndërmjet njohurisë së Perëndisë dhe njohurisë së Jezusit, e kemi te Zbulesa 1:1, ku thuhet: *“Zbulesa e Jezusit që Perëndia ja dha...”*. Nëse vetë Jezusi ishte pjesë e një Hyjnie, a do të ishte e nevojshme t’i jepej ky zbulim nga një pjesë tjetër e Hyjnisë, pra Perëndia? Sigurisht, ai duhej të dinte gjithçka rreth këtij zbulimi, sepse Perëndia e dinte. Mirëpo, Jezusi nuk i dinte të gjitha, sepse ai nuk ishte Perëndia.<sup>188</sup>

Buletini i Rylandit deklaroi: *“Duhet pranuar faktin se kërkimet në Besëlidhjen e Re mbi këtë çështje, gjatë këtyre tridhjetë apo dyzet vjetëve të fundit, kanë çuar një numër gjithnjë e në rritje studiuesish të dëgjuar të kësaj Besëlidhje në përfundimin se Jezusi... sigurisht, nuk besoi kurrë se ishte Perëndi”*.<sup>189</sup>

<sup>187</sup> Ky komentim gjendet te *Bazat e Biblës - Udhëzim Kapitujsh* (Shpalosja e gëzimit dhe paqes së krishterimit të vërtetë), Botuar nga Christadelphian Bible Mission (CBM), England (pa vit botimi), fq. 154-155.

<sup>188</sup> *“A duhet të besosh në trinitet”*, fq. 19.

<sup>189</sup> Po aty, fq. 20.

Marrë nga “*A List of False Reading of the Scripture*”, nga Theophilus Lindsey (1723-1808)<sup>190</sup>. Lindsey i pyet ata që e adhurojnë Jezusin se si do të ishte reagimi i tyre nëse Jezusi do t’iu paraqitej atyre dhe do t’ua bënte pyetjet vijuese:

“Përse i adresoni devocionet tuaja tek unë? A u kam udhëzuar ndonjëherë që ta bëni këtë, ose a e kam propozuar veten si objekt të adhurimit religjioz?”

A nuk e kam vënë veten time vazhdimisht dhe deri në fundin e fundit si një shembull për t’iu lutur Atit; Atit tim dhe Atit tuaj, Zotit tim dhe Zotit tuaj? (Gjoni 20:17)

Kur apostujt e mi kërkuan nga unë që t’i mësoj se si të luten (Lluka 11:1-2), a i mësova unë ata që të më luten mua, ose ndonjë personi tjetër përveç Atit?

A e quajta ndonjëherë veten time zot, apo a ju thashë se Unë isha krijuesi i botës dhe se unë duhej të adhurohesha?”<sup>191</sup>

Si do të ishte përgjigjja jote nëse këto pyetje do të bëheshin ty?

Lidhur me Jezusin / Isanë a.s., se a është Zot, Kur’ani Famëlartë iu përgjigjet atyre që e konsiderojnë Jezusin zot dhe bir të Tij, duke iu thënë:

مَا الْمَسِيحُ ابْنُ مَرْيَمَ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِ الرُّسُلُ وَأُمُّهُ صِدِّيقَةٌ كَانَا  
يَاكُلَانِ الطَّعَامَ أَنْظِرْ كَيْفَ نَبِيِّنَ لَهُمُ الْآيَاتِ ثُمَّ أَنْظِرْ أَنِّي يُؤْفَكُونَ ﴿١٥٦﴾  
قُلْ أَتَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَمْلِكُ لَكُمْ ضَرًّا وَلَا نَفْعًا وَاللَّهُ هُوَ السَّمِيعُ  
الْعَلِيمُ

“*Mesihu, i biri i Merjemes, është vetëm një i dërguar. Edhe para tij kanë kaluar të dërguar. Nëna e tij përherë ka qenë e drejtë. Që të dy hanin ushqim. Shiko si ua shpjegojmë atyre shpalljet tona dhe shih si largohen nga e Vërteta! Thuaju (o Muhamed): “Si mundet vallë, që ju adhuroni në vend të Allahut, atë që nuk është në gjendje t’ju sjellë as dëm e as dobi, ndërkohë që Allahu dëgjon dhe di çdo gjë?!”. (Maide 75-76)*

<sup>190</sup> Halil Ibrahim, “*Islami dhe krishterimi*”, fq. 27.

<sup>191</sup> Po aty, fq. 27.

Po ashtu thotë:

يٰٓأَهْلَ ٱلْكِتَٰبِ لَا تَغْلُواْ فِي دِينِكُمْ وَلَا تَقُولُواْ عَلَى ٱللَّهِ ٱلْإِ ٱلْحَقِّ إِنَّمَا ٱلْمَسِيحُ  
عِيسَى ٱبْنُ مَرْيَمَ رَسُوْلٌ ٱللَّهِ وَكَلِمَتُهُ ٱلْقَوْلَآءَ إِلَىٰ مَرْيَمَ وَرُوْحٌ مِّنْهُ فَتَٰمِنُوْاْ بِٱللَّهِ  
وَرُسُلِهِۦ وَلَا تَقُولُوا ثَلَاثَةً ٱنتَهُوْاْ حَيْرًا لَّكُمْ إِنَّمَا ٱللَّهُ ٱلْوَٰحِدُ ٱلسُّبْحَٰنَةُ ٱلَّذِي  
يَكُوْنُ لَهُ وِلْدٌ ٱلَّذِي لَهُ مَا فِي ٱلسَّمَٰوَاتِ وَمَا فِي ٱلْأَرْضِ وَكَفَىٰ بِٱللَّهِ وَكِيلًا ﴿١٧١﴾

“O ithtarët e librit, mos teproni në fenë tuaj dhe mos thoni tjetër gjë për Allahun, përveç asaj që është e vërtetë. Mesihu, Isa, bir i Merjemes, ishte vetëm i dërguar i Allahut. Ishte fjalë e Tij (bëhu) që ia drejtoi Merjemes dhe ishte frymë (shpirt) nga Ai. Besojeni, pra, Allahun dhe të dërguarin e Tij e mos thoni: “Tre” (trini). Pushoni (së thëni), se është më mirë për ju. Allahu është vetëm një Allah; larg qoftë asaj që Ai të ketë fëmijë. Çfarë ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij. Mjafton që Allahu është planifikues i pavarur”. (Nisa 171)

وَإِذْ قَالَ ٱللَّهُ يَٰعِيسَى ٱبْنَ مَرْيَمَ ءَأَنْتَ قُلْتُ لِلنَّاسِ ٱلتَّخِذُونِي وَأُمِّي ٱلْإِهْيَٰبِ مِن دُونِ ٱللَّهِ قَالَ  
سُبْحَٰنَكَ مَا يَكُوْنُ لِيْ أَن أَقُولَ مَا لَيْسَ لِيْ بِحَقِّ ٱلْحَقِّ إِن كُنْتُ قُلْتُهُ فَقَدْ عَلِمْتَهُ تَعَلَّمَ مَا  
فِي نَفْسِي وَلَا أَعْلَمُ مَا فِي نَفْسِكَ إِنَّا كُنَّا نَعْلَمُ ٱلْغُيُوبِ ﴿١٧٢﴾ مَا قُلْتُ لَهُمْ إِلَّا مَا  
أَمَرْتَنِي بِهٖٓ أَنِ ٱعْبُدُوا ٱللَّهَ رَبِّي وَرَبَّكُمْ وَكُنْتُ عَلَيْهِمْ شَٰهِدًا مَّا دُمْتُ فِيهِمْ فَلَمَّا تَوَفَّيْتَنِي  
كُنْتُ أَنْتَ ٱلرَّقِيبَ عَلَيْهِمْ وَأَنْتَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَٰهِدٌ ﴿١٧٣﴾

“Pastaj Allahu do të thotë (në Ditën e Gjykimit): “O Isa, i biri i Merjemes! Ti ishe ai që u the njerëzve: “Adhuromëni mua dhe nënën time si zota krabas Allahut”?! Isai do të thotë: “Qofsh i lartësuar dhe i lavdëruar! Mua nuk më takon të them diçka, për të cilën nuk kam aspak të drejtë! Po ta kisha thënë ndonjëherë, Ti me siguri do ta dije. Ti e di çfarë ka në shpirtin tim, po unë nuk e di çfarë ka në Vetën Tëndë. Vetëm Ti i di të gjitha të fshehtat. Unë nuk u kam thënë asgjë tjetër, përveç asaj që më ke urdhëruar Ti: “Adhurojeni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj!” Kam qenë dëshmitar, për sa kohë që kam jetuar midis tyre dhe, qëkurse më more mua, vetëm Ti ishe mbikëqyrës i tyre. Ti je Dëshmitar për çdo gjë!”. (Maide 116-117)



Hafiz Ibrahim Dalliu, kur i komenton këto ajete, thotë: “Pyetja që i madhi Zot, do ti bëjë Isait, *“A ti u ke thënë njerëzve...”* është për t’ua mbyllur gojën të krishterëve dhe për t’ua nxjerrë në shesh se besimi i tyre është i kotë; ndryshe përse duhej të pyeste Zoti, kur e dinte që Isai nuk kishte thënë atë fjalë? Kjo pyetje nuk do të bëhet për të sqaruar ndonjë gjë që nuk di Zoti, por do të bëhet për t’u treguar të krishterëve me gojën e Isait se ata kanë një besim të kotë”.<sup>192</sup>

## 2.5. Dallimet ndërmjet Jezusit dhe Perëndisë

Le ta bëjmë një krahasim në mes Zotit dhe Jezusit, sipas citateve biblike:

- Zoti është i pavdekshëm,

Bibla tregon se ndër cilësitë e Zotit janë pafillimësia dhe pavdekshmëria:

*“ai që i vetmi e ka pavdekësinë dhe rri në dritë të paafrueshme, të cilën asnjë njeri nuk e ka parë kurrë dhe as mund ta shohë; atij i qoftë nderi dhe pushteti i përjetshëm”.* (1 Timoteu 6:16)

*“Para se të kishin lindur malet dhe para se ti të kish formuar tokën dhe botën, madje nga mot dhe përjetë ti je Perëndia”.* (Psalmi 90:2)

*“Por ti je gjithnjë po ai dhe vitet e tua nuk do të kenë kurrë fund”.* (Psalmi 102: 27)

kurse Jezusi vdiq.

Bibla thotë: *“Dhe Jezusi bërtiti me zë të lartë dhe tha: “O Atë, në duart e tua po e dorëzoh frymën time!”. Dhe, si i tha këto, dha frymë”.* (Luka 23: 46)

*“por, kur erdhën te Jezusi, dhe si panë se ai tashmë kishte vdekur...”.* (Gjoni 19: 33)

*“Por Jezusi, si lëshoi një britmë të madhe, dha frymën”.* (Marku 15:37)

- Zoti është i Gjithëdijshtëm,

Bibla thotë: *“Mos u bëni, pra, si ata, sepse Ati juaj i di gjërat për të cilat keni nevojë, para se ju t’i kërkoni”.* (Mateu 6:8)

*“Unë jam Zoti, ky është emri im; nuk do t’ia jap lavdinë time asnjë tjetri, as lavdërimet e mia shëmbëlltyrave të gdhendura. Ja, gjërat e mëparshme kanë ndodhur,*

<sup>192</sup> H. Hafiz Ibrahim Dalliu, *“Ajka e kuptimeve të Kur’anit Kerijmit”*, fq. 651.

*dhe tani po ju njoftoj gjëra të reja; unë jua bëj të njohura para se të mbijnë*". (Isaia 42:8-9)

kurse Jezusi nuk ishte i Gjithëdijsëm.

Kur e pyetën Jezusin për ditën e fundit, ai u përgjigj:

*"Sa për atë ditë dhe atë orë, askush nuk e di, as engjëjt në qiell, as Biri, por vetëm Ati"*. (Marku 13:32 poashtu shih: Mateu 24:36)

Po ashtu padituria e tij ceket edhe në një citat tjetër biblik, në të cilin tregohet se Jezusi iu afrua një fiku duke menduar se do të gjente fruta, por kur shkoi s'gjeti kurrëgjë, përveç gjetheve sepse nuk ishte koha e fikeve.

*"Dhe, duke parë nga larg një fik që kishte gjethe, shkoi për të parë në se mund të gjente diçka atje; por, kur iu afrua, s'gjeti asgjë përveç gjetheve, sepse nuk ishte koha e fikeve"*. (Marku 11:13)

- Zoti është i Plotfuqishëm,

Bibla e tregon Zotin si të Plotfuqishëm:

*"Unë jam Perëndia i plotfuqishëm..."*. (Zanafilla 17:1)

*"... Perëndi i plotfuqishëm"*. (Ekzodi 6:3)

Jezusi ishte i pafuqishëm.

Kështu, Jezusi tregohet i pafuqishëm në shumë aspekte:

*"Unë s'mund të bëj asgjë nga vetja ime"*. (Gjoni 5:30)

*"Atëherë e pështynë në fytyrë, e goditën me shuplaka; dhe disa të tjerë i ranë me grushte, duke thënë: "O Krisht, profetizo! Kush të ra?"*. (Mateu 26:67-68)

*"Atëherë iu shfaq një engjëll nga qielli për t'i dhënë forcë"*. (Luka 22:43)

Për më tepër, Jezusi nuk u ringjall vetë nga të vdekurit, por ishte Perëndia ai që e ringjalli: *"Këtë Jezus, Perëndia e ka ringjallur; dhe për këtë të gjithë ne jemi dëshmitarë!"* (Veprat e apostujve 2:32). Këtu tregohet se kush është Perëndia i vërtetë. Po të ishte Jezusi zot, a nuk do të kishte mundur që ta ringjallte vetveten?!

- **Zoti nuk lodhet dhe nuk fle,**

Bibla bën fjalë për njëren nga cilësitë e Zotit dhe thotë: *“Nuk e di ti, vallë, nuk e ke dëgjuar? Perëndia i përjetësisë, Zoti, krijuesi i kufijve të tokës, nuk mundohet dhe nuk lodhet, zgjuarsia e tij është e panjohshme”*. (Isaia 40:28) *“Ja, ai që mbron Izraelin nuk dremit dhe nuk fle”*. (Psalmi 121:4)

ndërsa Jezusi lodhej, por edhe flinte sikur edhe ne.

Bibla thotë: *“Dhe Jezusi, i lodhur nga udhëtimi, u ul pranë pusit”*. (Gjoni 4:6)

*“Dhe ja, që u ngrit në det një stubi aq e madhe, sa valët po e mbulonin barkën, por ai flinte”*. (Mateu 8:24) *“Ai ndërkaq po flinte në një mbi një jastëk”*. (Marku 4: 38)

- **Zoti nuk mund të shihet,**

Bibla aludon qartë në faktin se Zoti nuk mund të shihet dhe se askush nuk e ka parë:

*“Dhe tha akoma: “Ti nuk mund të shikosh fytyrën time, sepse asnjë njeri nuk mund të më shikojë dhe të jetojë”*. (Ekzodi 33:20) Citati i lartpërmendur biblik tregon për rastin kur Moisiu deshi ta shihte Zotin, por Zoti iu përgjigj se asnjë njeri nuk mund ta shikonte dhe pastaj të jetonte. Ndërsa Jezusi iu tha shokëve të vet:

*“Dhe Ati, që më dërgoi, ai vetë ka dëshmuar për mua; ju nuk e keni dëgjuar kurrë zërin e tij dhe as nuk e keni parë fytyrën e tij...”*. (Gjoni 5: 37)

*“Askush s’e pa Perëndinë kurrë...”*. (Gjoni 1: 18)

*“Askush s’e ka parë ndonjëherë Perëndinë”*. (1 Gjoni 4: 12)

ndërsa Jezusi jetoi në mesin e njerëzve.

Jezusin e kanë parë dhe ai ka qëndruar në mesin e njerëzve, ka pasur familje, ka qenë i dërguar i Zotit etj., ndërsa Bibla tregon për këtë:

*“A nuk është ky i biri i marangozit? Nuk quhet nëna e tij Mari, dhe vëllezërit e tij Jakob, Iose, Simon dhe Juda?”*. (Mateu 13: 55)

*“Atëherë njerëzit, kur panë shenjën që bëri Jezusi, thanë: Me të vërtetë ky është profeti, që duhet të vijë në botë”*. (Gjoni 6: 14)

*“Ata i thanë: “Çështjen e Jezusit nga Nazareti, që ishte një profet i fuqishëm në vepra dhe në fjalë përpara Perëndisë dhe përpara gjithë popullit”. (Luka 24:19)*

Kurse te 1 Gjoni 1: 1 thekson se si njerëzit e panë Jezusin dhe e prekën atë.

- Zoti nuk është njeri dhe nuk jeton në tokë,

Bibla thotë: *“Perëndia nuk është një njeri, që mund të gënjejë, as edhe bir njeriu që mund të pendohet”. (Numrat 23: 19)*

*“Në të vërtetë, ai nuk është një njeri si unë, të cilit mund t’i përgjigjemi dhe të dalim në gjyq bashkë”. (Jobi 9: 32)*

*“Po a është e vërtetë që Perëndia banon mbi tokë? Ja, qiejt dhe qiejt e qiejve nuk mund të të nxënë dhe aq më pak ky tempull që kam ndërtuar!”. (1 Mbretërve 8: 27)*

Jezusi ka qenë njeri, i biri i njeriut dhe ka jetuar në Nazaret.

Bibla thotë: *“Me të vërtetë ky njeri ishte i drejtë!”. (Luka 23: 47)*

*“Erdhi Biri i njeriut, që ha dhe pi...”. (Mateu 11: 19)*

*“Por, ndërsa ata qëndronin në Galile, Jezusi u tha atyre: “Biri i njeriut do t’u dorëzohet në duart e njerëzve”. (Mateu 17: 22)*

*“dhe, mbasi arriti atje, zuri vend në një qytet që quhej Nazaret, që të përmbushej ajo që ishte thënë nga profetët: “Ai do të quhet Nazareas”. (Mateu 2:23)*

*“Ata i thanë: “Çështjen e Jezusit nga Nazareti, që ishte një profet i fuqishëm në vepra dhe në fjalë përpara Perëndisë dhe përpara gjithë popullit”. (Luka 24:19)*

- Zotit i takon adhurimi,

Bibla tregon se si Jezusi iu tha të pranishmëve dhe konkretisht dishepujve<sup>193</sup>, që e pyetën Jezusin për urdhërat, ndërsa ai ishte përgjigjur: *“Adhuroje Zotin, Perëndinë tënde, dhe shërbeji vetëm atij”. (Mateu 4:10)*

---

<sup>193</sup> Dishepull-i, m. (lat. Discipulus- nxënës), nxënës a pasues i një mendimtari, a i një mjeshtri të shquar; ai që ndjek doktrinën e një tjetri; ithtar. (Mikel Ndreca, *“Fjalor fjalësh dhe shprehjesh të huaja”*, fq. 163.) Këtu konkretisht ka të bëjë me nxënësit - pasuesit e Jezusit/ Isait a.s.

*“Por ti, kur lutesh, futu në dhomëzën tënde, mbylle derën dhe lutju Ati tënd në fshehtësi; dhe Ati yt, që shikon në fshehtësi, do të ta shpërblejë publikisht”.* (Mateu 6:6)

Jezusi nuk adhurohet, por ai vetë e adhuroi Zotin.

Kurse Jezusin nuk e kanë adhuruar, Jezusi ka urdhëruar që të adhurohet vetëm Perëndia, sepse edhe ai e ka bërë një gjë të tillë:

*“ndërsa po lutej, qielli u hap”, “Por ai tërhiqej në vende të vetmuara dhe lutej”, “Jezusi po lutej në vetmi”, “dhe ra në gjunjë dhe lutej”, “shkoi në mal për t’u lutur, dhe e kaloi natën duke iu lutur Perëndisë”* (Luka 3: 21/ 5: 16/ 9: 18/ 22: 41/ 6: 12),

*“Dhe, si shkoi pak përpara, ra me fytyrë për tokë dhe lutej”* (Mateu 26:39) Nëse Jezusi është zot. A i lutet zoti Zotit ?!

Po ashtu dishepujt kërkuan nga Jezusi si të luteshin, por ai u tregoi si t’i luten jo atij, por Perëndisë, ku thotë: *“Adhuroje Zotin, Perëndinë tënde, dhe shërbeji vetëm atij”.* (Mateu 4:10)

*“Dhe ai u tha: “Kur të luteni, thoni: “Ati ynë që je në qiej, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë vullneti yt si në qiell edhe në tokë. Na jep çdo ditë bukën tonë të nevojshme. Dhe na i fal mëkatet tona, sepse edhe ne i falim fajtorët tanë; dhe mos lejo të biem në tundim, por na shpëto nga i ligu”.* (Luka 11:2,4)

*“Edhe rashë përpara këmbëve të tij për ta adhuruar, por ai më tha: “Ruaju se e bën, unë jam bashkëshërbëtori yt si dhe i vëllezërve të tu që kanë dëshminë e Jezusit. Perëndinë adhuroje! Sepse dëshmia e Jezusit është frymë e profecisë”.* (Zbulesa 19:10)

- **Zoti nuk tundohet nga e keqja,**

Bibla thotë: *“Askush kur tundohet të mos thotë: “Jam tunduar nga Perëndia”, sepse Perëndia nuk mund të tundohet nga e keqja, dhe ai vet nuk tundon asnjëri”.* (Jakobi 1:13)

ndërsa Jezusin e ka tunduar djalli.

Bibla thotë: *“Atëherë Fryma e çoi Jezusin në shkretëtirë, që djalli ta tundonte”.* (Mateu 4:1) *“dhe qëndroi në shkretëtirë dyzet ditë, i tunduar nga Satanai”.* (Marku 1:13)

Citati tregon se si djalli e tundoi Jezusin, nëse Jezusi ishte Zot, atëherë si ka mundësi që krijesa ta sprovtojë apo ta tundojë Krijuesin e tij? Argumentet janë shumë të qarta dhe nuk duhen komentime.

Jezusi ia mohoi vetes mundësinë dhe dëshirën, siç tregohet në Bibël: *“Atëherë nëna e bijve të Zebedeut iu afrua bashkë me bijtë e vet, ra përmbys para tij dhe i kërkoi diçka. Dhe ai i tha: “Çfarë do?”. Ajo u përgjigj: “Urdhëro që këta dy bijtë e mi të ulen njeri në të djathtën dhe tjetri në të majtën në mbretërinë tënde”. Dhe Jezusi, duke u përgjigjur, tha: “Ju nuk dini çfarë kërkoni; a mund ta pini ju kupën që unë do të pi dhe të pagëzoheni me pagëzimin me të cilin unë do të pagëzohem? Ata i thanë: “Po, mundemi”. Atëherë ai u tha atyre: “Ju me të vërtetë do ta pini kupën time dhe do të pagëzoheni me pagëzimin me të cilin unë do të pagëzohem; por nuk është në dorën time që të uleni në të djathtën time ose në të majtën time, por u është rezervuar atyre, të cilëve u është përgatitur nga Ati im”.* (Mateu 20:20-23)

*“...por kjo ndodh që bota ta njohë se unë e dua Atin dhe se bëj ashtu siç Ati më ka urdhëruar”.* (Gjoni 14:31)

*“Pastaj u nis që andej dhe shkoi në krahinën e Tiros dhe të Sidonit; hyri në një shtëpi dhe donte që askush të mos e dinte, por nuk mundi të qëndrojë i fshehur”.* (Marku 7:24)

Sikur Jezusi të ishte nga origjina e babait, pra zot siç pretendojnë ata, atëherë ai duhej të ishte njësoj si Ati në dëshira dhe mundësi.

Këto ishin disa krahasime ndërmjet Zotit dhe Jezusit. Pra, mbështetur në këto citate që i cekëm, a mund të jetë Jezusi zot?

Gjithashtu, t'i analizojmë edhe këto citate në vijim që tregojnë se Jezusi nuk është Zot:

*“Ati është më i madh se unë”.* (Gjoni 14:28)

*“Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: Shërbëtori nuk është më i madh se padroni i tij, as i dërguari më i madh se ai që e ka dërguar”.* (Gjoni 13:16)

*“Dhe kur t'i ketë nënshtruar të gjitha, atëherë Biri vetë do t'i nënshtrohet Atij që i nënshtrroi të gjitha, që Perëndia të jetë gjithçka në të gjithë”.* (1 Korintasve 15:28)

Në të vërtetë para 2000 vjetësh Jezusi profetizoi se njerëzit do ta adhuronin më kot dhe do ta besonin duke u mbështetur në doktrina të krijuara nga njerëzit dhe jo nga Perëndia:

*“Por në padobi ata më adhurojnë mua, duke mësuar urdhëresa të shpikura nga njerëzit”. (Mateu 15:9) “Por kot më bëjnë një kult, duke mësuar doktrina, të cilat janë porosi nga njerëzit”. (Marku 7:7) Po ashtu tha: “Do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do t’ju bëjë njerëz të lirë”. (Gjoni 8:32)*

## 2.6. Jezusi / Isai a. s. profet (pejgamber) dhe i dërguar i Zotit

Që nga krijimi i njeriut të parë fillon misioni i të dërguarve të Zotit xh.sh. Ademi a.s./ Adami ishte njeriu i parë dhe pejgamberi i parë. Pejgamberia nuk arrihet me mundim e me lodhje dhe as me shumë ibadet, por është begati e dhuruar nga Allahu xh.sh. atij që dëshiron prej robërve të Tij. Qëllimi i dërgimit të pejgamberëve ishte për t’i udhëzuar njerëzit në rrugë të drejtë dhe të vërtetë, për besimin në një Zot dhe për largimin e tyre nga rruga e shtrembër, nga e pavërteta, nga adhurimi i shumë zotave.

Allahu xh.sh. zgjodhi pejgamberë nga vende të ndryshme. Çdo popull ka pasur pejgamber. Pra, qëllimi i tyre ishte që t’i ndihmohet mendjes së njeriut që, sa më lehtë, ta gjejë rrugën e drejtë, për besimin në Allahun xh.sh. dhe për t’ia ngritur njeriut moralin e lartë.

Kur shfletojmë Biblën, shohim se edhe në vetë Biblën tregohet qartazi se Jezusi/ Isai a.s. erdhi si i dërguar nga Allahu xh.sh. dhe është njëri ndër profetët e tjerë. Në vazhdim do t’i cekim disa nga citatat që përmenden në katër ungjijtë, si të Mateut, Markut, Llukës dhe Gjonit, duke mos iu referuar krejt Dhiatës së Re, megjithëse edhe aty ka plot vende, ku tregohet për Jezusin dhe dërgimin e tij si profet.

Tek Ungjilli i Mateut 10:40-41 tregohet se si Jezusi u tha nxënësve të vet:

*“Ai që ju pranon, më pranon mua; dhe ai që më pranon mua, pranon atë që më ka dërguar. Ai që pranon një profet në emër të një profeti, do të marrë shpërblimin që*

*i takon profetit; dhe ai që pranon të drejtin në emër të të drejtit, do të marrë shpërblimin që i takon të drejtit”.*

Po ashtu Jezusi tha:

*“Cilido që pranon një nga këta fëmijë në emrin tim, më pranon mua; dhe kushdo që më pranon mua, nuk më pranon mua, por atë që më ka dërguar”* (Marku 9: 37)

Në Ungjillin e Llukës tregohet se si Jezusi u tha nxënësve:

*“Kush ju dëgjon, më dëgjon mua; kush ju përbuz, më përbuz mua; dhe kush më përbuz, përbuz atë që më ka dërguar”.* (Luka 10: 16)

Transmetohet nga Jezusi të ketë thënë:

Jezusi u tha atyre: *“Ushqimi im është të bëj vullnetin e atij që më dërgoi dhe të kryej veprën e tij”.* (Gjoni 4: 34)

Po ashtu te Gjoni 5: 37 thuhet se Jezusi ka thënë:

*“Dhe Ati, që më dërgoi, ai vetë ka dëshmuar për mua; ju nuk e keni dëgjuar kurrë zërin e tij dhe as nuk e keni parë fytyrën e tij”.*

Këto pjesë të cituara nga Bibla qartazi bëjnë me dije se Jezusi pohon që është i dërguar i Zotit. Jezusi pohon se Zoti e ka dërguar dhe kush e pranon mesazhin, dërgesën e tij, ka pranuar Zotin që e dërgoi Jezusin. Jezusi pohon se është peygamber, sepse deklarohet: *“Ai që pranon një profet, në emër të një profeti do të marrë shpërblimin që i takon profetit”.* Ky është pohim i qartë nga Jezusi se është peygamber, i dërguar i Zotit.

Verseti biblik *“Ushqimi im është të bëj vullnetin e atij që më dërgoi dhe të kryej veprën e tij”* vërteton se Jezusi u thoshte njerëzve se ai është vetëm i dërguar i Zotit dhe vërteton se veprimi i Jezusit është realizimi i vullnetit të Zotit e se është nënshtrim ndaj atij vullneti, të predikojë dhe ta kryejë shpalljen me të cilën Zoti e dërgoi. Jezusi deklarohet dhe shprehet me gjuhë tepër të qartë, për atë që dëshiron të dëgjojë dhe të kuptojë se ai është i dërguar i Zotit.



Fjalët që përmenden në citatat “i dërguar”, “më ka dërguar”, “i dërguar prej Zotit”, tregojnë qartazi se Jezusi ka qenë profet, pejgamber. Lidhur me këtë profesor dr. A. M. Renwick thotë se fjala “i dërguar” është në të vërtetë profet.<sup>194</sup>

Jezusi u tha shokëve:

*“Asnjë profet nuk përçmohet, veçse në vendlindjen e vet dhe në shtëpinë e vet”.*  
(Mateu 13: 57)

Ashtu edhe kritika tjetër që Jezusi iu tha popullit të vet për mosbesimin e tyre shprehet te Lluka 4:24 nëpërmjet fjalëve: *“Në të vërtetë, po ju them se asnjë profet nuk mirëpritet në atdheun e vet”.* Jezusi pohoi se është pejgamber dhe se çifutët nuk e njihnin, nuk e pranonin si të tillë.

Në citatin tjetër Jezusi tha:

*“Më duhet ta shpall lajmin e mirë të mbretërisë së Perëndisë edhe në qytete të tjera, sepse për këtë jam dërguar”.* (Lluka 4: 43)

Ky citat tregon se obligimi i Jezusit/ Isait a.s. është ta përhapë Lajmin e Mirë (Shpalljen), ai pohoi se ishte i dërguar, d.m.th. profet. Në Ungjillin sipas Llukës 24:19 tregon rastin e dy nxënësve që i rrëfenin Jezusit, pas shfaqjes së tij (pas kryqëzimit të supozuar), duke mos e njohur atë, i thanë:

*“Çështjen e Jezusit nga Nazareti, që ishte një profet i fuqishëm në vepra dhe në fjalë përpara Perëndisë dhe përpara gjithë popullit”.*

Gjithashtu në versetin tjetër thuhet:

*“Dhe turmat thoshin: “Ky është Jezusi, profeti nga Nazareti i Galileë”.* (Mateu 21:11) *“Atëherë të gjithë u mrekulluan dhe lëvdonin Perëndinë duke thënë: “Midis nesh doli një profet i madh”. “Ata duke u përgjigjur thanë: “Disa thonë “Gjon Pagëzori”, të tjerë “Elia” dhe të tjerë një nga profetët e lashtë që është ringjallur”.* (Lluka 7: 16; 9: 19) *“Atëherë njerëzit, kur panë shenjë të bëri Jezusi, thanë: Me të vërtetë, ky është profeti, që duhet të vijë në botë”.* (Gjoni 6: 14)

<sup>194</sup> A.M. Renwick, *“The Story of the Church”*, Bristol: InterVarsity Press 1977, fq. 19, sipas: Marmarinta-Omar P. Mabaya, *“Božija Jednoća: Konačno rješenje proturiječnosti trojstva”*, fq. 24.

Këtu shihen krejt qartë argumentet bindëse se Jezusi për nxënësit ishte njeri, lajmëtar, i dërguar<sup>195</sup>, profet i Zotit.

Këto gjëra të qarta a duhet të qartësohen edhe më tepër? Për atë që dëshiron udhëzim, rruga është tepër e qartë.

Po ashtu shumë ajete kur'anore tregojnë se Isai a. s./ Jezusi ishte dërguar ashtu siç ishin të dërguarit e tjerë që ishin para tij dhe se misioni i tij ishte thirrës në adhurimin e Zotit të vetëm, Një, të pashoq, dhe largimin nga idhujtaria që e ka kapluar popullin e tij. Le të lexojmë ajetet në vijim:

وَلَمَّا جَاءَ عِيسَى بِالْبَيِّنَاتِ قَالَ قَدْ جِئْتُكُمْ بِالْحِكْمَةِ وَلِأُبَيِّنَ لَكُمْ بَعْضَ الَّذِي  
خْتَلَفْتُمْ فِيهِ فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ هُوَ رَبِّي وَرَبُّكُمْ فَاعْبُدُوهُ هَذَا صِرَاطٌ  
مُسْتَقِيمٌ

*“Po kur Isai erdhi me argumente tha: “Erdha te ju me pejgamberllëk dhe erdha t’jua sqaroj atë pjesë që e kundërshtonit, pra kijeni frikë Allahun dhe më respektoni mua! S’ka dyshim, Allahu është Ai Zoti im dhe Zoti juaj, andaj Atë adhurojeni! Kjo është rrugë e drejtë!”.* (Zuhruf 63-64)

وَلَقَدْ آتَيْنَا مُوسَى الْكِتَابَ وَقَفَّيْنَا مِنْ بَعْدِهِ بِالرُّسُلِ وَآتَيْنَا عِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ الْبَيِّنَاتِ  
وَأَيَّدْنَاهُ بِرُوحِ الْقُدُسِ أَفَكُلَّمَا جَاءَكُمْ رَسُولٌ بِمَا لَا تَهْوَى أَنْفُسُكُمْ اسْتَكْبَرْتُمْ فَفَرِّقُوا  
كُدُوبَكُمْ وَفَرِّقُوا تَقْتُلُونَ

*“Ne ia patëm dhënë Musait librin dhe pas tij patëm dërguar shumë pejgamberë. Isait, birit të Merjemes i dhamë argumente (mrekulli) dhe e fuqizuam me (xhibrilin) shpirtin e shenjtë. E sa herë që u erdhi ndonjë i dërguar me çka nuk u pëlqeu juve, a nuk u bëtë kryelartë dhe disa prej tyre i përgënjeshtruat e disa i mbytet?”.* (Bekare 87)

Po ashtu edhe në këto citate kur'anore Allahu xh.sh. tregon se çdo të dërguar që erdhi te populli i vet, i urdhëroi që të adhurojnë vetëm Një Zot dhe të largohen nga idhujtaria. Kjo ishte një thirrje e gjithë të dërguarve të Zotit, si e Ibrahim-

<sup>195</sup> Fjalën i dërguar e gjejmë edhe në citatat e tjera, si p.sh. te Gjoni 7:18, Gjoni 8:29, Gjoni 8:42 etj.

it, Ismailit, Is'hakut, Jakubit, Musait, Isait, e të gjithë pejgamberëve dhe nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre (Paqja e Zotit qoftë mbi ta).

وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ ۗ فَمِنْهُمْ مَن هَدَى اللَّهُ وَمِنْهُمْ مَن حَقَّتْ عَلَيْهِ الضَّلَالَةُ ۚ فَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُكذِبِينَ ﴿١٠٦﴾

“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë: “Adhurojeni vetëm Allahun, e largohuni djajve (adhurimit të tyre)!” Por, pati nga ata që Allahu i udhëzoi dhe pati nga ata që ishin të gjykuar me humbje, pra udhëtoni nëpër botë dhe shihni se si ishte fundi i gënjeshtarëve?”. (Nahl 36)

وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ مِنْ رَسُولٍ إِلَّا نُوحِي إِلَيْهِ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا فَاعْبُدُونِ ﴿١٠٧﴾

“Ne nuk dërguam asnjë të dërguar para teje e të mos i kemi shpallur atij se: nuk ka zot tjetër përveç Meje, pra më adhuroni!”. (Enbija 25)

وَقَالُوا كُونُوا هُودًا أَوْ نَصَارَى تَهْتَدُوا ۗ قُلْ بَلْ مِلَّةَ إِبْرَاهِيمَ حَنِيفًا ۗ وَمَا كَانَ مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿١٠٨﴾ قُولُوا ءَامَنَّا بِاللَّهِ وَمَا أُنزِلَ إِلَيْنَا وَمَا أُنزِلَ إِلَىٰ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ وَالْأَسْبَاطِ وَمَا أُوتِيَ مُوسَىٰ وَعِيسَىٰ وَمَا أُوتِيَ النَّبِيُّونَ مِنْ رَبِّهِمْ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِنْهُمْ وَنَحْنُ لَهُ مُسْلِمُونَ ﴿١٠٩﴾

“Ata (ithtarët e librit) thanë: “Bëhuni hebrej ose të krishterë, e gjejeni rrugën e drejtë!” Thuaj: “jo, (asnjërin) por fenë e drejtë të Ibrahimit, i cili nuk ishte nga idhujtarët. Ju (besimtarë) thoni: “Ne i besuam Allahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në dymbëdhjetë kabile), atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm Atij i jemi bindur”. (Bekare 135-136)

## 2.7. Jezusi / Isai a.s. i dërguar vetëm te një popull

Jezusi / Isai a. s. ishte i dërguar veç te një popull, ashtu siç ishin Pejgamberët e tjerë para tij. Jezusi ishte i dërguar veç te populli hebre-çifut, te populli i tij, këtë gjë e argumenton Bibla.

Në citatin Mateu 1:21, në të cilin thuhet se engjëlli i tha Jozefit<sup>196</sup>:

*“Dhe ajo do të lindë një djalë dhe ti do t’ia vësh emrin Jezus, sepse ai do ta shpëtojë popullin e tij nga mëkatet e tyre”.*

Nga verseti biblik kuptojmë se togfjalëshi *“popullin e tij”* ka domethënie populli i Jezusit, hebrenjtë. Në citat nuk thuhet *“do ta shpëtojë njerëzimin”*, ose *“ta shpëtojë botën”*, por theksohet qartazi: *“do ta shpëtojë popullin e tij”*. Kjo për faktin se Jezusi nuk erdhi për tërë njerëzimin, por qe i dërguar nga Zoti xh.sh. vetëm për çifutët, ashtu siç kanë qenë edhe të dërguarit para tij për një popull.

Përsëri në Ungjillin e Mateut 2:6 thotë:

*“Dhe ti, Bethlehem, tokë në Jude, nuk je aspak më e parendësishmja ndër princat e Judesë, sepse nga ti do të dalë një udhëheqës, që do të kullojë popullin tim, Izraelin”.*

Nga argumentet përfundojmë se Jezusi si profet, i dërguar i çifutëve/ hebrenjve, erdhi që ta shpëtojë popullin e vet nga rruga e shtrembër, nga devijimi; erdhi që ta udhëheqë popullin e tij drejt së vërtetës, besimit në një Zot dhe adhurimit të një Perëndie.

Te Mateu 7:6 thuhet: *“Mos u jepni qenve ç’është e shenjtë dhe mos i hidhni margaritarët tuaj para derrave, që të mos i shkelin me këmbë dhe të kthehen kundër jush dhe t’ju shqyejnë”.*

<sup>196</sup> Sipas Biblës tregohet se engjëlli i tha Jozefit që do të lindte Jezusi, gjë që nuk është e vërtetë, sepse këtë e kundërshton Kur’ani Famëllartë që tregon se engjëlli Xhebrail iu drejtua Merjemes, e jo Jozefit, ku thotë: *“Ajo, vuiri një perde ndaj tyre, e Ne ia dërguam asaj Xhibrilin, e ai iu paraqiti asaj njeri në tërësi. Ajo tha: “Unë i mbështetem të Gjithëmëshirshmit prej teje, nëse je që frikësohesh Atij (pra më lër të lirë)!” Ai (Xhibrili) tha: “Unë jam vetëm i dërguar (melek) i Zotit tënd për të dhuruar ty një djalë të pastër (pejgamber)”.* (Merjem 17-19); *“Rikujtoje kur engjëjt i thanë: “Oj Mejreme, Allahu të përgëzon me fjalën e vet (me lindjen e një femije si rezultat i fjalës së Zotit) emri i të cilit është Mesih, Isa, i biri i Merjemes, i famshëm në dynja e ahiret dhe nga të afërmit (e Zotit)”.* (Ali Imran 45)

Jezusi këtu i urdhëron dhe i porosit nxënësit e vet që thirrjen e tyre të mos ua predikojnë derrave. Në traditën çifute derrat janë njerëz të etniteteve joçifute.<sup>197</sup> Ky fragment vërteton se Jezusi përkufizoi misionin e tij vetëm për bijtë e Izraelit.

Kur i dërgoi dymbëdhjetë apostujt e tij, Jezusi i porositi duke iu thënë:

*“Këta janë të dymbëdhjetët që Jezusi i dërgoi mbasi u dha këto urdhra: “Mos shkoni ndër paganë dhe mos hyni në asnjë qytet të Samaritanëve, por shkoni më mirë te delet e humbura të shtëpisë së Izraelit”. (Mateu 10:5-6)*

Jezusi ua ndaloi apostujve që njerëzit joçifutë të mos i thërrasin në fe, as fqinjët e tyre, samaritanët. Misioni i tij ishte i përkufizuar apostafat për delet e humbura të shtëpisë së Izraelit. Në Mateu 15:24 thuhet: *“Unë nuk jam dërguar gjetiu, përveç te delet e humbura të shtëpisë së Izraelit”.*

Në krahinat e Tirit e Sidonit, një grua e ardhur nga Kananeja, filloi të thërriste e të bërtiste: *“O Zot bir i Davidit! Vajza ime është tmerrësisht e pushtuar nga një Demon!”* Jezusi iu përgjigj: *“Unë jam i dërguar vetëm te delet e humbura të shtëpisë së Izraelit”.* Pse e refuzoi Jezusi shërimin e bijës së gruas nga Kananeja? Sepse ai, siç theksoi, është i dërguar vetëm për popullin e Izraelit, i dërguar vetëm për delet e humbura të Izraelit d.m.th. profet i Zotit për popullin çifut.

Lluka tregon se si Jezusi iu drejtua një turme të çifutëve (hebrenjve) me fjalët:

*“Sepse, ashtu si Jona që një shenjë për Ninivasit, kështu edhe Biri i njeriut do të jetë një shenjë për këtë brez”. (Lluka 11:30)*

Citati vërteton se Jezusi/ Isai a.s. ishte i dërguar i veçantë për një vend. Jona (Junusi a.s.), sipas citatit, ishte peygamber për banorët e Ninovës; po ashtu Jezusi ishte shenjë për këtë brezni. Fjala “për këtë brez”, nënkuptohet për vendndodhjen e brezit në kohën e ekzistimit, d.m.th. Jezusi ishte për bijtë e Izraelit, vetëm për atë brez (për popullin e caktuar dhe vend të caktuar).

<sup>197</sup> Dr. Muhamed Ali El-Havli, *“Komperacioni mes katër ungjijve”*, fq. 34.

Gjithashtu, te Lluca 13: 33-34, tregohet se, kur çifutët kërkuan nga Jezusi ta lëshonte Jerusalemin, ai u tha:

*“Por sot, nesër e pasnesër më duhet të eci, sepse nuk mundet që një profet të vdesë jashtë Jerusalemit. Jerusalem, Jerusalem, që i vret profetët dhe i vret me gurë ata që të janë dërguar! Sa herë desha t’i mbledh bijtë e tu sikurse kllloçka i mbledh nën krahë zogjtë e vet, por ju nuk deshët!”.*

Jezusi tregoi se është peygamber dhe se nuk do ta lëshonte Jerusalemin dhe nuk do t’i braktiste banorët e Jerusalemit, ndërsa çifutët i cilësoi si vrasës peygamberësh. Po ashtu argumenti vërtetonte se Jezusi është i dërguar enkas për izraelitët.

*“Dhe ti, Bethlehem, tokë në Jude, nuk je aspak më e parëndësishmja ndër princat e Judesë, sepse nga ti do të dalë një udhëheqës, që do të kullojë popullin tim, Izraelin”* (Mateu 2: 6)

Këto ishin disa citate-argumente nga Bibla që e lajmëronin Jezusin si profet i çifutëve. Shtrohet pyetja, nëse Jezusi ishte Zot, pse atëherë Zoti erdhi vetëm për popullin hebraik, e jo për tërë njerëzimin?!

Gjithashtu edhe Kur’ani Famëlartë e vërteton se misioni i Isait a.s./ Jezusit ishte vetëm te beni israilët. Kur’ani tregon fjalët e Isait a.s. që iu drejtua popullit të tij:

وَإِذْ قَالَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ بَنِي إِسْرَائِيلَ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيَّ مِنَ  
التَّوْرَةِ ﴿٦﴾

*“Dhe, kur Isai, i biri i Merjemes, tha: “O beni israilë, unë jam i dërguar i Allahut te ju, jam vërtetues i Tevratit që ishte para meje....”.* (Saff 6)

وَرَسُولًا إِلَىٰ بَنِي إِسْرَائِيلَ أَنِّي قَدْ جِئْتُكُمْ بِبَيِّنَاتٍ مِّن رَّبِّكُمْ

*“Dhe, të dërguar të bijtë e Israilit: unë kam ardhur nga Zoti juaj me argumente...”.* (Ali Imran 49)

وَلَمَّا جَاءَ عِيسَى بِالْبَيِّنَاتِ قَالَ قَدْ جِئْتُكُمْ بِالْحِكْمَةِ وَلِأُبَيِّنَ لَكُمْ بَعْضَ الَّذِي  
 خْتَلَفْتُمْ فِيهِ فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا ۖ إِنَّ اللَّهَ هُوَ رَبِّي وَرَبُّكُمْ فَاعْبُدُوهُ هَذَا صِرَاطٌ  
 مُسْتَقِيمٌ

*“Po kur Isai erdhi me argumente tha: “Erdha te ju me pejgamberllëk dhe erdha t’jua sqaroj atë pjesë që e kundërshtonit, pra kijeni frikë Allahun dhe më respektoni mua! S’ka dyshim, Allahu është Ai Zoti im dhe Zoti juaj, andaj Atë adhurojeni! Kjo është rrugë e drejtë!”.* (Zuhruf 63-64)

إِنَّ هُوَ إِلَّا عَبْدٌ أَنْعَمْنَا عَلَيْهِ وَجَعَلْنَاهُ مَثَلًا لِّبَنِي إِسْرَائِيلَ

*“Ai (Isai) ka qenë vetëm një rob, të cilin e bëmë pejgamber dhe e bëmë shembull të jashtëzakonshëm si përvojë për beni israilët”.* (Zuhruf 59)

## 2.8. Mrekullitë e Jezusit / Isait a.s.

Duke lexuar literaturë krishtere lidhur me Jezusin shohim se si, pothuajse, në çdo tekst të tyre, të botuar apo në internet, madje edhe nga bisedat e debatet me misionarët, vërejmë se sa herë që bie fjala për hyjninë e Jezusit, ata i cekin edhe mrekullitë e bëra nga ai, duke e argumentuar me anë të tyre karakterin hyjnor të Jezusit. Jezusi i ringjalli të vdekurit, eci mbi ujë, shëroi sëmundje të ndryshme, etj. etj. dhe këto, sipas tyre, e bëjnë atë meritort të jetë Zot, apo tek disa të tjerë i biri i Zotit.

Hebrenjtë, të cilët kishin devijuar nga mësimet e Musasë a. s. dhe të dërguarve të tjerë që kishin ardhur tek ai popull, dhe të cilët e braktisën rrugën e drejtë dhe besimin e pastër të cilin ua kanë treguar pejgamberët e Zotit. Allahu xh.sh. përgatiti në mënyrë të veçantë Isain a.s. (Jezusin) për ta vazhduar misionin e pejgamberëve të tjerë para tij, duke i thirrur njerëzit në rrugë të drejtë, në besimin në një Zot dhe duke i larguar nga rruga e shtrembër, nga idhujtaria. Si çdo pejgamber edhe Jezusi kishte bërë mrekulli me ndihmën e Zotit të Plotfuqishëm për t’i treguar masës se ishte i dërguar nga Allahu xh.sh-Pejgamber, ashtu që t’i besonin misionit të tij.

Për fat të keq, të krishterët mundohen që me anë të mrekullive të Jezusit / Isait a.s. ta ngrenë në shkallën hyjnore dhe ta quajnë Zot. Duke menduar se mrekullitë që i ka bërë Jezusi s'i ka bërë askush tjetër para tij dhe prandaj duhet të jetë patjetër zot. Shtrohet pyetja: Mrekullitë që i ka bërë Jezusi, a e shndërrojnë atë në qenie hyjnore?

Po ta shikojmë dhe ta analizojmë Biblën në tërësi, me ato mrekulli që i ka bërë Jezusi, do të vërejmë se ai, edhe pse i ka pasur këto mrekulli, nuk mund të quhet perëndi, nga fakti se Zoti xh.sh. ia ka mundësuar çdo të dërguari të Tij të ketë mrekulli dhe se këto mrekulli mund t'i kenë pasur edhe të tjerët.

Le t'i analizojmë disa nga mrekullitë e Jezusit dhe me mrekullitë e të dërguarve të tjerë të Zotit, si p.sh.:

- Sipas Biblës tregohet se Jezusi ushqeu 5000 burra me 5 bukë dhe 2 peshq.

Në Bibël tregohet:

*“Atëherë i urdhëroi që turmat të ulen mbi bar; pastaj i mori pesë bukët dhe dy peshqit dhe, pasi i çoi sytë drejt qiellit, i bekoi; i ndau bukët dhe ua dha dishepujve, dhe dishepujt turmave. Dhe të gjithë hëngrën dhe u ngopën; pastaj dishepujt mbledhën tepricat në dymbëdhjetë kosha plot. Dhe ata që hëngrën ishin rreth pesë mijë burra, pa i numëruar gratë dhe fëmijët”.* (Mateu 14:19-21)

Ose Jezusi ushqeu 4000 veta me 7 bukë e disa peshq të vegjël, siç tregohet në një vend tjetër:

*“Dhe dishepujt e tij iu përgjigjën: “Si do të mund t'i ngopte me bukë këta dikush, këtu në shkretëtirë?”. Dhe ai i pyeti: “Sa bukë keni?”. Ata i thanë: “Shtatë”. Atëherë ai e urdhëroi turmën të ulet për tokë; dhe mori të shtatë bukët, falënderoi, i theu dhe ua dha dishepujve të vet që t'ia shpërndajnë turmës; dhe ata ia shpërndanë. Kishin edhe disa peshq të vegjël; mbasi i bekoi, urdhëroi që edhe ata t'i shpërndahen turmës. Kështu ata hëngrën dhe u ngopën; dhe dishepujt çuan shtatë kosha me copat që tepruan. Ata që hëngrën ishin rreth katër mijë veta; pastaj i lejoi. Dhe menjëherë hipi në barkë me dishepujt e vet dhe shkoi në rrethinën e Dalmanutës”.* (Marku 8:4-10)



Të njëjtën mrekulli e patën Eliseu dhe Elijahu. Eliseu ushqeu 100 njerëz me 20 bukë të bëra nga thekra dhe disa kallinj gruri.

*“Erdhi pastaj një njeri nga Baal-Shalila, që i solli njeriut të Perëndisë bukë nga korrja e parë; njëzet bukë prej elbi dhe disa kallinj gruri. Eliseu tha: “Jepua njerëzve që ta hanë”. Por shërbëtori i tij u përgjigj: “Si mund ta shtroj këtë përpara njëqind vetave?”. Eliseu urdhëroi përsëri: “Jepua njerëzve që ta hanë, sepse kështu thotë Zoti: “Do të hanë dhe ka për të tepruar”“. Kështu ai e shtroi para njerëzve, që hëngrën dhe teproi sipas fjalës së Zotit”. (2 Mbretërve 4:42-44)*

Po ashtu Eliseu i dha një të veje vaj dhe i tha: *“Shko shite vajin dhe paguaji borxhet. Pjesa tjetër do të mjaftojë që sot e tutje”*. (shiko: 2 Mbretërve 4:1-7) Shih gjithashtu libri i parë i Mbretërve 17:16: *“Ena e miellit nuk mbaroi dhe qypi i vajit nuk u pakësua, sipas fjalës që Zoti kishte shqiptuar me anë të Elias”*. Po kështu, në 1 Mbretërve 17:6 thuhet: *“Korbat i sillnin (Elias) bukë e mish në mëngjes dhe bukë e mish në mbrëmje, dhe pinte ujë në përrua”*.<sup>198</sup>

- Jezusi i shëronte të lebrosurit.

Mrekullia tjetër që kishte Jezusi ishte shërimi i të lebrosurve:

*“Ndodhi që, ndërsa Jezusi ndodhej në një nga ato qytete, erdhi një njeri i mbushur plot me lebër, i cili, kur e pa Jezusin, ra me fytyrë për dhe dhe iu lut duke thënë: “Zot, po të duash, ti mund të më pastrosh”. Atëherë ai e zgjati dorën, e preku duke thënë: “Po, e dua, qofsh i pastruar”. Dhe menjëherë lebra iu zhduk”. (Luka 5:12-13)*

*“Dhe erdhi tek ai një lebro i cili, duke iu lutur, ra në gjunjë dhe i tha: “Po të duash, ti mund të më pastrosh”. Dhe Jezusi, duke e mëshiruar, shtriu dorën, e preku dhe i tha: “Po, e dua, qofsh pastruar!”. Dhe, posa tha këto, menjëherë lebra e la dhe u shërua”. (Marku 1:40-42)*

Po ashtu edhe profeti Eliseu i tha Neomanit, i cili ishte lebro, që të shkonte dhe të lahej në lumin Jordan, ku do të shërohej:

<sup>198</sup> Për këto mrekulli shih te: Hasan Baxhil, *“Dialog ndërmjet të krishterit dhe myslimanit”*, fq. 36-37.

*“Atëherë ai zbriti dhe u zhyt shtatë herë në Jordan, sipas fjalës së njeriut të Perëndisë, mishi i tij u bë si mish i një fëmije të vogël dhe ai u pastrua”.* (2 Mbretërve 5: 14)

- Mrekullia tjetër e Jezusit ishte që t’ua kthente shikimin të verbërve.

Bibla e tregon këtë mrekulli dhe thotë:

*“Dhe Jezusi mori fjalën dhe i tha: “Çfarë do që unë të të bëj?”. I verbri i tha: “Rabboni, që të më kthehet të parit!”. Dhe Jezusi i tha: “Shko, besimi yt të shëroi”. Dhe në çast atij iu kthye të parit dhe nisi të ndjekë Jezusin në udhë”.* (Marku 10:51-52)

*“Pastaj arriti në Betsaida; dhe i prunë një të verbër e iu lutën ta prekte. Atëherë e mori për dorë të verbrin, e nxori jashtë fshatit dhe, pasi i pështyu në sy dhe vuri duart mbi të, e pyeti nëse shihte gjë. Dhe ai, duke hapur sytë, tha: “Po shoh njerëz si pemë që ecin”. Atëherë Jezusi i vuri përsëri duart mbi sytë dhe e bëri të shikojë lart; dhe atij iu kthye të parit dhe shikonte qartë gjithçka”.* (Marku 8:22-26)

Sipas Biblës tregohet se të njëjtën gjë e bëri edhe Eliseu:

*“Pastaj Eliseu u lut dhe tha: “O Zot, të lutem, hap sytë e tij që të mund të shohë”. Atëherë Zoti ia hapi sytë të riut dhe ai pa; dhe ja, mali ishte plot me kuaj dhe me qerre të zjarrta rreth e qark Eliseut..... Kur arritën në Samari, Eliseu tha: “O Zot, hapua sytë që të shohin”. Zoti ua hapi sytë dhe ata panë; ja, ndodheshin brenda në Samari”.* (2 Mbretërve 6: 17,20)

Po në 2 Mbretërve 6: 18, thuhet se Eliseu mund të shkaktonte verbërimin:

*“Ndërsa Sirët po zbrisnin në drejtim të Eliseut, ky iu lut Zotit dhe i tha: “Të lutem, goditi këta njerëz me verbëri”. Dhe ai i verboi sipas fjalës së Eliseut”.*

- Jezusi mund t’i ringjallte të vdekurit.

Kjo është njëra ndër mrekullitë, nëpërmjet së cilës misionarët mundohen ta ngrenë Jezusin sa më tepër në shkallën e hyjnisë, duke pasur parasysh se ai ringjalli të vdekurit, gjë që, sipas tyre, kjo cilësi i takon vetëm Zotit, meqë Jezusi e pati këtë cilësi atëherë duhet të quhet Zot! Mirëpo, a e ka pasur vetëm Jezusi këtë mrekulli? Le të lexojmë në vazhdim pjesë nga Bibla:

*“Atëherë Jezusi, kur pa se ajo dhe Judenjtë që kishin ardhur me të po qanin, u psherëtiu në frymë dhe u trondit,.....Jezusi qau. Atëherë Judenjtë thanë: “Shih, sa e donte!”..... Prandaj Jezusi, përsëri i tronditur përbrenda, erdhi te varri; por ky ishte një guvë dhe kishte përpara një gur. Jezusi tha: “Hiqni gurin!”. Marta, motra e të vdekurit, i tha: “Zot, ai tashmë qelbet, sepse ka vdekur prej katër ditësh”. Jezusi i tha: “A nuk të thashë se po të besosh, do të shohësh lavdinë e Perëndisë?”. Atëherë ata e hoqën gurin prej vendit ku ishte shtrirë i vdekuri. Dhe Jezusi i ngriti sytë lart dhe tha: “O Atë, të falënderoj që më ke dëgjuar. Unë e dija mirë se ti gjithnjë më dëgjon, por i kam thënë këto për turmën që është përreth, që të besojnë se ti më ke dërguar”. Dhe, mbasi tha këto, thirri me zë të lartë: “Llazar, eja jashtë!”. Atëherë i vdekuri doli, me duart e këmbët të lidhura me rripa pëlhure dhe me fytyrën të mbështjellë në një rizë. Jezusi u tha atyre: “Zgjidheni dhe lëreni të shkojë!”. (Gjoni 11:33-44)*

Nga ky citat vërejmë qartazi se mrekullia e bërë në ringjalljen e të vdekurit, është nga ana e Zotit Fuqiplotë e jo nga vetë Jezusi, sepse *“Jezusi i ngriti sytë lart dhe tha: “O Atë, të falënderoj që më ke dëgjuar”, kjo tregon se Jezusi s’ka mundur të bëjë asgjë vetë pa ndihmën e Zotit xh.sh. dhe se mrekullitë ishin burim nga Zoti Fuqiplotë. Sepse Jezusi tha: “Unë s’mund të bëj asgjë nga vetja ime...”. (Gjoni 5:30)*

Mirëpo, a e kishte vetëm Jezusi këtë mrekulli? Sipas Biblës, jo. Të njëjtën mrekulli rreth ringjalljes së të vdekurve, e ka pasur edhe Elija, p.sh. tek 1 Mbretërve 17:22, ku thuhet:

*“Zoti e plotësoi dëshirën e shprehur në zërin e Elias; shpirti i fëmijës u kthye tek ai dhe ai mori jetë përsëri”.*

Po ashtu edhe tek 2 Mbretërve 4:34:

*“Pastaj hipi mbi shtratin dhe u shtri mbi fëmijën; vuri gojën e vet mbi gojën e tij, duart e veta mbi duart e tij; u shtri mbi të dhe mishi i fëmijës filloi të ngrohet”.*

Madje, edhe kockat e Elijas mund ta kthenin një të vdekur në jetë po të fërkoreshin pas kufomës:

*“Por ndodhi që, ndërsa disa varrosnin një njeri, panë një bandë plaçkitësish; kështu e hodhën njeriun në varrin e Eliseut. Sa arriti ai të prekë kockat e Eliseut, u ringjall dhe u ngrit në këmbë”. (2 Mbretërve 13:21)*

Kurse thuhet se Ezekieli ka ringjallur shumë më tepër të vdekur se sa ka ringjallur Jezusi:

*“Dora e Zotit u ndodh mbi mua, më çoi jashtë në Frymën e Zotit, dhe më lëshoi në mes të një lugine që ishte plot me kocka. Pastaj më bëri të kaloj afër tyre, rreth e qark; dhe ja, ishin në sasi të madhe mbi sipërfaqen e luginës; dhe ja, ishin shumë të thata. Më tha: “Bir njeriu, a mund të rijetojnë këto kocka?”. Unë u përgjigja: “O Zot, o Zot, ti e di”. Më tha akoma: “Profetizo këtyre kockave dhe u thuaj atyre: Kocka të thata, dëgjoni fjalën e Zotit. Kështu ju thotë Zoti, Zoti, këtyre kockave: Ja, unë po fus te ju frymën dhe ju do të rijetoni. Do të vë mbi ju mishin, do t’ju mbuloj me lëkurë dhe do të shtie te ju frymën, dhe do të jetoni; atëherë do të pranoni që unë jam Zoti”. Profetizova ashtu si më ishte urdhëruar; ndërsa profetizojta, pati një zhurmë; dhe ja një tronditje; pastaj kockat iu afruan njëra tjetrës. Ndërsa po shikoja, ja ku u rritën mbi ta dejtë dhe mishi, që lëkura i mbuloi; por fryma nuk ishte tek ato. Atëherë ai më tha: “Profetizoji frymës, profetizo bir njeriu dhe i thuaj frymës: Kështu thotë Zoti, Zoti: Frymë, eja nga të katër erërat dhe fryj mbi këta të vrarë, që të jetojnë”. Kështu profetizova, si më kishte urdhëruar dhe shpirti hyri në to, dhe u kthyen në jetë dhe u ngritën më këmbë; ishte një ushtri e madhe, shumë e madhe”. (Ezekieli 37:1-10)*

Në Bibël përmendet edhe Pjetri si apostull i Jezusit që ta ketë ngjallur Tabithën, pasi ajo kishte vdekur:

*“Atëherë Pjetri, mbasi i nxori jashtë të gjithë, u gjunjëzua dhe u lut. Pastaj iu kthye trupit dhe tha: “Tabitha, çohu!”. Dhe ajo i hapi sytë dhe, si pa Pjetrin, u ngrit ndenjor”. (Veprat 9:40)*

- Jezusi mundi të ecte mbi ujë.

Bibla tregon se Jezusi eci mbi det-ujë:

*“Jezusi shkoi drejt tyre, duke ecur mbi det”. (Mateu 14:25)*

Po ta analizojmë mirë dhe ta bëjmë një krahasim të thjesht ndërmjet Jezusit dhe Moisiut (që të dy kishin mrekullia nga Zoti Fuqiptotë), do të themi se Moisiu bëri një mrekulli më të madhe se vetë Jezusi, sepse Moisiu shtriu dorën e tij mbi det dhe deti u hap. Nuk e kemi qëllimin e dhënies përparësi njërit pejgamber ndaj tjetrit lidhur me mrekullitë, dhe vënien e tyre në një lloj gare me muxhizet (mrekullitë), por sa për një ilustrim, sepse edhe pejgamberët e tjerë posedonin mrekulli, madje edhe më të mëdha, atëherë këto a paskan qenë hyjni më të mëdha se Jezusi? Sipas besimit të krishterë kështu duhet të jetë, por sipas logjikës të shëndoshë kjo tregon se edhe Jezusi kishte mrekulli si të Moisiut/ h. Musau a.s. para tij.:

*“Kështu bijtë e Izraelit hynë në mes të detit në të thatë; dhe ujërat formonin si një mur në të djathtë dhe të majtë të tyre”. (Exodi 14:22)*

Po ashtu edhe Pjetri eci mbi ujëra, siç ceket te Mateu 14:29:

*“Ai tha: “Eja!”. Dhe Pjetri zbriti nga barka dhe eci mbi ujëra, për të shkuar te Jezusi”.*

- Jezusi ka mundur t'i trembë, apo t'i largojë djajtë.

Lluka tregon se Jezusi: *“iu përgjigj atyre: “Shkoni e i thoni asaj dhelpre: “Ja, sot dhe nesër po dëboj demonë dhe kryej shërimë...” (Lluka 13:32), kurse Marku tregon:*

*“Atëherë në sinagogën e tyre ishte një njeri i pushtuar nga një frymë e ndyrë, i cili filloi të bërtasë, duke thënë: “Ç’ka midis nesh dhe teje, o Jezus Nazareas? A erdhe të na shkatërrosh? Unë e di kush je: I Shenjti i Perëndisë”. Por Jezusi e qortoi duke thënë: “Hesht dhe dil prej tij!”. Dhe fryma e ndyrë, mbasi e sfiliti, dhe duke lëshuar një britmë të madhe doli prej tij. (Marku 1:23-26)*

Jezusi e ka pranuar se të njëjtën gjë mund ta kryenin edhe të tjerët. Shih te Mateu 12:27 dhe Lluka 11: 19. Shpirtrat e këqij dëboheshin edhe prej dishepujve të Jezusit, Mateu 7: 22:

*“Shumë do të më thonë atë ditë: “O Zot, o Zot, a nuk profetizuaam ne në emrin tënd, a nuk i dëbuam demonët në emrin tënd, a nuk kemi bërë shumë vepra të fuqishme në emrin tënd?”.*

Madje, Jezusi profetizoi se mrekullitë do të kryhen edhe nga profetë të rremë:

*“Sepse do të dalin krishterë të rremë dhe profetë të rremë, dhe do të bëjnë shenja të mëdha dhe mrekulli të tilla aq sa t’i mashtrojnë, po të ishte e mundur, edhe të zgjedhurit”.* (Mateu 24:24)<sup>199</sup>

Të gjitha këto mrekulli që i pa bërë Jezusi janë bërë nga profetët e tjerë, nga dishepujt e tij, madje edhe nga njerëzit e tjerë<sup>200</sup>. Pra, këto mrekulli Jezusi i kreu me ndihmën e Zotit, ndaj edhe thotë: *“Unë s’mund të bëj asgjë nga vetja ime...”*. (Gjoni 5:30) dhe *“Por në se unë i dëboj demonët me gishtin e Perëndisë, mbretëria e Perëndisë, pra ka arritur deri te ju”*. (Lluka 11:20)

E tërë kjo që u tha, na nxit ta shtojmë pyetjen: A mund të themi se Jezusi është Zot? Nëse po, atëherë, në analogji me këtë konstatim, të gjithë të tjerët, të cilët i kanë bërë të njëjtat mrekulli si të Jezusit, na qenkan zota.

Jezusi/ Isai a.s. erdhi me argumente, mrekulli që Allahu xh.sh. ia mundësoi si çdo pejgamberi tjetër. Erdhi t’ua tregonte rrugën e drejtë dhe të vërtetë. Të besojmë në Allahun Një, ta adhurojmë vetëm Atë, e jo të besojmë se Jezusi është Zot, bir i Zotit, apo pjesë e trinisë. Larg qoftë Ai nga ato që i përshkruajnë, që shpifin.

Sa i përket mrekullive të Isait a.s./ Jezusit, libri i fundit i shenjtë, Kur’ani, i cek këto mrekulli të tij dhe tregon se mrekullitë burojnë nga Zoti i Plotfuqishëm, e jo nga vetë Jezusi.

Në suren Ali Imran, ajeti 49 tregon fjalët e Isait a. s., me të cilat iu drejtua beni israilëve (popullit për të cilin u dërgua Isai a.s.):

وَرَسُولًا إِلَىٰ بَنِي إِسْرَائِيلَ أَنِّي قَدْ جِئْتُكُمْ بِبَيِّنَاتٍ مِّن رَّبِّكُمْ ۚ أَنِّي أَخْلُقُ لَكُمْ مِّنَ الطِّينِ كَهَيْئَةِ الطَّيْرِ فَأَنْفُخُ فِيهِ فَيَكُونُ طَيْرًا بِإِذْنِ اللَّهِ ۚ وَأُبْرِيءُ الْأَكْمَهَ وَالْأَبْرَصَ

<sup>199</sup> Për këto mrekulli dhe të tjera shih te këta libra: Hasan Baxhil, *“Dialog ndërmjet të krishterit dhe myslimanit”*, fq. 36-37, dhe Tahir Kukaj, *“Besueshmëria e citateve kur’anore dhe atyre biblike”*, fq. 59-63.

<sup>200</sup> Gjithmonë mendojmë sipas Biblës, ashtu siç e paraqet Bibla.

وَأُحِي الْمَوْتَى بِإِذْنِ اللَّهِ وَأُنَبِّئُكُمْ بِمَا تَأْكُلُونَ وَمَا تَدَّخِرُونَ فِي بُيُوتِكُمْ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِّكُمْ إِن كُنتُمْ مُؤْمِنِينَ ﴿١٥٦﴾

*“Dhe, të dërguar te bijtë e Israilit: unë kam ardhur nga Zoti juaj me argument, unë nga balta ju bëj diç si shpendi, i fryj atij dhe ai me lejen e Allahut bëhet shpend, unë i shëroj të verbrit, të sëmurët në lekure, dhe unë me lejen e Allahut ngjalli të vdekurit: unë ju tregoj për atë që e hani dhe për atë që e keni në shtëpitë tuaja. Vërtet, ky është fakt për ju nëse jeni besimtarë”.*

Isai a.s./ Jezusi bëri edhe mrekulli të tjera, për të cilat nuk flet gjë Bibla, siç ishte rasti kur Isai a.s./ Jezusi foli kur ishte foshnjë në djep. Pastaj, kur populli e akuzonin nënën e tij Merjemen (Marinë) për tradhti pasi që e panë me foshnje, sepse ajo nuk ishte e martuar, duke i thënë, si mund të kishte lindur fëmijë pa qenë e martuar? Kur dihet se prej çfarë familjeje të ndershme je, si ke mundur ta bësh një krim të tillë? Këto akuza dhe pyetje i bëheshin Merjemes sikur të ishte autore e krimit. Merjemja (Maria) nuk u përgjigjej, heshte dhe bënte me shenjë kah foshnja e porsalindur që të flisnin me të, ngase ai do t’iu përgjigjej pyetjeve dhe akuzave që ia bënin asaj. Zoti i Plotfuqishëm bëri mrekulli, duke mundësuar që Isai a.s. të flasë qysh si foshnjë e vogël dhe t’i demantojë shpifjet e akuzat ndaj nënës së vet. Këtë ngjarje e tregon Kur’ani Famëllartë:

فَأْتَتْ بِهِ قَوْمَهَا تَحْمِلُهُ ۗ قَالُوا يَمْرَأَتُ لَقَدْ جِئْتِ شَيْئًا فَرِيًّا ﴿١٥٧﴾ يَأْتِخَتْ هَرُونَ مَا كَانَ أَبُوكَ أَمْرًا سَوَاءً وَمَا كَانَتْ أُمُّكَ بَغِيًّا ﴿١٥٨﴾ فَأَشَارَتْ إِلَيْهِ قَالُوا كَيْفَ نُكَلِّمُ مَنْ كَانَ فِي الْأَمْهِدِ صَبِيًّا ﴿١٥٩﴾ قَالَ إِنِّي عَبْدُ اللَّهِ ءَاتَنِي الْكِتَابَ وَجَعَلَنِي نَبِيًّا ﴿١٦٠﴾ وَجَعَلَنِي مُبَارَكًا أَيْنَ مَا كُنْتُ وَأَوْصَانِي بِالصَّلَاةِ وَالزَّكَاةِ مَا دُمْتُ حَيًّا ﴿١٦١﴾ وَرَبًّا بَوَالِدَتِي وَلَمْ يَجْعَلْنِي جَبَّارًا شَقِيًّا ﴿١٦٢﴾ وَالسَّلَامُ عَلَيَّ يَوْمَ وُلِدْتُ وَيَوْمَ أَمُوتُ وَيَوْمَ أُبْعَثُ حَيًّا ﴿١٦٣﴾ ذَلِكَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ قَوْلَ الْحَقِّ الَّذِي فِيهِ يَمْتَرُونَ ﴿١٦٤﴾

*“Dhe u kthye te populli i vet, duke e mbajtur fëmijën. Ata i thanë: “Oj Merjeme, ke bërë një punë shumë të keqe!” Oj motra e Harunit, babai yt nuk ka qenë njeri i keq, e as nëna jote nuk ka qenë e pamoralshme! Atëherë ajo u dha shenjë kah (Isai).*

*Ata thanë: “Si t’i flasim atij që është foshnjë në djep?” Ai (Isai) tha: “Unë jam rob i Allahut, mua më ka dhënë (ka caktuar të më japë) librin (Ungjillin) dhe më ka bërë Pejgamber. Më ka bërë dobiprurës kudo që të jem dhe më ka porositur me namaz (fajle) e zeqatë për sa të jem gjallë! Më ka bërë të mirësjellshëm ndaj nënës sime, e nuk më ka bërë kryelartë as të padëgjueshëm! Selami (shpëtim prej Allahut) është me mua ditën kur u lindi, ditën kur të vdes dhe ditën kur të dal (prej varrit) i gjallë!” Kjo është (fjalë) e vërtetë, rreth Isait, të birit të Merjemes, në të cilin ata shkaktojnë dyshime”. (Merjem 27-34)*

Po ashtu edhe te surja Ali Imran 46, tregohet mrekullia se si Isai a.s./ Jezusi, duke qenë në djep, u fliste njerëzve:

وَيُكَلِّمُ النَّاسَ فِي الْمَهْدِ ﴿٥١﴾

*“E që duke qenë në djep (foshnjë) u flet njerëzve...”*

Mrekullia tjetër, të cilën Bibla nuk e përmend, është edhe zbritja e sofrës nga qielli, kur apostujt (Havariunët) e Isait a.s./ Jezusit kërkuan nga ai që ta luste Zotin xh.sh. që ta zbriste një tryezë-sofër nga qielli. Ja citati nga Kur’ani:

إِذْ قَالَ الْحَوَارِيُّونَ يَٰعِيسَىٰ ابْنَ مَرْيَمَ هَلْ يَسْتَطِيعُ رَبُّكَ أَنْ يُنَزِّلَ عَلَيْنَا مَائِدَةً مِّنَ السَّمَاءِ ۗ قَالَ أَتَقْوُونَ اللَّهَ إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ ﴿٥١﴾ قَالُوا نَزِيدُكَ أَنْ نَأْكُلَ مِنهَا وَتَطَهِّرَ قُلُوبُنَا وَنَعْلَمَ أَنْ قَدْ صَدَقْتَنَا وَنَكُونَ عَلَيْهَا مِنَ الشَّاهِدِينَ ﴿٥٢﴾ قَالَ عِيسَىٰ ابْنُ مَرْيَمَ اللَّهُمَّ رَبَّنَا أَنْزِلْ عَلَيْنَا مَائِدَةً مِّنَ السَّمَاءِ تَكُونُ لَنَا عِيدًا لِأَوَّلِنَا وَآخِرِنَا وَآيَةً مِّنكَ وَأَرْزُقْنَا وَأَنْتَ خَيْرُ الرَّزُقِينَ ﴿٥٣﴾ قَالَ اللَّهُ إِنِّي مُنَزِّلُهَا عَلَيْكُمْ فَمَنْ يَكْفُرْ بَعْدَ مِنْكُمْ فَلِي عَذَابُهُ عَذَابًا لَّا أُعَذِّبُهُ أَحَدًا مِّنَ الْعَالَمِينَ ﴿٥٤﴾

*“Kujtoje kur Havarijunët (dishepujt) thanë: “O Isa, i biri i Merjemes, Zoti a mund të na zbresë një tryezë nga qielli?” (Isai) tha: “Kijeni frikë Allahun nëse jeni besimtarë!” (Ata) Thanë: “Ne dëshirojmë të hamë nga ajo dhe të na binden (edhe më shumë) zemrat tona dhe të vërtetojmë bindshëm se na e the të vërtetën e të bëhemi dëshimues të saj!” Isai, i biri i Merjemes, tha: “O Allah, Zoti ynë, zbritna nga qielli një tryezë, të na jetë festë (gëzim) për ne dhe për ata (që vijnë) pas nesh, të jetë argument*



prej Teje, dhe dburona se Ti je furnizuesi më i mirë!” Allahu u përgjigj: “Unë do t’jua zbres, por cilindo nga ju që nuk beson pas kësaj, do ta dënoj ashtu siç nuk e kam dënuar askënd në botë”. (El-Maide 112-115)

Ndërsa në ajetin në vazhdim Zoti na tregon dialogun e Tij me Isanë a.s./ Jezusin, për të mirat e Zotit ndaj tij dhe nënës së tij, për mrekuellitë që Zoti ia mundësoi Isait a.s., dhe shpëtimin e tij nga beni israilët, kur tentuan ta mbysin dhe mënyrën se si disa nga njerëzit nuk besuan dhe e cilësuan Isanë si magjistar etj.

إِذْ قَالَ اللَّهُ يٰعِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ اذْكُرْ نِعْمَتِي عَلَيْكَ وَعَلَىٰ وَالِدَتِكَ إِذْ أَيَّدْنَاكَ بِرُوحِ  
الْقُدُسِ تُكَلِّمُ النَّاسَ فِي الْمَهْدِ وَكَهَلًا وَإِذْ عَلَّمْنَاكَ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَالتَّوْرَةَ  
وَالْإِنْجِيلَ وَإِذْ تَخْلُقُ مِنَ الطِّينِ كَهَيْئَةِ الطَّيْرِ بِإِذْنِي فَتَنفُخُ فِيهَا فَتَكُونُ طَيْرًا بِإِذْنِي وَتَبْرِئُ  
الْأَكْمَامَ وَالْأَبْرَصَ بِإِذْنِي وَإِذْ تُخْرِجُ الْمَوْتَىٰ بِإِذْنِي وَإِذْ كَفَفْتُ بَنِي إِسْرَائِيلَ  
عَنْكَ إِذْ جِئْتَهُم بِالْبَيِّنَاتِ فَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْهُمْ إِن هَذَا إِلَّا سِحْرٌ مُّبِينٌ ﴿١١٥﴾

“Allahu (atë ditë) i thotë: “O Isa, i biri i Merjemes, rikujtoji të mirat e Mia ndaj teje dhe ndaj nënës sate, kur të fuqizova me shpirtin e shenjtë (Xhibrilin), e ti u fole njerëzve (kur ishe) në djep dhe (kur ishe) i pjekur (si burrë), kur ta mësova ty librin e urtësinë, Tevratin e Inxhilin, kur me lejen Time formova nga balta si formë shpeze e i fryve asaj dhe me urdhrin Tim u bë shpend, kur e shërove të verbrin dhe të sëmurin nga sëmundja e lëkurës me dëshirën Time, kur me urdhrin Tim i nxore (të gjallë) të vdekurit, kur i zmbropsa beni israilët prej teje (që deshën të të mbysin) atëherë kur erdhe me argumente, e disa prej tyre që nuk besuan thanë: “Kjo (mrekullia e Isait) nuk është tjetër vetëm se magji e qartë!” (Maide 110)

## 2.9. Jezusi/ Isai a.s. paralajmëroi ardhjen e Muhamedit s.a.v.s.

Në Kur’anin Famëlartë Allahu xh.sh. na tregon fjalët e Isait a.s., i cili e paralajmëroi popullin e tij rreth ardhjes së një pejgamberi tjetër mbas tij, emri i të cilit do të jetë Ahmed (Muhamed). Po ashtu tregon qartazi se Muhamedi s.a.v.s. është i përshkruar në librat e tyre, Tevrat e Inxhil, me cilësitë e me vetitë e tij dhe kjo

gjë vërtetohet edhe në Biblat që i kemi sot në duart tona<sup>201</sup>, ardhja e tij si i dërguar, edhe pse të krishterët mundohen ta fshehin këtë gjë në lidhje me Muhamedin s.a.v.s.<sup>202</sup> Kur'ani Famëlartë tregon:

وَإِذْ قَالَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ بِنَتِيِّ إِسْرَائِيلَ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيَّ مِنَ التَّوْرَةِ وَمُبَشِّرًا بِرَسُولٍ يَأْتِي مِنْ بَعْدِي اسْمُهُ أَحْمَدٌ فَلَمَّا جَاءَهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ قَالُوا هَذَا سِحْرٌ مُّبِينٌ ﴿١٠١﴾

*“Dhe, kur Isai, i biri i Merjemes tha: “O beni israilë, unë jam i dërguar i Allahut te ju, jam vërtetues i Tevratit që ishte para meje dhe jam përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed!” E kur ai u erdhi atyre me argumente të qarta, ata thanë: “Kjo është magji e hapët”. (Saff 6)*

الَّذِينَ يَتَّبِعُونَ الرَّسُولَ النَّبِيَّ الْأُمِّيَّ الَّذِي يَجِدُونَهُ مَكْتُوبًا عِنْدَهُمْ فِي التَّوْرَةِ وَالْإِنْجِيلِ ﴿١٠٢﴾

<sup>201</sup> Më gjerësisht rreth kësaj teme lexo: Abdul Ahad Dawud, “Muhamedi në Bibël”, Prishtinë, 1995; Ahmed Didat, “Ç’thotë Bibla për Muhamedin a.s.”, Tiranë, 1992; Abdurrahman Ajgyn, “Profeti Islam në Ungjillin e Barnabeut”, Konja 1989; Rahmetullah El-Hindi, “Trumfi i së vërtetës”, Shkup, 1998 etj.

<sup>202</sup> Fjala e parë që Allahu xh.sh. ia zbriti Muhamedit s.a.v.s. përmes Xhebrailit ishte “Ikre”, që do të thotë “Lexo”, ajetet e para të sures Alek 1-5. Muhamedi s.a.v.s., duke qenë se nuk dinte shkrim lexim iu përgjigj: “Unë nuk di të lexoj”. Kjo shpallje e parë profetizohet edhe në Bibël tek Isaia 29:12, ku tregohet: “Dhe libri do t’i jepet atij që nuk di të lexojë, duke i thënë: “Të lutem, lexoje këtë!”, por ai përgjigjet: “Nuk di të lexoj”. Radhitja e ajeteve të shpallura në Kur’an Famëlartë nuk është sipas radhitjes që gjendet tani, d.m.th. se ajeti i parë sipas kohës së zbritjes nuk është radhitur nga fillimi i Kur’anit, por në fillim e kemi Fatihan, kjo radhitje e tanishme është e urdhëruar nga Zoti i Plotfuqishëm dhe jo nga orvatjet e Pejgamberit s.a.v.s. Me fjalë të tjera, shpallja e parë nuk jepet në faqen e parë dhe shpallja e fundit nuk jepet në faqen e fundit. Mënyra e radhitjes së këtyre ajeteve në Kur’an është vendosur nga Allahu xh.sh. dhe kjo jepet madje edhe në Bibël po ashtu tek Isaia 28: 10-11 ku thuhet: “Pasi ajo duhet të jetë urdhër mbi urdhër, urdhër mbi urdhër, rregull mbi rregull, rregull mbi rregull (rresht mbi rresht), pak këtu dhe pak atje: me buzë të dridhura e me një gjuhë të huaj ai do t’u drejtohet njerëzve”. Gjuha e huaj ka këtu kuptimin e një të foluri tjetër që nuk është as hebraisht e as aramaike, por arabishtja. Muslimanët në tërë botën i drejtohen Zotit, në namaz vetëm në një gjuhë, në arabisht, në të cilën ka zbritur Kur’ani. Edhe ky unitet gjuhësor është profetizuar në librin e Sofonia 3: 9, ku thuhet: “Ndaj unë do t’u jap njerëzve një gjuhë të pastër që ata të mund t’i drejtohen Perëndisë me një zë dhe t’i shërbejë Atij të bashkuar”. Për më tepër shih Hasan Baxhil, “Dialog ndërmjet të krishterit dhe myslimanit”, fq. 72-73.

“Që pranojnë të dërguarin (Muhamedin), pejgamberin arab, (që nuk shkruan, as lexon), të cilin e gjejnë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij), te ata në Tevrat dhe në Inxhil...”. (El-A’raf 157)

## 2.10. Jezusi/ Isai a.s. nuk u kryqëzua

Ndërsa ajeti në vazhdim hedh poshtë thëniet dhe trillimet e tyre lidhur me Isanë a.s./ Jezusin, të cilin kinse e mbytën, e gozhduan, po ashtu këtë trillim e hedh poshtë edhe vetë bibla po të studiohet dhe po të analizohen mirë citatet e saj<sup>203</sup>.

Allahu xh.sh. thotë në Kur’anin Famëlartë:

وَقَوْلِهِمْ إِنَّا قَتَلْنَا الْمَسِيحَ عِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ رَسُولَ اللَّهِ وَمَا قَتَلُوهُ وَمَا صَلَبُوهُ وَلَٰكِن شُبِّهَ  
هَمَّ وَإِنَّ الَّذِينَ اٰخْتَلَفُوا فِيهِ لَفِي شَكٍّ مِّنْهُ مَا لَهُمْ بِهِ مِنْ عِلْمٍ إِلَّا اتِّبَاعَ الظَّنِّ وَمَا  
قَتَلُوهُ يَقِينًا ﴿٥٧﴾ بَل رَفَعَهُ اللَّهُ إِلَيْهِ وَكَانَ اللَّهُ عَزِيزًا حَكِيمًا ﴿٥٨﴾

“Madje për shkak të thënies së tyre: “Ne e kemi mbytur Mesihun, Isanë, të birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut”. Po ata as e mbytën, as e gozhduan (nuk e kryqëzuan në gozhda), por atyre u përngjau. Ata që nuk u pajtuan rreth (mbytyes së) tij, janë në dilemë për të (për mbytyje) e nuk kanë për të kurrfarë dijeje të saktë, përveç që janë iluzion. E ata, në të vërtetë, nuk e mbytën atë. Përkundrazi, Allahu e ngriti atë pranë Vetes. Allahu është i Plotfuqishëm, i Gjithëdijshëm”. (Nisa 157-158)

Si përfundim mund të themi se kushdo që thotë diçka më tepër sesa na ka mësuar Kur’ani dhe Pejgamberi s.a.v.s. për Isanë a.s., ose për ndonjë të dërguar tjetër të Allahut, ka gabuar dhe është larguar nga rruga e vërtetë. Të gjitha teoritë si “triniteti”, barazia e Isait me Zotin, barazia ndërmjet Krijesit dhe krijesave të

<sup>203</sup> Duke pasur parasysh se po të shtjellohej këtu çështja lidhur me kryqëzimin e Jezusit, do të ndryshonte tematika e këtij punimi për të cilin po flasim dhe do të na merrte shumë vend shtjellimi i saj sipas Biblës dhe Kur’anit, duke e zbuluar vërtetësinë e një gënjeshtre që ia veshin Jezusit, Paqja e Zotit qoftë mbi të. Ju kisha sugjeruar që t’i lexoni këta libra me këtë tematikë: Ungjilli sipas Barnabes, përktheu Avdi Berisha, Prishtinë, 1998; Halil Ibrahim, “Islami dhe krishterimi”, Prishtinë, 2005; Dr. Muhamed Ali El-Havli, “Komperacioni mes katër ungjijve”, Shkup, 2002; Ahmed Deedat, “Crucifixion or crucifixion” etj.

Tij, të gjitha të çojnë në mosbesim në Allahun xh.sh. dhe njëherësh i bën shok, rival, Zotit të Plotfuqishëm, gjë që bën pjesë ndër mëkatet më të mëdha, për çfarë vetë Zoti ka thënë në Kur'anin Famëlartë:

إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ ۚ وَمَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ ضَلَّ ضَلَالًا بَعِيدًا ﴿١١٦﴾

“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush, apo diçka tjetër, veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ai, me të vërtetë, ka humbur dhe është larguar shumë prej udhës së drejtë”. (Nisa 116)

Ndërkaq, besimi ynë është ashtu siç ka qenë besimi i të dërguarit të fundit ndaj pejgambereve të tjerë. Allahu xh.sh. na i rrëfen besimin e Pejgamberit s.a.v.s., duke thënë:

ءَامَنَ الرَّسُولُ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْهِ مِنْ رَبِّهِ ۚ وَالْمُؤْمِنُونَ كُلٌّ ءَامَنَ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِّن رُّسُلِهِ ۚ وَقَالُوا سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا ۚ غُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ ﴿٢٨٥﴾

“I Dërguari beson në atë (Kur'anin) që i është shpallur nga Zoti i tij e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të dërguarit e Tij (duke thënë): “Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij”. Ata thonë: “Ne dëgjojmë dhe bindemi. Faljen Tënde kërkojmë, o Zoti Ynë dhe te Ti do të kthehemi!”. (Bekare 285)

### 3. Trajtimi biblik dhe kur'anor ndaj shpirtit të shenjtë

Sipas doktrinës së trinitetit, shpirti i shenjtë, apo siç quhet ndryshe në Bibël - fryma e shenjtë, është personi i tretë i një hyjnie, i barabartë me Atin dhe të birin. Ndërkaq një libër mbi ortodoksinë thotë: “Fryma e shenjtë është tërësisht Perëndi”.<sup>204</sup> Në shkrimet hebraike, fjala e përdorur më shpesh për “frymë” është “RU’ACH” - frymë, shpirt, ndërsa në shkrimet greke fjala PNEU’MA ka një kuptim të ngjashëm.<sup>205</sup>

Kur’ani Famëlartë na tregon se, të flasësh për shpirtin në përgjithësi, nuk do të kemi fort njohuri në lidhje me të, veç aq sa na ka njoftuar Zoti i Plotfuqishëm në librin e Tij, Kur’anin, ku, lidhur me pyetjet për shpirtin, i drejtohet Muhamedit s.a.v.s., duke e porositur ta japë këtë përgjigje:

وَسْأَلُونَكَ عَنِ الرُّوحِ قُلِ الرُّوحُ مِنْ أَمْرِ رَبِّي وَمَا أُوتِيتُمْ مِنَ الْعِلْمِ إِلَّا قَلِيلًا ﴿١٥٦﴾

*“Do të të pyesin për shpirtin. Thuaj: “Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, ndërsa juve nuk ju është dhënë veçse pak dijeni”.* (El-Isra 85)

Ndërkaq, sa i përket frymës së shenjtë, apo shpirtit të shenjtë, në Kur’an përmendet me emrin Ruhul-Kudus, ku aludohet në melekun Xhebrail (Gabrieli)<sup>206</sup>. Kjo vërtetohet në ajetin e Kur’anit Famëlartë, ku tregohet se Kur’anin nga Allahu xh.sh. Muhamedit s.a.v.s. ia përcolli shpirti i shenjtë :

قُلْ نَزَّلَهُ رُوحُ الْقُدُسِ مِنْ رَبِّكَ بِالْحَقِّ لِيُثَبِّتَ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَهُدًى وَبُشْرَىٰ  
لِلْمُسْلِمِينَ ﴿١٠٢﴾

*Thuaj: “Atë (Kur’anin) e solli “Ruhul Kudus” - shpirti i shenjtë - plot vërtetësi nga Zoti yt, për t’i përforcuar edhe më ata që besuan dhe për të qenë udhërrëfyes e lajmi i mirë për muslimanët”.* (En-Nahl 102)

<sup>204</sup> Our Orthodox Christian Faith, sipas “A duhet të besosh në trinitet”, fq. 20.

<sup>205</sup> Po aty, fq. 20; Pra në greqisht “Fryma” quhet PNEUMA; latinisht SPIRITUS; ndërsa arabisht RUH, ngjashëm me RUAH në gjuhën hebraike. (shiko: Halit Muharremi, “Fjalori i teologjisë”, fq. 98-99)

<sup>206</sup> Ismail Hakki, “Tefsir Ruhul-bejan”, sipas Mehmed Karahodžić, *ISA a.s. u knjigama sufija*, Sarajevo, 2002, fq. 43.

Ndërsa, në disa raste të tjera, Meleku Xhebrail quhet edhe RUH. Po ashtu këtë e vërteton Kur'ani:

تَزَلُّ الْمَلَائِكَةُ وَالرُّوحُ فِيهَا بِإِذْنِ رَبِّهِمْ مِنْ كُلِّ أَمْرٍ ﴿١٩٦﴾

*“Engjëjt dhe shpirti”<sup>207</sup> (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet”. (Kadër 4)*

Mund të përfundojmë se, sipas Biblës, shpirti i shenjtë, përveç këtij emri, ka emra të tjerë si engjëll që i merr fjalët direkt nga Zoti, por edhe Gabriell si interpretues i shpalljeve të profetët. Ndërkohë, ky shpirt i shenjtë apo engjëll, ka rolin edhe si çlirues apo mbrojtës ndaj njerëzve, të cilët e besojnë dhe i frikësohen Zotit etj. Pra, shpirti i shenjtë është njëri prej shpirtave të shenjtë të panumërt në shërbim të Zotit të Gjithfuqishëm.<sup>208</sup>

### 3.1. Koncepti i shpirtit të shenjtë në Bibël

Në Bibël do të vërejmë se shpirti i shenjtë nuk është një person<sup>209</sup>, ngase përdorimi biblik i shprehjes “Fryma e Shenjtë”, apo “Shpirti i Shenjtë”, tregon se ajo është një forcë e kontrolluar, të cilën Perëndia e përdor për t’i realizuar qëllimet e ndryshme që ka. Si p. sh. në Bibël ceket:

- Në zanafillën 1:2, Bibla e deklaron si forcë aktive: *“Forca aktive {fryma (hebraisht, RU’ACH)} e Perëndisë lëviste andej-këndej mbi sipërfaqen e ujërave”*.
- Profecitë biblike u shkruan kur njerëzit e Perëndisë *“u shtynë nga fryma (greqisht PNEU’MA) e shenjtë”*. (2 Pjetri 1:20,21)

<sup>207</sup> Fjala “shpirti” në këtë ajet, e cila në gj. arabe është “er-Ruh”, përdoret për Xhebrailin a. s., sipas „*Tefsir ibn Kesir*”, Skraćena izdanje (Izabrao najispravnije verzije Muhamed Nesib er-Rifa’i), Sarajevo, 2000, fq. 1515.

<sup>208</sup> Prof. Abdul Ahad Dawud, *“Muhamedi në Bibël”*, fq. 27.

<sup>209</sup> Fjala *person* sipas fjalorit të gjuhës shqipe: Person-i (është i gjinisë mashkull). Njeriu si individ; njeri, vetë. I njëjti person. Emrat e personave të pranishëm, etj. Sipas: *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, fq. 1404.

- Gjithashtu, Fryma e Shenjtë i udhëhoqi disa njerëz që të shohin vizione apo ëndërra profetike. (2 Samueli 23:2; Joeli 2:28-29; Lluka 1:67; Veprat 1:16/ 2:32-33)
- Me anë të Frymës, Perëndia zbaton gjykimet e tij mbi njerëzit dhe kombet. (Isaia 30:27-28/ 59:18-19)
- Fryma e Perëndisë mund të arrijë kudo, duke vepruar në favor të njerëzve ose kundër tyre. (Psalmi 139:7-12)<sup>210</sup>
- Fryma zbulon vullnetin e Zotit dhe është në shërbim të Tij. (Gjoni 14:26/ 16:13)

Nga kjo mund të përfundohet se shpiti i shenjtë, apo fryma, nuk ishte një person siç pretendojnë ta paraqesin, ngase Bibla na jep shumë funksione të frymës, por edhe nëse në Bibël hasim formulime që e theksojnë frymën e shenjtë si person konkret, siç e cek edhe Don Nosh Gjolaj më poshtë. Teologu katolik, Edmund Fortman, në *“The Triune God”*, lidhur me këtë, thotë: “Megjithëse kjo frymë përshkruhet shpesh me terma personalë, duket fare qartë se shkrimtarët e shenjtë (të shkrimeve hebraike) nuk e konceptonin apo nuk e prezantonin kurrë këtë frymë si një person të dallueshëm”.<sup>211</sup>

Sipas librit *“Meditime për Trininë e Shenjtë”*, të autorit Don Nosh Gjolaj, prift, në pjesën ku flet për shpirtin e shenjtë, thotë: “Shpirti i Shenjtë nuk është forcë anonime, parim abstrakt, por person konkret, me të cilin besimtari ftohet të bëjë një dialog ndërpersonal”.<sup>212</sup>

Disa shembuj nga Bibla lidhur me këtë:

Kur Maria, nëna e Jezusit, e vizitoi kushërirën e saj, Elizabetën, Bibla thotë se foshnja, e cila ishte në barkun e Elizabetës, lëvizi *“dhe Elizabeta u mbush me frymën e shenjtë”*. (Luka 1:41) Nëse e marrim frymën e shenjtë si person, a është e logjikshme të mendojmë se një person *“u mbush”* me një person tjetër?

<sup>210</sup> Lidhur me këto të dhëna dhe të tjera shih te *“A duhet të besosh në trinitet”*, fq. 20-21.

<sup>211</sup> *“A duhet të besosh në trinitet”*, fq. 21.

<sup>212</sup> Don Nosh Gjolaj *“Meditime për Trininë e Shenjtë”*, fq. 51.

Kur po u tregonte dishepujve të tij se Jezusi ishte ai që do ta pasonte, Gjon Pagëzori tha: *“Unë ju pagëzoj me ujë... por ai që po vjen pas meje... Ai do t’ju pagëzojë me frymën e shenjtë”*. (Mateu 3:11) Gjoni nuk nënkuptonte se fryma e shenjtë është një person, kur po thoshte se njerëzit do të pagëzoheshin me të.<sup>213</sup>

Nuk është gjë e pazakontë që mjaft gjëra në Bibël të personifikohen, si p.sh.

a) Për mençurinë thuhet se ka bij. (Lluka 7:35);

b) Mëkati dhe vdekja janë quajtur mbretër. (Romakëve 5:14,21); c) Mëkati është rojtar te porta, siç thuhet: *“Por në qoftë se bën keq, mëkati po të ruan te porta dhe dëshirat e tij drejtohen ndaj teje; por ti duhet ta sundosh”*. (Zanafilla 4:7); d) Ndërsa te 1 Gjoni 5: 6-8, thuhet se Uji dhe Gjaku janë dëshmitarë; e) Te Mateu 28:19 referimi për shpirtin e shenjtë bëhet *“në emër të .... Frymës së Shenjtë”*. Por fjala “emër” nuk nënkupton gjithmonë një emër personal, qoftë në greqisht, qoftë në shqip. Kur themi “në emër të ligjit”, nuk po i referohemi një personi. Ne nënkuptojmë atë që ligji përfaqëson, autoritetin e tij etj. Nga kjo që u tha nuk pretendojmë se mençuria, mëkati, vdekja, uji, gjaku janë persona; po kështu edhe fryma e shenjtë nuk është një person. Prandaj, edhe kur disa vargje të Biblës thonë se fryma flet, tekste të tjera tregojnë se kjo gjë, në të vërtetë, është bërë përmes njerëzve apo engjëjve. (shih citatet: Mateu 10:19-20; Veprat 4:24-25/28:25; Hebrenjve 2:2)<sup>214</sup>

Në *Enciklopedinë biblike*, thuhet: “Përsa i përket shpirtit të shenjtë – tekstet që i përkasin këtij klasifikimi janë të shumta, por asnjë nga ato, nëse merren më vete, nuk mund ta provojë personalitetin e shpirtit të shenjtë”.<sup>215</sup>

Le t’i shohim në vazhdim disa citatet tjera biblike:

Te Zakaria e tregon shpirtin e shenjtë si Engjëll, nëpërmjet fjalëve:

<sup>213</sup> “A është person fryma e shenjtë?”, “Zgjohuni”, korrik 2006, fq. 14.

<sup>214</sup> “A duhet të besosh në trinitet”, fq. 21-22.

<sup>215</sup> *Encyclopaedia of Byblical, Theological and Ecclesiastical Literature*, vëll. X, Harper &Brothers Publishers, New York 1894, fq. 551.



*“Natën pata një vegim; dhe ja, një burrë, që i kishte hipur një kali të kuq, rrinte midis shkurreve të mërsinave në një gropë të thellë dhe prapa tij kishte kuaj të kuq, të kuqërremë dhe të bardhë. Unë pyeta: “Imzot, çfarë kuptimi kanë këto gjëra?”. Engjëlli që fliste me mua m’u përgjigj: “Unë do të të bëj të shohësh çfarë kuptimi kanë ato”... Pastaj Zoti i tha disa fjalë të mira, fjalë inkurajimi, engjëllit që fliste me mua”.* (Zakaria 1: 8,9,13)

*“Pastaj engjëlli që fliste me mua u kthye dhe më zgjoi ashtu si zgjojnë dikë nga gjumi.*

*Kështu nisa t’i them engjëllit që fliste me mua: “Imzot, ç’kuptim kanë këto gjëra?”.*

*Engjëlli që fliste me mua u përgjigj dhe më tha: “Nuk e kupton se ç’duan të thonë këto gjëra?”. Unë i thashë: “Jo, imzot”. (Zakaria 4: 1,4,5)*

Te Zbulesa 22:6, tregohet se si engjëlli është transmetues i fjalëve (shpalljes) dhe të fshehtave të Zotit te njerëzit e zgjedhur si profet:

*“Këto fjalë janë besnike dhe të vërteta; dhe Zoti, Perëndi i profetëve të shenjtë, dërgoi engjëllin e tij, për t’u treguar shërbëtorëve të tij gjërat që duhet të ndodhin për së shpejti”.*

Te Danieli dhe Lluka paraqitet si engjëll Gabriel:

*“Tani, ndërsa unë, Danieli, e kisha parasysh vegimin dhe përpiqesha ta kuptoja, ja ku po rri para meje dikush që ka pamje burri. Dëgjova pastaj në mes të lumit Ulai zërin e një burri, që bërtiste dhe thoshte: “Gabriel, shpjegoja këtij vegimin”. Ai iu afrua vendit ku ndodhesha unë dhe, kur arriti, unë pata frikë dhe rashë me fytyrë. Por ai më tha: “Kuptoje mirë, o bir njeriu, sepse ky vegim ka të bëjë me kohën e fundit”. (Danieli 8: 15-17)*

*“...po, ndërsa unë po flisja akoma në lutje, ai njeri, Gabrieli, që e kisha parë në vegim në fillim, i dërguar me fluturim të shpejtë, më arriti në orën e blatimit të mbrëmjes. Ai më mësoi, më foli dhe më tha: “Unë kam ardhur tani, o Daniel, që të të vë në gjendje të kuptosh”. (Danieli 9: 21-22)*

*“Në muajin e gjashtë, engjëlli Gabriel u dërgua nga Perëndia në një qytet të Galilesë, që quhej Nazaret, te një e virgjër, që ishte e fejuar me një njeri që quhej Jozef, nga shtëpia e Davidit; dhe emri i virgjëreshës ishte Maria”. (Lluka 1: 26-27)*

Ndërsa tek Isaia quhet engjëll mbrojtës:

*“Në çdo hidhërim të tyre ai u hidhërua, dhe Engjëlli i pranisë së tij i shpëtoi; me dashurinë dhe dhembshurinë e tij i çliroi, i lartoi dhe u solli tërë ditët e së kaluarës. Por ata u rebeluan dhe e trishtuan Frymën e tij të shenjtë; prandaj ai u bë armiku i tyre dhe luftoi kundër tyre”. (Isaia 63: 9-10)*

Engjëj që zbatojnë vullnetin e Zotit:

*“Bekoni Zotin ju, engjëj të tij të pushtetshëm dhe të fortë, që bëni atë që thotë ai, duke iu bindur zërit të fjalës së tij. Bekoni Zotin, ju, tërë ushtritë e tij, ju, tërë ministrat e tij, që zbatoni vullnetin e tij”. (Psalmet 103: 20-21)*

Engjëlli Gabriel paralajmëron për lindjen e profetëve:

*“Atëherë një engjëll i Zotit iu shfaq duke qëndruar në këmbë në të djathtën e altarit të temjanit. Zakaria, kur e pa, u trondit dhe e zuri frika. Por engjëlli i tha: “Mos u tremb, Zakaria, sepse lutja jote u plotësua dhe gruaja jote Elizabeta do të lindë një djalë, të cilit do t’ia vësh emrin Gjon... Dhe engjëlli, duke iu përgjigjur, i tha: “Unë jam Gabrieli që rri në prani të Perëndisë, dhe më kanë dërguar që të flas me ty dhe të të njoftoj këto lajme të mira”. (Lluka 1: 11-13, 19)*

*“Në muajin e gjashtë, engjëlli Gabriel u dërgua nga Perëndia në një qytet të Galilesë, që quhej Nazaret, te një e virgjër, që ishte e fejuar me një njeri që quhej Jozef, nga shtëpia e Davidit; dhe emri i virgjëreshës ishte Maria. Dhe engjëlli hyri te ajo dhe tha: “Tungjatjeta, o hirplote, Zoti është me ty; ti je e bekuar ndër gratë”. Por kur e pa atë, ajo mbeti e shqetësuar nga fjalët e tij, dhe pyeste vetveten çfarë kuptimi mund të kishte një përshëndetje e tillë. Dhe engjëlli i tha: “Mos ki frikë, Mari, sepse ke gjetur hir para Perëndisë”. (Lluka 1: 26-30)*

*“Pastaj Engjëlli i Zotit shtoi: “Unë do t’i shumëzoj fort pasardhësit e tu aq sa të mos mund të llogariten për shkak të numrit të tyre të madh”. (Zanafilla 16: 11)*

Shpirti i shenjtë me nyjën shquese “i” nënkupton personin e veçantë ungjil-lor-Gabrielin/Xhebrailin, apo cilindo nga shpirtrat e “pastër” që i ka krijuar Zoti, i cili u ka caktuar mision të posaçëm. Zbritja e shpirtit të shenjtë në një qenie njerëzore bëhet për t’ia shpallur atij personi vullnetin dhe mrekullitë e Allahut xh.sh. dhe për ta emëruar profet.<sup>216</sup>

Burime të ndryshme pohojnë se Bibla nuk e mbështet idenë sipas së cilës fryma e shenjtë është personi i tretë i një triniteti. Në Enciklopedinë katolike thuhet: “Në asnjë vend në Besëlidhjen e Vjetër nuk gjejmë ndonjë tregues të qartë të një personi të tretë”. Kështu që as hebrejtë dhe as të krishterët e parë, nuk e shihnin frymën e shenjtë si pjesë të Trinitetit. Ky mësim doli shekuj më vonë, kjo u shpall në Këshillin e Aleksandrisë në vitin 362... dhe përfundimisht në Këshillin e Kostandinopojës në vitin 381.<sup>217</sup>

Njëra prej tezave sipas të cilës të krishterët mundohen ta mbrojnë mendimin se Jezusi është zot apo i biri i Zotit, theksojnë se Jezusi është mbushur me shpirtin e shenjtë. Nëse Jezusi është zot, apo i biri i Zotit, për arsye se ka qenë i mbushur me “Shpirtin e Shenjtë”, atëherë si i argumentojmë, apo si t’i quajmë të tjerët, të cilët me të njëjtin “Shpirt të Shenjtë” janë mbushur? Ja po i sjellim citatat:

*“Zakaria... u mbush me Shpirtin e Shenjtë”*. (Luka 1: 67)

*“Elizabeta.... u mbush me Shpirtin e Shenjtë”*. (Luka 1: 41)

*“Pjetri plot me Shpirtin e Shenjtë”*. (Veprat 4: 8)

*“Të gjithë u mbushën me Shpirtin e Shenjtë”*. (Veprat 2: 4)

*“Sauli që quhet Pal, plot me Shpirt të Shenjtë”*. (Veprat 13: 9)

*“Gjon Pagëzori u mbush me Shpirtin e Shenjtë qysh në bark të nënës”*. (Luka 1: 13-15)

<sup>216</sup> Prof. Abdul Ahad Dawud, *“Muhamedi në Bibël”*, fq. 188-189.

<sup>217</sup> *“A duhet të besosh në trinitet”*, fq. 22-23; dhe tek *“Pyetje nga lexuesit”*, “Kulla e rojës”, 15 maj 2004, fq. 29.

“Edhe ata që janë të bindur ndaj Perëndisë janë të mbushur me Frymën e Shenjtë”. (Veprat 5: 32)<sup>218</sup>

Profesori Abdul Ahad Davud, kur flet për shpirtin e shenjtë, thekson: “Të mendojmë për besimin se personi i tretë i trinisë zbret te njerëzit<sup>219</sup>, duke i shenjtëruar dhe atëherë i lejon të gabojnë, të bien në herezi dhe në ateizëm e të jepen pas kryerjes së vrasjeve dhe masakrave. A thua është e mundur kjo? Është e vërtetë se të krishterët nuk kanë koncept definitiv, ose të përpiktë, lidhur me shpirtin e shenjtë, i cili po e frymëzuaka të krishterët e pagëzuar. Po të jetë ai shpirt zoti, atëherë si guxon t’i afrohet djalli, ta kandisë dhe ta mashtrorë njeriun e shenjtëruar? Përveç tjerash, çështja më kryesore është se si mund ta ndjekë – ta largojë djalli shpirtin e shenjtë dhe të vendoset vetë në zemrën e heretikut të pagëzuar, apo në atë të ateistit të pagëzuar?”

Në anën tjetër, nëse me shprehjen shpirt i shenjtë nënkuptohet engjëlli Xhebrail (Gabrieli) apo ndonjë engjell tjetër, atëherë kishat kishtarë sorollatën më kot në shkretëtirën e besëtytnive, pasi që engjëlli nuk është (Zot) i Gjithëfuqishëm. Nëse ky shpirt, që po e pastruaka dhe po e pagëzuaka Krishtin, është “Vetë Zoti”, ngase i tillë është besimi i tyre në tre persona - perëndi të trinisë, atëherë të gjithë të krishterët e pagëzuar duhen ta pandehin veten se janë hyjnorë dhe të pamëkate”<sup>220</sup>.

<sup>218</sup> Rreth shpirtit të shenjtë shih edhe këto citate biblike: Veprat 6:5, 2 Pjetrit 1:21, 2 Timoteut 1:14, 1 Korintasve 2:12-16, Gjoni 20:22, etj.

<sup>219</sup> Të krishterët ortodoksë besojnë se te çdokush, gjatë pagëzimit të tij, zbret shpirti i shenjtë: “Pendohuni dhe secili nga ju le të pagëzohet në emër të Jezu Krishtit për faljen e mëkateve, dhe ju do të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë. Sepse premtimi është për ju dhe për bijtë tuaj dhe për gjithë ata që janë larg, për ata që Zoti, Perëndia ynë, do t’i thërrasë”. (Veprat 2: 38-39). Shpirti i shenjtë, gjithashtu është inspirues i fjalës së Zotit te njerëzit. Ai i shenjtëron profetët, mbretëritë dhe priftërinjtë e Dhiatës së Vjetër. Po ashtu ai përmendet edhe në tekstet e Biblës, sipas së cilës ka zbritur në formë të zogut në Jezu Krishtin në rastin kur ka qenë duke u pagëzuar nga ana e Gjonit (Luka 3:21-22). Më tepër shih: Qani Nesimi, “Ortoksizmi te shqiptarët”, fq. 164-165.

<sup>220</sup> Prof. Abdul Ahad Dawud, “Muhamedi në Bibël”, fq. 186-187.

### 3.2. Shpirti i shenjtë mes ortodoksëve dhe katolikëve

Sa i përket shpirtit të shenjtë ka mospajtime ndërmjet kishës katolike dhe asaj ortodokse. Sipas kishës ortodokse, dallimi ndërmjet tri elementeve të shenjta është në atë se, i Ati nuk ka lindur, i biri ka lindur prej të Atit, kurse shpirti i shenjtë buron vetëm prej të Atit. Ndërsa sipas kishës katolike, shpirti i shenjtë buron edhe prej të Atit, edhe prej të Birit.<sup>221</sup>

Megjithatë, në historinë e kishës kanë lindur diskutime të ndryshme lidhur me dallimin ndërmjet të birit, që lind prej të Atit, dhe shpirtit të shenjtë që buron prej të Atit. Pra, pretendohet se njëri ka lindur, kurse tjetri ka buruar. Sipas kishës ortodokse, është më rëndësi të kuptohen marrëdhëniet e të birit dhe shpirtit me të Atin dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre e, gjithashtu, lidhjet e tyre me botën. Ndërkaq, sipas Shën Vasilit të Madh, të gjitha fjalët e thëna për Zotin, duke përfshirë edhe fjalët “ka lindur” dhe “ka buruar”, nuk kanë mundësi që të thonë gjithçka lidhur me Zotin dhe të shenjtën, pasi kanë mangësi në të shprehurit e plotë të së vërtetës hyjnore. Njerëzit mund ta kuptojnë Zotin vetëm nëpërmjet diturive që ua ka dhënë Ai vetë, kurse nuk është aspak e mundshme që njeriu të dalë nga kjo kornizë. Kjo do të thotë se fjalët e thëna realisht nuk shprehin një mjaftueshmëri.<sup>222</sup> Sipas kësaj mund të shtrohet pyetja: Nëse shpirti rrjedh prej të Atit, a është shpirti gjithashtu bir i Zotit (Atit)? Nëse jo, pse jo? Nëse shpirti rrjedh prej të birit, a është shpirti i nipi i Atit? Nëse jo, pse jo?

Irenaeusi (130-202 të e.s.) thotë se shpirti i shenjtë dhe i biri janë dy shërbëtorë të Zotit. Pas deklaratës së Irenaeusit, dy shekuj më vonë, ngritën në dinjitet të Zotit dhe shpallën dy persona hyjnorë në shoqëri me një Zot të vërtetë, nga i cili ata të dy ishin krijuar. Justini<sup>223</sup>, i quajtur “Martiri” (100-167) dhe Theofilusi

<sup>221</sup> Qani Nesimi, “Ortoksizmi te shqiptarët”, fq. 152, 163; shih edhe Dr. Ivan Cvitković, “Rječnik religijski pojmovna”, fq. 430.

<sup>222</sup> Shën Vasili i Madh, “Mbi Shpirtin e Shenjtë”, KOASH (pa vend dhe datë botimi), fq. 85, sipas Qani Nesimit, “Ortoksizmi te shqiptarët”, fq. 164.

<sup>223</sup> Justini u lind në vitin 100, në Flavia Neapolis, Palestinë, tani Nablus, vdiq më 165, në Romë Itali. Justini ishte njëri prej filozofëve-apologetëve më të rëndësishëm grekë në kishën e hershme krishtere. Shkri-

(120-180) me shprehjen “Shpirt të shenjtë” kurrë nuk nënkuptuan ndonjë person hyjnor. Duhet kujtuar se këta dy etër dhe shkrimtarë grekë të shekullit të dytë të erës sonë, nuk kanë pasur njohuri definitive rreth besimit lidhur me shpirtin e shenjtë të trinisë së shekullit të katërt dhe të atyre vijues.<sup>224</sup>

### 3.3. Këndvështrimi hebraik mbi shpirtin e shenjtë

Kaufman Kohler<sup>225</sup> dhe Krauss Samuel<sup>226</sup>, kur shkruajnë për *Trinitetin në këndvështrimin hebraik*, lidhur me frymën e shenjtë theksojnë: “Ideja e frymës së shenjtë si personi i tretë i trinitetit mund ta ketë pasur origjinën vetëm në një tokë xhentile, meqenëse ajo bazohet në një gabim gjuhësor. “Ungjilli sipas hebreujve”, i cili gëzonte popullaritet të lartë veçanërisht te rrethet ebionite, ende e konsideron termin “nënë” si të barasvlershëm me “Frymën e Shenjtë”<sup>227</sup>, kjo meqenëse në gjuhën aramaike, gjuha e këtij ungjilli dhe mesa duket dialekti fillestar i të gjithë ungjijve, emri “ruha” (frymë) është në gjininë femërore<sup>228</sup>. Ofitët, për më tepër, mësonin një trinitet të përbërë nga Ati, i biri dhe nëna<sup>229</sup>; dhe fakti se ati i kishës Hipoliti gjeti ndërmjet ofitëve doktrinën asiriane të trinitetit të frymës<sup>230</sup> justifikon supozimin e ngjashmërisë së doktrinës së trinitetit me koncepte të ngja-

---

met (veprat) e tij e paraqesin përplasjen e parë pozitive të hakmarrjes krishtere me filozofinë greke, dhe vuri bazat për një histori të teologjisë, etj. Për më tepër shih: “Justin Martyr, Saint.”Encyclopædia Britannica 2007 Ultimate Reference Suite. DVD.

<sup>224</sup> Abdul Ahad Dawud, “*Muhamedi në Bibël*”, fq. 203-204.

<sup>225</sup> Dr.Kaufmann Kohler, është Rabbi Emeritus në Temple Beth-El, New York; si dhe president i Hebrew Union College, Cincinnati, Ohio. Marrur nga webfaqja [www.erasmusi.org/afisho\\_temat.php?f=44](http://www.erasmusi.org/afisho_temat.php?f=44), Kaufman Kohler & Krauss Samuel, “*Triniteti në këndvështrimin hebraik*”.

<sup>226</sup> Pr.dr. Samuel Krauss, professor i kolegjit të përgjithshëm, Budapest, Hungari. Po aty.

<sup>227</sup> Origen, *Commentary* on John II. 12; shih, Preuschen, “*Antilegomena*”, Giessen, 1901, fq. 4; Henneke, “*Neutestamentliche Apokryphen*”, Tübingen 1904, fq. 19. Po aty.

<sup>228</sup> Krahajo pohimin gnostik Ἐντέθειν; Φάλτυ ἀναδεχθῆναι μητέρα καὶ υἱόν Irenæus, “*Adversus Hereses*”, I. 271. Po aty.

<sup>229</sup> Hilgenfeld, “*Ketzergeschichte*”, fq. 255. Po aty.

<sup>230</sup> Hilgenfeld, “*Ketzergeschichte*”, fq. 259. Po aty.

shme të lashtësisë. Po ashtu edhe mandeazit besonin se RUHA (fryma) ishte Nëna e Mesias, ndonëse ato i konsideronin të dy si demonë.<sup>231</sup>

Njerëzit e kishës “Shpirtin e Shenjtë” e shndërruan në pjesë përbërëse të trinitisë dhe e kthyen në Zot. Citati në vijim thotë: “*Ati juaj qiellor do t’ju dhurojë frymën e shenjtë atyre që ia kërkojnë*”. (Luka 11:13) Nga citati kuptojmë se ky shpirt është për t’ua dhënë dhe për t’ua shpërndarë atyre që e kërkojnë. Si ka mundësi që shpirti i shenjtë t’ua shpërndahet njerëzve në rast se është “Zot”?! Vallë, Zoti e shpërndan (copëton) Vetën?! Fjala shpirti i shenjtë dhe fjala Zot janë nga fjalët më të ngatërruara në ungjij. Në çdo fletë has në kuptim të ri të këtyre dy fjalëve!<sup>232</sup>

Në *Enciklopedinë e re katolike*, lidhur me shpirtin e shenjtë, theksohet: “Pjesa më e madhe e teksteve të Besëlidhjes së Re e zbulojnë frymën e Perëndisë si të jetë *diçka* dhe jo *dikush*; kjo shihet veçanërisht në paralelizmin ndërmjet frymës dhe fuqisë së Perëndisë”. Ndërsa në njërin ndër fjalorët katolikë thuhet: “Në tërësi, si Besëlidhja e Re, ashtu edhe e Vjetra, flasin për frymën si për një energji apo fuqi hyjnore”.<sup>233</sup> Fryma e shenjtë nuk është një person dhe nuk është pjesë e një triniteti. Fryma e shenjtë është forca vepruese e Perëndisë, të cilën ai e përdor për ta kryer vullnetin e tij. Nuk është e barabartë me Perëndinë, por është gjithmonë në dispozicion të tij dhe e nënshtuar ndaj tij.<sup>234</sup>

### 3.4. Koncepti i shpirtit të shenjtë në Kur’an

Kur’ani Famëlartë e përmend shpirtin e shenjtë me emrin “*Ruhul-Kudus*”, por edhe me terma të tjerë, si “Ruh”, me të cilin emërtim quhet meleku Xhebraili a.s./engjëlli Gabriel. Por në disa raste termi “Ruh” tregon se ka të bëjë me

<sup>231</sup> Brandt, “*Die Mandäische Religion*”, Leipsic, 1889, fq. 124. I tëri ky citat është i marrë nga webfaqja [www.erasmusi.org/afisho\\_temat.php?f=44](http://www.erasmusi.org/afisho_temat.php?f=44), Kaufman Kohler & Krauss Samuel, “*Triniteti në këndvështrimin hebraik*”.

<sup>232</sup> Dr. Muhamed Ali El-Havli, “*Komperacioni mes katër ungjijve*”, fq. 159.

<sup>233</sup> “*A duhet të besosh në trinitet*”, fq. 22.

<sup>234</sup> Po aty, fq. 23.

shpirtin e njeriut<sup>235</sup> si krijesë e Zotit xh.sh., të cilit Zoti ia jep qysh në barkun e nënës, fetusit.

Por ne do t'i paraqesim ato ajete që kanë të bëjnë me shpirtin e shenjtë - Ruhul Kudus. Ajetet në vijim na tregojnë:

وَلَقَدْ آتَيْنَا مُوسَى الْكِتَابَ وَقَفَّيْنَا مِنْ بَعْدِهِ بِالرُّسُلِ ۗ وَآتَيْنَا عِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ الْيَتِيمَ  
وَأَيَّدْنَاهُ بِرُوحِ الْقُدُسِ ۖ

“Ne i patëm dhënë Musait librin dhe pas tij patëm dërguar shumë pejgamberë. Isait, të birit të Merjemes, i dhamë argumente (mrekulli) dhe e fuqizuam me (Xhibr-ilin) shpirtin e shenjtë”. (El Bekare 87)

تِلْكَ الرُّسُلُ فَضَّلْنَا بَعْضَهُمْ عَلَى بَعْضٍ ۗ مِنْ كَلِمَ اللَّهِ ۗ وَرَفَعَ بَعْضَهُمْ دَرَجَاتٍ  
وَآتَيْنَا عِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ الْيَتِيمَ وَأَيَّدْنَاهُ بِرُوحِ الْقُدُسِ ۖ

“Nga këta të dërguar, disa syresh i ngritëm mbi të tjerët. Disave Allahu u foli drejtpërdrejt, kurse të tjerë i ngriti në shkallë të larta. Ne i dhamë Isait, të birit të Merjemes, prova (mrekulli) të qarta dhe e ndihmuam me shpirtin e shenjtërisë (Xhebra-ilin a.s.)”. (El Bekare 253)

قُلْ نَزَّلَهُ رُوحُ الْقُدُسِ مِنْ رَبِّكَ بِالْحَقِّ لِيُثَبِّتَ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَهُدًى وَبُشْرَى  
لِلْمُسْلِمِينَ ۖ

Thuaj: “Atë (Kur’anin) e solli “Ruhul Kudus” - shpirti i shenjtë - plot vërtetësi nga Zoti yt, për t’i përforcuar edhe më ata që besuan, dhe për të qenë udhërrëfyes e lajm i mirë (myzhde) për muslimanët”. (En-Nahl 102)

إِذْ قَالَ اللَّهُ لِعِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ اذْكُرْ نِعْمَتِي عَلَيْكَ وَعَلَىٰ وَالِدَتِكَ إِذْ أَيَّدْنَاكَ بِرُوحِ  
الْقُدُسِ تُكَلِّمُ النَّاسَ فِي الْمَهْدِ وَكَهْلًا ۖ وَإِذْ عَلَّمْنَاكَ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَالتَّوْرَةَ  
وَالْإِنْجِيلَ ۖ وَإِذْ تَخْلُقُ مِنَ الطِّينِ كَهَيْئَةِ الطَّيْرِ بِإِذْنِي فَتَنفُخُ فِيهَا فَتَكُونُ طَيْرًا بِإِذْنِي وَتُبْرِئُ

<sup>235</sup> Lidhur me shpirtin e njeriut, shih këto ajete: Sexhde 9; Sad 72; Hixhr 29; El-Enbija 91; Et Tahrim 12, etj.



الْأَكْمَهَ وَالْأَبْرَصَ بِإِذْنِي <sup>ط</sup> وَإِذْ أَخْرَجَ الْمُؤْتَىٰ بِإِذْنِي <sup>ط</sup> وَإِذْ كَفَفْتُ بَنِي إِسْرَائِيلَ  
عَنْكَ إِذْ جِئْتَهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ فَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْهُمْ إِن هَذَا إِلَّا سِحْرٌ مُّبِينٌ ﴿١١٠﴾

“Allahu (atë ditë) i thotë: “O Isa, i biri i Merjemes, rikujtoji të mirat e Mia ndaj teje dhe ndaj nënës sate, kur të fuqizova me shpirtin e shenjtë (Xhibrilin), e ti u fole njerëzve (kur ishe) në djep dhe (kur ishe) i pjekur (si burrë), kur t’i mësova librin e urtësinë, Tevratin e Inxhilin, kur me lejen Time formova nga balta si formë shpeze e i fryve asaj dhe me urdhrin Tim u bë shpend, kur i shërove të verbrin dhe të sëmurin nga sëmundja e lëkurës me dëshirën Time, kur me urdhrin Tim i nxore (të gjallë) të vdekurit, kur i zmbarsa beni israilët prej teje (që deshën të të mbysin) atëherë kur erdhe me argumente, e disa prej tyre që nuk besuan thanë: “Kjo (mrekullia e Isait) nuk është tjetër vetëm se magji e qartë!” (Maide 110)

Ajetet e lartpërmendura tregojnë qartazi se si shpirti i shenjtë është Xhebraili a.s.<sup>236</sup>, i cili ua përcillte shpalljet prej Zotit xh.sh. të dërguarve - pejgamberëve të Tij; po ashtu i fuqizonte dhe i përforconte të dërguarit e Zotit, ndërsa në këtë rast, ajetet e lartpërmendura kanë të bëjnë me Isanë a.s.

Ndërsa, sa u përket ajeteve në të cilat Xhebraili përmendet me termin “Er-Ruh”, duhet thënë se janë këto:

وَإِنهٗ لَتَنْزِيلُ رَّبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٠١﴾ نَزَلَ بِهِ الرُّوحُ الْأَمِينُ ﴿١٠٢﴾ عَلَىٰ قَلْبِكَ لِتَكُونَ مِنَ الْمُنذِرِينَ ﴿١٠٣﴾

“Nuk ka dyshim se ky (Kur’an) është shpallje (zbritje) e Zotit të botëve. Atë e solli shpirti besnik (Xhebraili). (E solli) Në zemrën tënde, për të qenë ti prej atyre që tërheqin vërejtjen (pejgamber)”. (Esh-Shuara 192-194)

Në ajetin e sipërpërmendur Zoti xh.sh. e quan Xhebrailin a.s. “Ruhul Emin”- “Shpirti Besnik”, që ia solli shpalljen Pejgamberit të fundit Muhamedit s.a.v.s. Kur’anin<sup>237</sup>. Ndërsa në ajetin në vijim të sures Gafir, ajeti 15, me fjalën “Er-

<sup>236</sup> Lidhur me këto ajete kur’anore shih komentimin e Ibn Kethirit mbi shpirtin e shenjtë, “Tefsir ibn Kesir”, Skraçeno izdanje, fq. 74, 166, 729, 398.

<sup>237</sup> Po ashtu këtë e vërteton Ibn Kethiri në Tefsirin e tij, “Tefsir ibn Kesir”, Skraçena izdanje, fq. 966.

Ruh”, Zoti i Plotfuqishëm tregon për Xhebrailin që sjell shpalljen atij që do nga robërit e Vet:

رَفِيعُ الدَّرَجَاتِ ذُو الْعَرْشِ يُلْقِي الرُّوحَ مِنْ أَمْرِهِ عَلَى مَنْ يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ لِيُنذِرَ يَوْمَ  
التَّلَاقِ ﴿١٥﴾

“Ai (Allahu) është i pozitës më të lartë, i zoti i Arshit; Ai me urdhrin e vet ia sjell shpirtin (shpalljen) atij që do nga robërit e vet, për t’ua tërhequr vërejtjen ndaj ditës së takimit (të kiametit)”. (Gafir 15)

Allahu xh.sh. në ajetin në vazhdim tregon lindjen e Isait a.s., mënyrën se si Zoti dërgoi te Merjemja melekun Xhebrail (RUH), për ta përgëzuar me lajmin, për lindjen e një fëmije si mrekulli nga ana e Zotit Fuqiplotë.

فَاتَّخَذَتْ مِنْ دُونِهِمْ حِجَابًا فَأَرْسَلْنَا إِلَيْهَا رُوحَنَا فَتَمَثَّلَ لَهَا بَشَرًا سَوِيًّا ﴿١٧﴾ قَالَتْ إِنِّي  
أَعُوذُ بِالرَّحْمَنِ مِنْكَ إِنْ كُنْتَ تَقِيًّا ﴿١٨﴾ قَالَ إِنَّمَا أَنَا رَسُولُ رَبِّكِ لِأَهَبَ لَكِ غُلَامًا  
زَكِيًّا ﴿١٩﴾

“Ajo, vuri një perde ndaj tyre, e Ne ia dërguam asaj Xhebrailin, e ai iu paraqit asaj njeri në tërësi. Ajo tha: “Unë i mbështetem të Gjithëmëshirshmit prej teje, nëse je që frikësohesh Atij (pra më le të lirë)!” Ai (Xhebraili) tha: “Unë jam vetëm i dërguar (melek) i Zotit tënd për të dhuruar ty një djalë të pastër (pejgamber)”. (Merjem 17-19)

Këto ishin disa nga ajetet e Kur’anit Famëlartë lidhur me melekun Xhebrailin a.s., i cili në gjuhën arabe u quajt me termat: *Ruhul Kudus* (shpirti i shenjtë); *Ruh* (shpirti); *Ruhul Emin* (shpirti besnik) etj.

Profesori Abdul Ahad Davud (David Benjamin Keldani, ish-prift katolik) thotë:

“Vetë ndryshimi dhe marrëdhënia që pranohet se ekziston ndërmjet personave të trinisë nuk lë fije dyshimi se ata as nuk janë të njëjtë me njëri-tjetrin, as nuk mund të identifikohen me njëri-tjetrin. Babai lind dhe nuk lindet; i biri është i lindur dhe nuk është Atë; shpirti i shenjtë është rrjedhim i dy personave të

tjerë; personi i parë përshkruhet si krijues dhe rrënues; personi i dytë si shpëtimtar ose shëlbues dhe i treti si jetëdhënës. Rrjedhimisht, asnjëri i të treve nuk është vetëm Krijuesi, Shëlbuesi apo Jetëdhënësi. Më pas na thuhet se personi i dytë është Fjala e Personit të parë, se bëhet njeri dhe flijohet në kryq për të kënaqur drejtësinë e Atit dhe se mishërimi dhe ringjallja e tij janë kryer dhe plotësuar nga personi i tretë.

Më pas na thuhet, se çdo person i trinisë ka disa cilësi të veçanta që nuk u përkasin të tjerëve. Këto cilësi tregojnë, sipas arsyes dhe gjuhës njerëzore, përparësinë dhe posterioritetin ndër ta. Ati mban gjithmonë anën e djathtë dhe qëndron përpara të birit. Shpirti i shenjtë jo vetëm që është i prapmë si i treti në numërim, por është i vendosur edhe më poshtë në krahasim me dy të tjerët. A nuk do të vlerësohej si një mëkat herezia nëse emrat e tre personave do të përsëriteshin në të kundërt? A nuk do të shihej nga ana e kishave si mungesë përkushtimi kryerja e shenjës së kryqit mbi elementët e eukaristisë nëse formula do të shndërrohej kështu: “Në emër të Shpirtit të Shenjtë dhe të Birit dhe të Atit”? Nëse ata janë të barabartë dhe të barasvlershëm, radha e përmendjes nuk ka nevojë të vihet re me kaq kujdes.

Në përfundim, më duhet t’ua kujtoj të krishterëve se, nëse ata nuk besojnë në Njëshmërinë absolute të Zotit dhe nuk heqin dorë nga besimi në tre persona hyjnorë, janë, pa dyshim, jobesimtarë në Zotin e vërtetë. E thënë në realisht, të krishterët janë politeistë, vetëm me përjashtimin se perënditë pagane janë të rreme, ndërsa tre zotat e kishave kanë një karakter të shquar, nga të cilët Ati – si një tjetër epitet për Krijuesin – është Zoti Një dhe i Vetëm, por i biri është vetëm një profet dhe shërbëtor i Zotit dhe personi i tretë një nga shpirtrat e shenjtë e panumërt në shërbim të Zotit të Plotfuqishëm”.<sup>238</sup>

### **3.5. Dallimet ndërmjet Atit, të birit dhe shpirtit të shenjtë**

Në vijim do t’i vërejmë disa dallime ndërmjet Atit, të birit dhe shpirtit të shenjtë, disa kontradikta, gabime, probleme që gjenden në këtë doktrinë.

<sup>238</sup> Benjamin Keldani, “*Muhamedi në Bibël*”, botuar nga Qendra Erasmus, 2004, fq. 27-29.

- Te Gjoni tregohet një dallim ndërmjet Jezusit dhe shpirtit të shenjtë. Këtu tregohet që Jezusi dhe fryma e shenjtë nuk janë në raport të barabartë, sepse shpirti i shenjtë duhet të marrë nga Jezusi njohuri dhe t'ua kumtojë, apo t'ua përcjellë ato të tjerëve:

*“Por, kur të vijë ai, Fryma e së vërtetës, ai do t’ju prijë në çdo të vërtetë, sepse ai nuk do të flasë nga vetja, por do të thotë gjitha ato gjëra që ka dëgjuar dhe do t’ju kumtojë gjërat që do vijnë. Ai do të më përlëvdojë, sepse do të marrë prej meje dhe do t’jua kumtojë. Të gjitha gjërat që ka Ati janë të miat; për këtë ju thashë se ai do të marrë prej simes dhe do t’jua kumtojë”.* (Gjoni 16:13-15)<sup>239</sup>

Një dallim tjetër ndërmjet Atit dhe frymës së shenjtë, ku thuhet se fryma e shenjtë dërgohet prej Atit dhe del prej tij, vërtetohet nga Gjoni 15:26: *“Por kur të vijë Ngushëlluesi, që do t’ju dërgoj prej Atit, Fryma e së vërtetës, që del nga Ati im, ai do të dëshmojë për mua”.*

- Gjithashtu në Bibël tregohet:

*“Dhe kushdo që flet kundër Birit të njeriut do të falet; por ai që flet kundër Frymës së Shenjtë nuk do të falet as në këtë botë as në atë të ardhme”.* (Mateu 12:32)

*“Dhe kushdo që do të flasë kundër Birit të njeriut do të jetë i falur, por ai që do të blasfemojë kundër Frymës së Shenjtë, nuk do të jetë i falur”.* (Lluka 12:10)

Mateu dhe Lluka na tregojnë fjalët e Jezusit, ku theksohet një dallim shumë i madh ndërmjet Jezusit dhe shpirtit të shenjtë. Pse blasfemia është e pafalshme kundër shpirtit të shenjtë, ndërsa është e falshme nëse bëhet ndaj Jezusit? Pse ky dallim? A nuk janë të barabartë Jezusi dhe shpirti i shenjtë, a nuk janë pjesë e një triniteti të përbashkët?

- Mateu dhe Lluka na tregojnë:

<sup>239</sup> Edhe pse ky citat tregon dhe aludon në ardhjen e Pejgamberit të fundit Muhamedit s.a.v.s., ne do ta marrim ashtu siç e transmetojnë të krishterët, si frymë të shenjtë. Përkritazi me këtë citat dhe citatat tjera që tregojnë ardhjen e Muhamedit a.s. në Bibël, shih: Abdul Ahad Dawud, *“Muhamedi në Bibël”*, Prishtinë, 1995; Ahmed Didat, *“Ç’rbotë Bibla për Muhamedin a.s.”*, Tiranë, 1992; Rahmetullah El-Hindi, *“Trumfi i së vërtetës”*, Shkup, 1998 etj.

*“Dhe Jezusi, sapo u pagëzua, doli nga uji; dhe ja, qiejt iu hapën, dhe ai pa Frymën e Perëndisë duke zbritur si një pëllumb e duke ardhur mbi të; dhe ja një zë nga qielli që tha: “Ky është Biri im i dashur, në të cilin jam kënaqur”. (Mateu 3:16-17)*

*“Tani, si u pagëzua gjithë populli, edhe Jezusi u pagëzua; dhe ndërsa po lutej, qielli u hap dhe Fryma e Shenjtë zbriti mbi të, në trajtën trupore si të pëllumbit, dhe nga qielli erdhi një zë, që thoshte: “Ti je Biri im i dashur, në ty unë jam kënaqur!”. (Luka 3: 21-22)*

Nga këto citate lindin shumë çështje që kërkojnë përgjigje:

a) Zoti i foli Jezusit prej qiellit duke thënë: “Ky është Biri im...” Shtrohet pyetja si ka mundësi që Jezusi, në të njëjtën kohë, të jetë Zot, por edhe i biri i Zotit? Si ka mundësi që Zoti të jetë në qiell dhe Zoti të jetë në tokë, dhe t’i thotë Zoti zotit ti je biri im?! Nëse besoni se Zoti erdhi në tokë në formë të Jezusit, atëherë i kujt ishte zëri që u dëgjua nga qielli? I Zotit?

b) Gjithashtu, në citat vërejmë edhe një dobësi tjetër të Perëndisë, sipas Biblës, duke pasur parasysh se edhe fryma e shenjtë është Perëndi (sipas doktrinës së krishterë), në rastin e pagëzimit të Jezusit tregohet se “Fryma e Perëndisë zbriti si një pëllumb” mbi Jezusin. Përsëri shtrohet pyetja, a i përket cilësisë së Zotit, që Zoti të shndërrohet në shpend, apo në ndonjë krijesë tjetër? Vërtet, ky gjykim të habit dhe si i tillë nuk i nënshtrohet logjikës së shëndoshël!

- Nëse shpirti i shenjtë është zot, apo Jezusi zot, përse atëherë nuk kanë njohuri për ditën, apo orën e fundit, por veç Ati e di se kur do të jetë, siç tregohet te Marku 13:32, dhe Mateu 24:36, ku thuhet: *“Sa për atë ditë dhe atë orë, askush nuk e di, as engjëjt në qiell, as Biri, por vetëm Ati”.*

- Nëse shpirti i shenjtë është pjesëtar i barabartë i trinisë, pse Bibla gjithmonë flet për të si të dërguar nga Ati, ose nga Jezusi?

*“por Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë, që Ati do ta dërgojë në emrin tim, do t’ju mësojë çdo gjë dhe do t’ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë”.*

*“Por kur të vijë Ngushëlluesi, që do t’ju dërgoj prej Atit, Fryma e së vërtetës, që del nga Ati im, ai do të dëshmojë për mua”.* (Gjoni 14:26/ 15:26)

- Nëse Jezusi qëndron mbi fron, si mund të qëndrojë ai në anën e djathtë të Zotit? Ulet, apo qëndron në këmbë? Te Marku 16:19 thuhet se ulet: *“Zoti Jezus, ... u ngrit në qiell dhe u ul në të djathtë të Perëndisë”*. Si mund të ulet Zoti te Zoti?

Ndërsa te Veprat 7:55, tregohet se qëndroi në këmbë: *“...pa laudinë e Perëndisë dhe Jezusin që rrinte në këmbë në të djathtën e Perëndisë”*.

Apo ndoshta Jezusi rri në kraharorin, gjirin e të Atit? Te Gjoni 1:18, thotë: *“... i vetëmlinduri Bir, që është në gjirin e t’Et”*. Shumë kontradikta nëpër cite. Po shpirti i shenjtë ku qëndron ai, pasi që edhe ai është pjesë e trinitetit?!

- Nëse Jezusi është zot i pandryshueshëm e i përjetshëm, si mund të ketë një fund mbretëria e tij dhe t’i nënshtrohet Atit? Shih 1 Korintasve 15:25-28:

*“Sepse duhet që ai të mbretërojë, derisa t’i vërë të gjithë armiqtë e tij nën këmbët e veta. Armiku i fundit që do të shkatërrohet është vdekja. Sepse Perëndia i vuri të gjitha nën këmbët e tij. Por, kur thotë se çdo gjë i është nënshtuar, është e qartë se përjashtohet ai që ia ka nënshtuar çdo gjë. Dhe kur t’i ketë nënshtuar të gjitha, atëherë Biri vetë do t’i nënshtrohet Atij që i nënshtroi të gjitha, që Perëndia të jetë gjithçka në të gjithë”*.

- Te Mateu tregohet se Jezusi i urdhëroi apostujt që ta pagëzojnë në emër të Atit, të Birit dhe të shpirtit të shenjtë.

*“Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë”*. (Mateu 28:19)

Ndërsa Apostujt kanë pagëzuar vetëm në emër të Jezusit (shih Veprat e apostujve 2:38/ 8:16/ 10:48/ 19:5, etj).

- Sipas Biblës thuhet se Jezusi vdiq dhe pastaj u ringjall. Shtrohet pyetja, kush e ringjalli Jezusin, pasi që në Bibël hasim në kontradikta. Në Bibël, te Veprat e apostujve thuhet se Jezusin e ringjalli Zoti:

*“Por Perëndia e ka ringjallur, pasi e zgjidhi nga ankthet e vdekjes, sepse nuk ishte e mundur që vdekja ta mbante atë”*. (Veprat 2:24);

Te Gjoni thuhet se Jezusi vetvetiu u ringjall: *“Jezusi u përgjigj dhe u tha atyre: “Shkatërroni këtë tempull dhe unë për tri ditë do ta ngre përsëri!”. Atëherë Judenjët thanë: “U deshën dyzet e gjashtë vjet që të ndërtohet ky tempull, dhe ti do ta ngresh për tri ditë?”. Por ai fliste për tempullin e trupit të vet”.* (Gjoni 2:19-22);

Ndërsa te Letra e romakëve thuhet se si shpirti i shenjtë ishte ai që e ringjalli Jezusin: *“Dhe në qoftë se Fryma i atij që ringjalli Krishtin prej së vdekurish banon në ju, ai që e ringjalli Krishtin prej së vdekurish do t’u japë jetë edhe trupave tuaj vdekatarë me anë të Frymës së tij që banon në ju”.* (Romakëve 8:11). Atëherë, sa herë u ringjall Jezusi? Cila nga këto është e vërtetë?

- Nëse shpirti, fryma është zot, atëherë a mund të quhet Zot fryma e keqe, pasi që fryma është nga ana e Perëndisë, siç tregohet në Bibël:

*“Zoti ynë të urdhërojë, pra, që shërbëtorët e tu që rrinë përpara teje të gjejnë një njeri që i bie mirë harpës; kur pastaj fryma e keqe nga ana e Perëndisë do të të zotërojë, ai do t’i bjerë harpës dhe ti do ta ndjesh veten mire”.* (1 Samueli 16:16)

*“Por një frymë e keqe nga ana e Zotit e pushtoi Saulin, ndërsa rrinte në shtëpinë e tij me shtizë në dorë dhe Davidi i binte harpës”.* (1 Samueli 19:9)

- *“Prandaj Zoti ka vënë një frymë gënjeshtre në gojën e të gjithë profetëve të tu; por Zoti parashikon fatkeqësi kundër teje”.* (1 Mbretërve 22:23) Nëse Fryma është Zot, A rren Zoti?!

- Le t’i parashitrojmë disa pyetje, që të gjykojmë në mënyrë sa më të drejtë:

- Nëse Jezusi është zot, pse Jezusi tha: *“Ati është më i madh se unë”.* (Gjoni 14:28)
- Nëse Jezusi është zot, pse Jezusi tha: *“...unë po ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te Perëndia im dhe Perëndia juaj”.* (Gjoni 20:17)
- Nëse Jezusi është zot, pse Jezusi tha: *“O Atë, në duart e tua po e dorëzoj frymën time”.* (Luka 23:46)
- Nëse Jezusi është zot, pse Jezusi tha: *“Adhuroje Zotin, Perëndinë tënde, dhe shërbeji vetëm atij”.* (Mateu 4:10)

- Nëse Jezusi është zot, pse Jezusi tha: *“Askush s’e pa Perëndinë kurrë...”*. (Gjoni 1:18) *“Askush s’e ka parë ndonjëherë Perëndinë”*. (1 Gjonit 4:12), etj. etj.

Këto kontradikta shihet qartë se janë shpifje dhe trillime, apo, në rastin më të mirë, gabime të shtuara në këto citate nga ana e njerëzve, të cilat çojnë në përfundim se, Bibla që e kemi sot, vështirë se mund të quhet fjalë e Perëndisë. Aspekt tjetër është fakti se të krishterët mundohen që nëpërmes citateve të Biblës t’i ofrojnë argumentet e tyre, duke iu referuar citateve të përgjysmuara, pa e sjellë citatin komplet, por duke marrë një varg të shkëputur nga konteksti. Lidhur me këtë teologu, Mike Brown, në një nga temat e librit të tij të quajtur *“Interpretim dhe Ekzegjesh false”*, shprehet:

“Çështja e interpretimit Biblik është shumë e rëndësishme. Nganjëherë është shumë lehtë që në Bibël të gjejmë një bazë për ta mbështetur një mësim tonin thjesht duke marrë një varg të shkëputur nga konteksti dhe duke e lidhur atë me një varg tjetër marrë nga një pjesë tjetër e Biblës, edhe ky i shkëputur prej kontekstit në të cilin është përdorur, dhe, duke i bashkuar të dyja këto pasazhe mund të krijojmë një doktrinë të re që nuk ka të bëjë fare me vargjet që i kemi përdorur, të marra siç janë në kontekstet e duhura. Ashtu siç ka thënë dikush: “Është shumë e lehtë ta bësh Biblën të thotë çfarëdo që ne duam që ajo të thotë”.<sup>240</sup>

Në një nga fjalorët teologjikë në gjuhën italiane, i cili është fryt i punës së më se 114 specialistëve nga fakultete të ndryshme katolike, realiteti i lartpërmendur shprehet me këto fjalë: “Duhet konstatuar se argumenti trinitar nuk duket se gëzon dhe aq rëndësi në jetën e krishterizmit bashkëkohor. Besimtarët më të ditur [d.m.th. ekleziastët specialistë], të zhytur në çështje që duken më urgjente, nuk arrijnë të fshehin një lloj sikleti përballë një doktrine, të cilën vërtet e konsiderojnë si një sënduk të çmuar, por ama të mbyllur [...] Vazhdohet të përsëritet se triniteti është e vërteta themelore e fesë, por nuk është e vështirë të kuptosh që ajo nuk është e vërteta themelore në bindjen e shumicës së besimtarëve. Mund të

<sup>240</sup> Mike Brown, *“Përgjigjet për Dëshmitarët e Jehovës”*, Prishtinë, 1999, fq. 12.



guxojmë të hedhim hipotezën se triniteti është tashmë një e vërtetë e ‘fshirë’ nga ndërgjegjja e përbashkët e besimit, në të cilën mbijeton, përkundrazi, një monot-eizëm dobësish i krishterizuar [...] ai monot-eizëm i padallueshëm, i cili karakter-izon sot pjesën dërrmuese të “besimtarëve” [...] e dërgon sot krishterizmin në kri-zën e tij të identitetit, duke qenë se krijon gjithnjë kushtet e nevojshme për lindj-en e një ateizmi proteste”.<sup>241</sup>

Në Koncilin e Nikesë, në vitin 325, ata vendosën vetëm në lidhje me natyr-ën e Jezusit, por jo rolin e Frymës së Shenjtë. Nëse triniteti do të kishte qenë një mësim i qartë biblik, pse nuk e zgjodhën edhe shpirtin e shenjtë si pjesë të trin-itetit? Por kjo ndodhi më vonë.

Më vonë në koncilin e Kostandinopojës, që u mbajt në vitin 381 përvetëso-het besimi, që tash quhet besimi katolik, se “Shpirti i Shenjtë” rrjedh prej zotit bir. Ky këshill pranoi ta vinte frymën e shenjtë në të njëjtin nivel me Perëndinë dhe Krishtin. Për herë të parë, triniteti i të ashtuquajturit krishterizëm filloi të vinte në qendër të vëmendjes.<sup>242</sup>

Në *Enciklopedinë amerikane* tregohet se: “Triniteti i shekullit IV ishte një devijim nga mësimet fillestare të krishterizmit”.<sup>243</sup> Po ashtu edhe *Enciklopedia e re katolike* lejon mendimin se doktrina e trinitetit nuk ka qenë e njohur për të krishterët e hershëm dhe se është vendosur në çerekun e fundit të shekullit IV.<sup>244</sup>

<sup>241</sup> Dizionario Teologico Interdisciplinare della Marieti, fq. 472-73; shih edhe “*The Promise of the Trinity*”, Gunton, fq.31, sipas [http://www.erasmusi.org/afisho\\_temat.php?f=69](http://www.erasmusi.org/afisho_temat.php?f=69), “*Paradoksi trinitar*”, Rezart Beka.

<sup>242</sup> “Constantinople, Council of.” Encyclopædia Britannica 2007 Ultimate Reference Suite. DVD; “*A dubet të besosh në trinitet*”, fq. 8; Hajrudin Pekarić- Dino, “*Sljedbenici Knjige*”, fq. 133; Dr. Muhamed Ali El-Havli, “*Komperacioni mes katër ungjijve*”, fq. 70; Victor Paul Wierwille, “*Jesus Christ is not God*”, fq. 25; dhe te: Marmarinta- Omar P. Mabaya, “*Božija Jednoća: Konačno rješenje proturiječnosti trojstva*”, fq. 8; Ndërsa, sipas Ivan Cvitković në librin e tij “*Religije suvremenoga svijeta*”, fq. 169, thotë: “*Në dy këshilla, mbledhje në Nike 325 dhe në (Kostandinopojë) 381, është vërtetuar mësimi themelor i besimit të krishterë*”.

<sup>243</sup> “*The Encyclopedia America*”, sipas “*A dubet te besosh në trinitet*”, fq. 8.

<sup>244</sup> Ulfe Azizus Samed, “*Islami dhe krishterimi*”, fq. 35.

Ndërsa, sipas një enciklopedie tjetër të ilustruar, lidhur me këtë theksohet: “Pasuesit e tij (Jezusit), pas vdekjes, e ndryshuan thirrjen e tij, ngase ai thërriste si të gjithë të dërguarit e tjerë në besimin në Zot, e jo edhe në dikë tjetër”.<sup>245</sup>

Ndërsa, Allahu xh.sh. në Kur’anin Famëlartë na tërheq vërejtjen lidhur me trinitetin me fjalët:

لَقَدْ كَفَرَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ ثَالِثُ ثَلَاثَةٍ وَمَا مِنْ إِلَهٍ إِلَّا إِلَهُ وَاحِدٌ وَإِنْ لَمْ  
يَنْتَهُوا عَمَّا يَقُولُونَ لَيَمَسَّنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٧٣﴾

“Gjithashtu bënë kufër (mosbesim) ata që thanë: “Allahu është i treti i treve”. S’ka në gjithësi tjetër pos një Allahu, e nëse nuk pushojnë nga ajo që thanë (tre zota), do t’i kapë dënim i dhembshëm ata që nuk besuan prej tyre”. (El-Maide 73)

<sup>245</sup> Driton Sejdiu, “Enciklopedi, e ilustruar botërore dhe shqiptare (Almanak 2007)”, Prishtinë, 2006, fq. 166.

## Kapitulli III



# Triniteti dhe vërtetësia e tij

## 1. Rreth citateve të doktrinës së trinitetit

Fakti se në Bibël nuk ekziston asnjë citat që, në mënyrë të qartë e të prerë, të flasë për trinitetin dhe për bashkësubstancialitetin e personave hyjnorë që ndodhen në të, si dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre, ka bërë që teologët e krishterë t'i drejtohen filozofisë njerëzore duke shkaktuar më shumë hutim se më parë dhe duke mos e zgjidhur asnjërin nga problematikat që e prekin këtë doktrinë.

Kjo doktrinë nuk arrin ta shpjegojë natyrën e vërtetë të Perëndisë, të cilën ajo merr përsipër ta sqarojë. Cila është natyra e vërtetë e Atit, po e të birit, po ajo e shpirtit të shenjtë? Si lidhen dhe çfarë raportesh kanë këta persona hyjnorë me njëri-tjetrin, si i merr Perëndia vendimet, kur dihet se brenda tij ekzistojnë tre persona me ndërgjegje dhe vullnet të pavarur? Pyetje si këto, si edhe shumë të tjera, kanë bërë që spekulimet e ndryshme ta zënë vendin e arsytimeve logjike.

Teologët e krishterë nisen në kërkim të provave, të cilat do ta vërtetonin këtë hamendësim. Në këtë mënyrë ato shohin në tekst, jo atë që teksti thotë, por atë që ata dëshirojnë që ai të thotë. Rrjedhimisht ata dalin në përfundime të gabuara. Ato mundohen të sjellin prova, citate nga bibla që e mbështesin këtë doktrinë, duke u argumentuar me to. Ne do të shqyrtojmë disa hipoteza dhe të shohim saktësinë e vërtetësinë e tyre se a e mbështesin këtë doktrinë apo jo?

Le të shohim në vijim:

***Fjala ishte Perëndi. (Gjoni 1:1)***

Te Gjoni 1:1 lexojmë: *“Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi”*.

Duke lexuar këtë citat të krishterët tregojnë se “Fjala”, që përmendet këtu aludon në Jezusin dhe Jezusi ishte Perëndi. Nëse e analizojmë me vëmendje citatin, ku Gjoni thotë “*Fjala ishte pranë Perëndisë*”, imponohet pyetja: Si mund të jetë dikush pranë një personi tjetër, e njëkohësisht të jetë po ai person? <sup>246</sup> Vallë, në bazë të çfarë logjike të shëndoshë mund të përfundojmë kështu!!

Te Bibla katolike ky citat del kështu: “*Në fillim ishte Fjala, e Fjala ishte në Hyjin, e Fjala ishte Hyj*”<sup>247</sup> Kur ta analizojmë fragmentin “*Fjala është Zoti*”, atëherë del me këtë kuptim: “*Në fillim ishte Zoti, e Zoti ishte në Zotin*”. Çfarë kuptimi ka kjo? Si ka mundësi që Zoti të jetë në Zotin?!<sup>248</sup>

Le t’i marrim disa shembuj. Nëse themi “*Zoti është i mirë*”, ne kënaqemi me të mirën e Tij, apo me veprën e Tij të mirë. Mirëpo, ne nuk mund ta përshkruajmë Atë si duhet, duke thënë “*Zoti është mirësia*”, ngase mirësia nuk është Zot. Nëse themi “*Zoti është i ditur*” ne nuk mund të themi se “*Dituria është Zot*”. Apo “*Kur’ani, ose Bibla është fjalë e Zotit*”, ne nuk mund t’i quajmë “*Kur’anin apo Biblën Zot*”, sepse nuk janë.

Këtu “*Fjala*” nuk mund të konsiderohet si Zot, siç besohet, ngase “*Fjala*” është përdorur në Bibël në shumë tekste si urdhër, nëpërmjet së cilës Zoti urdhëron, si p.sh. tek Zanafilla 1:3,20:

“*Pastaj Perëndia tha: “U bëftë drita!”. Dhe drita u bë. Pastaj Perëndia tha: “Të mbushen ujërat nga një numër i madh qeniesh të gjalla dhe të fluturojnë zogjtë lart mbi tokë nëpër hapësirën e madhe të kupës qiellore”.*

Kurse Kur’ani Famëlartë e thekson kështu:

قَالَتْ رَبِّ اِنِّيْ يَكُوْنُ لِيْ وُلْدٌ وَلَمْ يَمَسِّنِيْ بَشَرٌ ۗ قَالَ كَذٰلِكَ اَللّٰهُ يَخْلُقُ مَا يَشَآءُ ۗ اِذَا قَضٰى اَمْرًا فَاِنَّمَا يَقُوْلُ لَهُ كُنْ فَيَكُوْنُ

<sup>246</sup> Grup autorësh, “*Çfarë mëson vërtet Bibla*”, botuar nga Watchtower Bible and Tract Society of New York, shtypur në Itali, nga Dëshmitarët e Jehovahit në gjuhën shqipe, Romë, 2005, fq. 203.

<sup>247</sup> *Bibla*, përktheu dhe shtjelloi Dom Simon Filipaj.

<sup>248</sup> Dr. Muhamed Ali El-Havli, “*Komperacioni mes katër ungjijve*”, fq. 182.

إِنَّ مَثَلَ عِيسَىٰ عِنْدَ اللَّهِ كَمَثَلِ آدَمَ ۖ خَلَقَهُ مِنْ تُرَابٍ ثُمَّ قَالَ لَهُ كُن فَيَكُونُ ﴿١٦٦﴾

*“Ajo tha: “Zoti im! Qysh do të kem unë femijë, kur nuk më ka prekur askush?!” - “Kështu - tha (engjelli) - Allahu krijon ç’të dojë Vetë. Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të: “Bëhu!” - dhe ajo bëhet”.*

*“Vërtet, çështja e Isait (të lindur pa baba) tek Allahu është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj atij i tha “Bëhu!” dhe ai u bë”. (Ali Imran 47, 59)*

Fjala e parë me të cilën fillon Ungjilli i Gjonit ishte përgëneshtruar shpeshherë nga *“hartuesit unitarianë”<sup>249</sup>*, të cilët e ofruan tekstin e tyre të vërtetë si vijon: *“Në fillim ishte fjala”, e “fjala” ishte me Zotin dhe fjala e Zotit ishte*.<sup>250</sup> Do të vihet re se forma greke e rasës gjinore *“Teou”*, që do të thotë *“e Zotit”*, ishte ndryshuar në *“Teos”*, që do të thotë *“Zot”*, në rasën emërore të emrit.<sup>251</sup> Ibni Hazmi, studiues i religjioneve, kur e komenton këtë citat, mes tjerash, thotë se është një marri dhe vërtet një shpifje që i bëhet Jezusit.<sup>252</sup>

Në librin *“Bazat e Biblës”*, të botuar nga të krishterët, lidhur me citatin e lartpërmendur, thuhet: *“Ky citat është një nga pjesët më të keqkuptuara, për të mësuar se Jezusi ekzistoi në qiej para lindjes së tij. Një kuptim i drejtë i këtyre*

<sup>249</sup> Unitar, Unitarianizëm-pasues të doktrinës së krishterë që mohon dogmën mbi trininë e Zotit. Kjo doktrinë ka lindur në periudhën e formimit të dogmatit kryesor të krishterizmit-trinisë (shekujt II-IV). Pas-uesit në fillim quheshin antitrinitarë (greq. kundër trinisë). (Hali Muharremi, *“Fjalori i teologjisë”*, fq. 334.) Thelbi i unitarizmit qëndron në theksimin e njëshmërisë dhe unitetit të Zotit si qenie personale; nga këtu logjikisht pason refuzimi: a) i trinisë së shenjtë, b) i natyrës hyjnore të Jezusit dhe të shpirtit të shenjtë etj. Unitarizmin e përfaqëuan dhe e mbrojtën shumë mendimtarë të shquar, siç ishin: Migel Servetosi (1509-1553), Hugo Grociusi (1583-1645), Samuel Klarku (1675-1729), Xhozef Pristli (1733-1804), Ricard Prajsi (1723-1791), Xhon Miltoni (1608-1674), etj. (Ekrem Murtezai, *“Fjalori i feve”*, fq. 568.)

<sup>250</sup> Prof. Abdul Ahad Dawud, *“Muhamedi në Bibël”*, fq. 21.

<sup>251</sup> Prof. Benjamin Keldani, *“Muhamedi në Bibël”*, botuar nga Qendra Erasmus, 2004, fq. 25 (duhet të përmend faktin se në këtë punim u jam referuar dy përkthimeve të të njëjtit autor dhe të njëjtit libër *“Muhamedi në Bibël”*, ngase kemi të bëjmë me dy përkthyes. Kështu, te përkthimet i vitit 1995 botuar në Prishtinë, kundruall atij të përkthyer në vitin 2004 në Tiranë nga qendra Erasmus, kemi disa dallime, ndaj më është dashur t’i shfrytëzoj dy botimet e këtij libri. P.sh. këtë varg që citova më lart nuk e ka përkthimi i vitit 1995, ndërsa në gj. angleze ekziston ky varg (shih *“Muhamedi in the Bible”*, fq. 16-17), por në këtë botim është një lëshim i përkthyesit).

<sup>252</sup> *“Ibën Hazm Al-Andalusi dhe vështrimet e tij mbi doktrinën e trinisë”*, Muhamed Uruçi, Takvim, 2003, fq. 98.

rreshtave varet në vlerësimin se çfarë do të thotë “Fjala” në këtë kuptim. Nuk mund të bëhet fjalë direkt për një person, sepse një person nuk mund të jetë “me Perëndinë” dhe megjithatë të *jetë* Perëndi në të njëjtën kohë. Fjala greke “logos” që përkthehet “fjalë” këtu, nuk do të thotë “Jezusi” në vetvete”.<sup>253</sup>

Tausti, anëtar i shkollës spiritualiste të shek. III, thotë:

“Shumëkush e di se ungujtë nuk janë shkruar as nga Isai e as nga apostujt, por shumë më vonë nga ana e disa personave anonimë, të cilët, duke e ditur se njerëzit nuk do t’u besonin autorëve që s’i kishin parë gjërat vetë, në krye të rrëfimeve vunë emrat e apostujve, apo të personave që i kanë shoqëruar ata”.<sup>254</sup>

Verseti aq i cituar: “*Në fillim ishte Fjala, dhe Fjala ishte tek Zoti, dhe Fjala ishte Zoti*”, është citat i një punimi pagan mbi filozofinë platonike, që ka gjasa të jetë shkruar nga Ireneusi. Pasazhi citohet nga Ameliusi, filozof pagan, sikur bën fjalë përjashtimisht vetëm për Logosin, ose Merkurin, Fjalën, dhe që duket se është një dëshmi që bëhet ndaj një perëndie pagane nga një barbar... Kështu, pra, shohim se titulli “Fjala” apo “Logos”, që i atribuohen Jezusit, është një tjetër element i përzierjes pagane me krishterizmin. Ajo nuk e mori formën e saj të ligjëruar të krishterë gjerë në shekullin e dytë pas Krishtit.

Edhe romakët e lashtë paganë e adhuronin një kult triniteti. Për një orakull<sup>255</sup> thuhet se ka deklaruar se si në fillim ishte “I pari Zoti, pastaj Fjala, dhe me ta Shpirti”. Këtu, në Romën e lashtë, shohim të renditur qartësisht, Zotin, logosin, dhe shpirtin e shenjtë, vend ku tempulli më me emër i këtij kryeqyteti – ai i

<sup>253</sup> *Bazat e Biblës - Udhëzime Kapitujsh* (Shpalosja e gëzimit dhe paqes së krishterimit të vërtetë), botuar nga Christadelphian Bible Mission (CBM), England (pa vit botimi), fq. 146.

<sup>254</sup> Osman Nuri Topbash, “*Vargu i profetëve -3*”, fq. 238.

<sup>255</sup> Orakull m. vjet. 1. Vendi a tempulli ku në kohën e lashtë priftërinjtë paganë gjoja e parashikonin të ardhmen, ose parathoshin diçka gjoja në emër të hyjnive; që besohej se parashikonte të ardhmen ose paralajmëronte diçka. *Orakulli i Dodonës. Orakulli i Defit. Përgjigja e orakullit*. 2. fig. libr. Ai që i paraqet fjalët, mendimet e parashikimet e veta si të vërteta të pakundërshtueshme. *Në rolin e orakullit*. (“*Fj. i gj. së sotme shqipe*”, fq. 1306.)



Jupiter Capitolinus - u ishte dedikuar tri perëndive, që adhuroheshin të tria me një adhurim të vetëm.”<sup>256</sup>

Në një studim të bërë nga Geoffrey Parrinder, lidhur me këtë citat dhe të ngjashëm, ai gjen ndikimin e besimit të *Memfisit*<sup>257</sup>, edhe në besimin e lashtë grek, e sidomos lidhur me “fjalën” *Logos*, e cila më pas pati ndikim direkt edhe në krishterizëm, bile në vetë ungjijtë, duke thënë: “*Ptah* po ashtu ishte perëndia e krijimit të qytetit *Menf*, i cili, ndërkohë, quhej *Atë* dhe *Ëmë* në “teologjinë menfisiane” që është një dokument i shkëlqyer dhe e tëra është nga shteti i lashtë. Dokumenti thotë se krijimin e botës e ka planifikuar mendja e perëndisë, ndërkaq mjeti i zbatimit ishte “*fjala*” të cilën e shqiptoi, - kjo ishte një garë çuditëse e besimit grek që u shfaq pas një periudhe të gjatë rreth “*logos-it*” ose “*fjalës së shenjtë*”. Këtu vlen të bëhet një krahasim me Ungjillin e Gjonit, me ç’rast shihet një përputhje mahnitëse ndërmjet “*fjalës*” në të dyja tekstet: “*Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi. Ajo (fjala) ishte në fillim me Perëndinë. Të gjitha gjërat u bënë me anë të saj (fjalës), dhe pa atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë.*” (Gjoni 1:1-3)<sup>258</sup>

### **Në emër të Atit, e të Birit, e të Frymës së Shenjtë. (Mateu 28:19)**

Një ndër shembujt më kryesorë me të cilin të krishterët argumentojnë rreth doktrinës së trinitetit dhe që njëherësh përbën edhe një ndryshim të citatit biblik me qëllim të ngritjes së Jezusit në hyjni e të vendosjes së besimit mbi trininë, është citati nga Mateu 28:19:

*“Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë.”*

Të krishterët pohojnë se gjoja nëpërmjet këtyre fjalëve vetë Jezusi e ka predikuar trininë, duke e përdorur fjalën “emër” në njëjës dhe duke e pasuar këtë me për-

<sup>256</sup> T.W.Doane, “*Bible Myths and Their Parallels in Other Religions*”, fq. 375-376.

<sup>257</sup> Qytet në Egjiptin e lashtë, rreth 25 km në jug të Kajros së sotme, afër piramidave të famshme egjiptase. [Shiko: Enciklopedinë elektronike: DVD, Enciclopedia Britanica Library 2007, “*Memphis*”]

<sup>258</sup> Geoffrey Parrinder, *vepër e cituar*, fq. 47, sipas Dr. Zija Abdullahu, “*Hyrje në studimin e feve*”, fq. 38.

mendjen e formulës së trinisë; ndërsa kjo, sipas tyre, do të duhej të nënkuptonte se Zoti është NJË Perëndi i vetëm, por i përbërë nga TRE persona. Mirëpo, nuk ekziston asnjë manuskript nga shekujt e parë të krishterizmit, i cili do ta mbështeste autenticitetin e këtij vargu, të këtillë siç gjendet sot në shumicën e biblave tona. Për më tepër, gjatë tre shekujve të parë pas Krishtit, sikundër edhe deri në gjysmën e shekullit të katërt, kjo frazë nga etërit kishtarë si Euzebiusi, Justin Martiri, Origeni, Afratesi, etj. citohej në formën: *“Dhe shkoni bëni dishepuj në emrin tim”* pa e përmendur fare pagëzimin, ose formulën e trinisë. Vetëm pas Koncilit të Nikesë ky rresht fillon gjerësisht të përdoret në formën e tanishme, duke e përmbajtur formulën trinitare të pagëzimit. Kështu, në një mori rastesh, zbulimi i shkrimeve të vjetra të krishtere e vuri në pah padrejtësinë e bërë mësimëve të Jezuit.<sup>259</sup>

### ***Kush më ka parë mua, ka parë Atin. (Gjoni 14:8-9)***

Citati tjetër, me të cilin argumentohen, gjendet te Gjoni 14:8-9:

*“Filipi i tha: “Zot, na e trego Atin, dhe na mjafton”. Jezusi i tha: “Ka kaq kohë që unë jam me ju dhe ti nuk më ke njohur akoma, o Filip? Kush më ka parë mua, ka parë Atin”.*

Këtu tregohet se si Filipi donte ta shihte Zotin, por një gjë e tillë është e pamundur, sepse pak më poshtë, në këtë ungjill, tregon se Jezusi ka thënë: *“Askush s’e pa Perëndinë kurrë”*. (Gjoni 1:18) Po ashtu edhe te 1 Gjoni 4:12 thuhet: *“Askush se ka parë ndonjëherë Perëndinë”*.

Kështu është e qartë se Jezusi thjesht po i thoshte Filipit se veprat dhe mrekullitë e tij do të ishin fakte të mjaftueshme të ekzistencës së Zotit (*Kush më ka parë mua ka parë Atin*).<sup>260</sup>

Përsëri te Gjoni 5: 37 thuhet: *“Dhe Ati, që më dërgoi, ai vetë ka dëshmuar për mua; ju nuk e keni dëgjuar kurrë zërin e tij dhe as nuk e keni parë fytyrën e tij”*.

---

<sup>259</sup> Si u zhvillua besimi mbi trininë?, sipas <http://mesohu.net/showthread.php?t=578>

<sup>260</sup> Misha'al Ibn Abdullah, *“What did Jesus really say?”*, fq. 58.

Të njëjtën gjë e argumenton edhe Kur'ani, duke treguar se është e pamundur të shihet Zoti:

لَا تُدْرِكُهُ الْأَبْصَارُ وَهُوَ يُدْرِكُ الْأَبْصَارَ ۖ وَهُوَ اللَّطِيفُ الْخَبِيرُ ﴿٢٥٦﴾

*“Shikimet njerëzore nuk mund ta arrijnë Atë, ndërkohë Ai i arrin shikimet e të gjithëve. Ai është Bamirës i pakufishëm dhe di çdo gjë”.* (El-Enam 103)

وَلَمَّا جَاءَ مُوسَى لِمِيقَاتِنَا وَكَلَّمَهُ رَبُّهُ قَالَ رَبِّ أَرِنِي إِلَيْكَ ۖ قَالَ لَنْ تَرِنِي وَلَكِن  
أَنْظُرْ إِلَى الْجَبَلِ فَإِنِ اسْتَقَرَّ مَكَانَهُ فَسَوْفَ تَرِنِي ۖ فَلَمَّا كَلَّمَهُ رَبُّهُ لِلْجَبَلِ جَعَلَهُ  
دَكًّا وَخَرَّ مُوسَى صَعِقًا ۖ فَلَمَّا أَفَاقَ قَالَ سُبْحَانَكَ تُبْتُ إِلَيْكَ وَأَنَا أَوَّلُ الْمُؤْمِنِينَ

*“E kur Musai erdhi në kohën që ia caktuam dhe i foli Zoti i vet, ai tha: “Zoti im! Më mundëso që ta shoh pamjen tënde!” Ai (Zoti) i tha: “Ti nuk ke mundësi të më shohësh, por shikoje kodrën, e nëse ajo qëndron në vendin e vet, ti do të më shohësh Mua. Kur u drejtua nga kodra, një pjesë e dritës nga Zoti i tij e bëri atë (kodrën) thërrmijë, e Musait i ra të fikët. Kur erdhi në vete, tha: “E lartë është madhëria Jote, pendohem te Ti (për atë që kërkova) dhe unë jam i pari i besimtarëve!”* (Araf 143)

Veprat, mrekullitë e Jezusit/ Isait a.s., janë fakte për ekzistencën e Zotit. Ai që e njih Jezusin si pejgamber, e njih edhe Zotin që e ka dërguar. Ai që e urren Jezusin, e urren edhe Atin, le të shohim vargjet e mëposhtme:

*“Atëherë i thanë: “Ku është Ati yt?”. Jezusi u përgjigj: “Ju nuk më njihni as mua, as Atin tim; po të më njihnit mua, do të njihnit edhe Atin tim”.* (Gjoni 8:19)

*“Pastaj Jezusi thirri dhe tha: “Kush beson në mua, nuk beson në mua, por në atë që më ka dërguar”.* (Gjoni 12:44)

*“Kush më urren mua, urren edhe Atin tim”.* (Gjoni 15:23)

*“Ai që ju pranon, më pranon mua; dhe ai që më pranon mua, pranon atë që më ka dërguar. Ai që pranon një profet në emër të një profeti, do të marrë shpërblimin që i takon profetit; dhe ai që pranon të drejtin në emër të të drejtit, do të marrë shpërblimin që i takon të drejtit”.* (Mateu 10:40-41)

Fragmentet e mësipërme janë aq të qarta sa nuk mbetet fije dyshimi për të vërtetën. Pra, Jezusi nuk është zot, por i dërguar me shpalljen e Zotit të populli i tij. Nxjerrja e fjalëve të tyre jashtë kontekstit përbëjnë një veprim naiv.

### **Unë dhe Ati jemi një. (Gjoni 10:30)**

“Unë dhe Ati jemi një”. (Gjoni 10:30), kjo fjali shpesh citohet nga të krishterët për ta mbështetur doktrinën e trinitetit, edhe pse këtu nuk përmendet asnjë person i tretë?! Po ta lexojmë një citat më lart, Gjoni 10:29, do të vërejmë fjalët e Jezusit, i cili tha: “Ati im, që më i dha, është më i madh se të gjithë”. Fjala “të gjithë”, këtu përfshin secilin, edhe vetë Jezusin. Kurse, në të kundërtën, do të jetë kontradiktë ndërmjet dy citateve.

Vetë Jezusi tregon se në ç’kuptim ai ishte “një” me të Atin. Duke i lexuar disa citate më poshtë të Gjoni 17:20-23, kuptojmë:

*“Tani unë nuk lutem vetëm për ta, por edhe për ata që do të besojnë në mua me anë të fjalës së tyre, që të gjithë të jenë një, ashtu si ti, o Atë, je në mua dhe unë në ty; edhe ata të jenë një në ne, që bota të besojë se ti më ke dërguar. Dhe unë u kam dhënë lavdinë që më ke dhënë, që ata të jenë një, ashtu si ne jemi një. Unë jam në ta dhe ti në mua, që të jenë të përsosur në unitet dhe që bota të njohë që ti më ke dërguar dhe që i ke dashur, ashtu si më ke dashur mua”.*

Në tërë këta rreshta për fjalën NJË është përdorur e njëjta fjalë greke HEN, pra jo vetëm për të përshkruar Jezusin dhe Atin, por edhe Jezusin, Atin dhe njëmbëdhjetë apo dymbëdhjetë dishepujt e Jezusit. Prandaj, nëse vargjet e tilla i kuptojmë tekstualisht, në këtë rast, do të kemi jo trini, por trembëdhjetëni. Kështu që Jezusi dhe Ati janë një, jo në një trini apo hyjnieshmëri. Por në një qëllim. Si-kurse edhe është Jezusi një me apostujt dhe me besimtarët në qëllimin e bërjes së vullnetit të Atit.<sup>261</sup>

Pra, fjalë greke HEN - “Një”, që është përdorur në këtë citat, si te Gjoni 10:30, ashtu edhe te Gjoni 17:20-23, tregon njëjtësi veprimi. Prandaj, kur përd-

<sup>261</sup> Artikulli “Unë dhe Ati jemi një”, marrë nga webfaqja: [www.islamidhekrishterimi.com/jezusifaqja.html](http://www.islamidhekrishterimi.com/jezusifaqja.html)

oret fjala Një (Hen) në këto raste, e ka fjalën për unitetin e mendimit dhe të vepërimit.<sup>262</sup>

Lidhur me Gjonin 10:30, Xhon Kelvin (një trinitarian) në librin e tij tha: “Të vjetrit bënë një gabim duke përdorur këtë rresht për të provuar se Krishti është ... në thelb i njëjtë me të Atin. Në fakt, Krishti nuk flet për unitetin në përbërje, por për marrëveshjen që ka me të Atin”.<sup>263</sup>

Fjala “Atë”, e cila përmendet shumë herë në Dhiatën e Re, quhet EBB apo ABB-A në përkthim, ndërsa RABB përkthehet Zot, Zot i botëve. Fjala “Atë”-Ebb, sipas krishterizmit d.m.th. “Ai që e LINDI djalin Jezusin”.<sup>264</sup> Zoti i Plotfuqishëm përmes Muhamedit s.a.v.s. e ka mbrojtur islamit dhe muslimanët, duke e lënë fjalën “Atë” (EBB) për Zot, jashtë fjalorit të tij fetar. Është një fakt i mrekullueshëm se, megjithëse Kur’ani Fisnik numëron nëntëdhjetenëntë vetitë (emrat) e Zotit, duke përfshirë fjalën RABB në arabisht, që nënkupton – Zot, Zot i botëve, Shpikës, por fjala më e lehtë EBB, që nënkupton “Atë” në gjuhën arabe (Ebu) dhe hebraishte (Aba), nuk është përdorur asnjëherë, kështu që i ka ruajtur muslimanët nga blasfemia e të vetmit bir të lindur.<sup>265</sup>

<sup>262</sup> “A duhet të besosh në trinitet”, fq. 24.

<sup>263</sup> Commentary on the Gospel According to John, sipas: “A duhet të besosh në trinitet”, fq. 24.

<sup>264</sup> Ahmed Deedat, “Kur’ani-Mrekullia e mrekullive”, fq. 63.

<sup>265</sup> Po aty, fq. 65.

Siç thamë më lart, emri i Zotit në krishterizëm “Ati” nuk është një nga nëntëdhjetenëntë cilësitë, emrat që thekson Kur’ani Famëllartë. Në qoftë se pejgamberi Muhamed s.a.v.s do të ishte ai që përpiloi Kur’anin Fisnik, ashtu siç e akuzojnë armiqtë e islamit, atëherë pse për të treguar për “Allahun xh.sh.” ai iu largua fjalës “Atë” përgjatë njëzetetë vjetësh, që ishin vitet e jetës së tij si pejgamber? Fjala arabe (Ebu) apo ajo hebraike (Aba), është më e lehtë se fjala (Rabbu), që ka kuptimin e Zotit, Zotit i botëve, Shpikësit, Kujdestarit, apo Ruajtësit etj., megjithatë cilësia “Rabbu/Zoti” përmendet më së shumti në shpalljen e fundit, Kur’anin Famëllartë. Arsyeja e mospërdorimit të fjalës ATË, nga cilësitë dhe emrat e bukur të Zotit Fuqiptotë, është se njerëzit e kanë deformuar këtë koncept, duke e thirrur Zotin xh.sh, ATË, duke e përshkruar si BABA, i cili e ka lindur të birin e tij të vetëm Jezusin (Gjoni 3:16), duke e krahasuar Atin të ngjashëm me njerëzit në aspektin material dhe me cilësi të tyre, dhe duke i dhënë formë Atij. Kështu, kjo fjalë nuk është përdorur në Kur’an për ta ruajtur të vërtetën lidhur me Krijuesin, Zotin Fuqiptotë dhe për t’iu treguar njerëzve që të kenë kujdes e të ruhen nga blasfemia, sipas së cilës Zoti lindi të birin e tij Jezusin. (I lartësuar është Zoti nga shpifjet që i bëhen).

### ***Këta të tre janë një. (1 Gjoni 5:7)***

Këtu kemi të bëjmë me një citat tjetër të 1 Gjoni 5:7-8, të cilin e gjejmë në tri përkthime të ndryshme. Sipas Biblës, Diodati i Ri, përkthim 1991-1994, është kështu: *“sepse tre janë ata që dëshmojnë në qiell: Ati, Fjala dhe Fryma e Shenjtë, dhe këta të tre janë një”*.

Sipas Biblës që e përktheu Dom Simon Filipaj është kështu: *“Kështu, tre janë ata që dëshmojnë: Shpirti i shenjtë, uji dhe gjaku. Këta të tre bëjnë një dëshmi të vetme”*.

Te shkrimet e shenjta, përkthim nga *“Bota e Re”*, shkruan kështu: *“Sepse tre janë ata që japin dëshmi, fryma, uji dhe gjaku, dhe që të tre janë në përputhje me njëri-tjetrin”*.

Këtu shohim një dallim ndërmjet civateve të Biblave të ndryshme. Citati i lartpërmendur (Ati, fjala dhe fryma e shenjtë dhe këta të tre janë një) nuk paraqiten në asnjë nga dorëshkrimet e vjetra të Biblës, por janë shtuar më vonë me qëllim që të mbështetin doktrinën false të trinitetit. Megjithatë, dijetarët e dinë se fjalët e tilla janë false dhe në përkthimet e sotme të Biblës i lënë jashtë.<sup>266</sup>

Citati *“Ati, Fjala dhe Shpirti i Shenjtë dhe të tre këta janë një”*, gjendet në versionin e mbretit Xhejms, botuar në vitin 1916 dhe në atë kohë përbënte njërën ndër bazat më të forta për doktrinën e trinitisë. Por tani, kjo pjesë është hequr nga *“Revised Standard Version”*, i vitit 1952 dhe 1971, si dhe nga mjaft Bibla të tjera, pasi kishte depërtuar gabimisht në tekstin grek.<sup>267</sup>

Pra, këtu kemi përsëri të bëjmë me fjalën “Një”, sikurse e shqyrtuam më parë te citati *“Unë dhe ati jemi një”* (Gjoni 10:30), duke shikuar edhe citatet e biblave të tjera, këtu kuptojmë se fjala “Një”, nuk do të thotë unitet duke aluduar në trinitet, por në një qëllim, në një veprim, rreth një dëshmie të vetme, apo që

<sup>266</sup> *“The Eerdmans Bible Dictionary”*, Edited by Allen C. Myers, p.1020, sipas: Misha’al Ibn Abdullah, *“What did Jesus really say?”*, fq. 36-37; dhe në: *“Si mund ta gjejmë rrugën për në Parajsë”*, botuar nga Watchtower Bible and Tract Society of New York, shtypur në Itali, nga Dëshmitarët e Jehovahit në gjuhën shqipe, Romë, 1993, fq. 2.

<sup>267</sup> Hasan Baxhil, *“Dialog ndërmjet të krishterit dhe myslimanit”*, fq. 27.

janë në përputhje me njëri-tjetrin. P. sh., nëse tre persona në gjyq japin deklaratë të njëjtë, nuk do të thotë se tre personat janë i njëjti person, por dëshmia e tyre është e njëjtë. Mirëpo, këtu shihet qartë se është një shtim i citatit në Bibël, me qëllim të mbështetjes sipas tyre të Doktrinës së Trinitetit.

Më 1690 Isak Njutoni (1642-1727) shkroi një dorëshkrim mbi korrupsionin e tekstit të Dhiatës së Re, sa u përket citateve të 1 Gjoni 5:7 dhe 1 Timoteu 3:16, titullohej *“A Historical Account of Two Notable Corruptions of Scripture”* (Një llogari historike e dy korrupsioneve të shquara të shkrimeve). Lidhur me citatin 1 Gjoni 5:7, Njutoni thotë se ky varg për herë të parë është shfaqur në edicionin e tretë të Dhiatës së Re, tek Erasmusi.

“Kur ata krijuan Trinitetin; në edicionin e tij ata futën gjëra nga dorëshkrimi i tyre, në qoftë se ata kishin një të tillë, si një almanak që i ka kaluar koha. Dhe a ka mundësi që këto metoda jo të pastra ta kënaqin një njeri të arsyeshëm?... Është më tepër rrezik se sa avantazh në besim, që ta bësh atë të mbahet në një kallam të thyer”.<sup>268</sup>

Këtë citat nuk e kanë biblat e botuara të mëparshme, si: *“The revised standard version”*, *“The new revised standard version”*, *“The new american standard bible”*, *“The new english bibla”*, *“The philips modern english bibla”*, e shumë të tjerë. Përse kështu? Përkthyesi Benjamin Willson bën këtë sqarim: “Ky tekst nuk gjendet në asnjërin prej shkrimeve greke që është shkruar para shekullit XV. Nuk është cituar prej asnjë autori, as prej etërve të hershëm latinë...” Po ashtu edhe dr. Herbert W. Amstrog pajtohet me atë se ky verset është shtim, sepse nuk gjendet në shkrimet greke.<sup>269</sup>

<sup>268</sup> A. Wallace, *“Anti-Trinitarian Biographies”*, vol III, pp. 428-439, 1850, sipas:

[www.geocities.com/alcislam/tjera/njuton\\_bibel.html](http://www.geocities.com/alcislam/tjera/njuton_bibel.html); shih edhe te: Misha'al Ibn Abdullah, *“What did Jesus really say?”*, fq. 39. Lidhur me pikëpamjet e Isak Njutonit për trinitetin, të dhëna mund ta gjeni edhe te Enciklopedia Britanike, te webfaqja e saj zyrtare:

[www.britanica.com/eb/article?eu=115657&tocid=12258&query=isaac%20newton](http://www.britanica.com/eb/article?eu=115657&tocid=12258&query=isaac%20newton)

<sup>269</sup> Hajrudin Muja, *“Krishterimi paulian”*, shih te webfaqet: [www.zeriislam.com](http://www.zeriislam.com) dhe [www.bibladhekurani.com](http://www.bibladhekurani.com)

Lidhur me këtë një hulumtues përfundon: “Mua nuk më duket se doktrina e trinitetit nuk ka të bëjë vetëm me themelet e besimit të krishterë; meqë nga faktet del qartë se lidhur me të nuk gjejmë të shkruar asgjë të drejtpërdrejtë në Dhiatën e Re; ndërsa i vetmi pasazh ku bëhet fjalë për tre që janë dëshmitarë (1 Gjoni 5:7) është pa dyshim i rremë dhe stili i të shkruarit i tij, krejt i panatyrshëm, dëshmon për faktin se sa e huaj është një përmbledhje e tillë nga stili i shkrimeve të Dhiatës së Re”.<sup>270</sup>

### *Perëndia u shfaq në mish. (1 Timoteu 3:16)*

Një citat tjetër, në të cilin, sipas të krishterëve, mbështetet doktrina e trinitetit është te 1 Timoteu 3:16: “*Perëndia u shfaq në mish*”, (*Bibla-Diodati i Ri*), që tregon se si Perëndia u shfaq në mish, u bë njeri. Po ta shohim të njëjtin citat te *Bibla* e Dom Simon Filipajt, na del se Jezusi erdhi në natyrën e njeriut, e jo Perëndia: “*Krishti u dëftua në natyrën e njeriut*”. Kurse te *Bibla*, shkrimet e shenjta, shkruan: “*Ai u shfaq në mish*” (Këtu aludohet në Jezusin).

Vërehet qartë dallimi ndërmjet Perëndisë dhe Jezusit; në citatin e parë tregohet Perëndia, ndërsa në dy Biblat tjera fjala është për Jezusin. Çfarë ndryshimi i madh!

Në manuskriptet e vjetra nuk qëndron “*Perëndia u shfaq në mish*”, veçse “*Ai u shfaq në mish*”, por zbulimi i manuskripteve të vjetra e vuri në pah mashtrimin e bërë.<sup>271</sup> William Miller thekson: “Zoti nuk ka një trup si të njeriut dhe Ai nuk është i kufizuar në një vend, apo në një kohë, por është gjithmonë kudo i pranishëm”.<sup>272</sup>

Bart Ehrman lidhur me këtë citat biblik thotë: “Në Kodikun Aleksandrin, që tashmë gjendet në Bibliotekën Britanike (British Library), arritëm në përfundimin se te 1 Timoteu 3:16, ndërkohë që shumica e dorëshkrimeve të vonshme flisn-

<sup>270</sup> Neander, “*History of Christian religion*”, vol. II, fq. 286, sipas [www.erasmusi.org](http://www.erasmusi.org), “*Disa thënie në lidhje me trinitetin*”, Përmbledhi Rrezart Beka.

<sup>271</sup> Halil Ibrahim, “*Islami dhe krishterimi*”, fq. 50.

<sup>272</sup> William Miller, “*Besimet dhe ritet e krishtera*”, England, 1991, fq. 2.



in për Krishtin si “Perëndi i shfaqur në mish”, ky dorëshkrim i hershëm e përshkruan Krishtin si ai, “i cili u bë i shfaqur në mish”. Në gjuhën greke ndryshimi është shumë i vogël. Dallimi qëndron mes një *thete* dhe një *omikroni* që grafikiqsh ngjajnë, pak a shumë, kështu: ÈÓ dhe OÓ. Skribët e mëvonshëm e kanë ndryshuar tekstin fillestar, ndaj edhe tani aty nuk lexojmë më “i cili”, por “Perëndi” (i shfaqur në mish). Me fjalë të tjera, një korrigjues i mëvonshëm e ka ndryshuar tekstin në atë mënyrë që ta vërë në pah sa më mirë hyjninë e Jezusit”.<sup>273</sup>

### *Perëndia i ngjashëm me njeriun. (Zanafilla 1:26)*

Te Zanafilla 1:26 shkruan: “*Perëndia tha: Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne ...*”.

Gjithashtu, mundohen që ta argumentojnë doktrinën e tyre me këtë citat, kinse Jezusi është Zot dhe se Zoti u bë njeri në formën e Jezusit. Sipas citatit këtu tregohet në përgjithësi se si njerëzit janë sipas shëmbëlltyrës së Zotit, d.m.th. ne i ngjajmë Zotit (I pastër është Zoti nga shpifjet e tyre).

Shtrohet pyetja: Nëse Zoti është në ngjasim me ne, apo ne jemi të ngjashëm me Zotin? Nëse mendojmë pakëz, del se Zoti sipas Biblës na qenka në shumë forma, sepse ndër njerëz ka të bardhë, të zinj, të kuq, të verdhë, ka njerëz të gjinisë femërore dhe mashkullore etj. Në cilin grup të njerëzve hyn Zoti?! Këtu shihet një shpifje e madhe, një trillim që i bëhet Zotit të Plotfuqishëm. Kur i lexojmë citatet e tjera të Biblës, hasim në kontradiktë ndërmjet teksteve dhe njëherësh e kundërshton citatin e lartpërmendur. Pasi gjinden shumë citate që i kundërvihet citatit që sapo e përmendëm, ne do t’i paraqesim vetëm dy prej tyre.

Profeti Jeremia e kundërshton këtë citat duke thënë: “*Askush nuk është i ngjashëm me ty, o Zot ... nuk ka njeri të ngjashëm me ty*”. (Jeremia 10:6-7) Por edhe Jezusi e kundërshton, kur thoshte: “*Ju nuk e keni dëgjuar kurrë zërin e tij dhe as nuk e keni parë fytyrën e tij*”. (Gjoni 5:37)

Këtu shihet qartazi mënyra e manipulimit të njerëzve me Biblën.

<sup>273</sup> Bart D. Ehrman, “*Të keqcitosh Jezusin-Si dhe përse u ndryshua Bibla*”, fq. 86.

Në njërën ndër enciklopeditë e njohura të religjionit, lidhur me këtë çështje, pohohet: “Sot teologët janë të një mendjeje se Bibla hebraike nuk përmban ndonjë doktrinë të trinitetit, edhe pse ishte e zakonshme që në tekstet dogmatike të së kaluarës lidhur me trinitetin të citoreshin tekste të ngjashme me ato të Zanafillës 1:26, *“Le ta bëjmë njerëzimin të ngjashëm me ne, sipas shëmbëlltyrës sonë.”* (Shih gjithashtu Zanafilla 3:22, 11:7; Isaia 6:2-3) si një provë e shumësisë së zotave. Edhe pse Bibla hebraike e paraqet Zotin si Atin e Izraelit dhe përdor edhe personifikime të Zotit si: fjala (davar), shpirti (ruah), urtia (hokhmah) dhe prania (shekhinah), do të dilte përtej qëllimit dhe frymës së Dhiatës së Vjetër lidhja e këtyre koncepteve me doktrinën e mëvonshme trinitare.<sup>274</sup>

Në një tjetër enciklopedi të njohur gjendet edhe kjo shprehje: “Vështirë se mund të gjenden gjurmë të trinitetit në Dhiatën e Vjetër...”<sup>275</sup> Së fundmi nuk do ta lëmë pa e përmendur Levi Leonard Painen, profesor i historisë kishtare, i cili në njërën nga veprat e tij shprehet: “Dhiata e Vjetër është rreptësisht mono-teiste. Perëndia është një qenie më vete, një person i vetëm. Ideja që në të gjendet një trinitet...është krejtësisht pabazë”<sup>276</sup>

### ***Unë jam në Atin, Ati është në mua. (Gjoni 14:11)***

Gjoni tregon se si Jezusi tha: *“Më besoni se unë jam në Atin dhe se Ati është në mua”*. (Gjoni 14:11)

<sup>274</sup> *“Encyclopaedia of Religion”*, Mircea Eliade, editor in chief, 1987, vol 15, (Macmillan Publishing Company, NY) fq. 54.

<sup>275</sup> *“Encyclopaedia of Religion and Ethics”*, Charles Scribner’s Sons, vol. XI, New York 1928, fq. 458. E njëjta gjë tregohet dhe vërtetohet në Enciklopedinë e re katolike, shih M.A.C. Cave, *“Is the Trinity doctrine divinely inspired”*, fq. 36.

<sup>276</sup> Levi Leonard Paine, *“A Critical History of the Evolution of Trinitarianism”*, 1900, [Houghton, Mifflin, and Company, Boston and New York; The Riverside Press, Cambridge] fq. 4; shih edhe *“Harper’s Bible Dictionary”*, edited by Paul J. Achtemier, San Francisco: Harper and Row, 1985, fq. 1098; ky citat gjindet edhe tek *“A duhet të besosh në trinitet”*, fq. 12.

Disa citate më poshtë, përsëri nga ungjilli i Gjonit, pohojnë se Jezusi tha për dishepujt: *“që të gjithë të jenë një, ashtu si ti, o Atë, që je në mua dhe unë në ty; edhe ata të jenë një në ne”*. (Gjoni 17:21)

Pra, këtu tregohet se si Zoti dhe Jezusi janë një, por gjithashtu edhe dishepujt janë një në Jezusin dhe Zotin, sepse ai është në Zotin. Në qoftë se Jezusi është zot, pse atëherë nuk janë edhe dishepujt zot, duke qenë se edhe ata janë si Jezusi, janë perëndi? Nëse Ati, Jezusi dhe shpirti i shenjtë, janë në trininë, atëherë po qe se do t'i përfshinin edhe dishepujt, bashkësia perëndi do të përbëhej nga pesëmbëdhjetë veta<sup>277</sup>

Po ashtu te Gjoni 14:20 thuhet: *“Atë ditë do të mësoni se unë jam në Atin tim, dhe se ju jeni në mua dhe unë në ju”*. Dhe te Efesianëve 4:6 thuhet: *“një Perëndi i vetëm dhe Atë i të gjithëve, që është përmbi të gjithë, në mes të të gjithëve dhe në ju të gjithë”*.

Askush nuk tha se apostujt apo efesianët janë zota, sepse madhëstim, poshtërimi, dashuria, etj., që u përshkruhen më të ulëtëve, u përshkruhen të lartëve në mënyrë metaforike, prandaj Jezusi, për apostujt në ungjillin e Mateut 10:40, tha: *“Ai që ju pranon, më pranon mua; dhe ai që më pranon mua, pranon atë që më ka dërguar”*.<sup>278</sup>

### **Unë jam. (Gjoni 8:58)**

Referimi i të krishterëve për të mbrojtur tezën e tyre sipas së cilës Jezusi është Zot, i referohen citatit, në të cilin Jezusi thotë se ishte para Abrahamit me fjalën *“Unë jam”*, te Gjoni 8:58: *“Jezusi u tha atyre: “Në të vërtetë, në të vërtetë unë po ju them: para se të kishte lindur Abrahami, unë jam””*.

Nëse Jezusi është Zot për arsye se tha që ishte para Abrahamit, çka do të thoshim edhe për të tjerët që ishin më parë se Abrahami, bile edhe para krijimit të maleve dhe burimeve, para krijimit të tokës, siç e cek Bibla për Solomonin, Mel-

<sup>277</sup> Hasan Baxhil, *“Dialog ndërmjet të krishterit dhe myslimanit”*, fq. 29.

<sup>278</sup> Rahmetullah El-Hindi, *“Triumfi i së vërtetës”*, Shkup, 1998, fq. 91.

kisedekun, Jereminë, Kirin e shumë të tjerë. Ja disa citate biblike të të përmendurve:

*“Sepse ky Melkisedeku, mbret i Salemit dhe prift i Shumë të Lartit Perëndi... Pa atë, pa nënë, pa gjenealogji, pa pasur as fillim ditësh as fund jete, por i përngjashëm me Birin e Perëndisë, ai mbetet prift në amshim”.* (Hebrenjve 7:1,3)

*“Para se unë të formoja në barkun e nënës sate, të kam njohur; para se ti të dilje nga barku i saj, të kam shenjtëruar dhe të kam caktuar profet i kombeve”.* (Jeremia 1: 5)

*“Kështu i thotë Zoti të vajosurit të tij, Kirit, që unë e mora me dorën e djathtë, që të hedh poshtë para tij kombet: Po, unë do të zgjidh brezat që mbretërit mbajnë në ijë, për të hapur para tij”.* (Isaia 45:1)

Pra, siç pamë te citatet e lartpërmendura, a mund të themi se edhe këto janë zota? Jo, por fjala e përmendur e Jezusit “Unë jam”, nuk do të thotë se është Perëndi. Për ta krahasuar shprehjen “unë jam” do ta cekim të njëjtën fjalë te Gjoni 9:9, ku lypësi e përdori këtë fjalë, pasi që Jezusi e shëroi nga verbëria, a mund të themi se edhe lypësi ishte Zot? *Disa thoshin: “Ai është”. Të tjerë: “I përngjan atij”. Dhe ai thoshte: “Unë jam”.*

Një nga librat e krishterë me titull “*Bazat e Biblës*” thekson: “Vetë përshkrimi i Marisë në ungjill si “*nëna*” e Krishtit, e shkatërron në vetvete idenë se ai ekzistoi përpara lindjes së tij nga Maria”.<sup>279</sup>

### **Zoti Jezus. (Marku 16:19)**

Në ungjillin e Markut 16:19 thuhet: “*Zoti Jezus, pra, mbasi u foli, u ngrit në qiell dhe u ul në të djathtë të Perëndisë*”. Ndërmjet fjalës “*Zoti Jezus*”, siç e cek Diodati i Ri, dhe asaj te Bibla e Dom Simon Filipajt e te Shkrimet e Shenjta, ku e gjejmë të potencuar si “*Zotëria Jezus*”, kemi një dallim.

Së dyti, nëse Jezusi është Zot, si ulet zoti te Zoti? Mirëpo, nëse Jezusi është pjesë e trinitetit, po shpirti i shenjtë ku ulet në qiell, pasi që pranë Perëndisë është vetëm një vend; në të djathtën e Perëndisë? Nëse të krishterët mendojnë se fjala

<sup>279</sup> “*Bazat e Biblës - udhëzim kapitujsh*” (Shpalosja e gëzimit dhe paqes së krishterimit të vërtetë), fq. 141.

“Zot” apo “Zotëri”, që i është referuar Jezusit, është e njëjtë dhe megjithatë mundohen ta mbrojnë tezën e tyre, atëherë ç’të bëjmë kur në Bibël kemi personalitete të ndryshme të cilat quhen “Zotëri”. P.sh. fjala “Zotëri” përdoret për Esaun, i cili quhej Zotëri (shih Zanafilla 32:4), pastaj edhe Jozefi u quajt Zotëri (Zanafilla 44:20), Davidi po ashtu, bile Davidi quhet edhe “imzot” që do të thotë “Zoti im” (a mund të themi për të se është Zot?) (1 Samueli 25:24) e shumë të tjerë.

Pra, a mund të themi se këta janë zota? Jo, sepse fjala “Zotëri” nuk aludon në “Zot”.

Po ashtu Bibla na tregon se fjala Zot është përdorur edhe në vend të emrit Zotëri dhe jo për Krijuesin e qiejve dhe tokës. Në rastin e Marisë kur shkon tek varri, Maria mendon se është kopshtari dhe i thotë zot, po kështu edhe priftërinjtë e emërtojnë Pilatin zot. Pra, kjo tregon qartë se fjala Zot në Bibël, kur iu drejtohet njerëzve si Jezusit, Pilatit etj. ka kuptimin zotëri dhe jo Perëndi. Le t’i referohemi Biblës lidhur me këto argumente:

*“Jezusi i tha: “O grua, pse po qan? Kë kërkon?”. Ajo, duke menduar se ishte kopshtari, i tha: “Zot, po e pate hequr ti, më trego ku e vure dhe unë do ta marr”.* (Gjoni 20:15)

*“Dhe të nesërmen, që ishte mbas ditës së Përgatitjes, krerët e priftërinjve dhe faris-enjtë u mblodhën te Pilati, duke thënë: “Zot, na ra në mend se ai mashtruesi...”.* (Mateu 27:62-63)

Sikurse thuhet te Korintasve: *“Po a nuk e pashë Jezu Krishtin, Zotërinë tonë?”* (1 Korintasve 9:1)

Sipas R. P. Roge, vargjet 16:19 të ungjillit të Markut, përbëjnë një tekst *“të shtuar më vonë”*, edhe pse për kishën është kanonik<sup>280!</sup> <sup>281</sup> Vargjet 9 deri në 20 të kapitullit të 16 në ungjillin e Markut, janë hequr nga mjaft Bibla. Shih në shëni-

<sup>280</sup> *Kanon-i* (gr.) - norma, mostra, kriteri, dispozita apo ligji kishtar; në fenë krishtere - si në atë katolike, ashtu edhe në atë ortodokse - tërësia e atyre shkrimeve që kanë të bëjnë me fenë krishtere, të cilat organi apo personi i autorizuar kishtar i ka shpallur dhe i ka konfirmuar si të vërteta, burimore, të padyshimita dhe, si të tilla, të shenjta. (Ekrem Murtezai, *“Fjalori i feve”*, fq. 178.)

<sup>281</sup> Dr. Maurice Bucaille, *“Bibla, Kur’ani dhe Shkenca”*, fq. 120.

met në “*Revised Standart Version*”, “*New American Standard Bible*”, “*New World Translation of Holy Scriptures*”.<sup>282</sup>

Nëse, vërtet, sipas citatit besohet se Jezusi ishte i shenjtë, ngaqë u ngrit në qiell, pse nuk pranohen si të shenjtë edhe ata profetë të tjerë, të cilët po ashtu u ngritën në qiell? Shih p.sh. te 2 Mbretërve 2:11-12: “... dhe Elija u ngrit në qiell përmes një shtjelle ajri. Elisha e pa dhe thirri... E më ai nuk e pa...”. Po kështu Perëndia ngrii në qiell edhe Enokun: “Pra Enoku eci me Perëndinë, por nuk u gjend më, sepse Perëndia e mori me vete”. (Zanafilla 5:24) Kjo përsëritet edhe te Hebrejve 11:5.<sup>283</sup>

### **Adhurimi i Jezusit. (Mateu 28:17)**

Shprehja se “*Jezusi është Zot*” arsyetohet me atë se populli e kanë adhuruar atë, siç ceket te Gjoni 9:38 dhe Mateu 28:17, ku thuhet: “*Atëherë ai tha: “Unë besoj, o Zot”; dhe e adhuroi*”. “*dhe, kur e panë, e adhuruan; por disa dyshuan*”.

Fjala e përkthyer si “*adhurim*” apo “*lutje*” është fjala greke “*Prosekunesan*” e nxjerrë nga fjala “*Proskuneo*” (Pros-ku-neh’o), letrarisht e ka kuptimin e “*të puthurit*”. Kjo fjalë gjithashtu ka domethënie të përgjithshme, si: përshëndetje, kru-spullim, zgjatje e fjalës, gjunjëzim, apo i shtrirë përdhe. Në këtë rast është akt i të puthurit të dorës së dikujt, në shenjë të adhurimit ndaj tij.<sup>284</sup>

Nëse e marrim Biblën - shkrimet e shenjta, do të vërejmë se nuk përputhet me citatin e lartpërmendur, sepse fjala “*adhurim*” këtu ceket me fjalën “*nderime*”. Citati është kështu: “*atëherë ai i tha: Unë tregoj besim tek ai, Zotëri. Dhe i bëri nderime*”. Kurse citati tjetër te Mateu 28:17 është kështu: “*Kur e panë, ata i bënë nderime, por disa dyshuan*”. Këtu shihet qartazi ndryshimi ndërmjet fjalës “*adhurim*” dhe “*nderime*” dhe përkthimi i tyre gabim, diku si “*adhurim*” e diku si “*ra përmbys*”.

<sup>282</sup> Hasan Baxhil, “*Dialog ndërmjet të krishterit dhe myslimanit*”, fq. 50.

<sup>283</sup> Po aty, fq. 50.

<sup>284</sup> Hajrudin Muja, “*Krishterimi paulian*”, shih te webfaqet: [www.zeriislam.com](http://www.zeriislam.com) dhe [www.bibladhekurani.com](http://www.bibladhekurani.com)

Shprehje të tilla biblike nuk i referohen vetëm Jezusit, por edhe të tjerëve, si p.sh:

*“Kur Abigaili pa Davidin, zbriti shpejt nga gomari dhe ra përmbys me fytyrën për tokë përpara Davidit”. (1 Samueli 25: 23)*

*“Ajo hyri dhe u hodh në këmbët e tij, duke u shtrirë për tokë; pastaj mori djalin e saj dhe doli”. (2 Mbretërve 4: 37)*

*“Pastaj erdhën edhe vëllezërit e tij dhe u shtrinë para tij, dhe i thanë: “Ja, ne jemi shërbëtorët e tu”. (Zanafilla 50: 18)*

A mund të themi që edhe këta janë perëndi, sepse njerëzit ranë përmbys përpara tyre, me fytyrë për tokë?

### ***Biri i vetëmlindur. (Gjoni 1:14/ 3:16,18)***

Bibla e quan Jezusin *“Birin e vetëmlindur” të Perëndisë*. (Gjoni 1:14/ 3:16,18) Trinitarët thonë se pasi Perëndia është i përjetshëm, po ashtu edhe i biri i Perëndisë është i përjetshëm. Mirëpo, si është e mundur që një person të jetë bir, e ndërkohë të ketë të njëjtën moshë me të Atin?

Trinitarët pohojnë se në rastin e Jezusit *“i vetëmlindur”* do të thotë që Jezusi vetë u lind, që vetë Zoti është i vetëmlindur! Përse atëherë Bibla e përdor të njëjtën fjalë greke, për fjalën *“i vetëmlindur”* për të përshkruar marrëdhënien e Isakut me Abrahamin? Sipas Biblës-shkrimeve të shenjta te libri i Hebrenjve 11:17 tregon për Isakun si bir *“i vetëmlindur”<sup>285</sup>* i Abrahamit.<sup>286</sup> A mund të themi edhe për Isakun se është Zot, pasi që e njëjta fjalë si te Jezusi, ashtu edhe tek Isaku është fjala greke, për fjalën *“i vetëmlindur”*. Fjala greke bazë e përkthyer *“i vetëmlindur”* e përdorur në rastin e Jezusit dhe të Isakut, është MO-NO-GE-NES. Kështu

<sup>285</sup> *“Me anë të besimit, Abrahami, kur u vu në provë, pothuajse e flijoi Isakun, dhe ai që kishte marrë me gëzim premtimet, provoi të flijonte birin e vetëmlindur”. (Hebrenjve 11:17) Ky citat gjindet te “Shkrimet e shenjta”, përkthim “Bota e re”, Romë, 2006.*

<sup>286</sup> *“A duhet të besosh në trinitet”, fq. 15.*

monogenes përcaktohet si: “I vetëmlindur” që d.m.th. “bir i vetëm”. (*A Greek and English Lexicon of the New Testament*, nga E. Robinson)<sup>287</sup>

### **Jezusi nuk është prej kësaj bote. (Gjoni 8:23)**

Në ungjillin e Gjoni 8:23 thuhet se Jezusi ka pohuar: Dhe ai u tha atyre:

*“Ju jeni nga këtu poshtë, kurse unë jam nga atje lart; ju jeni prej kësaj bote, unë nuk jam prej kësaj bote”.*

Kjo thënie është në kundërshtim me realitetin; sepse Isai a.s. (Jezusi) ishte nga kjo botë, por ata e komentuan në atë mënyrë që ta argumentojnë hyjninë e tij, e ky komentim është i pavend në dy aspekte:

a) Sepse është në kundërshtim me argumentet logjike dhe me tekstet definitive.

b) Sepse Jezusi i tha këto fjalë edhe për nxënësit e tij, por askush nuk tha se ata ishin zota.<sup>288</sup>

Shih te Gjoni 17:14-16, ku të njëjtat fjalë që i ceku në citatin e mësipërm, i cek edhe për nxënësit e tij:

*“Unë ua kam dhënë atyre fjalën tënde dhe bota i ka urryer, sepse nuk janë prej botës, ashtu si edhe unë nuk jam prej botës. Unë nuk kërkoj që ti t’i heqësh nga bota, por që ti t’i mbrosh nga i ligu. Ata nuk janë nga bota, sikurse unë nuk jam nga bota”.*

### **Emanuel - Zoti me ne. (Isaia 7:14 / Mateu 1:23)**

Po ashtu është edhe një citat tjetër biblik ku të krishterët mundohen që ta argumentojnë hyjninë e Jezusit, me fjalët e një profeti të quajtur Isaia, i cili në librin e tij në Dhiatën e Vjetër bëri një profeci, në të cilën, mes tjerash, tha: *“Prndaj vetë Zoti do t’ju japë një shenjë: Ja, e virgjëra do të mbetet me barrë dhe do të lindë një fëmijë të cilin do ta quajë Emanuel.”* (Isaia 7:14)

Lidhur me këtë citat shumë teologë të krishterë, pas analizimit, kanë dhënë mendimet e tyre për domethënien e këtij pasazhi biblik, duke e komentuar në

<sup>287</sup> Po aty, fq. 16.

<sup>288</sup> Rahmetullah El-Hindi, *“Triumfi i së vërtetës”*, fq. 90.



bazë të origjinalitetit të këtij citati. Autorët e Dhiatës së Re kanë cituar shpesh pasazhe nga Dhiata e Vjetër, të cilat, sipas tyre, janë profeci të përmbushura në personin e Jezu Krishtit<sup>289</sup>. Numri i këtyre pjesëve të cituara është vërtet i madh. Ndërmjet ungjillorëve, Mateu është ai që e ka bërë këtë dukuri karakteristike të ungjillit të tij.

Kjo profeci e Isaia aludohet në ngjarjen që ka ndodhur me mbretin arameas Rezin nga Damasku (Siria) dhe mbretin Pekah të Izraelit (Efrain: mbretëria e veriut) që organizuan një revoltë ndaj superfuqisë së asaj kohe, Asirisë. Mbreti Ashaz refuzoi të bashkohej me ta dhe për këtë arsye ata u kthyen kundër tij, e rrethuan Jerusalemin dhe u përpoqën ta rrëzonin nga fronti e ta vendosnin një vasal në fronin e Judah. Mbreti Ahaz, për ta shpëtuar veten, mendoi t'i kërkonte ndihmë mbretit Tiglath-Pileser nga Asiria. Në këtë moment Isaia ia ndaloi mbretit ta bënte këtë gjë, sepse e dinte mirë se pasi që mbreti asirian t'i shkatërronte armiqtë e ata gjithashtu do ta shndërronin Judenë në një shtet vasal. Mbreti veproi në këtë mënyrë, por rreziku i shkatërrimit nga armiqtë e tij ishte ende shumë i madh. E gjithë kjo ndodhte rreth viteve 735-734 p.e.s., kurse mbreti Ahaz dhe populli i tij ishin shumë të frikësuar. Atëherë Zoti ia dërgoi Isaian për t'i siguruar për atë se ata *“dy mbretër”* nuk do të mund ta çonin deri në fund pushtimin e tyre. Pjesa më e rëndësishme e këtij rrëfimi, të paktën për ne, vjen kur Zoti dëshiron ta japë një *“shenjë”* për ta qetësuar mbretin Ahaz. Mirëpo, Ahazi nuk dëshiron ta tundonte Perëndinë dhe në këtë mënyrë ai refuzoi t'ia kërkonte Zotit një shenjë. Zoti vetë këmbënguli, duke e bërë Isaian që të thotë: *“Prandaj vetë Zoti do t'ju japë një SHENJË: “Ja, një GRUA E RE do të mbetet me barrë dhe do të lindë një fëmijë, të cilin do ta quajë Emanuel. Ai do të hajë ajkë dhe mjaltë derisa të mësojë të hedhë poshtë të keqen dhe të zgjedhë të mirën. Por para se fëmija të mësojë të hedhë poshtë të keqen dhe të zgjedhë të mirën, vendi që ti i druhesh për shkak të dy mbretërve të tij, do të braktiset”.* (Isaia 7:14-16)

<sup>289</sup> I njëjti citat sikur tek Isaia 7:14, e ka huazuar Mateu tek ungjilli i tij për ta vërtetuar kinse profecinë e Isaia lidhur me Jezusin dhe hyjnizimin e tij, shih Mateu 1:23: *“Ja, virgjëresha do të mbetet shtatzënë dhe do të lindë një djalë, të cilit do t'i venë emrin Emanuel, që do të thotë: “Zoti me ne”*“.

Siç shihet, kjo profeci është plotësuar gjatë jetës së Ahazit dhe jo disa shekuj më vonë, siç dëshiron të na bëjë të besojmë Mateu, sepse shenja e dhënë kishte si qëllim të qetësonte mbretin Ahaz dhe popullin e tij nga frika prej armiqve. Pasi Perëndia i tha Ahazit që ta kërkonte një shenjë për t'i treguar se ai ishte me të dhe popullin e tij dhe pas refuzimit të këtij të fundit për ta tunduar Perëndinë, atëherë vetë Zoti e mori iniciativën dhe i tregoi Ahazit për Emanuelin.

Para se ky fëmijë ta arrinte pjekurinë, mbretërit që e terrorizonin popullin e Ahazit, do të shkatërroheshin. Pra, mbretërit që frikësonin Ahazin u shkatërruan shumë shekuj para lindjes së Jezusit. Informacioni sipas të cilit ky fëmijë do të hajë ajkë dhe mjalte derisa të mësojë të hedhë poshtë të keqen dhe ta zgjedhë të mirën, është një tjetër element, i cili e identifikon këtë fëmijë me situatën aktuale që po e kalonte Judah në atë kohë, ku ajka dhe qumështi për një popull agrar, formonte përbënin ushqimin bazë të tij. Këto trajta njerëzore e vendosin fëmijën në kohën kur kjo profeci është kryer. “Zbatuar ndaj Mesisë, ajo duket e papërshtatshme dhe e tepërt”.<sup>290</sup>

Kjo do të thotë që profecia u plotësua shumë kohë para lindjes së Jezusit (krahaso 2 Mbretërve 15: 27-29; 16: 1 e më poshtë; 2 Kronikave 28:1 e më poshtë). Pra, në këtë profeci nuk ka vend për Jezusin dhe nënën e tij të ndershme.

Nëse bëhet një krahasim tjetër ndërmjet teksteve biblike, lidhur me lindjen e Jezusit dhe emrin e tij, mund t'i referohemi po ashtu Mateut 1:20, ku tregon se si një engjëll iu shfaq në ëndërr Jozefit dhe urdhëronte Jozefin që ta merrte për grua Marinë dhe djali që do të lindte është një ngjizje prej frymës së shenjtë, ndërsa fëmija do të quhej Jezus: “Por, ndërsa bluante me vete këto çështje, ja që iu shfaq në ëndërr një engjëll i Zotit dhe i tha: “Jozef, bir i Davidit, mos ki frikë ta marrësh me vete Marinë si gruan tënde, sepse ç’është ngjizur në të është vepër e Frymës së Shenjtë”, dhe “por ai nuk e njohu, derisa ajo lindi djalin e saj të parëlindur, të cilit ia vuri emrin Jezus”. (Mateu 1:25) Ndërsa në citatet e ungjillit të Llukës, shohim se Engjëlli

<sup>290</sup> “An Introduction to the Old Testament”, nga Samuel Davidson, Vol III, 1863, fq. 78; sipas artikullit “Shenja e Emanuelit”, nga Rrezart Beka, tek [www.erasmusi.org](http://www.erasmusi.org); lidhur me këtë tregim shih edhe te Harputli Ishak Efendija, “Nije mogao odgovoriti”, Istanbul-Temmuz, 2006, fq. 74-75.

iu shfaq Marisë dhe e lajmëroi se do të mbetesh shtatzënë dhe se do ta lindte një djalë që do t'ia vinte emrin Jezus: *“Dhe engjëlli i tha: “Mos ki frikë, Mari, sepse ke gjetur hir para Perëndisë. Dhe ja, ti do të mbetesh shtatzënë dhe do të lindësh një djalë, dhe do t'ia vesh emrin Jezus”.* (Luka 1:30-31)

Nga citatet shihet qartazi se emri i tij ishte Jezus, e jo Emanuel siç tregohet te Mateu 1:23, ndërsa autori i këtij ungjilli e ka huazuar këtë citat nga Isaia 7:14. Gjithashtu, te citatet e ungjillit të Mateut dhe të Llukës vërejmë një kontradiktë ndërmjet dy emrave: Jezus apo Emanuel (Mateu 1:25; Llukës 1:31 me Mateu 1:23). Mirëpo, s'duhet harruar një gjë, sepse Jezusi asnjëherë nuk tha dhe as që deklaroi para të tjerëve se emri i tij është Emanuel.<sup>291</sup>

Si përfundim mund të themi se teksti i Isaias nuk bën fjalë për asnjë lloj profecie të ndonjë lindje virgjërore e cila do të ndodhte shekuj me vonë. Mateu duke e shkëputur në mënyre arbitrare dhe të sforcuar pasazhin e Isaias nga konteksti i tij fillestar, si edhe duke e përkthyer keq tekstin e pasazhit në fjalë, është përpjekur të përfitojë një profeci për lindjen virgjërore të Marisë dhe hyjnizimin e Jezusit.

### **Zoti im dhe Perëndia im. (Gjoni 20:27-28)**

Në ungjillin e Gjoni thuhet se kur Thomai e pa Jezusin që ishte ringjallur<sup>292</sup> filloi të mos besonte se ishte Jezusi ai që po e shihte përballë dhe kur vërtetoi se ishte ai, atëherë Thomai i tha: Zoti im dhe Perëndia im: *“Pastaj i tha Thomait: “Vëre gishtin këtu dhe shiko duart e mia; shtrihe edhe dorën dhe vëre në brinjën time; dhe mos ji mosbesues, por besues! Atëherë Thomai u përgjigj dhe i tha: “Zoti im dhe Perëndia im!”.* (Gjoni 20:27-28)

Sipas citatit të lartpërmendur të krishterët mundohen që me fjalët e Thomasit thënë Jezusit *“Zoti im dhe Perëndia im”*, të arsyetojnë se Jezusi është me të vërtetë Perëndia dhe Zoti i tyre. Nëse i krahasojmë dhe i analizojmë citatet e tjera të Biblës dhe thënien e Thomasit që i drejtohet Jezusit, kjo na tregon se Thomasi

<sup>291</sup> Lidhur me këtë shiko, Harputli Ishak Efendija, *“Nije mogao odgovoriti”*, fq. 74.

<sup>292</sup> Sipas supozimeve të tyre.

nuk ka pasur për qëllim që ta ngrejë në shkallën e hyjnisë, apo nuk ka menduar në Zotin e Plotfuqishëm, ngase shprehja me të cilën është përgjigjur “*Zoti im dhe Perëndia im*” gjendet në shumë vende në Bibël, me ç’rast iu drejtohet edhe profetëve të tjerë, njerëzve të thjeshtë, engjëjve bile edhe djallit, por ne nuk mund të themi që edhe këta janë zota.

Në radhë të parë, sipas Biblës, Zotin nuk mund ta shohë askush dhe as që e ka parë ndonjëri. Kështu, Jezusi i drejtohet masës, duke i thënë: “*Askush s’e pa Perëndinë kurrë*” (Gjoni 1:18) “*Askush s’e ka parë ndonjëherë Perëndinë*”. (1 Gjoni 4:12) Përsëri te Gjoni 5: 37 Jezusi thoshte: “*Dhe Ati, që më dërgoi, ai vetë ka dëshmuar për mua; ju nuk e keni dëgjuar kurrë zërin e tij dhe as nuk e keni parë fytyrën e tij*”, etj.

Së dyti, në Bibël tregohet se Manoahu, duke vëzhguar engjëllin e Zotit në qiell, ai i tha bashkëshortes së vet: *e pamë Perëndinë*, ose siç tregohet: “*Ashtu si flaka ngjitej nga altari në qiell, Engjëlli i Zotit u ngjit me flakën e altarit. Duke parë këtë, Manoahu bashkë me gruan e tij ranë përmbys për tokë. Engjëlli i Zotit nuk iu shfaq më as Manoahut, as bashkëshortes së tij. Atëherë Manoahu kuptoi se ai ishte Engjëlli i Zotit. Manoahu i tha pastaj bashkëshortes së tij: “Ne me siguri do të vdesim, sepse pamë Perëndinë”.* (Gjyqtarët 13: 20-22) Gjithashtu, Bibla u referohet engjëjve si “*ata që ngjajnë me Perëndinë*” (Psalmi 8:5; Hebrenjve 2:7)

Po ashtu në Bibël hebrejntë konsiderohen Perëndi: “*Unë kam thënë: “Ju jeni perëndi, jeni të gjithë bijtë e Shumë të Lartit”.* (Psalmet 82:6) Bibla, Perëndi i quan edhe ata, të cilëve u qe drejtuar fjala e Perëndisë (shih: Gjoni 10:34, 35; Psalmi 82:1-6). Madje, edhe satanai në 2 Korintasve 4:4, quhet “*perëndia i kësaj bote*”.<sup>293</sup> Gjithashtu, me termin *Zoti im*, apo *Zot*, *Perëndia im* etj. janë quajtur edhe profetët e Zotit, si: Abrahami, Jozefi, Davidi, Esau, etj. (shih: Zanafilla 18:12; Zanafilla 44:20; 1 Samueli 25:24; Zanafilla 32:4)<sup>294</sup>

<sup>293</sup> Shih tek: “*A duhet të besosh në trinitet*”, fq. 28; dhe “*A ka vetëm një Perëndi të vërtetë?*”, Zgjhoni, shkurt 2006, fq. 29.

<sup>294</sup> Për më tepër lidhur me këto shih: Misha’al Ibn Abdullah, “*What did Jesus really say?*”, fq.66-67.

Po fjalën Zot e përdor edhe Maria Magdalena kur shkon te varri i Jezusit dhe nuk e gjen brenda, e duke menduar se i afrohet kopshtari ajo e thërret ZOT: *“Jezusi i tha: “O grua, pse po qan? Kë kërkon?” Ajo, duke menduar se ishte kopshtari, i tha: “Zot, po e pate hequr ti, më trego ku e vure dhe unë do ta marr”.* (Gjoni 20: 15) Gjithashtu priftërinjtë dhe farisenjtë e quajtën Pilatin ZOT, shiko: *“Dhe të nesërmen, që ishte mbas ditës së Përgatitjes, krerët e priftërinjve dhe farisenjtë u mblodhën te Pilati, duke thënë: “Zot, na ra në mend se ai mashtruesi...”.* (Mateu 27:62-63)

Gjithë kjo çka u tha me termat Zot, Zoti im (Imzot), Perëndi, apo Perëndia im, mund të shtrohet pyetja nëse mund të themi edhe për këta se janë Perëndi? Nëse po, atëherë të gjithë njerëzit qenkan perëndi!!

### **Shëmbëllimi i Perëndisë. (2 Korintasve 4:4)**

Te 2 Korintasve 4:4 thuhet: *“... Lavdisë së Krishtit, që është shëmbëllimi i Perëndisë”.* Nëse Jezusi është Zot, sepse është shëmbëlltyra apo imazhi i Perëndisë, siç e cek ky citat, atëherë çka mund të themi për atë se njerëzit në përgjithësi janë shëmbëlltyrë e Perëndisë, siç tregon Bibla te Zanafilla 1:26,27, ku thuhet:

*“Perëndia tha: Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne ... Kështu Perëndia krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së vet, sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë: Ai krijoi mashkullin dhe femrën”.* Sipas këtij citati, atëherë a mund të themi se të gjithë njerëzit janë zota, pasi që të gjithë ne jemi shëmbëlltyrë e Perëndisë?<sup>295</sup>

Habitemi kur në disa nga veprat e njohura teologjike i gjejmë këto fjalë: *“Në Dhiatën e Re nuk ekziston një pohim eksplicit i doktrinës së trinitetit”*<sup>296</sup> *“Teologët janë të pajtimit se në Dhiatën e Re nuk përmbahet ndonjë doktrinë e qartë mbi trinitetin”*.<sup>297</sup>

<sup>295</sup> Rreth kësaj çështjeje shih nën renditjen e shtatë, po në këtë artikull.

<sup>296</sup> Walter A. Elwell, *“Evangelical Dictionary of Theology”*, Baker Book House, Grand Rapids, Michigan 1984, fq. 112.

<sup>297</sup> Mircea Eliade, *“The Encyclopedia of Religion”*, editorinchief, 1987, Vol. 15, (Macmillan Publishing Company, NY) fq. 54.

Duke pasur parasysh se citatet që përmendëm lidhur me trinitetin, ishin kryesisht nga Ungjilli i Gjonit, ku shkencëtari dhe profesori i Universitetit të Parisit dhe anëtar i Akademisë së Shkencave të Francës, dr. Maurice Bucaille, thotë se ky ungjill na dërgon në besimin se këtë ungjill e kanë shkruar disa nxënës mbas të cilit qëndron Pali.<sup>298</sup>

Bart D. Ehrman thotë: “Ç’doi ka të thuash se tekstet origjinale të Biblës janë të frymëzuara? Ne nuk i zotërojmë tekstet origjinale, por kemi vetëm një kopje të mbushura me gabime dhe shumica e këtyre dorëshkrimeve janë prodhuar shekuj më vonë se origjinalët”.<sup>299</sup> “Ishte e qartë se kishte një problem në pohimin se Bibla ishte verbalisht e frymëzuar në çdo fjalë të saj. Siç mësuam në një nga kurset e para të ndjekura në institut, ne nuk i zotërojmë dorëshkrimet origjinale të Dhiatës së Re. Ajo që ne kemi përbëhet nga kopje të këtyre shkrimeve, të bëra vite më vonë. Mbi të gjitha, asnjëra prej këtyre kopjeve nuk është krejtësisht e saktë, duke qenë se skribët që i kanë prodhuar ato, pa dashje ose qëllimisht, i kanë ndryshuar në vende të ndryshme. Të gjithë skribët e kanë bërë këtë. Kështu, në vend që të kemi fjalët e frymëzuara të autorëve (d.m.th. origjinalet) të Biblës, ajo çka kemi janë vetëm kopje të shkruara në gabime të shumëfishimeve”.<sup>300</sup>

Këto ishin disa nga citatet me të cilat të krishterët argumentojnë në mbrojtje të tezës së tyre se Jezusi është Zot. Por deri tani vërejtëm se citatet kanë gabime, si në aspektin e përkthimit, ndryshimit, shtimit së disa civateve në Bibël, vetëm e vetëm për t’ia arritur qëllimit të tyre për ta argumentuar hyjninë e Jezusit.

Duke i parë këto gjëra, Shën Fausti, një peshkop i shekullit V, i shkruan Shën Augustinit me një zemërim, duke thënë: “Shumë gjëra u shtuan nga paraardhësit tanë në shkrimet e Zotërisë sonë, të cilat, edhe pse mbajnë emrin e tij, nuk pajtohen me mësimet e tij. Kjo nuk është befasuese, pasi që ne shpesh kemi vërtetuar se këto gjëra nuk janë shkruar nga Ai vetë e as nga apostujt e tij, por me të madhe janë të bazuara në përralla sipas raporteve të gjysmëhebrenjve, me mospajtime të shumta edhe ndërmjet tyre dhe duke i vënë emrat e apostujve në shkrimet e tyre ua atribuonin atyre gabimet dhe gënjeshttrat e veta”.<sup>301</sup>

<sup>298</sup> Muhamed Gazali, “Islam ili Kršćanstvo izazov vremena”, fq. 10.

<sup>299</sup> Bart D. Ehrman, “Të keqçitosh Jezusin-Si dhe përse u ndryshua Bibla”, fq. 27.

<sup>300</sup> Po aty, fq. 23.

<sup>301</sup> Halil Ibrahim, “Islami dhe krishterimi”, fq. 44; shiko edhe Rahmetullah Kairanvi, “Ngadhënjimi i së vërtetës”, Tiranë, 2003, fq. 53.

## 2. Mendime të personaliteteve të njohura rreth doktrinë së trinitetit

Gjatë shtjellimit të këtij punimi u pa si në planin historik, ashtu edhe nga vetë Bibla, një mohim të doktrinë së trinitetit, ndërsa Jezusi konsiderohet profet, i dërguar, njeri, e jo Zot, duke e argumentuar me shumë dëshmi biblike dhe kur'anore. Në vijim do t'i sjellim disa mendime nga teologët e krishterë, pastaj nga personalitete të ndryshme, veprat e të cilëve e mohojnë këtë doktrinë, dhe njëherësh e zhveshin Jezusin nga qenia hyjnore, duke e konsideruar atë si qenie njerëzore dhe profet sikurse janë profetët e tjerë. Gjithashtu do t'iu referohemi enciklopedive të ndryshme të njohura botërore lidhur me këtë çështje.

- Enciklopedia e re katolike mbështet mendimin se doktrina e trinitetit nuk ka qenë e njohur për të krishterët e hershëm dhe se është vendosur në çerekun e fundit të shekullit IV.<sup>302</sup>
- Në njërin nga fjalorët teologjikë në gjuhën italiane, i cili është fryt i punës së më se 114 specialistëve nga fakultete të ndryshme katolike realiteti i lart-përmendur shprehet me këto fjalë: “Duhet konstatuar se argumenti trinitar nuk duket se gëzon dhe aq rëndësi në jetën e krishterizmit bashkëkohor. Besimtarët më të ditur [d.m.th. ekleziastët specialistë], të zhytur në çështje që duken më urgjente, nuk arrijnë të fshehin një lloj sikleti përballë një doktrine të cilën vërtet e konsiderojnë si një sënduk të çmuar, por ama të mbyllur [...] Vazhdohet të përsëritet se triniteti është e vërteta themelore e fesë, por nuk është e vështirë të kuptosh që ajo nuk është e vërteta themelore në bindjen e shumicës së besimtarëve. Mund të guxojmë të hedhim hipotezën se triniteti është tashmë një e vërtetë e ‘fshirë’ nga ndërgjegjja e përbashkët e besimit, në të cilën mbijeton, përkundrazi, një monoteizëm dobësisht i krishterizuar [...] ai monoteizëm i padallueshëm, i cili karakterizon sot pje-

<sup>302</sup> “*The New Catholic Encyclopedia*” (1967), artikulli “The Holy Trinity”, vëllimi 14, fq. 295, sipas Ulfe Aziz Samed, “*Islami dhe krishterimi*”, fq. 35; Hassan Hathout, “*Leximi i mendjes së muslimanit*”, fq. 28, dhe tek M.A.C. Cave, “*Is the Trinity doctrine divinely inspired*”, fq. 32.

sën dërrmuese të “besimtarëve” [...] e dërgon sot krishterizmin në krizën e tij të identitetit, duke qenë se krijon gjithnjë kushtet e nevojshme për lindjen e një ateizmi proteste”.<sup>303</sup>

- Dr. Annold Meyer, profesor i teologjisë në Universitetin e Cyrihut, thotë: “Nëse me krishterim nënkuptojmë besimin në Krishtin, si bir qiellor i Zotit, i cili nuk i ka takuar njerëzimit të kësaj bote, por i cili ka jetuar i barabartë dhe në lavdi me Zotin, i cili ka zbritur nga qielli në tokë, i cili ka hyrë në njerëzoren dhe e ka marrë formën e njeriut përmes virgjëreshës Mari, që të mund të heqë (t’i shpaguajë) mëkatet njerëzore përmes gjakut të tij në kryq, i cili pastaj është zgjuar nga vdekja dhe është ngritur në të djathtë të Zotit, si zotërues i popullit të vet, i cili në të ka besuar, i cili i dëgjon lutjet e tyre, i mbron dhe i udhëheq; i cili, megjithatë, banon dhe vepron personalisht në secilin prej tyre; i cili do të vijë përsëri me retë e qiellit që t’i gjykojë botës; i cili do t’i rrëzojë të gjithë armiqtë e Zotit dhe i cili popullin e tij do ta marrë me vete në shtëpinë e dritës qiellore, ashtu që ata të mund të bëhen si trupi i tij i popullarizuar - nëse ky është krishterimi, atëherë krishterimin e tillë e ka themeluar Pali i shenjtë, e jo Zoti ynë”.<sup>304</sup>
- Fjalori biblik “*The Illustrated Bible Dictionary*” pohon: “Fjala trinitet nuk gjendet në Bibël... Formalisht, ajo nuk zë vend në teologjinë e kishës deri në shekullin IV”.<sup>305</sup>
- Andrews Norton, në një nga librat e tij, shprehet: “Ne mund të ndjekim historinë e kësaj doktrine dhe ta mësojmë burimin e saj, jo në zbulimin e krishterë, por në filozofinë platonike...Triniteti nuk është doktrinë e Krish-

<sup>303</sup> “*Dizionario Teologico Interdisciplinare della Marieta*”, fq. 472-73; shih edhe “*The Promise of the Trinity*”, Gunton, fq.31, sipas [www.bibladhekurani.com](http://www.bibladhekurani.com), Rrezart Beka, “*Triniteti i pakuptueshëm*”.

<sup>304</sup> “*Jesus or Paul*”, fq. 122, sipas *Ungjilli sipas Barnabes*, përktheu Avdi Berisha, fq. 179.

<sup>305</sup> “*A duhet të besosh në trinitet*”, fq. 5.



tit dhe e apostujve të tij, por një trillim i shkollës së platonistëve të mëvonshëm”.<sup>306</sup>

- “Kisha katolike nuk e ka marrë doktrinën e trinitetit nga Bibla, përkundrazi, ata ngulitën me forcë një teologji të tyren, për më se 700 vjet, e cila nuk ishte më shumë se dëshira se si ata e donin Zotin të jetë, duke e përzier filozofinë greke me fenë e mistereve të Babilonisë dhe interpretimet e tyre personale të Biblës”.<sup>307</sup>
- Në enciklopedinë Britanika, nën titullin “Triniteti”, shkruan: “As fjala Trini, e as ndonjë doktrinë eksplicite si kjo, nuk gjenden në Dhiatën e Re dhe as Jezusi, apo ndonjëri nga pasuesit e tij, nuk kanë pasur ndonjë qëllim që ta kundërshtojnë kredon e Dhiatës së Vjetër: *“Dëgjo o Izrael, Zoti, Perëndia ynë është një Zot i vetëm”* (Ligji i Përtërirë 6:4). Doktrina e Trinitetit u zhbilloa gradualisht gjatë disa shekujve dhe nëpërmjet shumë kontroversave...”.<sup>308</sup>
- Nuk gjendet asnjë provë që të vërtetojë se autorët e Dhiatës së Vjetër të kenë menduar, qoftë edhe prej së largu, për ekzistencën e një triade brenda hyjnisë. Nuk jemi në zotërim të asnjë teksti i cili në mënyrë eksplicite dhe të pakundërshtueshme të provojë ekzistencën e mësimëve trinitare në Dhiatën e Vjetër. Për hebrenjtë Doktrina e Trinitetit përbën një blasfemi kundrejt Hyjnisë. Për ta, kjo doktrinë, e copëton Perëndinë në tre perëndi të tjerë, njësoj të barasvlershëm. Ndër shekuj ajo ka përbërë një hendek të madh ndërmjet krishterizmit dhe hebraizmit, gjë që e ka vështirësuar dialogun ndërmjet këtyre religjioneve. Sipas tyre kjo doktrinë ka qenë krejtësisht e panjohur për profetët dhe njerëzit e Perëndisë që kanë ushtruar profetësinë e tyre në gjirin e Izraelit, madje për ta, kjo doktrinë bie në kundërshtim të

<sup>306</sup> Andrews Norton. *“A Statement of Reasons”*, 1872, Fifth edition, (American Unitarian Association, Boston, MA) fq. 94, 104.

<sup>307</sup> Robert M. Bowman Jr., *“Why you should believe in the Trinity”*, 1989, fq. 32.

<sup>308</sup> Halil Ibrahim, *“Islami dhe krishterimi”*, fq. 23; dhe tek, Jeff Rath, *“An Appeal to Trinitarian Christians”*, fq. 4.

hapur me mësimet e këtyre të fundit, për rrjedhojë ajo është e papranueshme.<sup>309</sup>

- Napoleon Bonaparta thotë: “Musai (Mojsiu), ia ka shpallur fenë e Zotit, popullit të vet, Isai (Jezusi) botës romake, kurse Muhamedi a.s., tërë botës. Arabia ishte vend pagan. Gjashtë shekuj pas Isait, Muhamedi e njohu botën me besimin në Një Zot të Vetëm, që është Zoti i Ibrahimit, i Musait dhe i Isait. Arianët dhe sektarët tjerë, e çoroditën botën me diskutime mbi trinitetin: Atin, të birin dhe shpirtin e shenjtë. Ndërkaq, Muhamedi, shpalli se Zoti është Një, kurse triniteti imponon idenë e idhujtarisë”.<sup>310</sup>
- Në njërën nga enciklopeditë më të njohura të religjionit gjejmë këtë shprehje: “Teologët janë dakord se në Dhiatën e Re nuk përmbahet ndonjë doktrinë e qartë mbi trinitetin”.<sup>311</sup>
- Në njërin ndër fjalorët e njohur biblikë pohohet: “Triniteti i Hyjnisë nga kisha përkufizohet si besim se në Zotin ekzistojnë tre persona, të cilët jetojnë në një natyrë të vetme. Ky besim i përkufizuar në këtë mënyrë, u arrit vetëm në shekujt IV dhe V të erës sonë dhe, rrjedhimisht, nuk mund të konsiderohet si qartësisht, apo zyrtarisht, një besim biblik”.<sup>312</sup>
- Dr. Joseph Priestly (1871): “Nëse është e vërtetë, atëherë pse doktrina e trinitetit nuk u shpall në një formë krejt të hapët dhe në një mënyrë përfundimisht të përcaktuar, të paktën në Dhiatën e Re, ashtu si shtjellohet doktrina e unitetit në Dhiatën e Vjetër dhe të Renë? Dhe pse doktrina e unitetit përçohet në një mënyrë kaq të papërpunuar dhe pa ndonjë përjashtim të bërë në favor të trinitetit, për ta parandaluar çdo gabim të mundshëm lidh-

<sup>309</sup> Shih “*The Jewish Encyclopedia*”, vëllimi i XII, KTAV Publishing House fq. 260-261.

<sup>310</sup> Ajni Sinani, “*Të tjerët për islamit*”, fq. 127.

<sup>311</sup> Mircea Eliade, “*The Encyclopedia of Religion*”, editorinchief, (Macmillan Publishing Company, NY), Vëll. 15, fq. 54.

<sup>312</sup> John L. McKenzie, “*Dictionary of the Bible*” 1995, (shih nëntitullin *Trinity*, është e fotokopjuar keq dhe nuk janë faqet e librit).

ur me të.”<sup>313</sup> “Të krishterët ruajtën të njëjtën fe, duke besuar në unitetin e Zotit dhe në natyrën njerëzore të Krishtit, gjatë gjithë kohës së dishepujve dhe të atyre që arritën t’i njihnin ata, por filluan të largoheshin nga kjo, menjëherë më pas; dhe devijimi përparonte kaq shpejt, sa që brenda një shekulli e gjysmë apo diçka më shumë, doktrina origjinale përgjithësisht gjykohej si heretike.”<sup>314</sup>

- Ndër mendimtarët e shquar, që e mohuan doktrinën e trinitisë së shenjtë, natyrën hyjnore të Jezu Krishtit dhe të shpirtit të shenjtë, ishin: Migel Servetosi (1509-1553), Hugo Grocius (1583-1645), Samuel Klark (1675-1729), Xhozef Pristli (1733-1804), Ricard Prajs (1723-1791), Xhon Milton (1608-1674), Ralf Valdo Emerson (1803-1882) e shumë të tjerë.<sup>315</sup>
- Orientalisti francez, H. Serouya, thotë: “Kur’ani është prej Zotit, ka stil të lartë dhe të përkryer. Me stilin e tij s’mund të krahasohet asnjë stil njerëzor. Njëkohësisht (ai është revolucion në fushën e besimit, nuk njeh as papatin, as ndonjë institucion klerikal, ose priftëror). Islami asnjëherë nuk ka treguar ndonjë dozë frike, ose të jetë trembur nga parimi i të gjykuarit logjiko-filozofik. Nëse e krahasojmë islamin me krishterizmin dhe hebraizmin, do të gjejmë vija ndarëse, sidomos me krishterizmin. Sistemi i krishterë dhe hebraik dallojnë nga ai islam. Në islam nuk ka zbrazëti në mes Krijuesit dhe njerëzve. Kjo zbrazëti, te hebrejtë dhe të krishterët, është përplot ndërmjetësues, gjë që bie ndesh me islamin. Muhamedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-

<sup>313</sup> Priestly, Joseph. “*A history of the Corruptions of Christianity*”. The British and foreign Unitarian Association, London, 1871, fq. 321, sipas [www.erasmusi.org](http://www.erasmusi.org), “Disa thënie në lidhje me trinitetin”, Përmbledhi Rrezart Beka.

<sup>314</sup> Priestly, Joseph. “*A history of the corruptions of Christianity*”. The british and foreign Unitarian Association, London, 1871, fq. 7, sipas [www.erasmusi.org](http://www.erasmusi.org), “Disa thënie në lidhje me trinitetin”, Përmbledhi Rrezart Beka.

<sup>315</sup> Ekrem Murtezai, “*Fjalori i feve*”, fq. 568, këto u quajtën unitarian, thelbi i unitarizmit qëndron në theksimin e njëshmërisë dhe unitetit të Zotit si qenie personale; nga këtu logjikisht pason refuzimi: a) i trinitisë së shenjtë, b) i natyrës hyjnore të Jezusit dhe të shpirtit të shenjtë, etj. Këta ishin disa nga mendimtarët, historianët, teologët që mohuan doktrinën e trinitetit.

lem], edhe pse ishte peygamber dhe i dërguar i Zotit, nuk u shfaq duke mohuar misionin e Musait ose të Isait. Gjithë përpjekjet e tij ishin që ta largonte nga Zoti gjithë atë që ia kishin veshur njerëzit më herët, si p.sh. trinitetin.

Ai ka tërhequr vërejtjen se Isai [alejhis-selam] s'është tjetër, veçse i biri i Merjemes dhe jo i biri i Zotit, sepse thënia se 'Zoti ka bir' është politeizëm (shirk) i rëndë, nga i cili mund të çahen qiejt, të copëtohet toka dhe të fluturojnë malet. Ndërkaq, shpirti i shenjtë është një engjëll, Xhibrili, misioni i të cilit ishte që Isait dhe Muhamedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] t'ua sillte thirrjen e shenjtë. Maria (Merjemja) është një zonjë e ndershme, e jo nëna e Zotit".<sup>316</sup>

- Në Enciklopedinë britanike, vëll. V, fq. 636 thuhet kështu: "Jezusi kurrë nuk pretendoi se qe prej një elementi mbinatyror, as nuk tha që ka natyrë mbinjerëzore".<sup>317</sup>
- John Milton (1608-1674): "Unë pasoj atë që shkruhet vetëm në shkrimet e shenjta dhe nuk ndjek asgjë tjetër, herezi apo sekt. Nëse, pra, Ati është Zoti i Krishtit, dhe i njëjti është edhe Zoti ynë, dhe nëse nuk ka Zot tjetër vetëm se Një, atëherë nuk mund të ketë zot tjetër veç Atit."<sup>318</sup> "Argumentet e Miltonit kundër trinitetit janë më se logjike dhe qartësisht të vetëkuptueshme: Përse u dashkan krijuar mistifikime të cilat nuk gjenden në Bibël? John Locke dhe Isaac Newton, së bashku me Miltonin, tre emrat më të mëdhenj të asaj kohe (1650) nuk mund ta gjenin në Bibël asnjë referencë për trinitetin."<sup>319</sup>

<sup>316</sup> Ajni Sinani, "Të tjerët për Islam", fq. 106-107.

<sup>317</sup> Osman Nuri Topbash, "Vargu i profetëve -3", fq. 229; dhe "Feja e krishterë dhe qytetërimi perëndimor", Dr. Qazim Qazimi, "Dituria Islame", nr. 178, fq. 27.

<sup>318</sup> Cituar nga Stannus Hugh, H. "A history of the Doctrine of the Trinity in the Early Church". 1882. London, Christian Life publishing Co. 281 Strand, London, fq.29, sipas www.erasmusi.org, "Disa thënie në lidhje me trinitetin", Përmbledhi Rrezart Beka.

<sup>319</sup> Christopher Mill, "Milton and the English Revolution", fq. 286, 295, sipas www.erasmusi.org, "Disa thënie në lidhje me trinitetin", Përmbledhi Rrezart Beka.

- Duke i përmbledhur dëshmitë historike, Alvan Lamson, në veprën e tij *“The Church of the First Three Centuries”*, thotë: “...Doktrina e sotme e trinitetit nuk gjendet në asnjë dokument apo relikte që i përket kishës së tre shekujve të parë pas Krishtit... Sa i përket gjithçkaje që ka mbetur dhe është ruajtur prej asaj kohe, duke ardhur gjer në kohët tona, asnjëra prej tyre nuk bën fjalë lidhur me këtë doktrinë. Doktrina ishte e një origjine të mëvonshme.”<sup>320</sup>
- Studimet më serioze të Biblës kanë treguar se ajo përmban një pjesë të madhe shtesash, të cilat nuk i ka thënë as Jezusi dhe as autorët e ungjijve. Kisha, siç ka thënë Heinz Zahrnt, “vendosi në gojën e Jezusit fjalë të cilat ai kurrë nuk i tha dhe i veshi atij vepra që kurrë nuk i bëri”. Po ashtu njëri prej atyre që ka treguar se më e shumta e gjërave që thotë kisha për Jezusin nuk ka bazë, është Rudolf Augustein në librin e tij “Jezusi, biri i njeriut” (botuar në Gjermani më 1972 dhe përkthyer në anglisht më 1977)<sup>321</sup>
- Punimet e shkollës biblike të Jerusalemit (R. P. Benoit dhe R. P. Boismard) tregojnë shumë mirë se ungjijtë kanë qenë shkruar, rishkruar dhe përmirësuar shumë herë. Kështu, ata e kanë tërhequr vëmendjen e lexuesit se “në më shumë se një rast duhet të heqim dorë nga ajo se po e dëgjojmë drejtpërdrejt zërin e Jezusit”.<sup>322</sup>
- Së fundmi, në njërën ndër enciklopeditë e njohura të religjionit, e gjejmë këtë shprehje: “Disa teologë kanë përfunduar se e gjithë doktrina trinitare postbiblike është e imponuar/e diktuar/e paarsyeshme”.<sup>323</sup>

<sup>320</sup> Alvan Lamson, *“The Church of the First Three Centuries”*, 1869 edition, (Horace B. Fuller, Boston, MA), fq. 57,58.

<sup>321</sup> Dr. Maneh Hammad Al Johani, *“E vërteta rreth Jezusit”*, fq. 13.

<sup>322</sup> Dr. Maurice Bucaille, *“Bibla, Kur’ani dhe shkencat”*, fq. 127.

<sup>323</sup> Mircea Eliade, *“The Encyclopaedia of Religion”*, editor in chief, (Macmillan Publishing Company, NY), Vol. 15, fq.54; shih edhe *“The HarperCollins Encyclopaedia of Catholicism”*, 1995; A Statement of Reasons for Not Believing the Doctrine of the Trinitarians Concerning the Nature of God and the Person of Christ 1833, Andrews Norton; Sipas: Arthur Weigall, *“The Paganism in Our Christianity”*, 1928, (G. P.

Për t'iu bishtnuar problematikave të lartpërmendura, disa nga teologët e krishterë e shpallën “mister” doktrinën e trinitetit. Kardinali Xhon O'Kanër deklaroi: “E dimë se ky është një mister mjaft i thellë, të cilin as mund ta kuptojmë dot”,<sup>324</sup> ndërsa Papa Gjon Pali II flet për të si “një mister të pazbërthyeshem të perëndisë trinitet”.<sup>325</sup>

Në këtë mënyrë çdo përçapje për ta shpjeguar trinitetin, apo për t'i zbuluar kundërshtitë dhe boshllëqet që hasen gjatë studimit të kësaj teorie, u mbytën duke përdorur konceptin e “misterit”. Mund të themi me bindje të plotë se kjo metodë është e padrejtë, sepse kështu i vihet fre çdo mundësie për të kritikuar këtë teori.

Është një fenomen me të vërtetë i rrallë që të ideosh një teori, të nxitësh të tjerët për ta besuar, madje në momentin kur kjo teori shfaq kundërshti të hapura me atë që deklaroi, ta shpallësh atë “misterin më të rëndësishëm të fesë”. Të njëjtën gjë mund të bëjnë edhe hinduistët trinitarë, ose të gjithë ata të cilët fillimisht propozojë një paradoks, të cilin, duke mos qenë në gjendje ta shpjegojnë, e shpallin ‘mister’. Kjo do t'i jepte të drejtë një hinduisti, i cili beson se zoti i tij është një lopë, që ta vërtetojë tezën e tij, duke u mbështetur në teorinë e misterit. Çdo përpjekje e bërë për ta shpalosur pamundësinë e kësaj teorie, do të shkëfmoqej përballë këtij qëndrimi.

Shpallja e kësaj doktrine si mister, si dhe pamundësitë për ta kuptuar atë, kanë sjellë si pasojë që në kohët moderne doktrina e trinitetit të jetë gjithnjë e më pak qendrore në jetën praktike të të krishterit të zakonshëm. Sot teologë të shqu-

---

Putnam's Sons, NY, London) fq. 31; si edhe *“A Short History of Christian Doctrine”*, by Bernhard, 1966, (Fortress Press, Philadelphia, PA) fq. 38.

<sup>324</sup> *“The New Yorker”*, (magazine; New York, NY) 23 Mart, 1987, fq. 64, sipas [www.bibladhekurani.com](http://www.bibladhekurani.com), Rrezart Beka, *“Triniteti i pakuptueshëm”*; shih edhe te, M.A.C. Cave, *“Is the Trinity doctrine divinely inspired”*, fq. 29.

<sup>325</sup> *“L'Osservatore Romano”*, (newspaper; Vatican City) 10 Gusht, 1987, fq. 4; shih edhe *Dictionary of Doctrinal and Historical Theology*, fq. 765; si edhe *The Voice of Prophecy radio broadcast*, H. M. S. Richards, speaker, Los Angeles, Dec. 20, 1958, sipas [www.bibladhekurani.com](http://www.bibladhekurani.com), Rrezart Beka, *“Triniteti i pakuptueshëm”*; shiko edhe tek, M.A.C. Cave, *“Is the Trinity doctrine divinely inspired”*, fq. 29.

ar dhe historianë të dogmës pohojnë se doktrina e trinitetit e ka humbur rolin e doktrinës qendrore të krishterizmit.<sup>326</sup>

A është kuptuar ndonjëherë triniteti nga njerëzimi gjatë këtyre 2000 vjetëve? Pikërisht për shkak të paradoksit që kjo doktrinë paraqet: “Në Perëndim, doktrina e trinitetit sa vjen e shihet me një sy gjithnjë e më kritik...Për një kohë të gjatë ajo është trajtuar si një problem dhe jo si thelbi i ungjillit të krishterë”.<sup>327</sup> Pikërisht për këtë arsye për Papa Gjon Palin II kjo doktrinë do të mbetet ende sot e kësaj dite “një mister i pazbërthueshëm të perëndisë trinitet”. Fjalët e Gjon Palit II përbëjnë edhe sot provën e mjaftueshme për pavlefshmërinë e kësaj hipoteze.

---

<sup>326</sup> Po aty, [www.bibladhekurani.com](http://www.bibladhekurani.com), Rrezart Beka, “Triniteti i pakuptueshëm”.

<sup>327</sup> Gunton, “*The Promise of the Trinity*”, fq.31.

### 3. Pikëpamjet kur'anore rreth doktrinës së trinitetit

Duke marrë parasysh kronologjinë historike të shpalljes hyjnore ndërmjet Inxhilit/Ungjillit dhe Kur'anit, Zoti i Lartmadhëruar na e sqaroi devijimin që kanë bërë të krishterët me Isanë a.s./Jezusin dhe me besimin e tij në tërësi. Duke hulumtuar e argumentuar njëren ndër doktrinat më të rëndësishme të krishterizmit, siç është doktrina e trinitetit, është me interes që të shihet se çfarë thotë për trinitetin Kur'ani, si shpallje e fundit hyjnore?

Njerëzimi e ka kuptuar Jezusin në katër mënyra: Sipas ateistëve Jezusi nuk ka ekzistuar fare. Për çifutët Jezusi është një hebre heretik, i lindur nga një grua e përdalë, andaj nuk gëzon të drejtën të quhet shpëtimtar (Mesia). Për të krishterët ai është zot, ose bir i Zotit. Kurse, sipas islamit, Jezusi (Isai a.s.) është i dërguar nga Zoti.<sup>328</sup>

Nën ndikimin e romakëve, të cilët, edhe pse e pranuan krishterizmin, nuk i braktisën zotat e tyre mitologjikë dhe nuk u bënë monoteistë të vërtetë, kisha i inkorporoi dhe i transplantoi mitet e tyre brenda mësimit të saj. Kjo degjeneroi me futjen e mitit të trinitetit si pjesë e pandashme e besimit të krishterë. Ndërkaq, Islami është kategorik në faktin se Zoti dhe krijesa nuk janë të njëjtë ontologjikisht, prandaj as Krijuesi nuk mund të transformohet në krijesë dhe as krijesa nuk mund të lartësohet, ose të shndërrohet në Zot.<sup>329</sup> Kjo do të thotë se është e pamundur zbritja e Zotit në tokë ose inkarnimi i Tij në trupin e njeriut, gjegjësisht në trupin e Jezusit, siç predikon doktrina e krishterë.

Duke e parë devijimin e popujve nga rruga e vërtetë dhe ndryshimin e librave të shpallur prej të Madhit Zot. Allahu xh.sh. para 14 shekujsh dërgoi pejsamberin e Tij, të dërguarin e Tij të fundit, Muhamedin s.a.v.s., me fjalën e Tij finale, dërguar njerëzimit. Librat e mëhershëm nuk u ruajtën ashtu siç u shpallën.

---

<sup>328</sup> Dr. Murad Hofmann, *“Islami në mijëvjeçarin e tretë”*, Shkup, 2007, fq. 193.

<sup>329</sup> Ismail Raxhi El Faruki, *“Tevhidi, implikimet e tij për mendimin dhe jetën”*, Prishtinë, 2006, fq. 40.



Bibla e sotme është një përzjerje e gjurmëve të mbetura të fjalëve të Zotit, me fjalët e profetëve, të historianëve, të autorëve dhe të njerëzve të tjerë, ashtu që as autorët e librave nuk dihen saktësisht.

Feja islame, Kur'ani është ai që ringjalli dhe e përtëriu fenë e Isait a.s./ Jezusit dhe fenë e të gjithë të dërguarve të tjerë para tij. Pika kryesore me të cilën islami, apo Kur'ani, ka ardhur është sqarimi i konceptit të Zotit, që është edhe esenca e vërtetë e fesë. Koncepti i Zotit në krishterizëm ka arritur deri në atë shkallë sa Zoti të krahasohet me vetitë dhe cilësitë njerëzore, duke i bërë shok Zotit, duke i bërë ortak, duke e adhuruar dikë tjetër në vend të tij etj.

Kur'ani është një udhëzues që e ndan dritën nga errësirat dhe na tregon në mënyrë perfekte se çka mund të besohet e çka nuk mund të besohet nga Bibla.<sup>330</sup>

Fetë e pavërteta e kanë të përbashkët një koncept bazë lidhur me Zotin: ose pretendojnë se të gjithë njerëzit janë zota, ose se natyra është Zot, ose se Zoti

<sup>330</sup> Dallimi ndërmjet Kur'anit dhe Biblës qëndron në faktin se Kur'ani vazhdimisht e pohon burimin e tij hyjnor nga Zoti i botës. (Shih këto ajete: Ali Imran 164; Nisa 82; Nisa 105; Junus 57; Nahl 64; Fussilet 53; Ali Imran 3; Ibrahim 1) Feja islame është një fe që është e argumentuar me Kur'an, ashtu siç u argumentua që Kur'ani është burim hyjnor, nga Zoti i Plotfuqishëm, teksa që në Bibël nuk gjejmë ndonjë citat që e argumenton krishterizmin. Askund në Bibël nuk keni për të gjetur se Zoti i drejtohet popullit të Musait, ose pasardhësve të këtij populli, duke u thënë se feja e tyre quhet judaizëm, ose se u shpall pasuesve të Krishtit se feja e tyre quhet krishterizëm. Me fjalë të tjera, emrat judaizëm dhe krishterizëm nuk kanë pasur origjinë dhe miratim hyjnor. Vetëm shumë kohë pas largimit të Jezusit nga kjo botë, fesë së tij iu vu emri krishterim. Ndërsa për islamin, Kur'ani thotë: *"Feja e pranueshme tek Allahu është islami, e atyre që është dhënë libri, pasi mësuar për të vërtetën, vetëm nga zilia mes vete kundërshtuan. E kush i mohon argumentet e Allahut, le ta dijë se Allahu shpejt do t'ia japë llogarinë"*. (Ali Imran 19) *"E, kush kërkon fe tjetër, përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit"*. (Ali Imran 85)

Me rastin e haxhit lamtumirës, në të cilin Pejgamberi s.a.v.s. e ka mbajtur fjalimin e fundit, dhe mbasi e mbajti fjalimin e tij para masës, po në atë ditë, Zoti xh.sh. shpalli ajetin e Kur'anit: *"Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjedha për ju islamin fe"*. (El Maide 3) Këto citate të lartpërmendura tregojnë se Kur'ani përmban pohimin për vulën e autorësisë së Allahut xh.sh., dhe se feja islame është feja së cilës duhet t'i bashkohemi. Po ashtu Zoti, jo vetëm që e shpalli Kur'anin, por edhe duke qenë se ai duhej të mbetej si mesazh njerëzimit deri në fundin e botës, ai duhej të ruhej ashtu siç është shpallur, edhe premtimi i Zotit për ruajtjen e Kur'anit është i mrekullueshëm, me ç'rast thotë: *"Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithësesi jemi mbrojtës të tij"*. (El Hixhr 9)

është një pjellë e imagjinatës së njeriut. Pra, mund të thuhet se mesazhi bazë i feve të pavërteta është se Zoti mund të adhurohet në formën e krijimit të Tij. Fetë që s'e thonë të vërtetën e ftojnë njeriun në adhurimin e krijimit duke e quajtur krijimin, ose disa aspekte të tij, Zot. P.sh., Pejgamberi Isai a.s./ Jezusi, i ftoi pasuesit e vet të adhuronin Zotin, por ata që pretendojnë të jenë pasues të tij sot i ftojnë njerëzit në adhurimin e Jezusit, duke pohuar se ai ishte Zot.<sup>331</sup>

Pra, Kur'ani erdhi që ta largojë njeriun nga adhurimet të ndryshme pagane, ta largojë nga rruga e shtrembër dhe ta udhëzojë në rrugën e drejtë, ashtu siç bënë edhe të dërguarit e Zotit xh.sh.

Orientalistja e famshme italiane, dr. Laura Veccia Vaglieri, në librin *"An Interpretation of Islam"*, thotë:

"Pejgamberi arab, me zërin që ka qenë i frymëzuar me lidhje të fortë me Krijuesin e Vet, ua ka predikuar monoteizmin më të pastër adhuruesve të fetishit dhe ithtarëve të krishterizmit e të judaizmit të prishur... Falë islamit, paganizmi, në të gjitha format e tij, qe mundur. Vizioni i kozmosit, ritualet religjioze dhe traditat e jetës shoqërore qenë liruara nga të gjitha lajthitjet, të cilat i patën degraduar, kurse mendimi njerëzor qe liruara nga paragjykimet. Njeriu, më në fund, qe bërë i vetëdijshëm për dinjitetin e tyre. I përulej vetëm Krijuesit dhe Sunduesit të mbarë njerëzisë..."<sup>332</sup>

Orientalisti francez, E. Demerngem, thotë:

"Mesihu a.s., në Kur'an, ka vend të ngritur. Lindja e tij nuk ishte e zakonshme, si e njerëzve të tjerë. Ai ishte i dërguari i Allahut, të cilit Zoti i foli me zë... Kur'ani e ka për qëllim krishterizmin e vërtetë kur thotë: Isa a. s., është rezultat i fjalës që Zoti ia përcolli Merjemes dhe ai është njeri. Kur'ani e lufton doktrinën e atyre që besojnë Isanë (Jezusin) për Zot... Ai nuk e lufton krishterizmin e vërtetë.

---

<sup>331</sup> Ebu Emine Bilal Filips, *"Feja e vërtetë e Zotit"*, Prishtinë, 2006, fq. 15-16.

<sup>332</sup> Ulfe Azizus Samed, *"Islami dhe krishterimi"*, fq. 52.

Prandaj, i krishteri duhet të jetë i kënaqur me sulmin që Kur'ani ia bën trinitetit".<sup>333</sup>

Napoleon Bonaparta thotë:

“Musai (Mojsiu), ia ka shpallur fenë e Zotit popullit të vet, Isai (Jezusi) botës romake, kurse Muhamedi a.s. tërë botës. Arabia ishte vend pagan. Gjashtë shekuj pas Isait, Muhamedi e njohu botën me besimin në Një Zot të Vetëm, që është Zoti i Ibrahimit, i Musait dhe i Isait. Arianët dhe sektarët e tjerë, e çoroditën botën me diskutime mbi trinitetin: Atin, të birin dhe shpirtin e shenjtë. Ndërkaq, Muhamedi shpalli se Zoti është Një, kurse triniteti imponon idenë e idhujtarisë”.<sup>334</sup>

Nuk do ta lëmë pa e përmendur edhe teologun e njohur, Hans Küng, profesor në Fakultetin e Teologjisë Katolike të Universitetit të Tubingas, nga 1960 deri më 1979, më pas drejtor i Institutit të Teologjisë Ekumenike në të njëjtin universitet, i cili pohon:

“Edhe muslimanët e mirinformuar, ashtu si edhe hebrejët, nuk kanë mundur deri tani ta kuptojnë idenë e trinitetit... Dallimet e krijuara nga doktrina e trinitetit midis një Perëndie dhe tri perëndive, nuk i kënaqin muslimanët, të cilët janë më shumë të paqartë sesa të sqaruar nga termat teologjike që vijnë prej sirianëve, grekëve dhe latinëve. Muslimanëve e gjitha kjo u ngjan me një lojë fjalësh... Përse duhet që dikush t'i shtojë diçka konceptit të identitetit dhe natyrës unike të Perëndisë, gjë e cila vetëm e zvogëlon ose e asgjëson këtë identitet dhe natyrë unike të tij”.<sup>335</sup>

Kur'ani Famëlartë e mohon rreptësisht doktrinën e trinitetit, hyjnizimin e Jezusit, mohon se Jezusi është Zot dhe që as nëna e tij Merjemja (Maria) të mos adhurohet siç bëjnë disa sekte krishtere. Kur'ani mohon po ashtu çdo fëmijë, bir që ia veshin Zotit xh.sh. etj. Allahu xh.sh. thotë:

<sup>333</sup> Ajni Sinani, “*Të tjerët për islam*”, Prishtinë, 2005, fq. 149.

<sup>334</sup> Po aty, fq. 127.

<sup>335</sup> “*Christianity and the World Religions*” by Hans Kung, 1986, (Doubleday & Co., Inc., Garden City, NY) fq. 113, sipas [www.bibladhekur'ani.com](http://www.bibladhekur'ani.com), “*Triniteti i pakuptueshëm*” nga Rrezart Beka.

لَقَدْ كَفَرَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ ثَالِثُ ثَلَاثَةٍ وَمَا مِنْ إِلَهٍ إِلَّا إِلَهُ وَاحِدٌ وَإِنْ لَمْ  
يَنْتَهُوا عَمَّا يَقُولُونَ لَيَمَسَّنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٧٥﴾

“Pa dyshim, janë jobesimtarë ata që thonë: “Allahu është njëri prej trinisë!” Nuk ka veçse një Zot të Vetëm të vërtetë! Nëse nuk heqin dorë nga ato që thonë, patjetër që jobesimtarët nga mesi i tyre do t’i godasë një dënim i dhembshëm”. (El Maide 73)

مَا الْمَسِيحُ ابْنُ مَرْيَمَ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِ الرُّسُلُ وَأُمُّهُ صِدِّيقَةٌ كَانَا  
يَأْكُلَانِ الطَّعَامَ أَنْظِرْ كَيْفَ نَبِيٍّ لَهُمُ الْآيَاتِ ثُمَّ أَنْظِرْ أَنِّي يُؤْفَكُونَ ﴿٧٦﴾  
قُلْ أَنْتَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَمْلِكُ لَكُمْ ضَرًّا وَلَا نَفْعًا وَاللَّهُ هُوَ السَّمِيعُ  
الْعَلِيمُ

“Mesihu, i biri i Merjemes, është vetëm një i dërguar. Edhe para tij kanë kaluar të dërguar. Nëna e tij përherë ka qenë e drejtë. Që të dy hanin ushqim. Shih si ua shpjegojmë atyre shpalljet tona dhe shih si largohen nga e Vërteta! Thuaju (o Muhammed): “Si mundet vallë, që ju adhuronit në vend të Allahut, atë që nuk është në gjendje t’ju sjellë as dëm e as dobi, ndërkohë që Allahu dëgjon dhe di çdo gjë?!”. (El Maide 75-76)

وَإِذْ قَالَ اللَّهُ يَعْيسَى ابْنُ مَرْيَمَ ءَأَنْتَ قُلْتَ لِلنَّاسِ اتَّخِذُونِي وَأُمَّيَ إِلَهَيْنِ مِنْ دُونِ اللَّهِ قَالَ  
سُبْحَانَكَ مَا يَكُونُ لِي أَنْ أَقُولَ مَا لَيْسَ لِي بِحَقِّ إِنْ كُنْتُ قُلْتُهُ فَقَدْ عَلِمْتَهُ تَعَلَّمَ مَا  
فِي نَفْسِي وَلَا أَعْلَمُ مَا فِي نَفْسِكَ إِنَّكَ أَنْتَ عَلَّمُ الْغُيُوبِ ﴿٧٧﴾ مَا قُلْتُ هُمْ إِلَّا مَا  
أَمَرْتَنِي بِهِ أَنْ أَعْبُدُوا اللَّهَ رَبِّي وَرَبَّكُمْ وَكُنْتُ عَلَيْهِمْ شَهِدًا مَا دُمْتُ فِيهِمْ فَلَمَّا تَوَفَّيْتَنِي  
كُنْتُ أَنْتَ الرَّقِيبَ عَلَيْهِمْ وَأَنْتَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ شَهِدٌ ﴿٧٨﴾

“Pastaj Allahu do të thotë (në Ditën e Gjykimit): “O Isa, i biri i Merjemes, ti ishe ai që u tha njerëzve: “Adhromëni mua dhe nënën time si zota krahas Allahut?! Isai do të thotë: “Qofsh i lartësuar dhe i lavdëruar! Mua nuk më takon të them diçka për të cilën nuk kam aspak të drejtë! Po ta kisha thënë ndonjëherë, Ti me siguri do ta dije. Ti e di çfarë ka në shpirtin tim, po unë nuk e di çfarë ka në Vetën Tënde. Vetëm

*Ti i di të gjitha të fshehtat. Unë nuk u kam thënë asgjë tjetër, përveç asaj që më ke urdhëruar Ti: “Adhurojeni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj!” Kam qenë dëshmitar, për sa kohë kam jetuar midis tyre dhe, qëkurse më more mua, vetëm Ti ishe mbikëqyrës i tyre. Ti je Dëshmitar për çdo gjë”.* (El Maide 116-117)

Gjithashtu në ajetin vijues Allahu xh.sh. iu drejtohet ithtarëve të librit, hebrejve dhe të krishterëve nëpërmjet të dërguarit të Tij të fundit, Muhamedit s.a.v.s. me fjalët:

يَا أَهْلَ الْكِتَابِ لَا تَغْلُوا فِي دِينِكُمْ وَلَا تَقُولُوا عَلَى اللَّهِ إِلَّا الْحَقَّ إِنَّمَا الْمَسِيحُ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ رَسُولُ اللَّهِ وَكَلِمَتُهُ أَلْقَنَهَا إِلَى مَرْيَمَ وَرُوحٌ مِنْهُ فَآمَنُوا بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ وَلَا تَقُولُوا ثَلَاثَةٌ انْتَهُوا خَيْرًا لَكُمْ إِنَّمَا اللَّهُ إِلَهٌ وَاحِدٌ سُبْحَانَهُ أَنْ يَكُونَ لَهُ وَلَدٌ لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ وَكَفَى بِاللَّهِ وَكِيلًا ﴿١٠٧﴾

*“O ithtarët e librit, mos teproni në fenë tuaj dhe mos thoni tjetër gjë për Allahun, përveç asaj që është e vërtetë. Mesihu, Isa, i biri i Merjemes, ishte vetëm i dërguar i Allahut. Ishte fjalë e Tij (bëhu) që ia drejtoi Merjemes dhe ishte frymë (shpirt) nga Ai. Besojini, pra, Allahun dhe të dërguarin e Tij e mos thoni: “Tre” (trini). Pushoni (së thëni), se është më mirë për ju. Allahu është vetëm një Allah; larg qofitë asaj që Ai të ketë fëmijë. Çfarë ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij. Mjafton që Allahu është planifikues i pavarur”.* (En Nisa 171)

Siç e kemi cekur më parë, triniteti nuk është asgjë më shumë se influencë e religjioneve pagane në krishterizëm, është një imitim i thënieve të jobesimtarëve të mëhershëm. Këtë më së miri e vërteton edhe vet Allahu xh.sh. në Kur’anin Famëlartë, ku thotë:

وَقَالَتِ الْيَهُودُ عِزَّىٰرُ بْنُ اللَّهِ وَقَالَتِ النَّصْرَى الْمَسِيحُ ابْنُ اللَّهِ ذَلِكَ قَوْلُهُمْ بِأَفْوَاهِهِمْ يُضَاهِعُونَ قَوْلَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ قَبْلُ قَاتَلَهُمُ اللَّهُ أَنَّى يُؤْفَكُونَ ﴿١٠٧﴾

*“Hebrenjtë thonë: “Uzejri është i biri i Allahut”; të krishterët thonë: “Mesihu është i biri i Allahut”. Këto janë fjalët e tyre, nga goja e tyre, i imitojnë fjalët e jobesimtarëve të mëparshëm. I vraftë Allahu! Si po shmangen (nga e vërteta)!”.* (Tevbe 30)

Po ashtu Kur’ani i thërret të krishterët dhe hebrenjtë që të besojnë në një Zot dhe ta adhurojnë vetëm atë:

قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ تَعَالَوْا إِلَى كَلِمَةٍ سَوَاءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا اللَّهَ وَلَا نُشْرِكَ بِهِ شَيْئًا وَلَا يَتَّخِذَ بَعْضُنَا بَعْضًا أَرْبَابًا مِنْ دُونِ اللَّهِ فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقُولُوا اشْهَدُوا بِأَنَّا مُسْلِمُونَ ﴿٦٤﴾

“Thua: “O ihtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t’i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!!”. (Ali Imran 64)

يَا أَهْلَ الْكِتَابِ قَدْ جَاءَكُمْ رَسُولُنَا يُبَيِّنُ لَكُمْ كَثِيرًا مِمَّا كُنْتُمْ تُخْفُونَ مِنَ الْكِتَابِ وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ قَدْ جَاءَكُمْ مِنَ اللَّهِ نُورٌ وَكِتَابٌ مُبِينٌ ﴿٦٥﴾  
يَهْدِي بِهِ اللَّهُ مَنِ اتَّبَعَ رِضْوَانَهُ سُبُلَ السَّلَامِ وَيُخْرِجُهُم مِّنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِهِ وَيَهْدِيهِمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿٦٦﴾

“O ihtarë të librit, juve ju erdhi i dërguari Ynë që ju sqaron shumë nga ajo që fshihnit prej librit, e për shumë nuk jep sqarime. Juve ju erdhi nga Allahu dritë dhe libër i qartë. Allahu e vë me atë (me Kur’anin) në rrugët e shpëtimit atë që ndjek kënaqësinë e tij dhe me ndihmën e Tij i nxjerr ata prej errësirave në dritë dhe i udhëzon në një rrugë që është e drejtë”. (El Maide 15-16)

لَقَدْ كَفَرَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ هُوَ الْمَسِيحُ ابْنُ مَرْيَمَ قُلْ فَمَنْ يَمْلِكُ مِنَ اللَّهِ شَيْئًا إِنْ أَرَادَ أَنْ يُهْلِكَ الْمَسِيحُ ابْنُ مَرْيَمَ وَأُمَّهُ وَمَنْ فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا وَلِلَّهِ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا تَخْلُقُ مَا يَشَاءُ وَاللَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٦٧﴾

“E mohuan (e bënë kufër) të vërtetën ata që thanë: “Zot është ai, Mesihu, i biri i Merjemes” Thuaju: “Nëse dëshiron Allahu ta shkatërrojë Mesihun, të birin e Merjemes, nënën e tij dhe gjithë çfarë ka në tokë, kush mund ta pengojë atë?” Vetëm Atij i takon pushteti i qiejve, i tokës dhe çfarë ka në mes tyre. Ai krijon çdo gjë që dëshiron. Allahu është i Gjithëfuqishëm për çdo gjë”. (El Maide 17)

Kur’ani i thërret njerëzit që të besojnë se Zoti është Një i vetëm, nuk lind dhe nuk është i lindur. Është Një dhe i pashoq, etj. Allahu në Kur’an thotë:

وَقَالَتِ الْيَهُودُ وَالنَّصْرَىٰ نَحْنُ أَبْنَاءُ اللَّهِ وَأَحِبُّهُرُ ۗ قُلْ فَلِمَ يُعَذِّبُكُمْ بِذُنُوبِكُمْ بَلْ أَنْتُمْ  
بَشَرٌ مِّمَّنْ خَلَقَ ۗ يَغْفِرُ لِمَن يَشَاءُ وَيُعَذِّبُ مَن يَشَاءُ ۗ وَلِلَّهِ مُلْكُ السَّمٰوٰتِ وَالْأَرْضِ وَمَا  
بَيْنَهُمَا وَإِلَيْهِ الْمَصِيرُ ﴿١٨﴾

“Hebrenjtë dhe të krishterët thanë: “Ne jemi bijtë e Allahut dhe të dashurit e Tij”. Thuaju: “Atëherë, përse Ai ju dënon për shkak të gjynaheve tuaja?” Jo, ju jeni njerëz që Ai ju krijoi. Ai fal kë të dojë dhe dënon kë të dojë. Sundimi i qiejve, i tokës dhe i gjithë asaj që gjendet mes tyre është vetëm e Allahut dhe vetëm tek Ai është e ardhmja”. (El Maide 18)

وَقَالَ اللَّهُ لَا تَتَّخِذُوا إِلٰهَيْنِ اثْنَيْنِ ۚ إِنَّمَا هُوَ إِلٰهٌ وَاحِدٌ ۚ فَإِنِّي فَأَرْهَبُونَ ﴿٥١﴾

“E, Allahu tha: “Mos adhuroni dy të adhuruar, sepse Ai është vetëm një Zot, pra vetëm Mua ma kini drojën”. (Nahl 51)

هُوَ الْأَوَّلُ وَالْآخِرُ وَالظَّاهِرُ وَالْبَاطِنُ ۗ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿٣﴾

“Ai është i pari që s’ka fillim dhe i fundit që s’ka mbarim, i dukshmi dhe i padukshmi, dhe Ai është më i Dijskmi për çdo gjë”. (Hadid 3)

فَاطِرُ السَّمٰوٰتِ وَالْأَرْضِ ۗ جَعَلَ لَكُم مِّنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا وَمِنَ الْأَنْعَامِ أَزْوَاجًا  
يَذَرُوكُمْ فِيهِ لِيَسَّ كَمَثَلِهِ شَيْءٌ ۗ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿١١﴾

“Ai është krijues i qiejve dhe i tokës. Ai nga lloji juaj krijoi për ju bashkëshorte, edhe nga kafshët krijoi çifte, ashtu që t’ju shumojë. Asnjë send nuk është si Ai; Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha”. (Shura 11)

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ﴿١﴾ اللَّهُ الصَّمَدُ ﴿٢﴾ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ ﴿٣﴾ وَلَمْ يَكُن لَّهُ كُفُوًا أَحَدٌ ﴿٤﴾

“Thuaj: Ai, Allahu është Një! Allahu është Ai të cilit i drejtohet (i mbështetet) çdo krijesë për çdo nevojë. As s’ka lindur kë, as është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë”. (El Ihlas 1-4)

Prof. Abdul Ahad Dawud (ish-kryepeshkopi David Benjamin Keldani) thekson: Formula e doktrinës së krishterë: “Në emër të Atit, të birit dhe të shpirtit të shenjtë” as që e përmend emrin e Zotit. Allahu s’është atë i birit, as bir i atit. Ai s’ka nënë (nuk ka lindur). Besimi në “zotin Atë, e në zotin djalë, dhe në zotin

shpirt i shenjtë” është mohim flagrant i njësisë së Zotit... i bazuar në tri qenie të papërsosura, të cilat qoftë bashkërisht, ose të ndara veç e veç, nuk mund të jenë Zot i vërtetë.<sup>336</sup> Matematika si shkencë ekzakte na mëson se njësia nuk është as më shumë, e as më pak se një: se një kurrë nuk është e barabartë me një plus një plus një. Me fjalë të tjera, një nuk mund të jetë e barabartë me tre dhe anasjelltas. Konstatimi juaj që  $1+1+1=1$  nuk është matematikor, por një konstatim absurd!<sup>337</sup>

Në një letër<sup>338</sup>, të shkruar nga Leon Nikollaeviq Tolstoj<sup>339</sup>, më 15 mars të vitit 1909, mes tjerash, thuhet: “... unë doemos duhet të them se nuk kam kurrfarë dyshimi në atë se, sipas reflektimit të tij të veçantë të jashtëm, islami është në nivelin më të lartë e të pakrahasueshëm ndaj kishës krishtere. Po qe se flitej për përparësinë ndërmjet kishës krishtere dhe fesë islame, çdo njeri i mençur - në vend të trinisë së pakuptueshme “hyjnore”, kremteve për faljen e mëkateve, ritualet (e komplikuar) fetare, lutja drejtuar nënës së Jezusit, lutjet e panumërta drejtuar shenjtorëve dhe fotografive të tyre - pa kurrfarë dyshimi, fenë islame do ta

<sup>336</sup> Abdul Ahad Dawud, “*Muhamedi në Bibël*”, fq. 23-24.

<sup>337</sup> Po aty, fq. 24-25.

<sup>338</sup> Kjo letër ka të bëjë me Jelena Vekilovën, e cila shprehte shqetësimin për fëmijët e saj lidhur me atë se cilës fe duhet t'i shërbejnë (fëmijët e saj kërkonin leje nga nëna që të kalojnë në fenë e babait të tyre, pasi që babai i tyre ishte musliman, ndërsa nëna e tyre ishte e krishtere). Jelena Vekilova, më 2 mars 1909, ia dërgon një letër Leon Tolstoj, duke e konsideruar se, përveç shkrimtarit inteligjent Tolstoj, askush tjetër nuk mund të ofronte përgjigje korrekte dhe vendimtare për këtë çështje mjaft serioze familjare. Ndërsa pyetjes së shtruar, Tolstoj i përgjigjet më 15 mars 1909. Letra origjinale, të cilën Leon Tolstoj ia dërgoi Jelena Velikovës, sot gjendet në muzeun e Leon Tolstoj në Moskë, ku e kishte dërguar në vitin 1978 i biri i Jelenës, Farisi (Borisi). Letrat edhe sot e kësaj dite janë të ekspozuara në këtë muze. Më tepër lidhur me këto të dhëna dhe me letrat e bashkëbiseduesve më gjerësisht: Leon Nikollaeviq Tolstoj, “*Tolstoj për Muhamedin (salallahu alejhi ves-sel-lem)*”, Shkup 2006, fq. 82-91.

<sup>339</sup> Leon Nikollaeviq Tolstoj është lindur në vitin 1828 në Jasna Pojana (Rusi). Me profesion ishte romanier, poet, novelist, kritik. Veprat e Tolstoj kishin ndikim të madh në mbarë letërsinë evropiane. Tolstoj ishte dhe është dukuri e jashtëzakonshme në letërsinë evropiane dhe atë botërore. Ndër veprat e tij të famshme veçojmë: *Lufta dhe paqja* (1864-1869); *Ana Karenina* (1873-1877); *Ringjallja* (1889-1899); *Poli-kushka*; *Haxhi Murati* etj., kurse ato janë përkthyer në njëqindetë gjuhë të ndryshme botërore dhe janë botuar në më shumë se 220 milionë ekzemplarë. (Biografi e marrë nga libri “*Tolstoj për Muhamedin (salallahu alejhi ves-sel-lem)*”)



konsideronte më të lartësuar, si fe që thërret në besim në Një Zot, ku Muhamedi (a.s.) është rob dhe i Dërguar i Tij. E kjo nuk mund të jetë ndryshe”.<sup>340</sup>

Në *Sahihun* e Buhariut është vërtetuar se i Dërguari i Allahut ka thënë:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَرَأَيْتُمْ قَالَ اللَّهُ تَعَالَى  
يَسْتَمِينِي ابْنُ أَدَمَ وَمَا يَبْغِي لَهُ أَنْ يَسْتَمِينِي وَيُكَلِّبَنِي وَمَا يَبْغِي لَهُ أَمَّا سَمِعْتُمْ فَقَوْلُهُ إِنَّ لِي  
وَلَدًا وَأَمَّا تَكْنِيهِ فَقَوْلُهُ لَيْسَ يُعِينَنِي كَمَا بَدَأَنِي.

Transmeton Ebu Hurejra r.a., i cili pohon se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“E shoh se Allahu xh.sh. ka thënë: Njeriu po më shan, edhe pse nuk ka të drejtë ta bëjë këtë. Njeriu po më përgënjeshton, edhe pse nuk ka të drejtë ta bëjë këtë. E sharja e tij ndaj Meje është pohimi se kam fëmijë, kurse përgënjeshtrimi i tij është pohimi se nuk më rikthen (në gjendje) siç më ka krijuar (për herë të parë)”.<sup>341</sup>

Gjithashtu në *sahihun* e Muslimit transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë:

عَنْ أَبِي مُوسَى قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ لَا أَحَدٌ أَصْبِرُ عَلَى أَدَى يَسْمَعُهُ  
مِنَ اللَّهِ عَزَّ وَجَلَّ إِنَّهُ يُشْرِكُ بِهِ وَيَجْعَلُ لَهُ الْوَلَدُ ثُمَّ هُوَ يُعَاقِبُهُمْ وَيَرزُقُهُمْ.

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

“Askush nuk është më i durueshëm ndaj ofendimit që e dëgjon më shumë se Allahu i Lartëmadhëruar, Atij i (bëhet politeizëm) përshkruajnë shok, dhe fëmijë, megjithatë Ai i u jep shëndet dhe furnizim”.<sup>342</sup>

Kurse Allahu xh.sh. në Kur’an i drejtohet Muhamedit s.a.v.s., që t’u thotë atyre që trillojnë:

<sup>340</sup> Leon Nikollaeviq Tolstoi, “*Tolstoi për Muhamedin (salallahu alejhi ves-sel-lem)*”, Shkup, 2006, fq. 87.

<sup>341</sup> Buhariu në *Sahih*, kitab: bed’ul halk, babu: ma xhae fi kavli-lahi vehuve jebde’ul halk. nr. i had. 2954. (Enciklopedia elektronike në CD e nëntë koleksioneve të haditheve, versioni II.) Ndërsa te libri i Ibën Kethirit kemi këtë hadith, ku tregohet se si Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Allahu i Lartëmadhëruar thotë: “Njeriu po më ofendon, edhe pse nuk ka të drejtë ta bëjë këtë. Pohon se kam fëmijë, e Unë nuk kam, meqë jam Një i Vetmi. Nuk kam lindur, e as që jam i lindur dhe askush nuk është i barabartë me Mua”. (Buhariu në *Sahihun* e tij, 59/1/3193- Fet’hul Bari; Nesaiu në *Es-Sunenul Kubra*, 21/118, sipas Hafidh Ibën Kethir, “*Rrejtme për të dërguarit e Allahut*”, Prishtinë, 2005, fq. 626.)

<sup>342</sup> Muslimi në *Sahih*, kitab: sifetul kijameti, vel xhenneti ven-nar, babu: la ehadun esbere minell-Llah ala edhen. nr. i had.5016. (Enciklopedia elektronike në CD e nëntë koleksioneve të haditheve, versioni II.)

قُلْ إِنِّ الَّذِينَ يَفْتُرُونَ عَلَى اللَّهِ الْكَذِبَ لَا يُفْلِحُونَ ﴿٦٩﴾ مَتَّعٌ فِي الدُّنْيَا ثُمَّ إِلَيْنَا مَرْجِعُهُمْ ثُمَّ نُنذِقُهُمُ الْعَذَابَ الشَّدِيدَ بِمَا كَانُوا يَكْفُرُونَ ﴿٧٠﴾

“Thuaaj: “Sigurisht, atyre që shpifin gënjeshtira për Allahun, nuk do t’u ecë mbarë”. Ata do të kenë kënaqësi të shkurtër në këtë botë e pastaj do të kthehen te Ne dhe Ne do t’ua japim ta shijojnë dënimin e ashpër për shkak se nuk besuan”. (Junus 69-70)

فَمَهْلَ الْكَافِرِينَ أَمَّهُمْ رُؤُودًا ﴿١٧﴾

“E ti jobesimtarëve jepu afat, afatizoji ata pak”. (Tarik 17)

Këta kapituj po i përfundoj me këto ajete famëlarta, në të cilat Allahu xh.sh. thotë:

يَا هَلْ أَلِكْتَبِ لِمَ تَكْفُرُونَ بِآيَاتِ اللَّهِ وَأَنْتُمْ تَشْهَدُونَ ﴿٧٠﴾ يَا هَلْ أَلِكْتَبِ لِمَ تَلْبِسُونَ الْحَقَّ بِالْبَاطِلِ وَتَكْتُمُونَ الْحَقَّ وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٧١﴾

“O ithtarë të librit, përse nuk i besoni ajetet (Kur’anin) e Allahut, e duke e ditur të vërtetën? O ithtarët e librit, përse, duke qenë se ju e dini të vërtetën, e ngatëroni me gënjeshtërën dhe e fshihni realitetin?”. (Ali Imran 70-71)

وَقَالَ اللَّهُ لَا تَتَّخِذُوا إِلَهَيْنِ اثْنَيْنِ إِنَّمَا هُوَ إِلَهُ وَاحِدٌ فَإِنِّي فَارَهُبُونَ ﴿٥١﴾

“E, Allahu tha: “Mos adhuronit dy të adhuruar, sepse Ai është vetëm një Zot, pra vetëm Mua ma kini drojën”. (En Nahl 51)

أَيُّكُمْ لَتَشْهَدُونَ أَنَّ مَعَ اللَّهِ إِلَهَةً أُخْرَىٰ قُلْ لَا أَشْهَدُ قُلْ إِنَّمَا هُوَ إِلَهُ وَاحِدٌ وَإِنِّي بَرِيءٌ مِّمَّا تُشْرِكُونَ ﴿١٩﴾

“Ju po dëshmoni se pos Allahut ka edhe zota të tjerë, a?” Thuaaj: “Unë nuk dëshmoj.” Ai është vetëm një Zot dhe unë jam i pastër nga ajo që ju i shoqëroni!” (El-Enam 19)

لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ قَدْ تَبَيَّنَ الرُّشْدُ مِنَ الْغَيِّ ﴿٢٥٦﴾

“Nuk ka detyrim në fe, rruga e drejtë është dalluar shumë qartë nga ajo e padrejtë”. (Bekare 256)

## Përfundim

Gjatë këtij studimi, që trajton çështjen e doktrinës së trinitetit, u zbuluan u vunë në pah tekstet biblike dhe ato kur'anore lidhur me këtë doktrinë dhe mohimin e saj. Kemi parë, gjithashtu, edhe influencën e madhe të doktrinave pagane dhe të shkriera në të ashtuquajturin krishterizëm.

Zhvillimi i besimit mbi trininë u ndikua nga shumë faktorë. Pikësëpari, realitetet pagane ishin gjigante në shekujt e parë të krishterizmit. Trualli ku u gdhendën doktrinat e krishterizmit ishte nga të gjitha anët një arenë e fuqishme e veprimeve dhe besëtytnive idhujtare. Janë shumë mirë të njohura trinitë e besimeve të vjetra pagane dhe ndikimi i tyre gjatë formimit të doktrinave të krishterizmit ishte i pashmangshëm. Po ashtu të mos harrojmë se Aleksandria e Egjiptit ishte një ndër vatrat kryesore ku formësohej doktrina e krishtere. Gjithashtu, besime pagane mbi hyjni trepjesëshe ishin të njohura edhe për romakët dhe babilonasit. Edhe filozofët grekë kishin zhvilluar ide mistike mbi trininë.

Kemi mësuar se si kjo doktrinë është zyrtarizuar nga kisha në shekullin IV, e posaçërisht nën kërcënimin e Konstantinit të Madh, i cili e imponoi mendimin e tij në koncil dhe e futi praktikën pagane për hir të mbrojtjes së fronit. Gjithashtu, është parë se kjo doktrinë nuk ka qenë prej mësimave të Jezusit dhe as prej dishepujve të tij.

Doktrina e trinitetit nuk përputhet me logjikën njerëzore, as është në harmoni me mësimet e Jezusit, ngase ai nuk ka urdhëruar që të besojmë në këtë doktrinë. Këto doktrina janë krijuar shumë kohë pas Jezusit si rezultat i ndikimit nga ana e besimeve pagane. Këto dogma njëherësh tregojnë se gjatë kohës Bibla ka pësuar shumë ndryshime dhe se krishterizmi është larguar mjaft nga mësimi i besimit i pastër në një Zot, siç na ka mësuar Jezusi.

Krahas këtyre zhvillimeve politike dhe teologjike në dëm të besimit të pastër monoteist, një ndikim të madh në zhvillimin e trinisë e kishte edhe mosekzistimi i një forme të pandryshuar të shkrimeve të shenjta. Ungjijtë dhe shkrimet e tjera, të cilat më vonë do të cilësoheshin si kanon i Biblës, kaluan nëpër disa ndryshime derisa morën formën që e kanë sot. Gjetja e manuskripteve të shekujve të hershëm të krishterizmit, na e bën të ditur në mënyrën më të mrekullueshme se si ndikimet teologjike të kishave të ndryshme vepronin direkt në ndryshimin e Biblës, me qëllim të vendosjes së dogmave të ndryshme, të cilat Jezusi kurrë nuk i kishte predikuar.

Në Bibël ekzistojnë shumë kundërthënie, gabime, shtesa, e gjëra të ndryshme, të cilat, lexuesin, në një mënyrë, e bëjnë për të mos besuar se Bibla është fjalë e Perëndisë. Kjo e vë në dilemë serioze pohimin që na është thënë se Bibla është e padiskutueshme dhe e pandryshueshme, fjalë e Perëndisë. Këtë gjë e vërtetojnë argumentet e sjella në këtë punim.

Ky edhe ishte njëri nga qëllimet kryesore të dërgimit të Pejgamberit të fundit, Muhamedit s.a.v.s., nga ana e Allahut xh.sh. në mënyrë që të rivendosej edhe një herë dhe përfundimisht besimi i pastër në një Zot të Vetëm, ashtu që, si i tillë, të mos ndikohej më nga besime pagane. Që të ndahet e vërteta nga e pavërteta. Kjo u arrit nëpërmjet ruajtjes së Kur'anit, Shpalljes së Fundit dhënë njerëzimit nga Zoti i Plotfuqishëm. Monoteizmi i pastër, ashtu siç është shpallur dhe ruajtur në Kur'an, nuk lë vend më për asnjë mëdyshje lidhur me natyrën e Perëndisë.

Të vërtetën e kësaj doktrine ka mundësi ta shohë çdo njeri me mendje të shëndoshë, duke iu larguar të pavërtetës. Sepse rruga e drejtë që duhet të ndjekim është shumë e qartë nga ajo e padrejta, siç e përmend edhe Allahu xh.sh. në Kur'anin Famëlartë:

لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ قَدْ تَبَيَّنَ الرُّشْدُ مِنَ الْغَيِّ ۗ

*“Nuk ka detyrim në fe, rruga e drejtë është dalluar shumë qartë nga ajo e padrejtë”* (Bekare 256)

Ndërsa palës tjetër i them:

*“A thua u bëra armiku i juaj, duke jua thënë të vërtetën?” (Galatasve 4: 16)*

Jam i vetëdijshëm për mangësitë që mund t'i ketë punimi, sepse është një temë e gjerë dhe për ta realizuar duhen shumë njohuri dhe punë, ndaj nuk pretendoj që ky punim përbën fjalën e fundit, pasi që të flitet për këtë doktrinë mbeten edhe shumë gjëra të tjera për t'u thënë. Jam munduar që në pika të shkurtra të paraqes argumente dhe ta elaboroj këtë doktrinë. Mund të themi se ky punim do të shërbejë si një shtytje për hulumtime të mëtutjeshme që të pasurohet literatura islame në gjuhën shqipe lidhur me këtë problematikë të mprehtë.

Kërkesa jonë e fundit është:

“ Gjithë falënderimet dhe lavdërimet qofshin për Allahun, zotin e botëve!”.  
Amin.



# Trojstvo - Vjekovna Misterija Hrišćanstva

## Sadržaj i zaključci ove knjige na bosanskom jeziku

### Sadržaj

*“U ime Oca i Sina i svetoga Duha”*, je dogma koju hrišćanstvo nudi hovječanstvu. Ovo je suština i temelj hrišćanstva. Ako ne vjeruješ i nisi kršten po ovoj formuli, nisi hrišćanin. Ova doktrina je jedna od najvažnijih učenja crkve. To je kamen temeljac hrišćanske vjere. Dakle, doktrina trojstva uči nas da postoji jedan Bog u tri lica, svaki od njih je Božanstvo, bez početka, svemogućće, ni veće ni manje od ostalih. Ova formula je uvijek zbunjivala čitaoce, bili hrišćani ili ne, koji su se u konfuiziji pitali: Kako je moguće da je Otac Bog, Sin Bog I Sveti duh Bog, ako nemamo tri Boga, već samo jedan?

Učenjaci biblijske teologije su se trudili kroz vjekove da daju zadovoljavajući odgovor na ovo pitanje i mnoga slična pitanja, koja ukazuju na nelogičnost ovakve doktrine. Međutim, svaki pokušaj je rezultirao sa još više zbunjenosti i konfuizije.

Da bi izašli na kraj sa problematičnošću u vezi sa ovom doktrinom, hrišćanski teolozi su proglasili Doktrinu Trojstva “misterijom”. Kardinal Džon O’Kander kaže: “Znamo da je ovo jedna duboka misterija, koju ne možemo razumjeti”.

Proglašenje ove doktrine misterijom, kao i nemogućnost da se ona shvati, dovele su do toga da u modernim vremenima Doktrina Trojstva postaje sve manje značajna u svakodnevnom životu jednog prosječnog hrišćanina. Danas, poznati teolozi, istoričari dogme tvrde da je Trojstvo izgubilo poziciju centralne doktrine Hrišćanstva.

Postavlja se pitanje: Da li je čovječanstvo ikada shvatilo Trojstvo tokom ovih 2.000 godina? Upravo zbog paradoksa koji ova doktrina predstavlja u knjizi *“The Promise of the Trinity”*, Gunton kaže: “Na zapadu, Doktrina Trojstva se posmatra sa sve više kritičnosti... Dugo vremena ona se tretirala kao problem a ne kao jezgro hrišćanskog Jevanđelja”. Upravo zbog ovoga će Papi Jovanu Pavlu II-om ova doktrina i danas predstavljati jednu “nerazrješenu misteriju božanskog trojstva”. Riječi Pape Jovana Pavla II-og su dovoljne da se dokaže neodrživost ove hipoteze.

Zbog značaja ove doktrine po hrišćanstvo, da bih se trudio da shvatim, a kasnije da bih objasnio čitaocima Doktrinu Trojstva, odlučio sam se da je proučavam, ističući istinu, koju ćemo uvidjeti u toku razrađivanja teme, oslanjajući se na Kur’an, Bibliju, zdrav razum i kritičku logiku, koja je mjerilo cijelog čovječanstva.

Ovaj rad je podjeljen na tri poglavlja.

*Glava prva*, koju sam naslovio “ISTORIJA TROJSTVA”, sadrži razmatranje Doktrine Trojstva u drugim vjeroispovjestima, njena istorija kao doktrina i Doktrinu Trojstva po vjerovanju hrišćana.

## Glava I

### Istorija Trojstva

#### Doktrina Trojstva kod drugih religija

Vavilonsko Trojstvo

Egipatsko Trojstvo

Grčko – Rimsko Trojstvo

Hindu – Indijsko Trojstvo

Palmirsko Trojstvo

Trojstvo u religiji Sumera

Trojstvo u Hititskoj religiji i dr.

#### Doktrina Trojstva kod hrišćana



Istorija Doktrine trojstva u Hrišćanstvu

Pavle – Arhitakta Hrišćanstva

Istorija Trojstva na Nikejskom Koncilu

Razvoj Trojstva na ostalim koncilima, naročito onog u Konstantinopolju (381.g.)

Smatranje Merjeme/Marije „Majkom Božijom”

U nastavku, u *poglavlju dva* koje sam naslovio “BIBLIJSKO I KURANSKO GLEDIŠTE NA DOKTRINU TROJSTVA”, gdje sam govorio o Biblijskom i Kuranskom gledištu na ovu doktrinu, naglašavajući imena koja sadrži ova doktrina, a to su: Otac, Sin i Sveti duh, elaborirajući svaki od njih na poseban način prema Biblijskim citatima i Kuranskim ajetima.

Poglavlje II

Biblijsko i Kuransko gledište na doktrinu trojstva

1. Koncept Boga u Bibliji i u Kuranu

1.1. Jednoća i osobine Boga u Bibliji i u Kuranu

1.1. Razlike između Biblije i Kurana u vezi sa osobinama Boga

2. Tretiranje Isusa/Isaa a.s. u Bibliji i u Kuranu

2.1. Poštovanje Mejreme(Marije)

2.2. Ljudskost Isusa

2.3. Da li je Isus sin Božiji?

2.4. Da li je Isus Bog?

2.5. Razlike između Isusa i Boga

2.6. Isus prorok (pejgamber) i Božji poslanik

2.7. Isus poslanik samo jednog naroda

2.8. Isusovo čudotvorstvo

2.9. Isaova predskazanja o Muhamedovom (s.a.v.s.) dolasku

2.10. Isa nije razapet

### 3. Odnos Biblije i Kurana prema Svetome Duhu

- 3.1. Koncept Svetoga Duha u Bibliji
- 3.2. Sveti Duh među Pravoslavnim i Katolicima
- 3.3. Jevrejsko gledište o Svetome Duhu
- 3.4. Koncept Svetoga Duha u Kuranu
- 3.5. Razlike između Oca, Sina i Svetoga Duha

Dok u posljednjem *trećem poglavlju* ovog rada koji sam naslovio “TROJSTVO I NJEGOVA ISTINITOST”, analizirao sam citate koji po hrišćanima argumentuju ovu doktrinu. Zatim sam govorio o mišljenjima poznatih ličnosti oko trojstva i na kraju sam obradio Kuranska gledišta o ovoj doktrini.

#### Poglavlje III

#### Trojstvo i njegova istinitost

##### 1. Oko citata o Doktrini Trojstva

- Riječ je Bog ( Jovan 1:1)
- U ime Oca i Sina i Svetoga Duha. (Mateja 28:19)
- Ko je vidio mene, vidio je Oca. (Jovan 14 : 8-9)
- Ja i Otac smo jedno. (Jovan 10-30)
- Ovo troje je jedno. (1 Jovan 5-7)
- Bog se prikaza u mesu.(1 Timitije 3-16)
- Bog sličan čovjeku. ( Knjiga postanja 1:26)
- Ja sam u Bogu. Bog je u meni. ( Jovan 14:11)
- Ja sam (Jovan 8:58)
- Bog Isus. ( Marko 16:19)
- Obožavanje Isusa. ( Mateja 28-17)
- Samorođeni sin. ( Jovan 1:14/ 3:16,18)
- Isus nije sa ovog svijeta ( Jovan 8:23)

Emanuel- Bog sa nama. (Isaija 7:14/Mateja 1:23)

Moj Bog i moje Božanstvo. (Jovan 20:27-28)

Po slici Božijoj. (2 Korićanima4:4)

2. Mišljenja poznatih ličnosti oko Doktrine Trojstva

3. Kuranska gledišta o ovoj Doktrini Trojstva

Trudio sam se da Doktrinu Trojstva prikažem iz Biblijskog gledišta i onog Kuranskog na korektan i argumentovan način, polazeći od toga da je prvo prikazem sa aspekta hrišćanstva a zatim sa aspekta Islama. Faktički, ova metoda nam i daje realni prikaz, kako sa istorijskog aspekta i hronologije predstavljanja ove doktrine, takođe i sa aspekta njihovog sučeljavanja, da bi na kraju izašle na vidjelo spletke, neistine koje su se desile i koje su učinjene prema hrišćanstvu tokom istorije.

### ***Zaključak***

Tokom izučavanja Doktrine Trojstva, otkrili smo bjelodano iz Biblijskih i Kuranskih tekstova kao i istorijskih činjenica u vezi sa tim, negaciju jedne ovakve doktrine. Uvidjeli smo veliki uticaj paganskih doktrina i njihovo stapanje sa takozvanim hrišćanstvom.

Razvoj vjere u trojstvo je impliciran iz više faktora. Prije svega, paganski uticaj je bio ogroman u prvim vijekovima hrišćanstva. Tlo u koje su uklesane hrišćanske doktrine bila je arena koja je sa svih strana snažno pod uticajem blasfemije paganstva. Kao što smo naveli u ovom radu, poznato je vrlo dobro, trojstvo u starim paganskim vjerama i njihov uticaj tokom formiranja hrišćanskih doktrina je bio neminovan. Takođe, da ne zaboravimo da je Egipatska Aleksandrija jedna od glavnih žarišta gdje je formirana hrišćanska doktrina. Isto tako, paganska vjerovanja o trodjelnim božanstvima bila su poznata i rimljanima i vaviloncima. I starogrčki filosofi su razvijali mistične ideje o trojstvu.

Saznali smo da je ova doktrina ozvaničena od Crkve u IV vijeku i istovremeno je postalo očito da ova doktrina nije bila dio Isusovog učenja niti njegovih sledbenika.

Tokom istraživanja koje smo po tom aspektu uradili izinjeli smo na vidjelo i izveli nauku da Doktrina Trojstvanije nije usklađena sa ljudskom logikom, niti je u skladu sa Isusovim učenjem, koji nije naređivao da se vjeruje u ovu doktrinu. Ove doktrine su uspostavljene mnogo poslije Isusa kao rezultat uticaja od strane paganskih vjerovanja. Ove dogme istovremeno pokazuju da je Biblija protokom vremena doživjela mnoge izmjene i da je hrišćanstvo dosta udaljeno od učenja i jasnog vjerovanja u jednog Boga, kao što nas je učio Isus.

Uporedo sa ovim političkim i teološkim razvojem na štetu jasnog monoteističkog vjerovanja, veliki uticaj u razvoj trojstva se nalazi i u činjenici da nije sačuvana jedna neizmjenjena forma svetih spisa. Zavjet i ostali spisi koji će kasnije biti vrednovani kao kanon Biblije, prošli su kroz nekoliko izmjena dok nijesu dobili današnju formu. Pronalaženje manuskripti iz ranih vjekova hrišćanstva omogućili su nam da saznamo na najbolji način kako su teološki uticale različite crkve i direktno radile na izmjenama Biblije sa ciljem da uspostave razne dogme koje Isus nije nikada ispovijedao.

U Bibliji postoje mnoge protivrječnosti, greške, dodaci, i druge stvari koje na neki način čitaoca dovode u situaciju da ne povjeruje da je Biblija Božija riječ. Ovo stavlja u ozbiljnu dilemu izrečenu tvrdnju da je Biblija nepromjenljiva i van svake sumnje Božija riječ. Ovo se može verifikovati argumentima iznijetim u ovom radu.

Ovo je i jedan od glavnih ciljeva poslanstva zadnjeg peygamera Muhameda s.a.s.v. od Allaha dž.š. da bi se jednom za sva vremena uspostavila jasna vjera u Jednog Jedinog Boga i da kao takva bude van uticaja paganskih vjerovanja. Da odvoji istinu od neistine. Ovo je postignuto putem očuvanja Kurana, Zadnje Objave koja je data čovječanstvu od Svemogućeg Boga. Čisti monoteizam, onako kako je objavljen i sačuvan U Kuranu ne ostavlja mjesta nikakvoj sumnji vezanoj za prirodu Boga.

Istinitost ove doktrine može vidjeti svaki čovjek sa zdravim razumom i logikom, i da se kloni neistine. Jer pravi put kojeg treba da se držimo je jasan i razlikuje se od krivog, kao što nam Allah dž.š. u Kuranu Časnom pominje: *“Nema prinude u vjeri, pravi put se veoma jasno razlikuje od krivog”* (Bekare 256) A drugoj strani poručujem: *„Zar sam postao vaš neprijatelj, govoreći vam istinu?”* (Galaćanima 4:16) jer *„ Oni su izmjenili Božiju istinu u laž i obožavali su i služili stvorenju umjesto Stvoritelju, koji je svet zauvijek”*. (Rimljani 1:16)

*Prevodio od Bosanskog jezika:*

*Xhemal Perović*



# Trinity - A Christian Mystery over Centuries

## Summary and conclusion of this book in English

### *Summary*

*"In the name of Father, the Son and the Holy Ghost"*, is the doctrine which Christianity offers to mankind. This is the essence, the basis of Christianity which, if you do not believe in it or do not submit yourself to it you cannot be a Christian. This doctrine is one of the most important teachings of the Church. It is considered as the corner stone of the Christian theology. Thus, the doctrine of trinity teaches that God exists in three persons (hypostases), each of them is a Deity, eternal, almighty, neither greater nor smaller than the other. This statement always has been confusing the reader, whether Christian or not, who after reading such a passage always asked: how can the Father be a god, the Son a god and also the Holy Ghost a god and still we do not have three gods but One!?

Scholars of Biblical theology over centuries endeavoured to give a pleasant answer to this and many similar questions which show the rational impossibility of such a doctrine. However, each attempt in this regard has resulted more confusion and rebellion.

In order to avoid issues regarding this doctrine, Christian theologians declared the Doctrine of Trinity as "Mystery". Cardinal John O'Conner states "we are aware that this is quite a deep mystery that we are unable to understand". Making this doctrine a mystery, along with inability to understand it, made it less important among modern Christians. Today, famous theologians and historians of the doctrines state that Doctrine of Trinity has lost its central position in Christianity.

The question arises: has ever the Doctrine of Trinity been understood by mankind throughout these 2000 years? Exactly due to the paradox that this doctrine shapes, Gunton in his book “*The Promise of the Trinity*” states: “In the West the Doctrine of Trinity is seen more and more within the eyes of criticism... for a long time it was treated as an issue and not as the essence of the Christian Gospel”. Accurately for this reason for Pope John Paul II (the Second) this doctrine will remain forever an “unresolved mystery of the three hypostatical deity”. Statements of Pope John Paul II prove sufficiently the invalidity of this hypothesis.

Due to the importance of this doctrine in Christianity and endeavours to understand it, and then to explain it to the others, I chose to study it, always showing the truth as it will be noticed during the elaboration of the topic, based on the Holy Qur’an, Bible, and clear rationalism; under critical thinking which often is the standard measurement for all mankind.

This work is separated into three chapters:

*First chapter* I have entitled “HISTORY OF TRINITY” where I basically talked about the Doctrine of Trinity in other religions, its history as a doctrine and its realism according to the Christian belief.

## Chapter I

### History of Trinity

#### The Doctrine of Trinity in other religions

Babylonian Trinity

Egyptian Trinity

Greek-Roman Trinity

Hindus-Indian Trinity

Palmyra Trinity

Samaritan Trinity

Hittites Trinity etc.



Christian Doctrine of Trinity

History of the Christian Doctrine of Trinity

Paul- the Architect of Christianity

History of Trinity in Council Nicaea

Development of Trinity in other councils, especially council of Constantinople (381 CE)

Considering Maryam/Mary as mother of God

Then *the second chapter* I entitled “BIBLICAL AND QURANIC VIEW OF THE DOCTRINE OF TRINITY” where I talked about the biblical and qur’anic outlook of this doctrine, mentioning all the consisting elements of this doctrine such as: the Father, the Son and the Holy Ghost (Spirit) elaborating each of them accordingly in accordance with the biblical and qur’anic verses.

## Chapter II

### Biblical and Qur’anic View of the Doctrine of Trinity

#### 1. The concept of God in the Bible and the Qur’an

1.1. Oneness and attributes of God in the Bible and the Qur’an

1.2 Difference between the Bible and the Qur’an regarding attributes of God

#### 2. Biblical and Qur’anic treatment of Jesus/ Isa a.s.

2.1. the Respect of Maryam (Mary)

2.2. the Humanness of Jesus

2.3. Is Jesus son of God?

2.4. Is Jesus God?

2.5. Difference between Jesus and God (Deity)

2.6. Jesus Prophet (Messenger) of God

2.7. Jesus sent only to one people

2.8. Miracles of Jesus

- 2.9. Isa presaged Muhammad's coming
- 2.10. Isa was not crucified
- 3. Biblical and Qur'anic Treatment of Holy Ghost (Spirit)
  - 3.1. the Concept of the Holy Ghost in the Bible
  - 3.2. the Holy Ghost between Orthodox and Catholics
  - 3.3. Hebrew outlook on the Holy Ghost
  - 3.4. the Concept of the Holy Ghost in the Qur'an
  - 3.5. Difference between the Father, the Son and the Holy Ghost (Spirit)

The *third and the last chapter* of this book I have entitled "TRINITY AND ITS VERACITY" where I looked over the verses that the Christians use to prove this doctrine. Then I discussed the opinions of different famous personalities about the Trinity and finally I brought the Qur'anic viewpoint about this doctrine.

## Chapter II

### Trinity and its Veracity

#### 1. About the verses of the Doctrine of Trinity

The Word was the Lord (John 1:1)

In the name of Father, the Son and the Holy Ghost (Mathew 28:29)

Who saw me, he has seen the Father (John 14:8-9)

I and the Lord are one (John 10:30)

These three are one (1 John 5:7)

The Lord appeared in flesh (1 Timothy 3:16)

The Lord like unto man (Genesis 1:26)

I am in the Lord and he is in me (John 14:11)

I am (John 8:58)

The Lord Jesus (Marc 16:19)

Jesus' Obedience (Mathew 28:17)

The Only Begotten Son (John 1:14, 3:16, 18)

Jesus is not from this world (John 8:23)

Emanuel- God is with us (Isaiah 7:14, Mathew 1:23)

Like-unto God (2 Corinthians 4:4)

2. Opinions of famous personalities about the Doctrine of Trinity

3. The Qur'anic viewpoints about the Doctrine of Trinity

I endeavoured to present the Doctrine of Trinity from the biblical and Qur'anic point of view authentically and proven. I presented the Christian view firstly followed by the Islamic one. This approach in fact points out the real and appropriate reflection, in the historical aspect of the chronology of the appearance of this doctrine as well as the confrontation, mistakes, and falsehood which was done to Christianity throughout the history.

### **Conclusion**

During this work on the Doctrine of Trinity, through biblical and Qur'anic verses and also historical facts related to this issue, we exposed clearly that there are many facts which deny this doctrine. Also we noticed the great impact of the pagan doctrines which were jointed into the so-called Christianity.

The development of the belief on trinity was influenced by several factors. Firstly the pagan reflections were enormous during the first centuries of Christianity. Then the land where the Christian doctrines were carved was a powerful area of the pagan mythologies. As we noted throughout this thesis the trinity was well known among ancient pagan faiths and the impact of these pagan faiths on Christianity was inevitable. Thus, pagan beliefs on three hypostasis deities were well known among Romans and Babylonians, and also the pagan Greek philosophers developed mystical ideas about trinity. Therefore, we should not neglect the fact that Alexandria, in Egypt, was one of the main seats where the Christian

doctrine was formed and as such it was highly influenced by the ideas of the Greek philosophers.

During this work we learnt that the Doctrine of Trinity was officialised by the Church only in the IVth century (CE) and it was not from the teachings of Jesus nor his disciples. During this research we got to know that the Doctrine of Trinity does not compile with the human logic, it is not in accordance with Jesus' teachings since he did not preach it neither asked his people to believe it. This doctrine was joined to Christianity long time after Jesus as a result of the pagan influence. This dogma also indicates that throughout ages the Bible has been changed and Christianity got far away from the real teachings of believing in One God Alone, as Jesus preached.

Beside these political and theological developments, in the disadvantage of the real monotheistic belief, the lack of the unchanged form of Holy Scriptures has a great impact on the development of trinity. The Gospels and other writings, which later were described as the Biblical Canon, went through different changes until they got the actual form that they have today. Recent finds of the early Christian manuscripts are the best fact on how the early theological influences of different churches worked directly on changing the Bible with the purpose of setting different dogmas, which, in fact, never were preached by Jesus.

There are a lot of contradictions, errors, additions, and different things which give to the reader the impression that Bible is not the word of God. This puts in the dilemma the claim which we were told that Bible is unchangeable word of God. This issue will be proven through this work.

So this was one of the reasons why the last Prophet, Muhammad (PBUH), was sent by Allah the almighty in order to reset finally the true monotheistic belief in One God Alone and as such to not be influenced by pagan beliefs. In order to separate the truth from the falsehood the Almighty God revealed the last revelation, the Holy Qur'an, to the mankind and prevented it from all the errors and contradictions. The real monotheism as it was revealed by God is saved in

the Holy Qur'an and as such it leaves no doubt to anybody about the nature of God.

The reality of this doctrine can be observed by every rational person and thus he/she can avoid the falsehood. Therefore, the right path that we should follow is very distinctive from the falsehood as Allah the Almighty states in the Holy Qur'an: *"there is no compulsion in faith; the right path is distinctive from the falsehood"* (Bakare, 256), whereas to the other side I would like to tell them: *"Did I become your enemy because I tell you the truth?"* (Galatasy 5: 16) because *"They changed the truth of God into a lie and worshiped and served the creature instead of Creator, who is blessed forever"* (Romans: 1: 25).

*Translated into English by:  
Mr. Sci. Driton Morina*



## Literatura e shfrytëzuar:

### Libra, enciklopedi, fjalorë:

#### Në gjuhën shqipe:

1. Kur'ani- Përkthim me komentim nga H. Sherif Ahmeti
2. Kurani i madhërisëm, përktheu prof. Hasan I. Nahi, Tiranë 2006, nga AIITC.
3. *Shpjegimi i Kuptimeve të Kur'anit të lartë në gjuhën shqipe*, Grup përkthyesish, Riad, 2000
4. *Bibla- Diodati i Ri*, përkthim 1991-94, Tiranë, 1999
5. *Shkrimet e Shenjta*, përkthim “Bota e re”, Romë, 2006
6. *Bibla*, përktheu dhe shtjelloi Dom Simon Filipaj, Ferizaj, 1994
7. *Bibla*, Shoqëria biblike, Tiranë, 2003
8. *Ungjilli sipas Barnabes*, përktheu Avdi Berisha, Prishtinë, 1998
9. Al Johani, Dr. Maneh Hammad, “*E vërteta rreth Jezusit*”, Tiranë, 1993
10. Abdalbaki, Muhamed Fuad, “*Klasifikimi tematik i ajeteve kur'anore*”, Shkup, 1995
11. Ajgyn, Abdurrahman, “*Profeti Islam në Ungjillin e Barnabeut*”, Konja, 1989
12. Abdullahu, Zija, “*Hyrje në studimin e feve*” (punim i pabotuar)
13. Baxhil, Hasan, “*Dialog ndërmyjet të krishterit dhe myslimanit*”, Prishtinë, 2001
14. Bucaille, Dr. Maurice, “*Bibla, Kur'ani dhe shkenca*”, Gjakovë
15. Brown, Dan, “*Kodi Da Vinçi*”, Tiranë, 2004

16. Brown, Mike, *“Përgjigjet për Dëshmitarët e Jehovës”*, Prishtinë, 1999
17. *Bazat e Biblës - Udhëzim Kapitujsh* (Shpalosja e gëzimit dhe paqes së Krishtianizmit të vërtetë), Botuar nga Christadelphian Bible Mission (CBM), England (pa vit botimi).
18. Çupi, Fatmir, *“Autoriteti dhe saktësia e shkrimit të shenjtë”*, Tiranë, 2003
19. Dawud, Abdul Ahad, *“Muhamedi në Bibël”*, Prishtinë, 1995
20. Dalliu, H. Hafiz Ibrahim, *“Ajka e kuptimeve të Kur’anit kerijmit”*, Tiranë, 2005
21. Didat, Ahmed, *“Krishti në islam”*, Mitrovicë, 1995
22. Didat, Ahmed, *“A është bibla fjalë e Zotit”*, Mitrovicë
23. Deedat, Ahmed, *“Kur’ani - Mrekullia e mrekullive”*, Podujevë (pa vit botimi)
24. El-Hindi, Rahmetullah, *“Trumfi i së vërtetës”*, Shkup, 1998
25. El-Havli, Dr. Muhamed Ali, *“Komperacioni mes katër ungjijve”*, Shkup, 2002
26. El Faruki, Ismail Raxhi, *“Tevhidi, implikimet e tij për mendimin dhe jetën”*, Prishtinë, 2006
27. Et-Terxhuman, Abdullah, *“Rruga e priftit në islam”*, Novi Pazar, 2006
28. Ehrman, Bart D., *“Të keqcitosh Jezusin - Si dhe përse u ndryshua Bibla”*, botoi qendra studimore fetare “Erasmus”,viti 2007.
29. *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1980
30. Filips, Ebu Emine Bilal, *“Feja e vërtetë e Zotit”*, Prishtinë, 2006
31. Grup Autorësh, *“Ti afrohemi Jehovahit”*, Romë, 2003
32. Grup Autorësh, *“Çfarë mëson vërtet Bibla?”*, Romë, 2005
33. Gjolaj, Don Nosh, *“Meditime për Trininë e Shenjtë”*, Prishtinë, 1999-2000
34. Hart, Majkël, *“100 Njerëz më me ndikim në histori”*, Shkup, 2000



35. Houssney, Dr. Georges, *“Perënditë paraislame të arabëve”*, Prishtinë, 2004
36. Hathout, Hassan, *“Leximi i mendjes së myslimanit”*, Tiranë, 2006
37. Hofmann, Dr. Murad, *“Islaim në mijëvjeçarin e tretë”*, Shkup, 2007
38. Ibrahim, Halil, *“Islami dhe krishterimi”*, Prishtinë, 2005
39. Ibën Kethir, Hafidh, *“Rrëfime për të dërguarit e Allahut”*, Prishtinë, 2005
40. Jasin, Muhamed Naim, *“Besimi, Bazat-Esenca-Negacioni”*, Prishtinë, 2000
41. Juniku, Nazim, *“Porositë hyjnore”*, Gjakovë, 1996
42. Kutub, Sejjid, *“Islami dhe paqja universale”*, Tetovë, 2005
43. Keldani, Benjamin, *“Muhamedi në Bibël”*, botuar nga Qendra Erasmus, 2004
44. Kukaj, Tahir, *“Besueshmëria e citateve kur’anore dhe atyre biblike”*, Prishtinë, 2005
45. Kairanvi, Rahmetullah, *“Ngadhënjimi i së vërtetës”*, Tiranë, 2003
46. Kutub, Muhammed, *“Bota në fokusin islam”*, Tiranë, 2006
47. McDowell, Josh dhe Don Stewart, *“Përgjigje & argumente”*, Albania, 2002
48. Miller, William, *“Besimet dhe ritet e Krishtera”*, England, 1991
49. Murtezai, Ekrem, *“Fjalori i feve”*, Prishtinë, 2000
50. Mutahhari, Dr. Murteda, *“Shkaqet e animit ndaj materializmit”*, Gjilan, 1997
51. Muharremi, Halit, *“Fjalori i teologjisë”*, Tiranë, 2006
52. Nesimi, Qani, *“Ortodoksizmi te shqiptarët”*, Tetovë, 2005
53. Nesimi, Qani, *“Dialogu obligim hyjnor”*, Shkup, 2005
54. Ndreca, Mikel, *“Fjalor fjalësh dhe shprehjesh të huaja”*, Prishtinë, 2000
55. Nikë Prela, *“Fjalori biblik”*, Ferizaj, 1994
56. Philips, Ebu Ameenah Bilal, *“Bazat e Tevhidit”*, Prishtinë
57. Presheva, Ekrem, *“Tregues i Kur’anit”*, Gjilan

58. Samed, Ulfe Azizus, *“Islami dhe Krishterimi”*, Prizren, 1992
59. Sinani, Ajni, *“Të tjerët për islamit”*, Prishtinë, 2005
60. Sarikçioglu, Ekrem, *“Historia e Feve – Prej fillimit deri sot”*, Shkup, 2007
61. Sejdiu, Driton, *“Enciklopedi, e ilustruar botërore dhe shqiptare (Almanak 2007)”*, Prishtinë, 2006
62. Tresmontant, Claude, *“Shën Pali”*, Prizren, 1999
63. Tërnavë, Naim, *“Islami, besimi i vërtetë dhe fetë e tjera- Akaidi 2”*, Prishtinë, 1998
64. Tolstoi, Leon Nikollaeviq, *“Tolstoi për Muhamedin (salallahu alejhi ves-sel-lem)”*, Shkup, 2006
65. Topbash, Osman Nuri, *“Vargu i profetëve- 3”*, Stamboll, 2004
66. Topaloglu, Prof. Dr. Bekir, *“Ekzistenca e Zotit”*, Prishtinë, 2002
67. Takvim 2003, Prishtinë, 2003
68. Takvim 2008, Prishtinë, 2008
69. Tërnavë, Naim, *“Pejgamberia, njeriu dhe përgjegjësia- Akaidi 3”*, Prishtinë, 1999

**Në gjuhën boshnjake:**

1. Belinger, Gerhard J., *“Veliki leksikon religija”*, Beograd, 2004
2. Cvitković, Dr. Ivan, *„Rječnik religijski pojmovna”*, Sarajevo, 2005
3. Cvitković, Dr. Ivan, *“Religije suvremenoga svijeta”*, Sarajevo, 2005
4. Grup Autorësh, *“Čovječanstvo u potrazi za Bogom”*, Brooklyn, New York, 1995
5. Gazali, Muhamed, *“Islam ili Kršćanstvo izazov vremena”*, Sarajevo, 2005
6. Harputli, Ishak Efendija, *“Nije mogao odgovoriti”*, Istanbul-Temmuz, 2006
7. Karahodžić, Mehmed, *ISA a.s. u knjigama sufija”*, Sarajevo, 2002

8. Marmarinta- Omar P. Mabaya, "*Bozija Jednoća: Konačno rješenje proturiječnosti trojstva*", Sarajevo, 2003
9. Pekaric, Hajrudin -Dino, "*Sljedbenici knjige*", Tuzla, 2003
10. „*Tefsir ibn Kesir*”, Skraćena izdanje (Izabrao najispravnije verzije Muhamed Nesib er-Rifa'i), Sarajevo, 2000

### Në gjuhën angleze:

1. *The Holy Bible*, King James Version, Michigan
2. Abdullah, Misha'al Ibn, "*What did Jesus really say?*" USA, 2001
3. Abdurrahman, Abuhuraira, "*The Bible or the Quran which one is the word of God?*" Malaysia, 2001
4. Abbott, Lyman, "*A Dictionary of Religious Knowledge*", 1875, (Harper & Brothers, Publishers, NY)
5. Achtemier, Paul J., "*Harper's Bible Dictionary*", San Francisco: Harper and Row, 1985
6. Buzzard, Anthony F. & Hunting, Charles F., "*The Doctrine of the Trinity - Christianity's Self-Inflicted Wound*", 1994 (pa vend botimi)
7. Buzzard, Anthony, "*Who is Jesus?*" (pa vit dhe vend botimi)
8. Bowman Jr., Robert M., "*Why you should believe in the Trinity*", 1989
9. Bernhard, "*A Short History of Christian Doctrine*", 1966, (Fortress Press, Philadelphia, PA)
10. Cave, M.A.C., "*Is the Trinity doctrine divinely inspired?*" - 1996
11. Charles Scribner's Sons, "*Encyclopaedia of Religion and Ethics*", vol. XI, New York, 1928
12. Dawud, Abdul Ahad, "*Muhamed in the Bible*", Kuala Lumpur, 1969
13. Deedat, Ahmed, "*Christ in Islam*", Al Ain- U.A.E.
14. Deedat, Ahmed, "*The Choice*", vol. II, New Delhi, 2001
15. Deedat, Ahmed, "*Combat Kit*", Durban, 1992

16. Doane, T.W., *"Bible Myths and Their Parallels in Other Religions"*, (pa vit dhe vend botimi)
17. *"Dictionary of New Testament Background"*, InterVarsity Press, Illinois, 2000
18. *Encyclopaedia of Byblical, Theological and Ecclesiastical Literature*, vëll. X, Harper&Brothers Publishers, New York, 1894
19. Elwell, Walter A., *"Evangelical Dictionary of Theology"*, Baker Book House, Grand Rapids, Michigan, 1984
20. Eliade, Mircea, *"The Encyclopedia of Religion"*, 1987, Vol. 15, (Macmillan Publishing Company, NY)
21. Elsaie, Dr. Adel, *"Please revise the Bible, Again"*, pa vend dhe vit botimi
22. Enciklopedia Britanica 2007, DVD
23. Ghounem, Muhamed, *"200 + ways the Quran corrects the Bible"*, Brooklyn NY, 2003
24. Gunton, *"The Promise of the Trinity"*, (pa vit dhe vend botimi)
25. Hugh, H., Stannus, *"A History of the Doctrine of the Trinity in the Early Church"*, London, 1882, Christian Life Publishing Co. 281 Strand London
26. Hislop, Alexander, *"The Two Babylons"*, 1916 (pa vend botimi)
27. Lamson, Alvan, *"The Church of the First Three Centuries"*, 1869 (Horace B. Fuller, Boston, MA)
28. Mckenzie, John L., *"Dictionary of the Bible"*, 1995
29. Microsoft Encarta Premium 2009 (DVD)
30. Norton, Andrews, *"A Statement of Reasons"*, 1872, Fifth edition, (American Unitarian Association, Boston, MA)
31. *"New Catholic Encyclopedia"*, 1967, vëll. XIV

32. Paine, Levi Leonard, *"A Critical History of the Evolution of Trinitarianism"*, 1900 (Houghton, Mifflin, and Company, Boston and New York; The Riverside Press, Cambridge)
33. Rath, Jeff, *"An Appeal to Trinitarian Christians"*, (pa vend botimi), 1997
34. Richardson, Alan, *"A Dictionary of Christian Theology"*, SCM Press LTD, 1969
35. Thomson, Ahmad & Ata'ur-Rahim, Muhammad, *"For Christ's Sake"*, London, 1996
36. The Harper Collins, *"Encyclopedia of Catholicism"*, 1995
37. *"The Jewish Encyclopedia"*, vëll. XII, KTAV Publishing House
38. The Harper Collins, *"Encyclopaedia of Catholicism"*, 1995 (pa vend botimi)
39. Wierwille, Victor Paul, *"Jesus Christ is not God"*, Ohio, 1985
40. W. R. Halliday, *"The Pagan Background of Early Christianity"*, Liverpool: University of Liverpool, 1925
41. Weigall, Arthur, *"The Paganism in Our Christianity"*, 1928, (G. P. Putnam's Sons, NY, London)

#### Në gjuhën arabe:

1. Ibn Kethir, Ismail, *"Tefisirul Kur'anil Adhim"*, Bejrut, 1969
2. Ibn Tejmijje, *"El-xhevabus-sahihu limen bed-dele dinel mesih"*, pjesa e parë (pa vend dhe vit botimi)
3. Enciklopedia elektronike në CD e nëntë koleksioneve të haditheve, versioni II.

#### Në gjuhë të tjera:

1. Lachatre, Maurice, *"Nouveau Dictionnaire Universel"*, Vëll. 1, Paris 1467
2. Hadot, P., *"La fine del paganesimo - Le Religioni del mondo classico"*, (nën kujdesin e H.-C. Puech), Roma-Bari 1987

## Libërtha, revista:

1. Libërth *"A duhet të besosh në trinitet?"*, Romë, 1996
2. Broshurë *"Cili është qëllimi i jetës?"*, Romë, 2000
3. Revista *"Zgjobuni"*, maj 2006
4. Revista *"Zgjobuni"*, 8 maj 2005
5. Revista *"Zgjobuni"*, 8 shtator 2005
6. Revista *"Zgjobuni"*, shkurt 2006
7. Revista *"Zgjobuni"*, 22 prill 2005
8. Revista *"Zgjobuni"*, korrik 2006
9. Revista *"Kulla e rojës"*, 15 dhjetor 2004, Romë
10. Revista *"Kulla e rojës"*, 15 maj 2004, Romë
11. Revista *"Kulla e rojës"*, 15 mars 1994, Romë
12. Broshurë *"Si mund ta gjejn rrugën për në parajsë"*, Romë, 1993
13. Revista *"Argumenti"*, shkurt 2006, nr. 2 (47), Prishtinë
14. Revista *"Dituria Islame"*, viti XIX, nr. 178, maj 2005, Prishtinë

## Web faqe interneti:

[www.zeriislam.com](http://www.zeriislam.com)  
[www.islamidhekrishterimi.com](http://www.islamidhekrishterimi.com)  
[www.bibladheKur'ani.com](http://www.bibladheKur'ani.com)  
[www.geocities.com/bibladheKur'ani](http://www.geocities.com/bibladheKur'ani)  
[www.geocities.com/alcislam](http://www.geocities.com/alcislam)  
[www.erasmusi.org](http://www.erasmusi.org)  
[www.mesohu.net](http://www.mesohu.net)  
[www.usislam.org](http://www.usislam.org)  
[www.montana.com](http://www.montana.com)

# Përmbajtja

Fjala e recensentit.....	7
Parathënie .....	11

## Kapitulli I

Doktrina e trinitetit dhe historia e saj.....	19
1. Doktrina e trinitetit te fetë e tjera .....	19
Vështro dhe krahaso trinitetin nëpërmjet fotove. ....	29
2. Doktrina e trinitetit te të krishterët.....	31
3. Historia e doktrinës së trinitetit në krishterizëm .....	33
4. Pali - arkitekti i krishterizmit .....	37
5. Historia e trinitetit në Koncilin e Nikesë .....	46
6. Zhvillimi i trinitetit në koncilë të tjerë, sidomos ai i Kostandinopojës (v. 381)..	51
7. Konsiderimi i Marisë si “Nëna e Zotit” .....	58

## Kapitulli II

Këndvështrimi biblik dhe kur'anor ndaj doktrinës së trinitetit .....	71
1. Koncepti i Zotit në Bibël dhe në Kur'an .....	71
1.1 Njeshmëria dhe cilësitë e Zotit në Bibël dhe në Kur'an .....	72
1.2. Dallimet ndërmjet Biblës dhe Kur'anit lidhur me cilësitë e Zotit .....	78
2. Trajtimi biblik dhe kur'anor ndaj Jezusit/ Isait a.s. ....	87
2.1. Nderimi i Merjemes / Marisë.....	88
2.2. Njerëzorja e Jezusit / Isait a. s.....	91
2.3. A është Jezusi/ Isai a. s. bir i Zotit? .....	98
2.4. A është Jezusi/ Isai a.s. Zot?.....	103
2.5. Dallimet ndërmjet Jezusit dhe Perëndisë .....	113
2.6. Jezusi / Isai a. s. profet (pejgamber) dhe i dërguar i Zotit.....	119
2.7. Jezusi / Isai a.s. i dërguar vetëm te një popull .....	124
2.8. Mrekullitë e Jezusit / Isait a.s.....	127
2.9. Jezusi/ Isai a.s. paralajmëroi ardhjen e Muhamedit s.a.v.s.....	137
2.10. Jezusi/ Isai a.s. nuk u kryqëzua .....	139
3. Trajtimi biblik dhe kur'anor ndaj shpirtit të shenjtë .....	141
3.1. Koncepti i shpirtit të shenjtë në Bibël.....	142
3.2. Shpirti i shenjtë mes ortodoksëve dhe katolikëve .....	149
3.3. Këndvështrimi hebraik mbi shpirtin e shenjtë .....	150
3.4. Koncepti i shpirtit të shenjtë në Kur'an .....	151
3.5. Dallimet ndërmjet Atit, të birit dhe shpirtit të shenjtë.....	155

Kapitulli I

Triniteti dhe vërtetësia e tij .....	165
1. Rreth citeve të doktrinës së trinitetit .....	165
Fjala ishte Perëndi. (Gjoni 1:1) .....	165
Në emër të Atit, e të Birit, e të Frymës së Shenjtë. (Mateu 28:19).....	169
Kush më ka parë mua, ka parë Atin. (Gjoni 14:8-9).....	170
Unë dhe Ati jemi një. (Gjoni 10:30) .....	172
Këta të tre janë një. (1 Gjoni 5:7).....	174
Perëndia u shfaq në mish. (1 Timoteu 3:16).....	176
Perëndia i ngjashëm me njeriun. (Zanafilla 1:26) .....	177
Unë jam në Atin, Ati është në mua. (Gjoni 14:11).....	178
Unë jam. (Gjoni 8:58).....	179
Zoti Jezus. (Marku 16:19) .....	180
Adhurimi i Jezusit. (Mateu 28:17).....	182
Biri i vetëmlindur. (Gjoni 1:14/ 3:16,18).....	183
Jezusi nuk është prej kësaj bote. (Gjoni 8:23).....	184
Emanuel - Zoti me ne. (Isaia 7:14 / Mateu 1:23) .....	184
Zoti im dhe Perëndia im. (Gjoni 20:27-28).....	187
Shëmbëllimi i Perëndisë. (2 Korintasve 4:4) .....	189
2. Mendime të personaliteteve të njohura rreth doktrinës së trinitetit .....	191
3. Pikëpamjet kur'anore rreth doktrinës së trinitetit.....	200
Përfundim.....	211
Trojstvo - Vjekovna Misterija Hrišćanstva .....	215
Sadržaj i zaključci ove knjige na bosanskom jeziku .....	215
Sadržaj .....	215
Zaključak.....	219
Trinity - A Christian Mystery over Centuries .....	223
Summary and conclusion of this book in English.....	223
Summary .....	223
Conclusion .....	227
Literatura e shfrytëzuar:.....	231
Libra, enciklopedi, fjalorë:.....	231
Në gjuhën shqipe: .....	231
Në gjuhën boshnjake:.....	234
Në gjuhën angleze:.....	235
Në gjuhën arabe:.....	237
Libërtha, revista:.....	238
Web faqe interneti: .....	238
Përmbajtja .....	239



